


Fuqia e besimit Përsosmëri e shpirtit



Ismet U. Shehibrahimoviq



0 [FUQIA E BESIMIT - PËRSOSMËRI E SHPIRTIT]

FUQIA E BESIMIT – PËRSOSMËRI E SHPIRTIT

Ismet U. Shehbrahimoviq

© LOGOS - A
2 0 0 8



S H K U P
PRISHTINË
T I R A N Ë

Ismet U. Shehibrahimoviq

FUQIA E BESIMIT –
PËRSOSMËRI E SHPIRTIT

Boton: Logos-A

Biblioteka: Mendimi Islam

Për botuesin: Adnan Ismaili

Kryeredaktor: Husamedin Abazi

Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim

Redaktor gjuhësor: Fatmire Ajdini - Hoxha

Redaktor artistik & disenji: Edi Agagjyshi

Redaktor teknik: Afrim Gashi

Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup

Shtypi: Focus - Shkup

Copyright©Logos-A, 2008

Shënimi i CIP katalogut i këtij libri gjendet në

Bibliotekën Kombëtare Universitare

ISBN 9989-58-272-6

www.logos-a.com.mk

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.

*Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit
apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.*

*Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi
pa lejen paraprake të Logos-A.*

FUQIA E BESIMIT – PËRSOSMËRI E SHPIRTIT

Ismet U. Shehibrahimoviq

E PËRKTHEU NGA BOSHNJAKISHTJA:

Mehmet Halimi

TITULLI I ORIGJINALIT:

Snagom Vjere do savršanstva duše

Starješinstvo Islamske zajednice

Sarajevo, 1988



Përmbajtja:

Parathënie 7

Në vend të parathënies 9

Drita e All-Llahut 13

Nëpër vështirësi drejt dritës së shpirtit 22

Qëllimi më i lartë 27

Duaj fuqishëm 30

Me besim në mbretërinë e shpirtit 33

Rruga e drejtë është treguar 39

Veprat e mira 45

O njeri, bëhu i karaktershëm! 52

Qëndresa 61

Qëndresa në parime 65

Të keqes duhet thënë: jo! 70

Zemra heroike 73

Me vullnet të fortë drejt suksesit 76

Frenoje zemërimin tënd 83

Porosia për durim (sabri) 87

Ejjubi a.s. i durueshëm 95

Puna - formë e ibadetit 105

Fshatari i vyeshëm 115

Vlera e kohës 121

- Saktësia është virtyt i të mençurve* 126
Trimave u ndihmon fati 130
Drita e virtytit 134
Njeriu është vepër madhështore e All-llahut xh.sh. 141
*All-llahu xh.sh. të mëshirshëmve
u dhuron mëshirën e vet* 149
Fjalëkeqi – fatkeqi 156
Muxhahidinët jovetjakë 162
All-llahu xh.sh. nuk i do mendjemëdhenjtë 168
Mos përqesh, mos fyej! 174
Zilia dhe shpirtligësia hapin dyert e xhehennemit 180
Zemra e mirëfilltë besimtare 183
Veprimi i drejtë 189
All-llahu xh.sh. është e vërteta 194
Sinqeriteti është obligim 199
Premtimi është borxh 203
Nuk duhet betuar pa nevojë 207
Paratë harxhoi me mend e me vend 210
Për çdo punë duhet të këshillohemi 216
Largohu nga i paditur 220
Fjala e mirë – veprim i mirë 226
Vetëdukimi 236
Rinia kalon 248

E lus All-llahun të më mbrojë nga shejtani i mallkuar,

*Në emër të All-llahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!*

“Falënderimi i takon vetëm All-allahut, Zotit të botëve! Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit!

Sunduesit në Ditën e Gjykimit! Vetëm Ty të adhuromë dhe vetëm te Ti kërkojmë ndihmë!

Udhëzona për në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!”

(Kur'an, El-Fatiha)

Parathënie

Në çdo njeri është mbjellë thellë përpjekje për realizimin e vlerave gjithënjëzore. Islami, për t'i realizuar këto synime njerëzore, në mënyrë të natyrshme dëshmoi rrugën e qartë drejtë arritjes së virtyteve më të bukura, duke ndriçuar qëllimin që gjendet në krye të kësaj rruge – përsosmërinë e shpirtit.

Dhuratë për përsosmërinë e shpirtit është paqja dhe lumturia absolute në të dy botët. Për të arritur sukses në këtë rrugë të shenjtë – kërkohet besim, dashuri, vullnet dhe përpjekje. Shumë njerëz ndalen, devijojnë, kurse të lodhurit heqin dorë që në fillim, mirëpo shumë prej tyre ecin me guxim drejt qëllimit të tyre.

Në faqet vijuese do të flitet për rrugën e mundimshme të shpitrave njerëzore nëpër kopshtet e virtyteve dhe moralet e veseve njerëzore në rrugën për qëllimin më të lartë – përsosmërinë e shpirtit. Këto janë nxitje modeste për njerëzit e rinj e të fuqishëm dhe për njerëzit e lodhur që të qëndrojnë në rrugë të mbarrë dhe që virtytet e tyre të lindura t'i ngrenë në vlera të larta, ashtu që dashuria, mëshira, bujaria dhe virtytet e shumta të tyre, me ngrohtësinë e shpirtit të vet njerëzor, të shndrisin si rreze dielli.

Është e njohur e vërteta: etja e njeriut për virtyte është e pashuar, e për njerëzit vullnetmirë e qëllimmirë këto virtyte kurrë nuk janë të mjaftueshme.

Shkrimtari – lexuesit

Në vend të parathënies

Çdo tekst, me rastin e përkthimit, humb sadopak vlerën e origjinalit të mirëfilltë. Gjithmonë ekziston mundësia që gjuha, nga e cila përkthejmë, me sistemin e vet morfologjik, sintaksor e leksikor, madje edhe me shprehjet frazeologjike, të ushtrojë ndikim të madh te përkthyesi dhe në gjuhën në të cilën përkthehet vepra në fjalë.

Sado që jemi përpjekur të punojmë me themel, me perkushtim e me vetëmohim, duke synuar që të arrijmë shkallën më të lartë të përsosmërisë së përkthimit, jemi të vetëdijsëm se këtë sukses nuk kemi mundur ta arrijmë në këtë përkthim.

Ekziston mundësia që, nën ndikimin e përkthimeve, të lëndohet, të sakatohet e të gjymtohet gjuha amtare, duke e ngarkuar atë me shprehje e konstrukte të huaja, me kalke, të cilat janë si “mish” i huaj (tumor) në trupin e gjuhës shqipe. Prandaj, duke qenë i vetëdijsëm për këtë mundësi, unë jam përpjekur me të gjitha aftësitë e mia profesionale që, gjatë përkthimit, ta ruaj origjinalitetin, natyrën dhe shijen e gjuhës shqipe; duke synuar që veprën origjinale të autorit Ismet U. Shehibrahimoviq, nga aspekti i përmbajtjes së saj, në gjuhën shqipe t’ua prezentoj lexuesve të nderuar sa më besnikërisht.

Mendimi paraqet origjinalin, ndërsa fjala paraqet modelin e origjinalit, do të thotë shprehjen e mendi-

mit. Fjala është pasqyrë e shpirtit dhe e zemrës, ajo është shprehje e mendimeve, e dëshirave dhe e synimeve të njeriut. Ajo është barometër i gjendjes psikike të individit. Prandaj, poeti, shkrimtari apo shkencëtari, duhet të jenë mjeshtër të përsosur të fjalës, sepse “nuk ka mjeshtëri më të rëndë sesa përsosmëria e fjalëve” (M.Gorki). Nëse, shkrimtari, mendimit, idesë ose ndjenjës së vet, që flenë si origjinale në “unin” e tij, u gjen fjalë të qëlluara si modele shprehëse të këtyre origjinaleve, atëherë do të arrijë shkallën më të lartë të besnikërisë, duke i dhënë vulën autentike të originalitetit njerëzor.

E në këtë rast, nëse vepra “Snagom vjere do sovrenstva due” e autorit në fjalë, e shkruar në boshnjakishte, konsiderohet origjinal, kurse “Fuqia e besimit – përsosmëri e shpirtit”, e përkthyer në gjuhën shqipe, si model i saj, varet edhe nga shija e lexuesit tonë të nderuar se sa ia kemi arritur ta prezentojmë besnikërisht në gjuhën tonë amtare.

Duke u përpjekur që të mos bëhemi rob i fjalës, por zotërues të saj, të mos bëjmë përkthim tekstual e të fjalëpërfjalshëm, sepse qëllimi ynë ka qenë që të përkthejmë mendimet dhe përmbajtjen, e jo fjalët, përkthimin e kemi bërë me mjete shprehëse origjinale të shqipes.

Kur kemi pasur të bëjmë me sinonime, jemi përpjekur të zgjedhim fjalën sinonimike më të qëlluar, më të fuqishme, që shpreh mendimin në mënyrë më origjinale e më besnike. Mirëpo, shpeshherë kemi ndjekur edhe parimin që ka ndjekur edhe autori. Për shembull, krahas emrit All-llah-u, kemi përdorur

edhe emrin Zot-i. Ndërkaq, në disa raste, duke menduar se kultura islame dhe Islami në përgjithësi, te të gjithë popujt e ndryshëm të botës, duhet të ketë terminologjinë e vet origjinale, me ngjyrë dhe kolorit të veçantë, përkundër korresponduesve sinonimikë, për shembull: *xhennet-i=parajs-i*; *xhehennem-i = ferr-i*; *pejgamber-i = i dërguari, profet-i*, në mënyrë standarde kemi përdorur fjalët: *xhennet*, *xhehennem*, ndërsa për *pejgamber* kemi përdorur më rrallë edhe *profet* dhe *i dërguar*. Kurse nga ana tjetër kemi përdorur *engjell* e *djall* në vend të: *melek* e *shejtan*, duke menduar se te lexuesit e arsimuar janë ngulitur trajtat e shqipes edhe në jetën e përditshme.

Vepra në fjalë ka një vlerë polivalente, sepse autori ka marrë shembuj nga të gjitha fushat shkencore dhe nga të gjitha aspektet e jetës: nga historia e fesë islame e historia e feve të tjera në përgjithësi, nga historia e fisit njerëzor, letërsia arabe e botërore, filozofia, psikologjia e sociologjia, nga biologjia e mjekësia, nga strategjia ushtarake, duke sjellë shembuj konkretë për qëllimin dhe synimin e njeriut që, me anë të fuqisë së besimit dhe të vullnetit, të vendosmërisë e të përpjekjeve të vazhdueshme të arrijë përsosmërinë e shpirtit. Me një fjalë, të arrijë përsosmërinë e kulturës dhe mirësjelljes njerëzore të individit në shoqëri. Kjo vepër në radhë të parë u është dedikuar të rinjve, brezit në formim e sipër, e shtruar në formë pyetjesh e përgjigjesh, në formë shembujsh konkretë prej të cilëve dalin këshillat, detyrat dhe obligimet konkrete si anëtarë të bashkësisë së fesë islame dhe anëtarë të shoqërisë njerëzore në përgjithësi. Shembujt janë

marrë, përveç nga historia e fesë islame edhe nga historia e njerëzimit në përgjithësi, duke ia shtuar vlerën shkencore veprës në fjalë. Prandaj mund të themi se kjo vepër jo vetëm që zgjeron horizontin e dijes dhe të kulturës, por edhe udhëzon se si të ndërtohet e të formohet personaliteti i përsosur i një të riu.

Vepra ka një vlerë të madhe fetaro-shkencore dhe edukative. Mirëpo sa kemi arritur ta artikullojmë e ta shqipërojmë në gjuhën tonë amtare, le ta thonë lexuesit tanë të nderuar. E dimë se, përkundër dëshirës, vullnetit e përpjekjeve dhe punës së mundimshme, nuk besojmë se kemi arritur të ofrojmë ndonjë punë të përkryer. Sepse në shoqëri asgjë nuk mund të ketë saktësi absolute, ndaj as puna jonë në përkthimin e këtij teksti. Asnjë punë nuk mund të jetë pa lëshime e pa gabime, asgjë nuk mund të jetë e përkryer. *I saktë, i qartë, i pagabuar dhe i përkryer mund të jetë vetëm All-llahu xh.sh.*, prandaj kërkojmë falje për lëshimet dhe gabimet tona të mundshme gjatë këtij përkthimi.

Vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet qëllimmira të lexuesve që shpiejnë në drejtim të përsosmërisë së përkthimit të veprës në fjalë, kurdoherë i mirëpresim dhe jemi mirënjohës për to.

Duke i falënderuar përzemërsisht dhe vëllazërisht do të përpiqemi që vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e lexuesve t'i marrim parasysht dhe t'i evitojmë në ndonjë ribotim eventual në të ardhmen.

Përkthyesi

Drita e All-Llahut

Djalosh i dashur, vajzë e dashur, njeri i dashur, ty që beson, ty po të flas.

Gjendesh në botën, e cila të rrethon me mrekullitë e veta të nduarduarta. Në çdo hap ndeshesh me jetën që lind, jeton dhe shuhet. Vdekja, dëshmitar memec i mrekullive, për çdo ditë, në të gjitha format e mundshme afër ose larg kalon pranë teje. Sikur do ta tërheqë vërejtjen për seriozitetin e të gjitha ngjarjeve që ndodhin.

Të ndalet fryma para qenieve të imëta, që i zbulon me mikroskop, të çudit fluturimi i shpendëve, të mahnit puna e palodhshme dhe frytdhënëse e bletës. Nuk ke mjaft fjalë që ta shprehësh çudinë tënde para ndërlikueshmërisë së trurit ose lëndës së pashpjegueshme të syrit të njeriut. Natën përsiat për hapësirat e paskajshme qiellore, kur në qiellin e kthjellët para teje shfaqen yjet e panumërta. Mediton për trupat e shumë qiellorë, të cilët, në harmoni të habitshme misterioze lundrojnë në mënyrë të pagabueshme e të saktë nëpër gjithësi. Sigurisht përpiqesh të thellohesh në hapësira kohore, në hapësira të gjithësisë dhe të gjithë asaj, që gjendet pas tyre. Me siguri do të pyesësh: ç'është koha? Prej kur dhe deri kur e gjithë kjo, e tërë kjo jetë që na rrethon? Pyet prej nga vjen ajo dhe ku shkon. Mundohesh të hysh në qenien dhe në kuptimin e paskajshmërisë.

Mirëpo, ndalesh, ndalesh ashtu siç janë ndalur me intelektin e vet mendor edhe shumë të tjerë para teje. Ndalesh ashtu siç do të ndalen edhe shumë të tjerë në të ardhmen. Intelekti njerëzor është ndalur para perdes, që nuk mund të kalohet. Pas saj qëndron fshehtësia, muri i përjetshëm memec, heshtja e vazhdueshme.

Me siguri e përjeton vetminë, braktisjen, ndoshta humbjen në padituri e pashtegdalje e në fshehtësitë e pashpjegueshme. Ndoshta të kaplon tmerri në pasigurinë e jetës, para vdekjes së pudritshme dhe pranë varrit të pashmangshëm që si të gjithë njerëzit e tjerë të pret edhe ty...

Megjithatë, duhet ta kesh të ditur, ta kesh të qartë se: askush nuk është i lënë pas dore, askush nuk është i vetmuar, askush nuk është i humbur...

Në të kaluarën e lashtë, shumë të lashtë, që nga koha e njeriut të parë, Ademit a.s., dhe gjatë tërë historisë botërore, i Mëshirshmi All-llah xh.sh., Krijuesi i gjithçkasë në mirësinë e Tij të pakufishme, ia dhuroi fisit njerëzor Porosinë e Vet të Madhe, Mësimin e Madh, në të cilin shpalli fshehtësinë dhe qëllimin e jetës, rrugën e shpëtimit e të lumturisë së amshueshme.

Shpallja e Mësimin zbriti me anë të një vargu njerëzish të zgjedhur e të ndershëm, të dërguarit e Zotit deri te pejgamberi i fundit, Muhammedi a.s. Ai e soli Kur'anin, i cili, si drita e All-llahut, do ta ndriçojë rrugën e fisit njerëzor deri në mbarimin e botës.

Ky Lajm i Madh u shpall në Mekke, në Arabi, në vendin e shkretëtirës misterioze, në shekullin VII sipas Isait a.s. Në atë kohë, në Arabi sundonin pasa-

nikët e korruptuar, skllavopronarët, tiranët mendjemëdhenj e fodullë. Ata jetonin në mirëqenie e bollëk, ndërsa pjesa dërmuese e popullit vuante në varfëri të madhe. Amoraliteti, orgjitë dhe dehja e marë, ishin bazë e jetës së tyre. Atyre u shërbenin robërit dhe robëreshat, të denigruar në pozitën e shtazëve të dëgjueshme. Paraja zotëronte shpirtin dhe trupin e tij. Ari ishte bërë objekt i adhuruar dhe e vetmja vlerë e njerëzve. Gënjeshtër, mashtrimi, vjedhja, intrigat, shpifjet, korrupsioni – mbretëron në atë shoqëri të sëmurë. Mjerimi, uria dhe sëmundjet ngjitëse e shkatërronin shtresën e varfër. Foshnjat e posalindura të gjinisë femërore varroseshin të gjalla. Çdo gjë njerëzore, çdo gjë fisnike, që e stolis njeriun si qenie me pozitë të veçantë në botë, ishte pothuaj krejtësisht e mbuluar me velin e harresës. Banorët e Arabisë kishin rënë në shkallën më të ulët të dinjitetit njerzor. Idhujt e ndërtuar nga gurët sundonin shpirtrat e idhujtarëve. Retë e errëta dhe të zymta valonin mbi horizontet e përpjekjeve të mira njerëzore, virtyteve dhe shtytjeve fisnike të njerëzve. Në këto kohë të liga e në këto kushte të rënda, u lind në Mekke Muhammedi, i biri i Abdull-llahut, nga familja e Hashimitëve të fisit Kurejsh. Nga ky det të metash e të këqijash. Ai u rrit e u zhvillua, si një rreze e rrallë drite. Përkundër fuqive të errëta dominuese, Muhammedi fisnik, jetonte modest, i mirë, guximtar, i urtë dhe i dashur. Për tiparet e karakterit të tij e quanin Emin, që do të thotë Besnik, i Besuar, i Ndershëm. Po ashtu Ai u martua me një grua të mirë e fisnike, me Hadixhenë e ndershme.

Kur po u afrohej të dyzetave Muhammedi a.s. filloi të jetonte në vetmi, në shpellën e kodrinës Hira, afër Mekkes.

Muhammedin a.s. e mundonte e keqja që zotëronte në Mekke dhe në tërë Arabinë. E brengoste shpirtligësia dhe korrupsioni që mbretëronin gjithkund. Ai, në kodrinën Hira, në qetësinë e shpellës, në vetminë e plotë, gjente prehjen e vet. Me orë të tëra sodiste horizontet e gjera, kaltrinën e qiellit gjatë ditës dhe shkëlqimin e yjeve në errësirën e natës. Thellohej në shpirtin e natyrës nëpërmjet barit e luleve, nëpërmjet ecjes së thneglave, duke e soditur merimangën që endte pëlhurën e rrjetës së saj, duke e soditur zogun në fluturim. Muhammedi a.s. filloi gradalisht t'i afrohej së vërtetës, të cilën ende nuk e njihte dhe të cilën ende nuk mund ta kuptonte. Shpirti i Tij i madh dhe fisnik përgatitej që të pranonte Njohuri të Gjera, Dije të Sigurt, Zbulimin e perdes nga Fshehtësia e Madhe. Kjo ishte dëshira e All-llahut xh.sh.

Dhe një natë, në vigjilje të ditës së njëzet e shtatë të muajit Ramazan, para Muhammedit a.s., që meditonte i thelluar në mendime të thella, përnjëherë vetoi drita, u shndrit shpella... Muhammedi a.s. u dridh, çoi duart që t'i mbulonte sytë. Drita u shndërrua në figurë.

Muhammedi a.s. i dëgjoji qartë fjalët: "O Muhammed, i biri i Abdull-llahut! Unë jam meleku Xhibril, po të sjell nga All-llahu, Zoti i Gjithësisë, Lajmin e Gëzueshëm se je zgjedhur Pejgamber i All-llahut".

Engjëlli pastaj i tregoi Muhammedit a.s. se si duhet të marrë abdest. Pastaj e thirri të mësojë, por kur Muhammedi a.s. u përgjigj se nuk di, Xhibrili e përsë-

riti thirrjen, e Muhammedi u përgjigj përsëri se nuk di. Kjo u përsërit tri herë. Pastaj Xhibrili filloi të flasë:

*“Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit,
Mëshirëbërësit!*

Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë).

Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me penë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.”

*(Kur’ani, 96:1-5)**

Drita e Xhibrilit filloi të shuhet ngadalë, kurse figura zhdukej lehtë e qetë. Muhammedi a.s. e kapluan dridhje e ethe të çuditshme dhe shpejtoi nga shpella në shtëpi, që Lajmin e Madh e shqetësues ta ndante me gruan besnike Hadixhen. Hadixheja njëherë u bren-gos shumë kur e pa bashkëshortin e saj të shqetësuar dhe të mbushur frymë. Mirëpo, kur Muhammedi a.s. i tregoi se ç’kishte parë dhe ç’kishte dëgjuar, Hadixheja u gëzua tepër, e kënaqur nga mëshira e madhe që e kishte ndriçuar Muhammedin a.s. e mirë dhe fisnik. Ajo nuk dyshoi asnjë fije në vërtetësinë e Lajmit të Madh. Hadixheja e dinte se ç’zemër të madhe e të mrekullueshme kishte Muhammedi a.s. dhe se ç’virtyte të shkëlqyeshme e stolisnin atë. Muhammedi a.s. me të vërtetë i kishte të gjitha cilësitë që dhurohej me emrin Pejgamber. Mu për këtë, Hadixheja e përgëzoi Muhammedin a.s.: “Pasha atë Zot, në pushtetin e të cilit është jeta ime, unë jam plotësisht e bindur se Ti

* Ajetet Kur’anore, janë marrë prej Kur’anit të përkthyer nga H.Sherif Ahmeti

me të vërtetë ke fituar Shpalljen dhe je bërë peygamber i Zotit". Dhe kështu, Muhammedi a.s. në Hadi-xhenë gjeti ithtarin e parë besnik, muslimanen e parë të periudhës së re.

Ngjarja në shpellën Hira e kishte pushtuar plotësisht Muhammedin a.s., ndaj Ai ishte i ekzaltuar nga ajo flakë.

"Në emër të All-llahut mëso... Në emër të All-llahut mëso... tingëllonte ky zë në veshët e Muhammedit a.s. Fjala e Zotit e kishte pushtuar tërë qenien e Tij. Muhammedi a.s. jetën e vet ia kushtoi misionit të shenjtë. Lajmin e Madh, Lajmin e Gëzueshëm, në zemrën e tij besnike e pranoi me qëllim fisnik që t'ia shpallë fisit njerëzor. Fjala dhe porosia e All-llahut nga zemra e Muhammedit a.s. filloi të kalonte në zemrat e njerëzve të mirë: të Aliut të ndershëm, të Ebu Bekrit të mirë, të Bilallit fisnik... Besimi në All-llahun si dritë e mrekullueshme, filloi të zhदारariste errësirën e idhujtarisë. Islami filloi të përhapej, por në mënyrë sekrete, fshehurazi, pothuaj në formë pëshpëritjeje. Me ditë e net të tëra vijimisht, me javë e muaj pandërprerë transmetohej Porosia e Madhe nëpër katakombe, nëpër sheshe, nëpër shkretëtira dhe oaza.

"O Zejd, i biri i Harithit, o Uthman, o Zubejr, o Hamza, dëgjoheshin thirrjet... Arriti Lajmi i Madh, gëzim për çdo njeri. Muhammedi, i biri Abdullahut (paqja e All-llahut qoftë me të!), është dhuruar peygamber i All-llahut, me mision të shenjtë që Islamin t'ia shpallë mbarë njerëzimit".

Ndërkaq, pëshpëritjet, fjalët me zë të ulët, përhapeshin duke pyetur: "E ç'predikon Muhammedi, i biri

i Allahut, çfarë porosie na sjell ai nga Krijuesi i çdo gjëje të gjallë dhe të vdekur?”

Nga zemra në zemër, si lumi i kjellët rridhnin Fjalët e Mëdha. Muhammedi a.s. predikon fenë e pastër, besimin në Një Zot. Porosit se nuk ka zot tjetër, përveç All-llahut xh.sh., porosit njerëzit të jenë vëllezër, të sillen mirë ndaj prindërve dhe të afërmve të tyre, të jenë të virtytshëm, të ndershëm, fisnikë, modestë, trimë dhe krenarë. Muhammedi a.s. porosit njerëzit që tepricën e pasurisë t’ua ndajnë të varfërve, thërret që të kenë sjellje të drejtë, porosit lirin e robërve, fton që të çmohet njeriu dhe dinjiteti njerëzor, të rrënohen idhujt, që Qabeja të bëhet e pastër, që ndërmjet njerëzve të vendosen ligjet e All-llahut. Muhammedi fton në rilindjen e fisit njerëzor, në ekspeditë të madhe drejt Paqes, Dashurisë dhe shpëtimit në të dy botët. Ai zbulon fshehtësitë e jetës, shpjegon çdo gjë, që ishte e panjohur, tregon se ç’është kuptimi i të jetuarit. Muhammedi resulull-llah porosit se All-llahu i besoi njeriut misionin e shenjtë në Tokë: që njeriu të jetë njeri, shpirtërisht të lartësohet dhe të arrijë lumturinë më të madhe që mund të jetë e mundshme.

Prandaj Muhammedi Resulull-llah thërret në rrugë të ndritshme dhe të përsosmërisë së shpirtit, që njeriu një ditë, kur të vijë momenti i vdekjes, të mund të qëndrojë i qetë para Krijuesit dhe t’i thotë: Zoti im i dashur, për gjithçka që jam, vetëm Ty të falënderoj. Zot i Madh, Ty dhe vetëm Ty krejtësisht të dorëzohem. Ty ta jap shpirtin tim, mendimet e mia, zemrën dime. Jam përpjekur që tërë jeta ime, tërë fuqia ime, të gjitha fjalët dhe veprat e mia të

jenë në rugën Tënde. Ma dhuro mëshirën Tënde dhe Ditën e Gjykimit”.

All-llahu xh.sh. atyre, që plotësisht i dorëzohen, në çastin e vdekjes, u thotë:

“O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar! Hyn në turmën e robërve të Mi! Dhe hyn në xhennetin Tim!”

(Kur’ani, 89:27-30)

Dhe kështu njeriun e shndriti drita e Mësimi të All-llahut, drita e Njohurisë së Sigurt. E vërteta e fjalëve të All-llahut depërtoi në zemrat e njerëzve. Drita e All-llahut shndriti shpirtrat e njerëzve. All-llahu flet nëpërmjet Kur’anit, i fton njerëzit në rrugën e shpëtimit. A thua e dëgjojnë njerëzit zërin e së Vërtetës së Sigurt? Shkenca Islamike pyet, engjëjt pyesin, madje edhe e tërë natyra pyet: “O njeri, a dëshiron t’i shtrish duart kah Paqja, kah Shpëtimi dhe kah Lumturia? A do ta begatosh jetën me qëllim dhe kuptim që çojnë përtej vdekjes dhe arrijnë në amshim? A dëshiron të arrish shkallën më të lartë të përsosmërisë shpirtërore?”

O njeri, ty që All-llahu xh.sh. të krijoi në trajtën më të bukur, që të nënshtroi çdo gjë që është në qiej dhe në Tokë, duke të caktuar mëkëmbës të Vet në Tokë, që të frymëzoi me Frymën e Vet që të fali besimin më të madh, trego: A do t’i përgjigjesh thirrjes së Zotit?

O njeri! Drita e All-llahut ta zbuloi kuptimin e ekzistencës, të udhëzoi në Njohuri të Sigurt, të ndriçoi Fshehtësinë e Madhe, të mësoi të jesh përherë i lumtur! E për të qenë gjithmonë i lumtur, përe të arritur qetësinë absolute, njeriu doemos duhet të orvatet ta

përsosë shpirtin e vet, që të ngritet në shkallët më të larta shpirtërore.

Si të arrihen këto vlera dëshmon Islami:

“Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten.”

(Kur’ani, 91:7-10)

Resulull-llahu Muhammedi a.s. ka thënë:

“Jam dërguar që ta përkryej moralin fisnik”.

Nëpër vështirësi drejt dritës së shpirtit

Unë e di se është e pamundshme që të gjithë njerëzit të bëhen mjekë të shquar, zanatçinj të përsosur, inxhinierë të shkëlqyeshëm. Dhe këtë e di çdo njeri. Mirëpo, është e vërtetë se të gjithë njerëzit, vërtet të gjithë, nëse dëshirojnë, mund ta realizojnë qëllimin më të lartë jetësor – përsosmërinë e shpirtit. Të gjithëve u është ofruar mundësia që vërtet të bëhen njerëz të përsosur. Gradualisht, guximshëm dhe me punë të vazhdueshme intensive mund ta pushtojmë mbretërinë e shpirtit tonë, sepse në parimet fisnike e të shenjta qëndron kuptimi i vërtetë i jetës. Shpirti i ndritur shpie drejt shpëtimit dhe lumturisë në të dy botët. Të luftosh për ndriçimin e shpirtit, nuk ka qëllim më fisnik, më të përshtatshëm e më të bukur.

Jeta e atij, i cili që nga ditët e para të jetës së vet, me dritën e së vërtetës pushton hapësirat e shpirtit, është përplot lumturi reale, sepse shpirtin e përsosur e presin dhuratat e All-llahut.

Muhammed El-Gazali shkruante:

“Djalosh, përpigu të jesh shpirtgjerë e fisnik. Mos lejo që epshi të të pushtojë, por ai gjithnjë le të jetë i frenuar, përpigu që trupin ta bësh të vdekur. Varri yt është shtëpia jote. Atje të presin çdo moment. Ruaju që atje të mos vish pa pajisje”.

Xhelaludin Rumi thoshte: “Biri im, edukoje shpirtin tënd, qenien tënde, kjo është rruga e drejtë. Për

shkak të edukimit të mirë kjo gjithësi noton në dritë, kurse engjëjt kanë fituar pastërinë dhe pafajësinë, ndërkaq Iblisi, për shkak të arrogancës, është përzënë nga Dyert e përdëllimit”.

Asnjë vepër e madhe në jetë nuk arrihet lehtë. Fitortja, që pason pas një pune të mundimshme, është njëqind herë më e ëmbël dhe më e dashur se ajo punë që eventualisht do të kryhej pa mund. Ne për çdo ditë shohim se si njerëzit luftojnë për para. Me mundim dhe përkushtim punojnë që nga mëngjesi deri në mbrëmje, jo vetëm për nevojat e tyre elementare, por shpeshherë edhe për luks. Heqin dorë nga shumë të mira në jetë. Përse? Për ar, për argjend, për para – për vlera afatshkurtra dhe kalimtare të kësaj bote. E çfarë do të duhej të ishte puna me vlerë të përjetshme siç është fisnikërimi i shpirtit të pastër dhe të ndritur? Për një punë të këtillë nuk duhet pyetur për lodhje, për ngecje, për pengesa dhe për kufij.

Në shtyp shpeshherë lexojmë se si sportistët përgatiten për gara të ndryshme. Të rinjtë dhe të rejat nuk kursejnë mundin dhe përpjekjet që të arrijnë sukses dhe të stolisin gjokset e tyre me medalje të bronzte, të argjendtë ose të arit. Këto janë poërpjekje të ndershme dhe fisnike.

Pyesim pra: përse të mos bëjmë përpjekje shumëfish më të mëdha që të jemi të gatshëm për sprova më të mëdha, për ndërmarrjen më të madhe jetësore – fisnikërimin e shpirtit tonë? Shpërblimin për këtë vepër trimërie e jep Krijuesi i Madhërishëm, i dashuri Allah xh.sh. kurse shpërblimi është lumturia dhe paqja e amshueshme.

Është e pamohueshme e vërteta e kulluar dhe e qartë se All-llahu xh.sh. shpirtrat e njerëzve mund t'i bëjë ashtu siç të dojë Ai. Mirëpo, me vullnetin e All-llahut, njeriu është krijuar pikërisht ashtu siç është. All-llahu xh.sh. besimtarëve u ka treguar rrugën e drejtë, e për ta ndjekur këtë rrugë Ai jep si shpërblim ndihmën e Vet. Në Kur'an thuhet:

“E ata, të cilët luftuan për hir Tonë, Ne, me siguri do t'i orientojmë rrugës për te Ne, e nuk ka dyshim se All-llahu është në anën e besimtarëve.”

(Kur'ani, 26:69)

All-llahu kërkon nga besimtari mundin e tij, përpjekjet e tij për të arritur qëllimet më të larta. Ai kërkon nga njeriu realizimin e fuqisë dhe vullnetit të All-llahut në zemrën e njeriut. All-llahu dëshiron që rrugë jetësore e besimtarit të jetë e pajisur me dashuri ndaj Islamit dhe ndaj çdo veprë që është e mirë dhe fisnike. Me mund, me punë dhe me përpjekje në rrugën e All-llahut sigurohet besimi i drejtë. E vërteta është didaktike dhe e pamohueshme:

“All-llahu nuk e ndryshon një popull derisa ai nuk e ndryshon vetveten.”

(Kur'ani, 13:11)

All-llahu xh.sh. dëshiron që njerëzit, me luftën e vet, me punën e vet, me durimin e vet në evitimin e së keqes nga trupi i vet, nga shpirti i vet, nga jeta e vet, të arrijnë përsosmërinë e mundshme maksimale. All-llahu xh.sh. në këtë rrugë ka paralajmëruar sprova të ndryshme:

“A menduan njerëzit të thonë: Ne kemi besuar, e të mos vihen në provë? Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që All-llahu gjithqysh do t’i dallojë ata që e thanë të vërtetën e do t’i dallojë edhe gënjeshtarët!”

(Kur’ani, 29:2 dhe 3)

Rruga e All-llahut, Mësimi i All-llahut, nuk realizohet në njeriun dhe rreth tij vetëm me Shpallje. Nuk do të realizohet edhe me vetë faktin që lexohet ose mësohet ai mësim. All-llahu xh.sh. gjithashtu nuk pranon që me Fuqinë e Vet ta ndryshojë qenien e brendshme njerëzore, nëse vetë njeriu nuk synon realizimin dhe fitoren e mësimin të All-llahut. Këtij qëllimi, besimtari duhet t’i përkushtohet me tërë qenien e vet, me tërë fuqinë e vet, me tërë vullnetin dhe dijen e vet. Njeriu, fitoren e Islamit në vetvete e siguron me luftë kundër pasioneve të veta negative dhe kundër ligësive, që janë në kundërshtim me mësimin e All-llahut. Arritja e fitores në luftë për përsosmërinë e shpirtit, varet nga fuqia e përpjekjeve dhe e synimeve të njeriut. Duhet dashur, por duhet dashur fuqishëm, sepse Islami e gjen lehtë rrugën e shpirtit njerëzor. Islami i njeh mirë vetitë dhe aftësitë e tij. Ai i qaset në atë mënyrë siç e përcakton All-llahu xh.sh. E kjo është rruga e vërtetë – rruga e All-llahut.

Rruga për përsosmërinë e shpirtit është e gjerë, e ndriçuar, por edhe e mbushur me ferra dhe e zënë me pengesa. Në këtë drejtim njeriun e presin konfliktet e brendshme, lufta e së mirës me të keqen. Për këtë kërkohet shumë forcë dhe shumë durim. Kjo luftë për ngadhënjimin e së mirës në shpirt, për rrugën e ndrit-

shme jetësore, me ndihmën e All-llahut do të kurorëzohet me fryte të mrekullueshme: me forcimin e fuqisë shpirtërore, me rezistencë dhe paluhatshmëri.

Rruga drejt përsosmërisë së shpirtit, me përpjekje të vazhdueshme fisnike, hap horizonte të gjera të besimit, çfarë njeriu as nuk mund t'i marrë me mend. Këto horizonte të besimit, aftësi të mirëfillta dhe njohuri të sigurta, u janë dhënë besimtarëve të sinqertë dhe të vendosur. Kurrë nuk do t'u jepen atyre, të cilët në letargjinë e vullnetit të vet qëndrojnë të palëvizshëm, duke mos bërë përpjekje për luftë në shpirtin e vet.

Njohja e besimit të qartë, të pastër, e ndriçon kuptimin e jetës, e shndërit shpirtin njerëzor në shkallë më të lartë të kufijve të dritës. Është kënaqësi dhe nder që në jetë të ecim me qëllime të larta. Ashtu siç përhap aromën e tij trungu me plot gjelbërim, po ashtu edhe mënyra islamike e jetës përhap aromën e bukurisë së vet në shpirtrat njerëzorë. Jeta islame është shenjë e Dashurisë dhe e Mëshirës së All-llahut. Romakët e vjetër thoshin: "Nëpër vështirësi deri te yjet!..." Kurse muminët do të thonë: "Nëpër vështirësi drejt dritës së shpirtit, drejt përsosmërisë së tij!"

Qëllimi më i lartë

Njeriu fisnik, njeriu i sinqertë nuk lejon që jeta t'i kalojë kot. Ai përpiqet që ta kurorëzojë atë me vepra të mëdha, sepse nuk bën pjesë në mesin e atyre, të cilët dekada të tëra të jetës së tyre i kalojnë me duar në xhepa pa punë dhe pa kurrfarë përpjekjesh. Ai nuk bën pjesë as në mesin e atyre, të cilët nga motivet egoiste të lakmisë së vet të sëmurë për pasuritë e kësaj bote, janë të gatshëm të shkelin mbi njerëzit e tjerë.

Qëllime jetësore ka shumë. Shkalla e vlerës së tyre është e madhe. Njerëzit orientohen në jetë sipas prirjeve të tyre. Mirëpo, All-llahu xh.sh. muminit i ka caktuar qëllim të qartë. E qëllimi është që të jesh njeri plotësisht i drejtë e i sinqertë, ta edukosh shpirtin tënd në atë mënyrë që të arrish në shkallën më të lartë shpirtërore. Me këtë qëllim para syve dhe mendimeve duhet të jenë të përshkuara të gjitha synimet dhe përpjekjet e muminit. Në rrugën drejt këtij qëllimi fitohet forca për vepër e përpjekje. Hapësirat për përsosmërinë e shpirtit njerëzorë janë të pakufishme. Ato shtrihen që nga heqja e leckave dhe e shkarpave nga rruga e deri te veprat e shumta që kryhen në emër të All-llahut xh.sh. Puna, kujdesi, vullneti i fortë, dashuria ndaj shkencës, mëshira, vetëmohimi – janë vetëm disa nga fushat e jetës së njeriut nëpër të cilat duhet kaluar për të arritur deri te qëllimi më i lartë.

Djalosh! Paramendo tani njerëzit, të cilët jetojnë pa ideal, pa qëllim! Sa të mërzitshme janë ditët e përditshmërisë së zbehtë pa gëzimet e qëllimit më të lartë! Aty as nuk ka mëngjes të mirëfilltë e as dritë të vërtetë jetësore. Të jetuarit e muminit në rrugën më të ndershme, tejkalon kufijtë shpirtërorë të kësaj jete, ai nuk di për vdekje. Ai di vetëm për jetën e bukur me plot kuptim, për jetën plot qëllime, për jetën madhështore dhe fisnike. Vdekja njerëzore, nuk është vdekje. Ajo është vetëm kalim në një botë më të mirë, ecje drejt takimit me më të dashurin, me All-llahun, Krijuesin tonë. Kjo jetë është një fazë kalimtare drejt jetës së amshueshme. Duke theksuar virtytet morale me të cilat dallohet ai që kultivon dashurinë ndaj All-llahut, ai që ka për qëllim përsosmërinë e shpirtit, Ibni Sina ka thënë: “Ai, i cili e ka njohur të Vërtetën është guximtar, e si të mos jetë kur është i kursyer nga frika e vdekjes. Është shpirtmirë, e përse të mos jetë, kur qëndron larg dashurisë ndaj të pavërtetës. Ai fal shumë, e përse të mos falë, kur shpirti i tij qëndron mbi atë që mund ta lëndojnë lajthitjet e njerëzve”.

Ndoshta dikush do të pyesë: përse gjithë ai mund, përse e synojmë atë qëllim?

Mumini do të përgjigjet: “Në rrugën e All-llahut për të pasuar të vërtetën, njeriun e presin shpërblime të mëdha në këtë botë dhe në botën tjetër – paqja, lumturia dhe kënaqësia. Nëse njeriu e fiton mëshirën e All-llahut, nëse shpirti i tij në momentin e vdekjes i dorëzohet All-llahut xh.sh. para tij do të hapen mundësi të papritura. E cila është, pra, lumturia më e madhe?

Të jesh i sigurt: Xhenneti, shpëtimi i amshueshëm në mëshirën e All-llahut xh.sh. dhe në shoqëri me njerëzit e mirë.

“Besimtarëve dhe besimtareve All-llahu u premtoi xhennete nëpër të cilët rrjedhin lumenj, në to do të jenë përgjithmonë, dhe (u premtoi) vendbanime të bukura në xhennetin e Adnit, edhe një disponim nga All-llahu që është mbi të gjitha. Ky, pra, është ai shpëtimi i madh.”

(Kur’ani, 9:72)

“E për sa i përket atyre fatmirëve, ata janë në xhennet përgjithmonë, sa të jenë qiejt e toka, përveç ata çka do Zoti yt (All-llahu ju dhuron) shpërblim të pakëputur.”

(Kur’ani, 11:108)

Për xhennetin, për dashurinë e All-llahut, janë të panumërta ata, që kanë jetuar dhe kanë vdekur. Atyre vdekja ua hap dyert drejt rrugës së xhennetit. Ata e kanë ditur që ai është shtegu drejt qëllimit më të lartë!

Thirrja për pranimin e vetive të mira dhe synimi për përsosmërinë e shpirtit, ka qenë thirrje të gjithë pejgamberëve të Zotit. Të gjithë pejgamberët e Zotit janë dalluar me veti të këtilla. E si të heqin dorë atëherë muminët në përkryerjen e vetive, kur e dinë se pas këtij qëllimi fisnik kanë synuar të gjithë njerëzit e ndershëm, njerëzit e mirë e shpirtgjerë, kur e dinë se vetitë e këqija janë helm, që e mbysin dhe e largojnë njeriun nga All-llahu xh.sh., e largojnë nga çdo e mirë tjetër!? Ky helm e radhit njeriun në grupin e të pandershmëve dhe të këqinjve, duke ia hapur hapekrah dyert e xhehennemit.

Duaj fuqishëm

Zgjedhja e qëllimit më të lartë është gjë e mrekullueshme. Shkëlqimi i dritës së tij shndrit tokën dhe gjithësinë, niset nga e kaluara drejt amshimit. Ai që e zgjedh këtë, vërtet e ka zgjedhur qëllimin e lartë dhe të ndershëm. Mirëpo, rruga deri në këtë cak është e gjatë. Për ta ndjekur këtë rrugë duhet pasur besim, fuqi dhe vullnet. Duhet dashur fuqishëm! Në rrugën drejt dritës së shpirtit, përsosmërisë së tij, ithtarët e vërtetë duhet të jenë të vendosur e të paepur. Duhet të mposhtet e këqja në qenien tonë!

Islami na mëson si arrihet lumturia e amsheshme dhe fatbardhësia e njeriut. Njeriu, që vendos të ndjekë rrugën e All-llahut drejt shpëtimit, duhet t'i flasë vetvetes pa u lodhur dhe pandërprerë:

- Me ndihmën e All-llahut dëshiroj që shpirti im të shndrisë me rreze më të shkëlqyeshme, kur të gjendem para Krijuesit tim – All-llahut xh.sh.

- Dua që vijimisht dhe guximshëm, deri në vdekje të ndjek idenë e së mirës;

- Dua të bëhem i mirë për prindër, për vëllezër, për motra, për farefis dhe për gjithë njerëzit e mirë;

- Dua t'i zotëroj pasionet e mia, ndjenjat dhe mendimet,

- dua më parë të mendoj, e pastaj të flas,

- dua të mësoj shkëlqyeshëm që në shkollë e në studime të jem ndër më të mirët,

- dua të punoj me zell që të jem i dobishëm për fisin njerëzor,

- dua që të gjitha veprat e mia të jenë të mira,

- dua të jem i moralshëm, i virtytshëm dhe shembullor,

- dua të jem i karaktershëm,

- dua që zëri im të jetë i ëmbël, që zemërimi të mos ketë kurrë vend në zemrën time,

- dua të mos jem mendjemadh dhe vetjak,

- dua të jem fisnik, trim dhe i durueshëm,

- dua që jeta ime me shpirt dhe me vepër të jetë e madhe, e ndershme dhe fisnike,

- dua që vërtet të jem mumin, që Islami për mua të jetë kuptim i jetës dhe i ekzistencës sime, me besim të plotë e bindje të thellë ndaj Zotit të dashur, ta kaloj tërë jetën time dhe përfundimisht këtë jetë ta lë në Islam.

Dhe me kënaqësi shqiptohet fjala "dua" që duhet të dëshmohet shumë herë në rrugën e realizimi të synimeve fisnike. Kjo "dua" duhet të dalë nga thellësia e zemrës, këtë "dua" e përkrah All-llahu xh.sh. Me këtë "dua", të cilën e përcjellin engjëjt, njeriu është i qet dhe i lumtur. Dije pra: se çdo gjë në këtë botë është kalimtare, vetëm All-llahu xh.sh. është i përjetshëm.

Hixhreti është rruga kah e mira. Të gjithë njerëzit e mirë e kanë hixhretin e vet. Dhe të gjithë pejgamberët e All-llahut e kanë bërë hixhretin e vet.

Përpjekjet intensive dhe të vazhdueshme për ngadhënjimin e së mirës në shpirtin tonë janë përpjekje të hixhretit.

Ibrahimi a.s. ka thënë:

“Unë shpërngulem atje ku më udhëzoi Zoti im. Ai është i gjithëfuqishmi, i urti”.

(Kur’ani, 29:26)

Dhe vërtet Ibrahim i a.s. me çdo akt të tij ka kryer hixhretin – duke folur, duke heshtur, duke menduar... me vullnetin e tij “dua” e tij kah e mira ka arritur shkallën më të lartë të ngritjes shpirtërore.

Përse duhet dashur kaq fuqishëm? Ç’është ajo që na fton të synojmë me aq admirim përsosmërinë e shpirtit?

Do të them ty: Vetëm besimi në Një Zot. E Ai është themel i besimit: Nuk ka zot tjetër, përveç All-llahut!

Nëse njeriu nuk synon të mirën, atëherë vihet në dyshim e tërë rruga e tij jetësore. Gëte ka thënë: “Dëshirat tona paraqesin parandjenjat e aftësive tona që flenë në ne, ato janë lajmëtarët e asaj vepre që ne jemi në gjendje ta realizojmë”.

Me besim në mbretërinë e shpirtit

Besimi është hapi i parë drejt mbretërisë së shpirtit, besimi i thellë i fortë dhe i paluhatshëm në Zotin. Besimi e nxit njeriun që burrërisht dhe guximshëm të shkojë përpara. Prandaj, njeriu duhet ta kërkojë besimin në vetvete, duhet ta ndezë atë si flakën. Besimi është i pashtershëm, është fuqi e nuk ka kufi.

Me besim njeriu ndërmeret ekspedita për ta pushtuar mbretërinë e shpirtit. Në besim gjejmë Zotin e dashur, mikun dhe ndihmëtarin e Madh të njeriut.

I biri i skulptorit Azer, Kaldeu nga Babilonia, që Ibrahimit a.s. Ai jetoi para Isait a.s. Adhuruesit e statujave, të zemëruar me veprimin e Ibrahimit a.s. dhe me thirrjen e tij drejtuar njerëzve që ta ndjekin rrugën e Zotit, filluan t'i bëjnë intriga, duke e penguar dhe duke e kërcënuar. Meqë nuk arritën ta pengonin, atëherë e hodhën në turrë të druve për ta djegur. Zjarri mori flakë, çdo gjë digjej rreth Ibrahimit a.s. Mirëpo atij nuk mundën t'i bëjnë asgjë. Me Dëshirën e All-llahut xh.sh. besimi i Ibrahimit e fiku zjarrin. Politeistët mbetën të pagojë para mrekullisë që ndodhte para syve të tyre.

Një natë në ëndërr Ibrahimit a.s. nga All-llahu xh.sh. mori urdhër që ta flijojë djalin e vet, Ismailin. Kjo ishte sprova e All-llahut drejtuar Ibrahimit a.s. dhe Ismailit a.s.

All-llahu xh.sh. e donte Ibrahimin a.s. dhe Ismailin a.s., ndaj u ndihmoi në përpjekjet e tyre. Tani

Ai dëshironte që ata ta dëshmonin besimin e tyre. Ndërkaq ata që të dy e donin aq shumë All-llahun sa që ishin të gatshëm edhe për flijime sado të mëdha qofshin ato. Ibrahim i kishte vendosur ta flijonte djalin e vet, kurse Ismaili jetën e vet.

Sakrificat e Ibrahimit nuk kishin shembull në historinë e fisit njerëzor. Kjo sakrificë e kërkuar dhe e ofruar ishte sakrificë vetëm e Ibrahimit. Ajo nuk ishte sakrificë e hapët dhe e dukshme, publikisht e çmuar dhe e madhëruar. Sakrificat të tilla publike për ideale të mëdha ndëshim gjatë tërë historisë njerëzore. Ato janë pranuar me krenari. Përkundrazi, sakrificat e Ibrahimit a.s. ishin sakrificë e fshehur. Për të nuk ka ditur askush, përveç All-llahut xh.sh., Ibrahimit dhe Ismailit. Ibrahim i a.s. ishte i gatshëm ta flijonte viktimën pa u hamenduar asnjë fije. Përse? Sepse këtë e kishte kërkuar All-llahu xh.sh. Ibrahim i a.s. nuk pyeti për shkaqet e sakrificës dhe asnjë çast nuk u hamend. Kjo ishte sakrificë në emër të Zotit dhe për dashurinë ndaj Zotit. Ky ishte akt madhështor i besimit ndaj Zotit. Zotit duhet dhënë çdo gjë prej vetes, madje edhe atë që të pjesa dërmuese e njerëzve është më e shtrenjtë se vetë jeta e tyre. Ibrahim i a.s. iu dorëzua plotësisht All-llahut xh.sh. në vetmi, pa praninë e shikimit të askujt, pa miratimin njerëzor. Ibrahim i a.s. trashëgonte në vete fuqi të sinqeritetit të lashtë parahistorik, besimin e vërtetë. Fuqia e tij ishte e pakufishme. E All-llahu xh.sh. e kërkonte pikërisht këtë besim, besimin pa asnjë fije egoizmi. Njeriu i madh, Ibrahim i a.s., dëshmoi se vërtet ishte i zgjedhuri i Zotit. Ndërsa All-llahu i Madhërishëm, kur pa se

Ibrahimi, në emër të dashurisë ndaj Tij, në emër të besimit, e ofron djalin e vet, atëherë Zoti, në vend të Ismailit të dashur, ia ofroi dashin.

Mëshira e Zotit qoftë me Ibrahimin a.s., robin e ndershëm dhe të përkryer të Zotit.

Isa a.s. i shëronte njerëzit e verbër, të gërbuluar dhe të paralizuar. Besimi i tij lindte besimin në zemrat e tyre, ndaj ata, me vullnetin e All-llahut xh.sh., shëroheshin për mrekulli.

Flitet se Isa a.s., me fuqinë e besimit të vet, ecte nëpër ujë. Besimi e udhëhiqte Isanë a.s., i jepte fuqinë me të cilën mbizotëronte ligjet e fizikës.

Umeri, i biri i Hattabit, ishte nisur që ta vriste Muhammedin a.s. Kur dëgjoji fjalët e Kur'anit, që vinin nga bodrumi, ku ishin motra dhe dhëndri i tij, ai u ndal i mahnitur. Përnjëherë e kuptoi se ato ishin fjalët e Zotit, se ai ishte zëri i së Vërtetës së Mirëfilltë. Mënjëherë e përqafoi Islamin, duke u bërë ithtar i madh i tij deri në fund të jetës së tij të ndershme dhe fisnike.

Besimi përnjëherë i ndërronte njerëzit, i riedukonte, i bënte më të mirë dhe më fisnikë.

Mrekullia që ndodhte me shërimin e të verbërve, po ashtu ndodhte edhe me transformimin e njeriut. Prandaj njeriu duhet të ndalet para fuqisë dhe para madhështisë dhe ta ndjejë se ç'është vullneti i All-llahut.

Në vllugun e luftës, që zhvillohej në Bedër, Muhammedi a.s. gjendje në radhët e para të luftëtarëve dhe, që mund ta dëgjonin të gjithë, tha me zë të lartë:

“Pasha All-llahun, në pushtetin e të cilit është shpirti i Muhammedit, asnjë njeri që mund të vritet sot në luftë kundër mushrikëve, nuk do të mbetet pa e çuar All-llahun

në xhennet, në qoftë se ka luftuar trimërisht, ka sulmuar dhe nuk është tërhequr!”

As’habi i nderuar Umejri ibn el-Himan qëlloi në afërsi të Muhammedit a.s. kur ai i shqiptoi këto fjalë. “Do të thotë se nuk ka pengesa për mua dhe hyrjen time në xhennet, në qoftë se vritem sot në luftë”, tha Umejri dhe me tërë fuqinë e vet u vërsul kundër armikut. Luftoi trimërisht deri në pikën e fundit të fuqisë së tij. Me vdekjen e tij heroike ra shehid përfundimisht.

Dashuria e Umejrit ndaj All-llahut xh.sh. dhe besimi i tij ishin më të fortë se instinktët njerëzore për ruajtjen e jetës. Besimi në All-llahun xh.sh. dhe vetëdija se po luftonte për ideale fisnike dhe të amshueshme, e nxitnin Umejrin në sulm. Me një besim të këtillë nuk ishte vështirë të shkohej në luftën më të rëndësishme për fitoren e së mirës në shpirt, për të arritur përsosmërinë e tij që të shkonte drejt dyerve të hapura të xhennetit.

Njeriu i ri, i cili synon lumturinë e amshueshme, duhet të mësojë nga besimi i njerëzve të mëdhenj, që ta forcojë besimin e vet, që në këtë mënyrë të mund të marshojë me hapa të sigurt drejt qëllimit më të lartë – përsosmërisë së shpirtit.

Dijetari Hasan Basri ka thënë:

“Thuhet se Hazreti Umer ibnu-l-Hattab-i e shprushte zjarrin dhe ia afronte dorën duke thënë: “Provo, o biri i Hattabiot, a do të mund ta durosh zjarrin e xhehennemit?” e menjëherë pastaj i drejtohej me lutje All-llahut xh.sh. që ta ruante nga xhehennemi dhe prej atyre që punojnë për xhehennem. E kur Umeri r.a. frikohej aq shumë prej xhehennemit, megjithëse xhen-

neti i ishte premtuar, atëherë si jeni ju, o njerëz, të sigurt se do të shpëtoni?”

E më tutje:

“Besimtari mbetet gjithnjë i njëjtë, pa marrë parasysh kohën dhe situatën, i pathyeshëm në besim, me një fytyrë dhe në një rrugë. Hipokritët ndërrojnë sipas kohës dhe sipas situatës, shikojnë vetëm interesat e veta, kurse dëmtojnë interesat e të tjerëve. Me veprën e tij besimtari i vërteton fjalët e tij. Jeta e tij publike dëshmon jetën e tij private” – thoshte Hasan Basri.

Pejgamberi i All-llahut, Muhammedi a.s. ka thënë:

“Gjërat më të mira, që kemi sjellë unë dhe pejgamberët para meje, janë fjalët: Nuk ka Zot tjetër, përveç ALL-LLAHUT!”

Dhe vërtet, besimi në një Zot është thelbi i Islamit, është zemra dhe shpirti i tij. Çdo gjë i është nënshtruar All-llahut xh.sh. Vetëm Ai është i denjë për adhurim. Si Ai nuk çmohen as baba, as nëna, as gruaja, as fëmijët, e as kurrfarë pasurie materiale, as çfarëdo nderi në këtë tokë e as kurrfarë fame e kësaj bote. Besimtari e kompletton qenien e vet me besim të paluhatshëm dhe me të arrin në sferat më të larta shpirtërore. Islami është besnikëri e plotë ndaj All-llahut.

“All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me xhennet.”.

(Kur’ani, 9:111)

Muhammedi a.s. thotë:

“Islam do të thotë dorëzim i plotë ndaj Krijuesit xh.sh. dhe bamirësi ndaj krijesave të Tij”.

Historiani Islam Tha'libi shënoi proverbin e dijetarit Llukman:

“O biri im! Bota është det i thellë, ndaj shumë njerëz fundosen në të. Anija le të jetë – frika ndaj All-llahut xh.sh., timoni – besimi në All-llahun xh.sh., kurse lopatat e lundrimit – shpresa e fortë në Krijuesin e gjithësisë, në All-llahun xh.sh.”

Me besim në Zotin arrihet sistemi më i mirë i sjelljes personale, kontrolli mbi vetveten dhe mbi pasionet e tua. Besimi mundëson praninë e përhershme të Fjalëve të All-llahut në të gjitha mendimet tona, në tregimet dhe në veprat tona. Dhe, nëpërmjet këtyre, besimtarit i hapen rrugët kah njohuritë më të larta dhe më të fshehta. Kurse njohuritë dhe dituritë më të larta, sigurisht shpiejnë drejt dritës së shpirtit, drejt përsosmërisë së tij.

Rruga e drejtë është treguar

All-llahu xh.sh. sigurisht dëshiron që të gjithë njerëzit të arrijnë përsosmërinë e shpirtit të vet. Në begatinë e Vet të pakufishme të fisnikërisë, të dashurisë dhe të mirësisë ndaj njerëzimit, q ënga krijimi i fisit njerëzor, u ka dërguar udhëzime njerëzve se si të bëhen njerëz të drejtë, si ta përsosin shpirtin e tyre, si ta arrijnë lumturinë dhe fatbardhësinë e amshueshme. Edhe Muhammedi a.s., peygamberi i fundit i All-llahut, ka ardhur me Udhëzim. Ai na solli Kur'anin, Fjalën e All-llahut, duke e shpjeguar Islamin me fjalë dhe me vepër të vet.

Kështu, pra, rruga e drejtë sigurisht u tregua. Për të nuk ka dyshim. Të gjitha porositë e All-llahut xh.sh. si dhe urdhërat e Tij, të gjitha fjalët e Resulullahut a.s. dhe të gjitha veprat e tij, synojnë që ta mësojnë njeriun se si ta arrijë qëllimin më të lartë.

Namazi

Namazi nuk është vetëm lutje. Ai është moment nga jeta kur njeriu qëndron drejtpërdrejt para Zotit, i përkushtohet me tërë qenien e vet duke i shprehur falënderimin e vet për të gjitha begatitë. Qëllimi i namazit është që ta pastrojë shpirtin e njeriut nga të gjitha mendimet e zeza, nga të gjith dëshirat dhe kër-

kesat e këqija. Namazi është faktor edukativ, nxitje për punë të mira, për të mirën e të gjithë njerëzve.

“Ti lexo atë që të shpallet nga libri (Kur’ani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat, e përmendja e All-llahut është më e madhja (e adhurimeve). All-llahu e di ç’punoni ju!”

(Kur’ani, 29:45)

Besimtari në namaz jep llogari para Zotit xh.sh. për të gjitha veprat e veta, e ekzaminon ndërgjegjen e vet. Namazi, namazi i sinqertë, i shton virtytet në shpirtin e njeriut, ndërsa i largon të metat. Ashtu siç e shpërlan uji gjatë marrjes së abdestit papastërtinë e trupit, ashtu edhe namazi e heq papastërtinë që është shtresuar në shpirtin e njeriut. Njeriu besimtar pesë herë në ditë e përtërin shpirtin e vet.

Muhammedi Resulull-llah a.s. ka thënë:

“Ç’mendoni, sikur dikush prej jush ta kishte pasur lumin para derës dhe për çdo ditë të ishte larë në të, a do të kishte mbetur papastërti në trupin e tij?”

Kur i dëgjuan këto fjalë besimtarët, që ishin mbledhur, u përgjigjën se nuk do të kishte mbetur papastërti. Resulull-llahu pastaj tha:

“Ja, kësaj i ngjajnë edhe pesë vaktet e namazit të ditës. Zoti xh.sh. atyre ua shlyen mëkatet dhe gabimet”.

Nëse namazi është i sinqertë dhe i çiltër, me ndihmën e All-llahut xh.sh. ai sjell përsosmërinë e shpirtit. Pas namazit, njeriut çdo gjë i duket më e bukur, më e qartë, më e shenjtë. Atë e stolisin cilësitë më të mira morale, ndaj ai i afrohet gjithnjë Zotit të Dashur. Edhe nëse bën ndonjë gabim deri në namazin e ardhshëm,

ai e shlyen atë dhe rishtas përjeton ngritje edhe më të madhe. Dhe kështu gjatë tërë ditës, gjatë tërë jetës.

Vlerë mjaft e rëndësishme e namazit është se ai, në shpirtin e njeriut, vendos paqen. Paqja dhe shpëtimi mbizotërojnë në të. Për të nuk ka shpirtngushtësi dhe dëshpërim.

Mirëpo, ka njerëz, që e falin namazin formalisht. Namazi i tillë nuk ka sjell shumë dobi, sepse ai nuk është falur me përkushtim.

Nganjëherë shohim burrin ose gruan, që falen rregullisht, vizitojnë xhamitë, kurse njëkohësisht përgojnë, janë lakmitarë, shpirtligj e smirëzez... Namazi i tyre nuk ka lënë gjurmë në shpirtrat e tyre. Namazi i këtillë është sprovë e madhe.

“Pra shkatërrim është për ata që falen, të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm”.

(Kur’ani, 107:4.6)

Agjërimi

Agjërimi i Ramazanit nuk është agjërimit i thjeshtë, qëllimi i të cilit është uria, mundimi dhe vuajtja. Agjërimi ka kuptimin e vet të thellë. Njeriu, me anë të agjërimit, arrin shkallën më të lartë shpirtërore, pastron shpirtin dhe nëpërmjet tij shpreh falënderimin në shkallën më të lartë ndaj Krijuesit xh.sh. Nëpërmjet agjërimit, njeriu përjeton solidaritetin vëllazëror me njerëzit e uritur dhe të varfër të mbarë botës, kalit karakterin e vet, ngre lart vetëdijen sociale ndaj obligimeve që ka ndaj vëllezërve, të cilët vuajnë. Me trup të lodhur, por shpirtërisht të forcuar,

lufta kundër të gjitha të metave e veseve, është më e suksesshme.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Pesë gjëra e prishin agjërimin: gënjeshtria, shpifja, përgojimi, betimi i rrejshëm dhe shikimi me plot afsh”, pastaj: “Agjërimi është mburojë nga mëkatet, prandaj ai që agjëron nuk duhet të flasë fjalë vullgare, nuk duhet të ketë sjellje të vrazhdë! Nëse ndokush me sharje e nxit të grindet ose të rrahet, le t’uo përgjigjet vetëm me fjalët: -Unë po agjëroj, unë po agjëroj.”

Agjërimi është i rëndësishëm për ndërtimin e karakterit, për forcimin e vullnetit. Ai është faktor i rëndësishëm në përvetësimin e fuqisë së vetëmohimit, të pavarësisë, të dashurisë ndaj njeriut dhe ndaj së vërtetës.

Kurbani

Me anë të kurbanit shprehet dashuria ndaj All-llahut dhe gatishmëria për çdo sakrificë. Kurbani është simbol i besimit të Ibrahimit a.s. që me në të flijimit e në emër të All-llahut xh.sh. ishte i gatshëm për sakrificë. Dhe çdo mumin, që bën flijimin e kurbanit, duhet të përjetojë në shpirt admirimin e besimit të Ibrahimit a.s., besnikërinë e tij të madhe dhe të pakufishme ndaj All-llahut xh.sh.

Kurbani është akt i jashtëzakonshëm edukativ, që shpie në lartësinë më të madhe të frymëzimit njerëzor.

* Hadithi nuk ka të bëjë me prishjen e agjërimin, por me humbjen e vlerës dhe të themeleve të agjërimin (sh.p.).

Zekati

Zekati nuk është kurrfarë mëshire e lënë në vullnetin e individëve, por ky është obligim që duhet ta kryejë çdo musliman i pasur për të zvogëluar dallimet ndërmjet të varfërve dhe të pasurve, për barazi dhe vëllazërim, për drejtësi të plotë sociale. Zekati është e drejtë e të varfërve, kurse obligim i të pasurve.

Me dhënien e zekatit, sadekai-fitrit dhe të dhënave tjera sociale muslimani e pastron shpirtin e vet nga lakmia e keqe, pangopshmëria dhe synimet e sëmura për të grumbulluar pasuri.

Është thënë qartë se e gjithë pasuria materiale u është dhënë njerëzve për përdorim të përkohshëm, sepse gjithçka është kalimtare. Sakrificat materiale për njerëzit e tjerë zgjojnë te njeriu ndjenja fisnike, e mbi të gjitha arrihet Mëshira e All-llahut xh.sh., aq e nevojshme për njeriun. Pasuria pushon të jetë qëllim i jetës mbi Tokë. Të gjitha të mirat materiale mbeten vetëm lëndë për përdorim. Njeriu i shërben vetëm All-llahut xh.sh. e kurrësi parasë dhe arit. Edhe ky urdhër i All-llahut xh.sh. shpie drejt përsosmërisë së shpirtit.

Haxhi

Haxhi nuk është vetëm një grumbull njerëzish që vijnë në Mekke që t'i luten All-llahut xh.sh. për faljen e mëkateve. Ky është manifestim i solidaritetit vëllazëror ndërmjet njerëzve të të gjitha racave dhe të të gjithë popujve. Në haxh nuk ka të pasur e të varfër,

nuk ekzistojnë dallime sipas pozitive. Të gjitha, pikërisht të gjitha dallimet shlyhen. Të gjithë, pendueshëm me ihram të bardhë, i bëjnë sexhde All-llahut, të gjithë të veshur njësoj, të gjithë plotësisht të barabartë ashtu siç do të jenë në Ditën e Gjykimit.

Ç'është rezultati i kësaj? Fuqia e zhvillimit të hovshëm të fesë, ngritja e re shpirtërore. Nëpërmjet përjetimit të vërtetë të namazeve, të zekatit, të agjërimit, të haxhit dhe të kurbanit, njeriu me siguri bëhet njeri i vërtetë. Atë e shoqëron bekimi i All-llahut.

Njerëzit e këtillë nuk i frikësohen as jetës as vdekjes. Ata i presin hapekrah dyert e xhennetit.

Veprat e mira

Në mësimin e All-llahut qëndron e vërteta e rëndësishme:

“E All-llahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se All-llahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues.”

(Kur’ani, 22:40)

Ndoshta ndokush do të pyesë: E si mund të jetë e mundshme që njeriu t’i ndihmojë All-llahut? Ja se si: Me jetën e vet në rrugën e All-llahut, në rrugën e mirësisë:

“...Ai që është i dorëzuar All-llahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten.”

(Kur’ani, 2:112)

All-llahu xh.sh. kërkon nga muminët që besimin e tyre ta dëshmojnë me vepra të mira. Me besim, me besim të vërtetë, pa të s’ka asgjë! All-llahu xh.sh gëzohet kur e sheh besimtarin, që i afrohet vëllait të vet dhe i thotë: “Më thuaj si mund të të ndihmoj? Vëlla, ç’mund të bëj për ty?” besimtari është i obliguar që çdo njeriut të mirë t’i ofrojë dorën ndihmëtare. Ndhimë është, qoftë edhe shprehja më e vogël e humanitetit.

Ofrimi i ndihmës, të ndihmosh, të ndihmosh vazhdimisht – ky është besim i vërtetë.

Nëse mumini ose mumineja sheh një nxënës të dobët, e vetë e di lëndën, në të cilën nxënësi në fjalë ka notë të dobët – le t’i ndihmojë!

Nëse e sheh të verbërin, i cili shkon vetë nëpër rrugë – le t’ia shtrijë dorën ndihmëtare!

Nëse e sheh të varfërin në rrugë – le t’i ofrojë një copë bukë, madje edhe drekën le ta ndajë me të!

Nëse e sheh pëllumbin e plagosur – le t’i ndihmojë!

Nëse e sheh ndonjë leckë të hedhur në rrugë – le ta heqë nga rruga!

Nëse, nëse... “nëse” të pakufishme, që radhiten në jetën e njeriut, që i bëjnë mirë gjithkujt, që i krijoi All-llahu xh.sh. që të bësh vepra të mira, vazhdimisht të bësh – e gjithë kjo është dëshmi e besimit, e gjithë kjo është dëshmi e dashurisë ndaj All-llahut xh.sh., dëshmi e pakufishme e besnikërisë njerëzore.

Muhammedi a.s. u tha as’habëve:

“Punoni për këtë botë aq sa do të jetoni në të; punoni për atë botë aq sa do të qëndroni atje, kurse për All-llahun xh.sh aq sa keni nevojë për Të, edhe për zjarrin aq sa mund ta duroni”.

Thuhet se Hatmu-l E’sam u shoqërua me Belhiun rreth 30 vjet. Kur pyeti Belhiu se ç’kishte mësuar gjatë kësaj kohe, ky iu përgjigj se nga dija e fituar kishte arritur të mësojë tetë dobi.

E para është: “Pashë se çdokush në jetë ka shokë, miq dhe dashamirë. Disa shoqërohen me ta derisa nuk sëmuren, disa shoqërohen deri në varr, por asnjë prej tyre nuk shkon me të në varr. Duke menduar për këtë, erdha në përfundim se për njeriun është më i miri shok ai, i cili shkon me të në varr, duke i qën-

druar edhe atje mik. Shok i këtillë janë veprat e mira. Prandaj i kam zgjedhur për dashamire të mia, sepse ato do të jenë dritë në varrin e errët dhe bashkëbiseduese kur të gjithë të tjerët më lënë vetëm”.

Gazali shkruan:

“Në një libër të vjetër e kam parë këtë thënie të Isait a.s.: Nga çasti kur i vdekuri shtrihet në tabut, e deri sa të dërgohet në varr, patjetër duhet të përgjigjet në 40 pyetje. Si pyetje të parë Zoti do t’i shtrojë këtë: shërbëtori im, me vite je përpjekur që ta zbukurosh pamjen tënde të jashtme, kurse pamjes sate ndaj Meje nuk i ke kushtuar asnjë orë kujdes. Unë për çdo ditë e kam shikuar zemrën tënde dhe të kam folur: - Gjen-desh i rrethuar me të gjitha të mirat e Mia të mundshme, kurse punon për të tjerët. A mos je i shurdhët e nuk dëgjon?”

Dëgjo se ç’thotë Muhammedi a.s.:

“Mirëbërësit në këtë botë do të jenë mirëbërës edhe në atë botë. All-llahu atyre do t’ua falë mëkatet për të mirat që u kanë bërë krijesave të Tij. Në Ditën e Gjykimit atyre do t’u thuhet: “Veprat tuaja të mira ju falni kujt të doni, sepse veprat tuaja të këqija i keni të falura. Dhe ata do t’i falin veprat e veta të mira, dhe kështu përsëri do të mbeten mirëbërës”.

E më tej tha:

“Kur njeriu shkëputet nga veprat e mira, All-llahu xh.sh. e ngarkon me telashe”.

Hasani nga Basra ishte besimtar i fortë dhe njeri i mençur. Ja disa mendime të tij, të cilat ai ua përcjell besimtarëve ë mbeten të shkruara: “O njeri, besim nuk do të thotë që vetëm të tregohesh besimtar para botës, e të përfundosh me dëshira boshe. Besim i mirëfilltë është

vetëm ai, i cili është gdhendur thellë në zemër dhe të cilin e vërtetojnë veprat e mira të njeriut”.

Merrmi mësim nga veprat e mira njerëzore, jo nga fjalët, sepse All-llahu xh.sh. nuk e ka dhënë asnjë fjalë, e që si dëshmi të mos ketë caktuar edhe veprën. Vetëm veprat e vërtetojnë ose e mohojnë të vërtetën e fjalëve të dikujt. Kur të dëgjosh ndonjë ligjërim të bukur, ngadalë me atë që flet, sepse, nëse fjalët e veta i vërteton me vepër – ai është njeri i mrekullueshëm. Por në qoftë ëse vepra ndryshon nga fjalët e tij, ruaju të mos i përngjasësh me asnjë gjësend, sepse kështu mashtrohen fatkëqijtë.

O njerëz, punoni dhe përgatituni për ditën e vdekjes! All-llahu dhe Resulull-llahu do t’i shohin veprat tuaja. Të gjithë do t’i ktheheni përsëri All-llahut. Ai që e njeh botën e dukshme e të padukshme, ai do t’ju njoftojë për atë që keni bërë.

O njeri, kurrë mos nënçmo asgjë nga përulja ndaj All-llahut xh.sh. qoftë ajo e vogël dhe e parëndësishme në sytë e tu, sepse All-llahu xh.sh. pranon edhe një grimcë të së mirës dhe shpërblen për një moment përulësie. Sikur të kishte qenë e mundshme të dish vlerën e saj te Krijuesi dhe Zoti yt, ti vërtet do të gëzohesh! E përsëri kurrë mos nënçmo asgjë nga mëkatet, dhe nëse në sytë e tu ajo duket e vogël dhe e parëndësishme, sepse All-llahu xh.sh. vërtet dënon rreptë.

O njerëz, shfrytëzoni shëndetin dhe kohën tuaj për të bërë vepra të mira, para Ditës kur sytë do të mbeten të hapur dhe kur njerëzit, duke shpejtuar me koka të ngritura, shikojnë ngultas, kurse zemrat do të jenë të zbrazëta.

Njeri, o njeri! Ki kujdes për veprat e tua! Shiko se në ç'situatë do ta takosh Krijuesin dhe Zotin tënd".

Umer ibn el-Hattab r.a. njëherë pyeti: "A dëshironi t'ju them se cilët janë njerëzit më të mirë e cilët më të këqij?" dhe, pasi shokët i thanë se dëshirojnë ta dëgjojnë, ai tha: "Njerëzit më të mirë janë ata, që kanë jetë të gjatë e vepra të mira e prej të cilëve njeriu gjithnjë pret mirë, e nuk pret keq prej tyre. Më të këqij janë ata, që kanë jetë të gjatë, e vepra të këqija dhe prej të cilëve nuk pritet kurrnjë e mirë, e as nuk jemi të sigurt nga e keqja e tyre.

Djalë fisnik, vajzë e ndershme! Ndër vepra të mira bën pjesë edhe thirrja në rrugën e Zotit. Kjo është thirrje dhe këshillë për fisnikëri, dashuri njerëzore, për respekt, realitet, moral, dashuri, vetëdije sociale, për vëllazërim ndërmjet njerëzve, për paqe... Kjo thirrje duhet të jetë e butë, tërheqëse, e kulturuar, dialog human e kuptimplotë për ndaruduarshmëri të botës në të cilën po jetojmë. Nëse njeriu thërret për të mirë, ai me këtë i bën mirë vëllait të vet – njeriut. Allahu xh.sh. ka thënë:

"Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit."

(Kur'ani, 16:125)

I urti Llukman e këshillonte të birin:

"O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira, e ndalo të këqijat, dhe përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të preferuara."

(Kur'ani, 31:17)

Muhammedi Resulull-llah a.s. ka thënë:

“Secili prej jush është i obliguar ta pengojë të keqen me dhunë; nëse me këtë nuk mundet, atëherë me gjuhë – me këshilla, e nëse nuk mund ta pengojë edhe me këtë, atëherë me zemër – me përbuzje dhe urrejtje ndaj së keqes. Mirëpo, kjo e fundit është imani më i dobët”.

Më tej tha edhe:

“Pasha Atë në duart e të cilit është shpirti im, ose do të urdhëroni atë që është mirë, e do ta pengoni atë që është keq ose së shpejti All-llahu do t’ju dërgojë dënimin e Vet, e pastaj do Ta thirrni, por Ai nuk do t’ju përgjigjet”.

Pa egoizëm ftoni në rrugë të mirë, për vepra të mira, me zemër të pastër, me plot dashuri ndaj All-llahut xh.sh. duke mos kërkuar kurrnjë shpërblim tjetër, pos Mëshirës së Tij. Kjo është vepër që ndriçon me shkëlqim të pashoq. Është e njohur se Muhammedi a.s. për vlerën e udhëzimit tha kështu:

“Ai që e udhëzon ndonjë njeri në rrugë të drejtë, është njësoj sikur ta kishte fituar tërë botën”.

As’habi Mus’ab ibni Umej e braktisi pasurinë dhe shtëpinë e prindërve për t’iu përgjigjur thirrjes së të Dërguarit të Zotit a.s. Resulull-llahu a.s. e caktoi atë që të bëhej predikues i parë i Islamit në Medine. Thirrjes së tij iu përgjigjën shumë Medinas dhe e pranuan Islamin. Ai u bë shembull i ndershëm për gjeneratat, që vinin pas tij.

Vdiq trimërisht në Uhud. Ishte aq i varfër saqë, kur vdiq, nuk pati veshmbathje të nevojshme për vete. Sikur t’ia mbulonin kokën, do t’i mbeteshin të zbuluara këmbët, nëse ia mbulonin këmbët, i mbetej e zbuluar koka. Muhammedi a.s. urdhëroi që pjesa tjetër e trupit t’i mbu-

lohet me bar. Ai dha gjithçka që pati, madje edhe jetën e vet. Jetoj vetëm për dashurinë ndaj All-llahut xh.sh.

Në Greqinë e vjetër, Sokrati i urtë iu preu me shkop rrugën një djaloshi dhe e pyeti se ku shiten gjëra të ndryshme. Djaloshi u përgjigj menjëherë, e kur Sokrati e pyeti ku janë njerëzit e mirë dhe të kujdesshëm, ai nuk diti të përgjigjej. Atëherë Sokrati i tha që të shkonte pas tij që ta mësonte. Dhe djaloshi shkoi pas tij. Ishte ky Ksenofani, që më vonë u bë dashamirë i njohur i diturisë dhe i virtyteve.

Sikur vetë njerëzit të mund ta kuptonin se ç' rëndësi kanë veprat e mira dhe si pranohen ato tek All-llahu xh.sh.! pa vepra të mira nuk ka besim. Njeriu duhet ta kuptojë se duke i bërë mirë tjetrit, në të vërtetë, i bën mirë edhe vetes, sepse All-llahu xh.sh. shpërblen edhe një fije mirësie. Duke bërë vepra të mira, si njëra ndër dëshmitë më të vlefshme të besimit, njerëzit do ta evitonin urrejtjen ndërmjet tyre, xhelozinë, shpirtligësinë dhe smirën. Do të zhdukeshin veset e këqija, të cilat do të zëvendësoheshin me virtyte.

Buzëqeshjet e engjëjve e shoqërojnë çdo akt të mirë. Engjëjt gëzohen për fatin e njeriut të mirë dhe për fatin e atij që bën mirë. Mumini kurrë nuk guxon të harrojë se është obligim të bësh mirë. Për çdo ditë, për çdo orë, pandërprerë, duhet bërë vepra të mira.

O njeri, bëhu i karaktershëm!

Ja një rast i një njeriu të panjohur, i cili tregoi shembull të mrekullueshëm të karakterit.

Një ditë të nxehtë përcëlluese të gushtit në vitin 79 sipas Isa-it a.s. nga krateri i vullkanit Vezuv, e përçjellë me zhurmë të tmerrshme dhe me dridhje shkatërruese, e përdrodh flaka dhe një tym i dendur. Për një moment, qielli mbi trevën rreth Vezuvit, deri atëherë i qetë dhe me diell, u bë i zi, i errët dhe i zymtë. Në qytet Herkulanum dhe Pompej, nga llava e zjarrtë, flaka ndezëse, gazet helmuese dhe hiri i nxehtë e mu-fatës që ta zinte frymën, lëshohej vdekja e zezë dhe e kobshme. Dridheshin muret e qytetit, rrëzoheshin shtyllat dhe çaheshin toka. Llava e zjarrtë dhe flaka shpërthenin nga krateri vullkanik. Njerëzve u zihej fryma në rrugë dhe vdisnin nën muret e shkatërruara. Mbizotëronte alarmi dhe frika. Gjithkund dominonte frika vdekjeprurëse dhe pikëllimi.

Ndërsa në roje, në vrojtore, qëndronte legjionari romak. Rreth tij dëgjoheshin vetëm britmat e njerëzve të tmerruar. Në çdo anë vdekje. Kurse ai guximshëm dhe me durim rrinte pa lëvizur. Për të betimi për atdheun dhe obligimin ndaj tij ishin më të çmueshëm dhe më të vlefshëm se jeta e tij. Duke qëndruar i mbështetur në shtizën e vet, vdiq. E gjetën 19 shekuj më vonë gjatë gërmimeve arkeologjike me trimërinë e këtij njeriu. Me qëndrimin e tij të vendosur ndaj pari-

mit të obligimit dhe besnikërisë ndaj atdheut, dëshmoi se ishte karakter i përkryer. Ta kujtojmë se ai njeri me siguri ka besuar në shumë zota, e nuk ka pasur rast ta dëgjojë Fjalën e Zotit. Ai me siguri nuk ka dëgjuar për virtytet që predikon Mësimi i Zotit.

Ndërsa ti, që e ke njohur Islamin dhe thirrjen e Islamit drejt virtyteve të mrekullueshme, drejt përsosmërisë së shpirtit, mund ta paramendosh se çfarë karakteri i ndritshëm duhet të jetë karakteri i një ithtari të vërtetë të Fjalës së All-llahut xh.sh.!

Cilësitë e njeriut të karaktershëm janë: të jetë besnik, të jetë besimtar, të jetë mbështetje e fortë për mikun dhe shokun. Ai e do të drejtën dhe të vërtetën. Ai është i dashur, i ndershëm, i qetë, fisnik i mirë. Është trim dhe i vendosur. Ka vullnet të fortë, që nuk njih pengesa, që thyen të gjitha vështirësitë. I provuari bëhet më i mirë dhe më i fortë. Çdo gjë në fillim duket si shkuma e detit, si pika të imëta të shiut. Mirëpo, me kohë shprehia nga shkuma e detit rritet në një valë gjigante, kurse pikat e shiut shndërrohen në vërshimë të fuqishme.

Samuel Smile ka shkruar:

*“Mbill Mendimin, do të korrësh Veprën,
Mbill Veprën, do të korrësh Shprehinë,
Mbill Shprehinë, do të korrësh Karakterin,
Mbill Karakterin, do të korrësh Fatin”.*

Karakteri është fryt i një pune të gjatë dhe të vështirë, fryt i vetedukimit, i një lufte të gjatë dhe të mundimshme me vetveten, fryt i vetëmohimeve të

panumërta. Ai nuk fitohet rastësisht ose në ndonjë moment të këndshëm. Thuhet për njeriun se është i karaktershëm në qoftë se u përmbahet vijimisht e me guxim dhe pa kompromis parimeve të veta, madje edhe atëherë kur jo qëndrueshmëri kërkon zemërgjerësi dhe durim.

Njerëzit me karakter janë të lidhur për parimet e veta, për idealet e veta, gjithmonë dhe gjithkund. Për ta nuk ka shmangie, nuk ka tradhti, nuk ka ikje. Ata, si shkëmbij, si shkrepë të formuar, qëndrojnë guximshëm, besnikë dhe me nder ndaj bindjeve dhe parimeve të tyre.

Ja një ngjarje e vërtetë për një njeri të madh, i cili kishte karakter të jashtëzakonshëm.

Në historinë e muslimanëve të parë është i pashlyeshëm emri i Bilalit të ndershëm e fisnik. Ai e pranoi Islamin në Mekke. Ishte skllav, ndaj skllavopronarit i tij filloi ta persekutonte për shkak të bindjeve të tija islamike. E shante, e rrinte, e pështynte, e ngarkonte me gjëra të ndyta, e detyronte të kryente punët më të rënda. Mirëpo, Bilali nuk u luhat. Ai u bë gjithnjë e më i fortë në besimin e tij, pamarrë parasysh vuajtjet, të cilave u ishte ekspozuar.

Meqë të gjitha këto të këqija të skllavopronarit nuk thyen Bilalin, ai i urdhëroi skllavërit e tjerë që ta lidhin Bilalin dhe ata e dëgjuan. Pastaj e shtruan në zallin e zjarrtë, ndërsa në gjoks ia vunë një shkëmb të madh... Dielli i zjarrtë i Arabisë përcëllonte, djersët e mbulonin Bilalin, shpina i digjej, e barku dhe kraharori sikur i thërrmoheshin nga dhembjet e barrës së rëndë të shkëmbit. Pronari kërkonte nga ai që ta mohonte

All-llahun xh.sh. dhe të hiqte dorë nga Islami, duke i premtuar se nëse e bënte këtë, do të lirohej dhe do të shpërblehej me pasuri të madhe.

Mirëpo, Bilali mbante në vete fuqi të madhe besimi. Nga vuajtjet dhe dhembjet herë-herë e humbte vetëdijen. Me buzë të shkrumuara, me gjuhë të ënjtur, me ngulm dhe me qëndresë e me plot ngadhënjim i shqiptonte fjalët: *"Zoti është Një, Zoti është Një!"* Dhe sa më të mëdha që ishin mundimet aq më i fortë bëhej besimi i Bilalit. Shpirti dhe zemra e tij ishin rritur në besim, duke synuar drejt lartësive më të mëdha shpirtërore. Vdekja sikur i afrohej, por Bilali guximtar, vazhdimisht përsëriste: *"Zoti është Një, Zoti është Një!"*

Të pafetë mund ta rrokullisnin edhe kodrën mbi Bilalin, mund ta hidhnin në kazan me ujë të valë, mund ta hidhnin në flakën e zjarrit të ndezur. Të gjitha këto mund t'i bënin ata, mirëpo Bilali kurrë nuk do ta mohonte besimin e vet në All-llahun xh.sh., kurrë nuk do ta tradhtonte peygamberin e vet, Muhammedin a.s., kurrë nuk do ta tradhtonte Islamin. Bilali që një besimtar i vërtetë, Bilali u shpërbley me durim.

Prandaj skllavopronari nuk arriti ta thente besimin e Bilalit. All-llahu xh.sh. e mëshiroi atë. E bleu hazreti Ebu Bekiri dhe e liroi nga robëria. Bilali u bë muezin i parë i muslimanëve dhe njëri nga as'habët, të cilëve qysh në këtë botë u ndriçoi me mëshirën e Vet. Bilali mbeti në histori shembull i durimit në vuajtje dhe shembull i karakterit të pathyeshëm sa të ekzistojë kjo botë.

Prandaj edhe ky tregim nga kohët e lashta flet qartë për fuqinë e karakterit njerëzor.

Buzë lumit të pasur me ujë, diku në trojet e Irakut të sotëm, jetonte familja e besimtarit të mirë, Abdull-llahut... Anëtarët e saj pajtoheshin mjaft mirë dhe jetonin në dashuri dhe paqe. Një itë u trokiti vdekja në shtëpi. Abdull-llahu bujar e i mirë ndërroi jetë. Para se të vdiste, djalit më të madh i tha në besim se e kishte fshehur në tokë thesarin që pas një kohe djemtë e tij duhet ta nxjerrin dhe të fillojnë ta shpenzojnë për shkollimin e tyre. Disa ditë pas vdekjes së babait, djali i madh u nis për rrugë që t'i vizitonte disa miq të babës, të cilët jetonin në shtetin fqinjë. Pas tri ditë udhëtimi, në errësirën e natës, arriti në një vendbanim të vogël. Duke mos e ditur rrugën arriti te një kopsht i bukur. Errësira tranimë e kishte kapluar dheun. Rojtari i kopshtit dëgjoji se po vinte dikush, e duke menduar se ishte ndonjë hajn, filloi ta ndiqte djaloshin me shkop. Ky u frikësua dhe filloi të ikte nëpër terr. Rojtari ishte në moshë dhe, duke vrapuar, u rrëzua dhe e theu kokën në një gur të madh. Fqinjët, kur e dëgjuan bërtimën dhe zhurmën në kopsht, dolën me vrap nga shtëpitë e tyre dhe e zunë djaloshin. Ai u tregonte se ishte udhëtar, dhe se e kishte zënë nata pikërisht para vendbanimit të tyre, por nga mosdija kishte hasur në kopsht. Në ndërkohë, vendasit e gjetën rojtarin e vdekur – me kokë të thyer. Lindi dyshimi se djaloshi ishte vrasës. Ishin të kota të gjitha pohimet dhe shpjegimet e tij se ai ishte krejt i pafajshëm. Të nesërmen e nxorën në gjyq, para kadiut.

Fakte të shumta flisnin kundër djaloshit, prandaj kadiu e dënoi me vdekje. I dërrmuar nga lodhja e dhembja, ai i luti vendasit që ta lejonin të shkonte në

shtëpi që të mund t'u tregojë vëllezërve të vet vendin se ku e kishte fshehur babai thesarin, duke u premtuar se brenda tri ditësh do të kthehej. Kadiu, duke menduar se vëllezërit e tij do të mbeteshin pa pasuri, në qoftë se nuk do të fitonin trashëgiminë, pranoi kërkesën e djaloshit, por vetëm me një kusht që të garantonte dikush se do të kthehej. Nëse djaloshi nuk do të kthehej, atëherë dorëzani do të ekzekutohej në vend të tij. Pllakosi heshtja. Sikur humbën të gjitha shpresat. Mirëpo, përnjëherë, nga thellësia e sallës së gjykatës, jehoi një zi i fuqishëm: "Unë garantoj me jetë për djaloshin". Ai është njeri në moshë mesatare, i njohur i ndershëm dhe bujar. Djaloshi e përqafoi njeriun dhe ia shtrëngoi dorën, duke i thënë: "Do të vij, nëse do Zoti, me kohë"! Shaloi kalin e vet dhe me vrap u nis në drejtim të qytetit të vendlindjes së vet.

Ditën e tretë, në perëndim të diellit, e tërë qyteza ishte çuar në këmbë, duke pritur se a do të kthehej djaloshi, sepse, përndryshe, bashkëqytetari i tyre do të ekzekutohej në vend të tij. Dhe, kur tanimë kishin filluar ta humbnin shpresën, në horizont u dukën retë e pluhurit. Ishin djaloshi me kalin e tij. Që të dy të larë në djersë dhe të mbuluar me pluhur, arritën në qytet. Besa e dhënë nuk u shkel. Të gjithë ishin të habitur dhe të prekur me besën e mbajtur të djaloshit. Besa e dhënë nuk u thye, edhe pse kjo nënkuptonte vdekjen. Këshilli gjyqësor, në krye me kadiun, u bindën se me të vërtetë kishin të bëjnë me një djalosh besnik, me karakter të fortë dhe të jashtëzakonshëm. Ata e pranuan si të vërtetë deklaratën e mëparshme të djaloshit dhe e liruan,

duke i dhuruar shumë dhurata për miqësi të përbetuar e të përhershme.

Kur e pyetën bashkëvendasin e vet se si ka mundur të garantojë për njeriun e panjohur, ai u përgjigj: “E kam ndjerë në thellësi të zemrës sime se kam të bëj me një njeri të ndershëm. Më ka ardhur keq për vëllezërit e tij. Kam dashur t’i tregoj atij, juve dhe vetes se duhet t’i besojmë njerëzisë dhe virtytit të karakterit!”

Në shkretëtirën e Libisë, në kohën e ekspeditës ushtarake të Lekës së Madh (356-323 para Isait a.s.), kur dielli i zjarrtë afrikan përcëllonte dhe tmerrësisht e kishte marrë etja, kur i ofruan ujë që ta shuante etjen, ai nuk e piu, por e derdhi në rërë, duke thënë këto fjalë: “Për mua është tepër, ndërsa për të gjithë ushtarët e mi është shumë pak”.

Edhe ai, Leka i Madh, ishte njeri me karakter, ndaj nuk desh të pinte ujë vetëm, ndërsa ushtarët e tij të mbeteshin të etshëm. Këto fjalë dhe gjesti i tij human u dhanë fuqi të madhe ushtarëve të tij dhe, duke u forcuar shpirtërisht, ata i përballuan të gjitha vështirësitë e shkretëtirës.

Njerëzit me karakter të fortë janë të pakompromis në jetën e tyre dhe kur e lyp puna t’i tregojnë virtytet e karakterit të tyre, ata shkëlqejnë me dritën e tyre të plotë, duke depërtuar deri në fijet më të holla e këndet më të vogla të jetës ashtu siç depërton drita e diellit edhe deri në hapësirat më të largëta. Stoli e vlerave njerëzore është madhështia e karakterit. Gjatë historisë së fisit njerëzor, me anë të shembujve të këtillë, gjeneratat mësuuan shembuj të rinj.

Është e arsyeshme që prindërit, që nga ditët e para të fëmijërisë, t'i mësojnë dhe t'i edukojnë fëmijët e tyre që të bëhen shembuj karakteri të fortë. Duhet t'i mësojmë e t'i provojmë edhe në zjarr që të kaliten në këtë zjar e të bëhen njerëz të vërtetë. Fëmijët le të ballafaqohen nganjëherë edhe me hidhërime e dëshpërime që të dalin nga ato edhe më të mirë dhe më fisnikë. Romakët e vjeteër thoshin: "Palma rritet nën peshë". Sa më e madhe të jetë pesha aq më madhe do të jetë palma!" sa më e madhe të jetë përpjekja e shpirtit dhe e trupit, aq më i madh e më i rëndësishëm do të jetë njeriu!

Sikur të rinjtë të mësonin nga historia dhe nga jeta për virytet, e karakterin e tyre t'i shpienin në lartësitë më të mëdha të mundshme, sa më shumë lumturi do të kishte në zemrat e njerëzve!

T'u qëndrosh besnik parimeve tua dhe të durosh për to - është vepër e madhe. Për sprova në fatkeqësi kërkohte guxim, kërkohet besim në Një Zot. Për sprova, në thirrje parësore ngadhënjyese, kërkohet besim i guximshëm. Djelmoshat dhe vajzat e këtilla, që me ngulm qëndrojnë si shkëmb i përkulur, përfaqësojnë flamurin e viryeteve. Ata janë tregues historikë dhe shkëlqejnë si yj të ndritshëm.

Të dëgjojmë se çfarë vargje të mrekullueshme për karakterin ka kënduar Hikmet Arif Rizvanbegović – Stoçević (1839-1903):

*"Të ngritesh lart nëse dëshiron,
Në një parim ndalesh e qëndron.
Aty ndalu i fortë si shkëmbi,*

*Se zakon s'e ka njerëzia,
Të ndërrojë vetë bindjet e tija!*

*Në qiej të kaltërt shikimin e hidh.
Yj pararendës atje me sy vidh,
Asfarë drite ata nuk japin,
Yjt' e qëndrueshëm kur ndriçojnë,
Dritë fisnike përherë lëshojnë.*

Shpërblimin për karakter të mrekullueshëm dhe
jetë të nderhme, për jetë me vlerë më të lartë, e jep
All-llahu xh.sh.

Qëndresa

Në det, para hyrjes në liman, është një shkëmb. Në shkëmbin e vetmuar është një fanar, i cili ua ndriçon rrugën anijeve. Ky fanar është ndërtuar kaherë. Shihen brigjet kur vrenjtet qielli, kur lëshohen retë e zeza dhe kur tërbohet deti i valëzuar. Mezi hetohet drita e fanarit. Valët e larta me fuqinë e tyre, përplasen furishëm për shkëmb, për fanar. Sikur të duan t'i shkatërrojnë, t'i shlyejnë nga faqja e dheut. Mirëpo, më kot! Shkëmbi qëndron trimërisht si roje, në rojë të përherëshme. Qëndron edhe fanari. Deti e bren, e sulmon, përplasat për të. Mirëpo, ai nuk tundet aspak! Shkëmbi është i rrethuar me det, i harlisur tmerrësisht në zemërimin e vet. Djaloshi guximtar është si ky shkëmb, si ky fanar. Karakteri i tij është i qëndrueshëm si ky, i bën qëndresë turrit dhe gjëmës së valëve. Ato, të pafuqishme, shkatërrohen duke u përplasur në shkëmb dhe për asnjë moment nuk e luhasin qëndresën e tij. Ndërsa drita e shpirtit ë tij është si drita e fanarit që shndrit dhe me dritë të qartë, madje edhe atëherë kur ndeshen retë e errëta, sprovohet kur ndeshet me gjëmën e stuhisë.

Prandaj, ta kujtojmë gjithnjë shkëmbin dhe qëndresën e tij në detin e tërbuar, ta kujtojmë gjithmonë djaloshin me karakter të fortë. Ai nuk e ndërron bindjen e vet, nuk heq dorë, është i qëndrueshëm si shkëmbi. Karakteri i fortë mbetet gjithmonë shembull për ata, që

e pasojnë atë. Ai nuk është dragua prej letre, të cilin e bartin erërat ku të duan. Ai nuk u dorëzohet pasioneve dhe veseve që ta mposhtin dhe ta shpiejnë në përqafimin e rrugëve të panjohura dhe të dyshimta.

Në ditët e para të thirrjes së të dërguarit të Zotit Muhammedit a.s., ndër të tjerët pranuan Islamin Habab ibni Mundhir, Jasiri dhe Sumejja. Të pafetë i venë në mundime të tmerrshme, duke kërkuar prej tyre që ta mohojnë All-llahun xh.sh. dhe që ta braktisin Islamin. Edhe pse zemrat e të persekutuarve pikonin gjak nga mundimet e tmerrshme, Hababi, Jasiri dhe Sumejja nuk e mohuan Zotin dhe nuk e tradhtuan besimin e tyre. Më në fund, Jasiri vdiq nga mundimet, kurse Sumejja trime ndërroi jetë e shpuar me shtizë. Hababi shpëtoi, por deri në fund të jetës mbetën tek ai gjurmë të vuajtjeve të tmerrshme. Më vonë ai shpesh i tregonte si dëshmi të tërbimit të idhujtarëve.

Këta trima kishin moral shkëmbor, karakter të qëndrueshëm, të cilët me shpirtin e tyre u bënë ballë valëve të detit të pafeve të tërbuar.

Para luftës në Bedër (më 17 Ramazan të vitit 2 sipas Hixhrit) i Dërguari i Zotit i ftoi as'habët në këshillim për luftën që do të zhvillohej. Përkundër fuqisë së të pafeve (mushrikëve), asnjëri nga të pranishmit nuk u luhat, por të gjithë qëndruan vendosmërisht me Resulull-llahun a.s., duke i dhënë përkrahje të plotë.

El-Mikdadi tha: "O, Pejgamber i Zotit! Shko asaj rruge që ta tregon All-llahu. Ne do të vijmë pas teje. Ne nuk do të themi siç i thanë bijtë e Izraelit Musait a.s.: -Ti dhe Zoti yt shkoni dhe luftoni, kurse ne do të

mbesim, por po të themi: - Lufto me ndihmën e Allahut dhe ne do të luftojmë bashkë me ty”.

Ensari Sa’d bin Mu’az tha: “Ne besojmë në pejgamberinë tënde, ne të shfaqin besnikërinë tonë, ne dëshmojmë se është e vërtetë ajo që na ke përcjellë nga All-llahu xh.sh. ne ta kemi dhënë fjalën dhe jemi marrë vesh se do të dëgjojmë dhe do të vijmë pas teje. Shko ku të duash, ne jemi me ty. Për Zotin, nëse kërkon prej nesh që ta kalojmë detin, ne do ta kalojmë, do ta kalojmë bashkë me ty. Asnjë njeri nuk do të mungojë. Ne nuk frikohemi nga konflikti me armikun. Ne kemi përvojë dhe jemi me mish e shpirt për luftë. Na prij në luftë me ndihmën e All-llahut!”.

Ja, shkëmbinj të tillë e tyen të keqen e të pafeve dhe paralajmëruan periudhë të re në historinë e njerëzimit. Kurrfarë fuqie e mynxyrës dhe e tërbimit nuk mundi ta thyejë të mirën që e bartnin në zemrat e tyre këta trima muxhahidinë. Përpyekjet e tyre fisnike bartnin me vete dritën e fitores së madhe.

Në Bedër, në agun e mëngjesit, të pafetë (mushrikët) e mësynë ushtrinë muslimane. Pluhuri përzihej në shakullimë, dëgjohej vringëllima e shpatave, trokëllima e këmbëve dhe hingëllima e kuajve dhe e deveve... Marshin e tyre të luftës e shoqëronte muzika. Të fuqishëm dhe të armatosur mirë, të ngopur, ishin tri herë më shumë se muslimanët, të cilët nuk kishin mjaft armë, parzmore e as kuaj. Jobesimtarët sulmuan si valë e fuqishme e detit të tërbuar. Ndërkaq, luftëtarët muslimanë qëndronin si shkëmb, të fortë, të qëndrueshëm dhe të pathyeshëm. Qëndronin trimërisht, pa fije frike, të gatshëm të vdesin çdo moment për çështje të Islamit.

Muhammedi Resulull-llah a.s. me zë të lartë lutej:

“O All-llah, ja si po vijnë Kurejshitët kryelartë dhe të krekosur, duke të mohuar Ty dhe duke më quajtur mua, pejgamberin Tënd, gënjeshtar. Dhurona ndihmën që ke premtuar. Zhduki këtë mëngjes!”

Sulmuan të pafetë me zemërim të tëruar kundër çdo gjëje që nënkuptonte dashurinë, shpëtimin dhe paqen. U vërsulën që ta shkatërronin të mirën që kishte aguar në horizont... Mirëpo, me ndihmën e All-llahut xh.sh., shkëmbi i fortë, graniti i muxhahidinëve i shkatërroi si pluhur. Muxhahidinët, me besimin e zemrës, i thyen fuqitë e errëta, duke hapur rrugë të reja, me dritë të madhe, e cila nuk do të shuhet kurrë më.

Dikur, moti, ndodhi kjo luftë e madhe. Kjo ishte luftë ndërmjet dritës dhe errësirës, luftë ndërmjet së mirës dhe së keqes.

Muminët mësojnë nga shembujt e këtyre trimave se si duhet qëndruar me të mirën kundër së keqes, se si duhet bartuar në shpirtin e vet luftën për të fituar çdo gjë të bukur, kundër veseve dhe anëve të këqija që na kapërdisin. Ata mësojnë se si duhet spastruar shpirtin e tyre që të shndrisë me shkëlqimin më të bukur që të niset me guxim drejt përsosmërisë së vet.

All-llahu xh.sh. dhe melekët u ndihmuan luftëtarëve islamë në luftën e Bedrit. All-llahu xh.sh. dhe engjëjt, nëse Ai do, do t'i ndihmojë përpjekjet e mira të muminëve në marshimin e tyre drejt përsosmërisë së shpirtit. Në rrugën e mirë, në mbrojtje të së drejtës dhe së vërtetës djaloshi fisnik dhe vajza fisnike gjithmonë do të jenë shkëmb i pathyeshëm.

Qëndresa në parime

Njëri nga tiparet themelore të muminit është qëndresa dhe të përmbajturit e tij ndaj parimeve të përveçësuar. Ai u qëndron besnik idealeve të veta fisnike edhe atëherë, kur të gjitha fuqitë e këqija ngriten kundër tij, madje edhe atëherë kur mbetet i vetmuar. Të përmendim qëndresën heroike të Pejgamberit të Allahut, Muhammedit a.s., në misionin e tij të madh dhe në thirrjen e tij në rrugën e Zotit.

Në kohën e bojkotit kundër muslimanëve në Mekke, në vitet e para të përhapjes së Islamit, mushrikët (jobesimtarët) përpiqeshin që në çdo mënyrë ta pengonin Muhammedin a.s. Shfrytëzoznin të gjitha mjetet, nga frikësimi deri te torturimet me uri. Më në fund i drejtohen axhës së Pejgamberit a.s. me kërkesë që ai të ndikojë që ai të ndikojë te Muhammedi ë të heqë dore nga misioni dhe rruga e vet. I kishin premtuar pasuri të madhe, kuaj, deve, gra, tenda, vetëm e vetëm që ta pranonte kërkesën e tyre.

“Sikur të ma vinin diellin në dorën e djathtë e hënën në të majtën, nuk do të largohesha nga misioni i All-llahut. Po qe se do të detyrohesha të zgjedh mes të mirve të ofruara dhe zhdukjes, do ta zgjedhja zhdukjen”.

Ebu Talibi, i prekur nga këto fjalë, i thotë Muhammedit a.s.: “Atë që do, prediko. Unë nuk do të lë vetëm kurrë dhe do të mbrojë nga të gjithë armiqtë derisa të marr frymë. Karakteri yt po më mahnit”.

Shembullin e qëndrueshmërisë ndaj këtyre parimeve nuk duhet harruar kurrë. Muhammedi a.s. ishte plotësisht i dhënë pas pasionit të vet, prandaj ishte i gatshëm të jepte dhe të sakrifikonte çdo gjë që kishte për të, qoftë edhe jetën e vet të shtrenjtë.

I riu që i ka dhënë vetes detyrë të arrijë lartësitë më të larta shpirtërore, duhet të qëndrojë patjetër i papërkulur, i fortë dhe besnik i parimeve të veta. Asgjë në botë nuk duhet ta pengojë në qëndrueshmërin e tij fisnike, në rrugën e tij të madhe drejt shpëtimit të amshueshëm.

Qëndresa për të kultivuar virtytet e bën njeriun të madh dhe të fortë. Rëndësia e rritjes së tij arrin deri në përmasa të papara. Gjithkund i hapen dyert e njohurive të fshehta deri atëherë të panjohura.

Kur dikush e përqesh dhe e fyen njeriun e mirë për shkak të bindjes së tij, nuk duhet luhatur, por guximshëm, qetë e me fjalë të mira duhet shprehur të vërtetën tënde në këtë mënyrë: "Nuk është mirë, nuk është e denjë të fyhen njerëzit për bindjet e tyre ose për qëndrimin e tyre në jetë. Këtë e bëjnë vetëm joto-lerantët, fodullët dhe egoistët. Vëllai im, mendo dhe përpiqu ta kuptosh tjetrin. Dëgjo se ç'thotë ai. Ndosh-ta pikërisht aty qëndron e vërteta!

Kur mumini sheh se si sulmojnë arrogantët, se si fyejnë dhe përbuzin dikë që është më i dobët se ata, ai vepron guximshëm për mbrojtjen e të rrezikuarit. Ai nuk do të lejojë të ngadhënjejë dhuna mbi të drejtën dhe ta poshtërojë dinjitetin njerëzor. Kjo sjellje fisnike është parim i njerëzve të karaktershëm, i atyre që ndjekin rrugën e drejtë.

Shpeshherë në pranverë, kur tërë natyra gjelbërohet, kur kundërmon era e luleve dhe e beharit, kur rrezon dielli dhe natyra josh në ajër të pastër, nxënësi duhet të ulet buzë tavolinës së punës dhe t'i kryejë detyrat e veta shkollore. Nesër e pret provimi i vështirë. Dëgjohet zhurma afër dritares. Shokët lozin dhe e ftojnë, qofte edhe një çikëz (pakëz) të luajë edhe ai. Dhe ja sprova e rëndë. Mirëpo, nxënësi me karakter të fortë i di parimet: duhet të qëndrojë në parimet e veta. Parim në këtë çast – është kryerja e detyrave shkollore, përgjigjja e përgatitur për ditën e nesërme. Jogatishmëria nuk është karakteristike e muminut. Ai patjetër duhet të jetë nxënës shembullor. Kjo është detyra e tij.

Dhe vërtet nxënësi i këtillë, përkundër thirrjes joshëse, qëndron vendosmërisht pranë librit të vet. Ai është i karaktershëm, besnik ndaj detyrave dhe parimeve të veta. Në këtë moment lufta e tij vendimtare është e lidhur me tavolinën e punës, është e lidhur me librin e tij. Ky është obligim mbi të gjitha. Ndërsa pas nxënies së mësimin, pas kryerjes së detyrave, ai shkon te shokët e vet, bashkohet në gëzimin e lojës, shkon në shëtitje, i gëzohet diellit dhe pranverës. Sa gëzim më i madh e më i plotë ndjehet atëherë dhe sa thellë përjetohet! Sepse, përkundër sprovave nxënësi ka qëndruar në parimet e veta. Tani gëzimi është i dyfishtë: ngadhë njen mbi sprovat dhe bukurinë e natyrës.

Në mëngjes kur muezini thërret për namazin e sabahut, mumini, pa pengesa, pa hamendje, brof shpejt në këmbë dhe fillon të marrë abdest me thirrjen:

*All-llahu është më i madh, All-llahu është më i madhi;
Besoj se nuk ka tjetër Zot, përveç All-llahut,*

Besoj se Muhammedi është Pejgamberi i Zotit

.....
Është më mirë të falësh salat (namaz) sesa të flesh...

ai shpejton të qëndrojë para Krijuesit të vet. I betohet All-llahut në besimin e parimeve islame, E lut për ndihmë në luftë, për lulëzimin e shpirtit të vet. Pas namazit zemra mbushet gëzim, shpirti është i qetë, sepse thirrja për namaz nuk është refuzuar. Janë respektuar parimet.

Edhe në përpjekjet e vogla, edhe në pengesat e imëta, duhet qëndruar besnik ndaj parimeve të tua, obligimet e tua duhet të përpiqesh t'i zbatosh në jetë. Besnikërinë ndaj idealeve duhet zhvilluar prej djepi e deri në vdekje. Qëndresa duhet të jetë e paluhatshme dhe e vazhdueshme.

T'i kujtojmë të dërguarit e Zotit Ibrahimin e Jakubin (paqja qoftë me ta!) si shembull të qëndrueshmërisë dhe të durimit ndaj idealeve të tyre. Ata jo vetëm që qëndruan vetë si shkëmb i pathyshëm në fenë Islame, por idealet e përqafulara ua lanë edhe fëmijëve të tyre si emanet i shenjtë. Dhe, në momentin e vdekjes, nuk duhet ta harrojnë këtë detyrë.

"E kush largohet prej fesë së Ibrahimit, përveç atij që poshtëron vetveten. Ne atë e bëmë të zgjedhur në këtë botë, kurse në botën tjetër ai është nëri prej të lartëve. Kur Zoti i vet atij i tha: Dorëzohu! Ai tha: iu kam dorëzuar Zotit të gjithësisë! E Ibrahim i porositi bijtë e tij me këtë (fe), e edhe Jakubi. (U thanë) O bijtë e mi, All-llahu ua zgjodhi fenë (islame) juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë muslimanë! A ishit ju (ithtarë të librit) dëshmitarë kur Jakubit iu afrua vdekja, e ai bijve të vet u tha: Çka do të

adhuroni pas meje? Ata thanë: Do të adhurojmë Zotin tënd, dhe Zotin e prindërve të tu: Ibrahimit, Ismailit, Is-hakut, një të vetmin Zot dhe ne, vetëm Atij i jemi dorëzuar!"

(Kur'ani, 2:130-134)

Tani dëgjo se si gruaja e Imranit frytin e barkut të vet, qysh atëherë e dorëzon në shërbim të qëllimit të lartë.

"Kur gruaja e Imranit pat thënë: Zoti im, unë këtë që është në barkun tim vendosa ta kushtoj thjesht vetëm për shërbimin Tën, pra pranoje këtë prej meje, vërtet Ti je Ai që dëgjon e di!"

(Kur'ani, 3:35)

Të keqes duhet thënë: jo!

Në furtunën e jetës, sprovat ndeshin në shpirtin e njerëzve të rinj. E keqja synon ta mposhtë të mirën në çdo zemër. Kjo është luftë e pandërprerë. I riu me karakter të fortë çdo të keqeje vendosmërisht i thotë: “Jo”. Motoja dhe parimi i tij është: Kurrfarë lëshimi pe ndaj të keqes! Në këtë luftë ai mësohet si të bëhet njeri i vërtetë. Këtu dobësia dhe butësia nuk duhet të kenë vend.

Çdo njeri, në shpirtin e vet, mund të korrë fitore të së mirës. Për këtë ndërmarrje ekzistojnë potenciale të mjaftueshme fizike dhe shpirtërore. Mirëpo, ato duhet të nxiten. E nxitje është: Të jesh tamam njeri, të shkosh rrugës së ndershme, rrugës së ndritshme, të ecësh rrugës që të shpie drejt përsosmërisë së shpirtit.

Sado qofshin joshëse thirrjet e shumta, të cilat të largojnë nga qëllimi më i lartë, nuk mund të gjejnë as më të voglën shprehje në shpirtin e të riut, i cili ka vendosur të jetojë për të përhershmen (botën tjetër) e që nuk do të vdesë përgjithmonë në këtë botë.

Në fund të rrugës së shenjtë qëllimi është i mrekullueshëm – shpirti i pastër si pikat e ujit më të kthjellët të përroit malor, si bora më e bardhë e majeve të maleve më të larta. Djaloshi trim dhe vajza trime duhet të marshojnë drejt majeve më të larta të shpirtit.

Sa mirë është të shohësh djaloshin kur gjen fuqi dhe guxim, që fotografisë pornografike, shund literaturës, vendosmërisht dhe trimërisht i thotë “Jo”. Çfa-

rë mrekullie është, kur thirrjes joshëse të shoqërisë, guximshëm i thotë "Jo".

Kur shokëve e miqve që e ftojnë për argëtim, ku fshihen veset, të metat e pasionet si shigjeta helmuese, me guxim dhe vendosmëri u thotë "Jo".

Provokimeve e nxitjeve, që nuk të shpiejnë kah e mira, gjithmonë duhet thënë "Jo". Për këtë duhet gjetur fuqi. "Jo" dhe për të njëqindtën herë "Jo", për gjithçka që të largon nga rruga, e cila të shpie kah e mira. Në rrugën e së mirës duhet ngadhënjyer.

T'i kujtojmë Idrizin, Nuhun, Salihun... se si trimërisht qëndruan në anën e së vërtetës (shpëtimi qoftë mbi ta!) dhe për asnjë fije nuk deshën të shmangen nga rruga e misionit të tyre. I kërcënuan, e kur e panë se nuk patën sukses, u ofruan pozita, dhurata e pushet. Mirëpo, ata i refuzuan të gjitha dhe të keqes dhe pasioneve vendosmërisht gjithmonë u thanë "JO".

I riu duhet të jetë shqiponjë që fluturon lart, e jo zvarranik që zvarritet nëpër dhé.

I urti Hasan Basri shkruante: "O njeri! Bëhu i matur dhe syçelë, sepse njeriu shpesh merr helm, do të thotë gjendet atje ku nuk ka vendin dhe rri me shoqëri, e cila e shpie kah e keqja. Dhe kështu pak nga pak dobësohet besimi i tij, ndërsa ai nuk e heton fare këtë".

Dhe vërtet, nëse njeriu nuk është i vendosur në qëndrimet e tij fisnike dhe nuk di ose nuk mund t'u kundërvihet të metave e pasioneve, mund të bjerë lehtë në rrjetën e merimangës, në fuqinë e errësirës, e cila e shpie në humnerë të përhershme, e shpie kah dyert e xhehennemit. Shpesh, shumë shpesh, i riu edhe nuk e heton se si. Ai dalëngadalë falimenton.

Hap pas hapi lëshon dhe në pjerrësirën e lëmueshme, fatkeqësia nuk ka ta ndalur, me përjashtim kur ndihma vjen nga All-llahu xh.sh.

Muhammedi Resulull-llahu a.s. e luti All-llahun xh.sh.:

“Kërkoj mbrojtje në Fjalët e përsosura të Zotit që të më ruajë nga të gjithë shpritzetztë që ka krijuar.

Kërkoj mbrojtje tek All-llahu nga e keqja që e di dhe nga e keqja që nuk e di.

Kërkoj mbrojtje tek All-llahu nga e keqja që e kam bërë dhe nga e keqja që nuk e kam bërë”.

Zemra heroike

Rinia është periudhë me plot energji, dëshira, shpresa dhe përpjekje për trimëri dhe heroizma të mëdha. Në të vërtetë, kjo është periudha më e rëndësishme e jetës. Sikur kjo periudhë e rëndësishme dhe e shkëlqyer të ishte përherë e ndërlidhur dhe e mbushur me vepra të mëdha e fisnike! Sa më me përmbytje dhe më e bukur do të ishte rinia! Sa më shumë lumturi do të kishte që në fillim të jetës!

Ndoshta do të pyesësh: çka mendoj kur them vepra të mëdha fisnike?

Nuk mendoj për vepra, që e trondisin botën, nuk mendoj për famën që hyn në histori. Përse nuk mendoj për këto?

Kjo i është dhuruar rrallëkujt. Të paktë janë ata, të cilët janë shënuar në vepra historike, emrat e të cilëve mbesin të shkruara në përmendore.

Unë po flas për vepra, për vepra të mëdha, që mund t'i bëjë çdo djalë i ri dhe çdo vajzë e re. Kjo është e arritshme për të gjithë. Flas për mundin, përpjekjen që të arrihet fitorja e madhe, fitorja e mirëfillë në betejën vendimtare të jetës, që zhvillohet në shpirt ndërmjet së mirës dhe së keqes. Në këtë betejë, fitorja e së mirës shpie kah drita e shpirtit, kah përsosmëria shpirtërore.

Të qëndrosh në këtë betejë, të jesh i fortë dhe i guximshëm, dukemos u larguar asnjë hap, dhe të korrësh fitore është heroizëm i vërtetë. Për këtë vepër

lyspet zemër heroike. Kjo do të ishte vepër e trimave sypatrembur.

I dashuri All-llah xh.sh. e kërkon këtë heroizëm, e kërkon këtë vepër heroike nga besimtari, nga mumini besnik. E ky heroizëm, kjo trimëri është thurur prej shumë trimërive të vogla, por të panumërta, që e përmbushin tërë rininë dhe tërë jetën.

Të mirat e vogla të përditshme, ndërmarrjet dhe aksionet e vogla në rrugën e së mirës, ndoshta në shikim të parë duken të parëndësishme dhe të pahetueshme, mirëpo në thelb ato janë shumë të rëndësishme! Kjo është detyrë e zemrës së muminit. T'u bësh mirë njerëzve, shtazëve, bimëve, gjithçkafes që ekziston. Të qëndrosh në një rrugë të këtillë lypset zemër heroike.

Duhet të jesh i mëshirshëm, të jesh punëtor, i sinqertë dhe i kujdesshëm, të gjitha virtytet e kësaj bote t'i shndërrosh në vepra. Përkundër temperamentve dhe sjelljeve të njerëzve ndonjëherë të çuditshme, duhet ofruar Dashuri të Madhe me të cilën Islami e ushqen zemrën e njeriut.

Për kryerjen e veprave më të bukura vërtet duhet pasur guxim.

Ndoshta historia nuk do t'i përmendë kurrë emrat e atyre, që dëshmuan përpjekjet e tyre në bamirësitë dhe në trimëritë më të vogla. Ndoshta pas vdekjes askush as nuk do t'i kujtojë e as nuk do t'i shënojë emrat e tyre. Ndoshta pluhuri i harresës njerëzore krejtësisht do ta mbulojë ekzistencën e tyre në këtë botë... Ndoshta...

Por, dije me siguri se çdo vepër, çdo gjë, qoftë edhe më të vogël, Zoti i dashur e sheh. Në ndërmarr-

jet për vepra të mira duhet të jemi të vendosur, të palodhshëm dhe guximtarë. Për vepër të mirë, sado e vogël qoftë, duhet pasur guxim dhe duhet qëndruar fuqishëm në realizimin e saj.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Është më e mirë ajo vepër në të cilën njeriu ngul këmbë dhe e shpie deri në fund, qoftë ajo edhe vepër sado e vogël”.

Me rëndësi është të dimë se All-llahu xh.sh. kurrë nuk do t'i harrojë përpjekjet heroike e fisnike, veprat gjatë tërë jetës, edhe pse, për botëkuptimet e njerëzve, këto përpjekje mund të duken të parëndësishme. Në Ditën përfundimtare të Gjykimit, Zoti i Dashur do të japë shpërblimin e mirëfilltë, të drejtë e të vërtetë për çdo vepër të mirë. Ky është shpërblimi më i madh që njeriu në përgjithësi mund ta dëshirojë, e kjo është paqja dhe lumturia e amshueshme.

Për këtë dhuratë vërtet vlen të jetosh burrërisht, të qëndrosh në mundime, të bësh vepra të mira.

E vërteta e All-llahut është:

“E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.”

(Kur'ani, 99:7-8)

Me vullnet të fortë drejt suksesit

Vullneti i fortë është njëri nga faktorët themelorë të karakterit të qëndrueshëm, rrugë e sigurt kah drita e shpirtit. Prandaj, njeriu i ri, që dëshiron ta ndjekë rrugën më të mirë dhe më të bukur, patjetër duhet të përpiqet që vullneti i tij të bëhet i çeliktë, i fortë dhe i paluhatshëm.

Ai nuk është dhunti e fituar si dhuratë, por fryt i përpjekjeve dhe i ushtrimeve të vazhdueshme. Ai arrihet edhe me pengesa të shumta rënie e dëshpërimë. Të dobëtit lodhen ose dështojnë që në fillim të sprovimeve të mëdha, kurse të fortët pas rënies ngrihen dhe vazhdojnë drejt qëllimit të tyre.

Janë të mëdhenj shpirtërisht ata njerëz që janë të qëndrueshëm. Ata, me shpatën e guximit të tyre, ia presin kokën vullnetit të dobët, e nënshtrojnë atë, ndaj ai (vullneti) bëhet i dëgjueshëm.

Për ngadhënjimin e vullnetit të fortë mbi dobësitë, duhet mposhtur më parë në zemrën tënde kuçedrën njëqindkrerëshe të dembelisë. Ata që kanë vullnet të fortë, vullnet të cilin e shfrytëzojnë në rrugë të drejtë, në horizont i presin sukseset dhe shpërblimi i All-llahut xh.sh.

Të lodhur nga përpjekjet, nuk guxojmë kurrë të heqim dorë nga forcimi i vullnetit. Shumë njerëz heqin dorë, sepse nuk kanë forcë të mjaftueshme që të thonë në mënyrë të paluhatshme dhe të vendosur: "Dua", e

që këtë ta vënë në veprim, në rrugën e fitores. Përpjekjet e kushtëzuara paralizojnë, çorientojnë dhe ngadalësojnë çdo veprim të sinqertë në këtë drejtim.

Vullneti kultivohet që nga fëmijëria e hershme. Forca e vullnetit duhet ushtruar çdo ditë, ndoshta edhe çdo orë, në mënyrë të vazhdueshme dhe të patundshme. Çdo rast të përshtatshëm duhet shfrytëzuar për forcimin e tij. Ashtu siç e ujisim farën e mbjellë, dhe nga ajo rritet bima shumë e bukur, po ashtu edhe vullnetin e njeriut duhet këndellur dhe forcuar me ushtrime dhe me dëshira të flakta që një ditë të rritet e të bëhet shembull karakteri të mrekullueshëm vullneti është fara që Zoti i Dashur e ka mbjellë në shpirtin e njeriut. Nga vendosmëria e djaloshit dhe e vajzës, varret se sa kujdesen ata ta kultivojnë dhe ta edukojnë bimën e vullnetit. Vullneti nuk forcohet me një vepër ose me një aksion të shkurtër. Për forcimin e tij kërkohet mund, përpjekje e vazhdueshme, kërkohet kohë. Njeriu nuk mund të mësojë të shkruajë e të lexojë menjëherë kësaj i paraprin një punë e konsiderueshme. Fillohet me vija të drejta e të pjerrëta, punohet me përvetësim germë pas germe. Është investuar shumë mund që të përvetësohen operacionet themelore matematikore, të cilat u paraprijnë të gjitha problemeve matematikore. Shpesh i shohim nxënësit se si ikin nga orët e vështira të algjibrës ose të gjeometrisë. Nga frika prej vështirësive kërkohen shtegdalje në ikje, e cila ua shton edhe më tepër mosdijen dhe ua bën frikën edhe më të madhe. Pasojat e këtyre ikjeve – janë dëshim në shkollë, ndoshta edhe humbje e klasës, janë vit i humbur.

Ndërkaq, në shkollën e jetës askush nuk guxon të ikë nga orët e ushtrimeve të vullnetit, nëse dëshiron të bëhet njeri i vërtetë. Në këtë shkollë të jetës, ikja nuk ofron kurrfarë zgjidhje, por vetëm shkatërrim në jetë dhe mosesukses tragjik.

Prandaj ata që në horizont presin shpëtim, me tërë fuqinë e qenies së tyre duhet të tregojnë kujdes e zell për forcimin e vullnetit. Para tyre do të hapen horizonte dhe botë të panjohura deri atëherë të mundësisë së papritur. E tërë pasuria e aftësive të reja do të zhvillohet nga errësira e deriatëhershme. Mundësitë e mëdha të njohurive dhe të guximit do të tregohen dhe do të paraqiten në dritë të qartë. Vetëm duhet qëndruar.

Hazreti Aliu ka thënë:

“Nëse fillon diçka, qëndro në të, sepse është dëm i madh ta nënçmosh dhe ta kundërshtosh dijen e Allahut xh.sh. Ruaju nga kjo ditën dhe natën”.

Ndërsa për qëndrueshmëri lypset vullnet i frotë.

“Ndriçimin e qiellit për një çast nga njëra anë në tjetrën mund ta bëjë vetëm vetëtimja, por për ndriçimin e pandërprerë e me fuqi të njëjtë për të lypset Dielli. Nganjëherë, kur qiellin e mbulojnë retë, ne, në të vërtetë, nuk e shohim Diellin, mirëpo drita dhe ngrohtësia, që na rrethojnë dhe që i hapin jetë çdo gjëje, rrjedhin prej tij.” (G.S.Petrov)

Demosteni, orator i njohur i Greqisë së vjetër, kishte një shprehi të keqe që ta lëvizte vazhdimisht krahun e djathtë. Kjo shprehi linte përshtypje mjaft të shëmtuar. A e dini si e zgjidhi këtë problem? E vari litarin për tavani, ku e lidhi pastaj shpatën. Ajo varej vertikalisht, kështu që maja e mprehtë e shpatës qën-

dronte pikërisht mbi krah. Sa herë që e lëvizte krahun (e djathtë) maja e mprehtë e shpatës ia therte krahun. Falë vullnetit të fortë e duronte dhembjen gjithnjë derisa e mposhti shprehinë e keqe.

Falë Zotit xh.sh. këso të mete nuk kanë shumë njerëz. Mirëpo, shi për këtë, duhet t'i mposhtin ato vese qëi kanë. Përse djemtë dhe vajzat, që synojnë qëllimet e mira, të kenë vullnet më të dobët se Demosteni? Kurrnjëherë nuk duhet nënçmuar vlerat dhe fuqinë e përpjekjeve të tua, por gjithashtu as nuk duhet mbiçmuar. Duhet përpjekur, duhet qëndruar, duhet fituar. Nuk humb ai, që pëson disfatë. Në humbje është ai, i cili, edhe pas rënies, nuk ngrihet!

“Sa më gjatë që po jetoj gjithnjë e më tepër po bindem se i tërë dallimi ndërmjet dy njerëzve, ndërmjet të fortit dhe të dobëtit, ndërmjet të fuqishmit dhe të pafuqishmit, qëndron vetëm në fuqinë e punës, në vendosmërinë e pathyeshme, e cila njih vetëm vdekjen dhe fitoren” (Fowel Buxton).

“Njerëzve nuk u mungon fuqia, por vullneti.” (Viktor Hygo).

Në betejën e Bedrit, një i pafe (mushrik) ia preu dorën e djathtë një as'habi trim. Trupin e tij e mbuloi gjaku. Ç'mendoni, a thua iku nga lufta? Kurrsesi. Ai me dorë të majtë e ngriti shpatën nga toka dhe me zemër e guxim e vazhdoi luftën. Shih, pra, atë fuqi shpirtërore, atë trimëri dhe atë vullnet të fortë! Ai shkoi në luftë që të fitojë dhe, përkundër humbjes së dorës dhe dhembjeve të mëdha, ai fitoi.

Eh, sikur njerëzit e rinj të kishin kësi vullneti të fortë siç kishte ky as'hab e të luftonin kundër dobësive të

veta, të cilat i brejnë vlerat njerëzore tek ata! Sikur të kishin vetëm fuqi të këtillë që, përkundër vështirësive e dhembjeve, të dinin dhe të mundnin të ngadhënjenin mbi të keqen në shpirtin e tyre! Është me rëndësi të dihet se në mënyrë të paluhatshme e të vendosur njëra ndër rrugët e rëndësishme, e cila shpie drejt fitores dhe kah vlerat më të mira të njeriut, është pikërisht vullneti i fortë, vendosmëria, përpjekja dhe dëshira e hekurt.

“Fjala – e pamundshme – është fjalë nga fjalori i të marrëve”, ka thënë Napoleoni I. Të rinjtë ankohen nganjëherë: “Kam natyrë të mbrapshtë. Unë nuk kam fuqi t’i kundërvihem!”

Është e vërtetë se njeriu ka temperament, i cili është strukturë e një vargu rrethanash, duke filluar nga trashëgimia e tutje, të cilat ne nuk i kemi zgjedhur dhe nuk i kemi dëshiruar. Mirëpo, shih për këtë arsye çdo njeri e ka edhe instinktin e rrënjosur për të mirën, nga fuqia e të cilit varet bashkëpunimi pozitiv me natyrën e tij.

Kërkohet vetëm vullneti, vetëm dëshira që këtë vullnet, këtë dëshirë ta ndezim në flakë të zjarrtë në unin tonë, kështu që ajo të ndriçojë jo vetëm në ne, por edhe rreth nesh. Duhet dëshiruar të jesh njeri i mirë, dhe me ndihmën e All-llahut xh.sh., nuk do të mungojë rezultati.

Kurrë nuk duhet të bëhemi ujë amull, i cili shpesh mund të shndërrohet në brrakë. Duhet të bëhemi prrua i fuqishëm dhe i kthjellët malor, i cili sjell freski, shëndet dhe hare.

“Vullneti i fortë mund të arrihet me ushtrime të vazhdueshme, me vetëdisiplinë dhe me veturdhë-

rim. Në luftën e jetës ngadhënjën gjithmonë vetëm ai, që ka vullnet më të fortë. Fuqia e vullnetit bëhet problem themelor i afirmimit jetësor, sepse të mos kesh vullnet, do të thotë të jesh i mundur, do të thotë të jesh i zhdukur, që paraqet mohim të jetës". (Pillar-i).

Flitet se një tregtar i kohëve të lashta disa herë e kishte humbur në det galerën* me mallin e vet, të cilin e dërgonte në vende të largëta për ta shitur. Një ditë, tërësisht i dëshpëruar, rrinte në kopsht i shtrirë, dhe duke ndenjtur e duke soditur natyrën, ia tërhoqi vërejtjen thnegla, e cila e tërhoqi një fije të madhe kashte përpjetë një trunq. Thnegla u përpoq disa herë të ngjitej përpjetë, mirëpo, kur i afrohej qëllimit, ajo rrëzohej prapa bashkë me fijen e kashtës. Megjithatë, ajo nuk dorëzohej. Ishte e vendosur. Vazhdoi me guxim disa herë, derisa përfundimisht arriti sukses, realizoi qëllimin e saj. Tregtari u mahniti nga vendosmëria dhe vullneti i fortë i kësaj thnegle aq të vogël. Ai e dërgoi përsëri lundrën (galenë) dhe kësaj here arriti ta shesë mallin dhe të fitojë aq shumë saqë i kompensoi të gjitha humbjet. Të mençurit duhet të mësojnë nga shembujt e këtillë. Duhet të mësojnë atë që është e mirë, qoftë edhe prej thneglës (buburrecit), dhe me siguri nuk do të gabojnë kurrë.

Në përpjekjet drejt qëllimit më të lartë, vërtet faktori themelor është vullneti, i cili, nëse është mjaft i fortë, i vendosur dhe i orientuar mirë, në dhëntë Zoti, jep sinjalizime të sigurta se njeriu do ta arrijë atë që dëshiron.

* Gale-ja, galerë, anije lufte ose tregtie, që përdorej në kohët e vjetra e që lundronte me pëlhurë e me lopata; (sh.p.)

“Pika e vazhdueshme e shpon gurin, ndërsa edhe vërshima më e madhe, e cila me zhurmë të madhe kalon mbi të, nuk lë pas vete kurrfarë gjurme” (Carlyle).

Frenoje zemërimin tënd

Disa djem e vajza hidhërohen shpejt, nxehen dhe marrin zjarr. Skuqen në fytyrë, prishen e çoroditen, përplasnin dyert, ulërijnë në vend që të flasin. Me këtë shfryrje jonormale e qesharake të zemërimit synojnë të bëjnë përshtypje presioni e imponimi. Gjithnjë kur shoh sjellje të këtilla të tërbuara, më kujtohet fëmija i vogël, të cilit, nëse nuk i plotësohet dëshira, bërtet, rrapëllon, qan, skuqet e mërdhezet. Fëmija ende është pothuaj pa vullnet dhe pa fuqi shpirtërore. Ai vështirë mund ta kontrollojë veten. Prandaj atë muind ta kuptojmë. Mirëpo, sa qesharakë e të gjorë duken njerëzit, që veprojnë e sillen si fëmijët!

A vlen ta poshtërojmë veten me ngritjen e zërit, duke ulëritur e duke shkumuar gojës? A i ka hije njeriut të veprojë kështu? Jo! Kjo sigurisht nuk është e denjë për njeriun. Vetëm njerëzit e ligj dhe qyqarët, egoistët dhe të llastuarit, nuk mund ta frenojnë dhe nuk mund ta mposhtin zemërimin e tyre.

Llukmani i urtë e këshilloi djalin e vet:

"Të jesh i matur në ecjen tënde, ulë zërin tënd, se zëri më i egër është pallja e gomarit."

(Kur'ani, 31-19)

Muhammedi a.s. ka qenë shembull se si duhet kontrolluar veten, si duhet frenuar dhe si duhet të sillen njeriu. Ai kurrë nuk zemërohej, kurrë nuk binte

në afekt. Gjithnjë ishte i butë, i këndshëm, i dashur. Me sjelljet e veta të mrekullueshme e të singerta i përvetësonte njerëzit.

Ai njëmend qe shembull i njeriut të vërtetë. Ai thotë:

“Muslimani më i fortë është ai, i cili e sundon vetveten”.

Në një rast një as’hab kërkoi prej tij këshillë.

“Frenohu në zemërim”,

i tha Resulull-llahu a.s.

Mrekulli do të ishte, sikur të gjithë besimtarët, djemtë e vajzat të merrnin mësim nga ky njeri i madh dhe ta ndiqnin rrugën e virtyteve të tij. Në Dhjatën e Vjetër kam lexuar se Sulejmani a.s. ka thënë:

“Ai që zemërohet vështirë, është më i mirë se trii,

Edhe ai që e frenon veten, është më i mirë se pushtuesi i qytetit”.

E di se nga djaloshi 15 deri 19vjeç është vështirë të kërkohet vetëfrenimi kur dikush e fyen ose e poshtëron. Njeriu i ri e ka gjakun e nxehtë dhe natyrën e temperamentin e zjarrtë. Sigurisht se është vështirë që të mos përgjigjet e të mos reagojë menjëherë. Ata e kuptojnë shumë vështirë se sjellja e butë dhe e qetë nuk është qyqari. Mirëpo, duhet ditur se është e ndershme dhe më e denjë, më heroike të përmbahemi nga reaksionet momentale të çdo provokimi apo nxitjeje. Duhet ndalur, duhet menduar dhe pastaj duhet të reagohet me maturi dhe mençuri. Kështu veprojnë njerëzit e vërtetë, ata që synojnë drejt qëllimeve më të larta. Njerëzit e mençur e të arsyeshëm i shmangen grindjes dhe konfliktit të panevojshëm. Ata janë të vetëdijshtëm se me vetëfrenim fitohet shpërblimi më i

lartë, dhutia që u takon njerëzve me cilësi të jashtëzakonshme. Ky shpërblim dhe kjo dhunti është vetëdije për fuqinë e brendshme dhe madhësinë shpirtërore, të cilës i nënshtrohet çdo gjë e është materiale – sipas zakoneve fisnike por të forta si graniti.

Hasan Basri thotë:

“Njeri i mrekullueshëm ka enë Bekr ibni Abdull-llahu. E kam dëgjuar njëherë se is urdhëronte që njeriu të jetë i butë dhe të kërkojë falje. Ai tha: -O njerëz mposhtni zemërimin tuaj, duke paramenduar zjarrin e xhehennemit!!”

Ndërsa Xhelaluddin Rumi shënoi:

“Anshmëria, nxitimi dhe pasionet e bëjnë njeriun të shtrembër”.

Dhe vërtet pengesat më të mëdha në rrugën e së vërtetës kah përsosmëria e shpirtit janë zemërimi dhe tërbimi, të cilat mund të ndizen flakë dhe ta ulin dinjitetin e njeriut. Kjo e keqe bën kërdi në zemrat tona dhe në shpirtrat tanë. Trimat dhe të bindurit, i tejkalojnë me guxim të gjitha këto pengesa.

Për perandorin romak, Jul Qesarin, thuhet se gjithnjë kur të kapte zemërimi gjente fuqi në vete të numëronte deri në dhjetë. E atëherë zemërimi kalonte. Shumë fjalë të rënda, të cilat do të mund t'i thoshte me kaplimin e zemërimit, do të mund të sillnin vetëm dëm dhe lëndime që është vështirë të shlyhen. Shih se si ka ditur ky udhëheqës i butë ushtarak të ngritet kundër zemërimit! Shih sa me mençuri e ka forcuar vullnetin e vet!

Përse të gjithë djemtë e vajzat të mos bënin përpjekje të numërojnë deri në dhjetë, përse të mos mundoheshin të ngadhënjejnë mbi të keqen e zemërimit në vete?

Para disa dekadash në Zvicër, një meteorolog i njohur kishte mbledhur të dhëna për kushtet meteorologjike. Këtë punë e bëri pothuaj njëzet vjet. Në mbështetje të këtyre të dhënave deshi të publikonte një punim të rëndësishëm. Një ditë, kur erdhi në zyrë, vërejti se në rafte nuk gjendeshin letrat në të cilat ishin shkruar me kujdes të veçantë të dhënat e tij të mbledhura vite me radhë. Kur e pyeti pastruesen se ku ishin letrat, ajo i tha se i kishte hedhur në zjarr, sepse ishin zverdhur dhe ishin në gjendje të amortizuar e të leckosur në vend të tyre ajo kishte blerë letra të reja dhe me to i kishte mbuluar raftet. A dini ç'bëri ky dijetar? Nuk u zemërua, nuk filloi të bërtiste. Heshti disa minuta, e pastaj në mënyrë të qetë i tha pastrueses:

“Ma ke humbur mundin e 20 vjetëve. Herëve të tjera mos i prek letrat e mia!”

Djalosh i dashur, vajzë fisnike, mund ta paramendosh se sa forcë vetëfrenimi është dashur të ketë në qenien e vet ky shkencëtar që të mos shpërthente flaka e zemërimit. Mund të paramendosh se sa fuqi është dashur për këtë gjest vërtet të mrekullueshëm dhe të denjë. Ky njeri i madh i kishte këto virtyte.

Të urtit mësojnë nga këto shembuj!

Porosia për durim (sabri)

Rrugët e jetës njerëzore nuk janë as të lehta as të thjeshta. Shpesh, shumë shpesh të shpiejnë nëpër dhembje, vuajtje, sprova e pengesa. Gëzimet e buzëqeshjet nuk janë përcjellësit e vetëm në shtigjet jetësore. Gjatë tërë jetës njerëzore ndërrohen ditët e ngrohta, me freski dhe diell, me ditët e dimrave të ashpër, me stuhi, me re të zymta.

Çdo njeri has në pengesa. Ato janë të nduarnduarta nga kuptimi dhe pikarritja e realizimi i tyre.

Edhe ti, o njeri i ri, sigurisht ke hasur në to. Ndoshta, veç e ke shijuar hidhërimin e dhembjes, të vuajtjeve dhe të lotëve. Po të pyes, a ke enë ndonjëherë i sëmurë? A ke humbur dikë, që e ke pasur të afërt dhe të dashur? A ke përjetuar zhgënjim për personin që e ke dashur, e ke nderuar dhe e ke çmuar? A ke pësuar disfatë në shkollë, në studime? A ke përjetuar poshtërimin nga mendjemëdhenjtë e krekosur? A ke pësuar mossukses në punë? Pyetjet mund të radhiteshin pa fund. Sepse format e vuajtjeve janë të pafundme, përjetimet e tyre të shumta. E vuajtjet dhe pësimet janë ligje të pamëshirshme të jetesës. Ato janë pjesë e jetës sonë. Njeriu e mban në vete dhe rreth vete.s

E përse dhembjet dhe vuajtjet? – do të pyesë dikush. Përse nuk ka gëzim të amshueshëm dhe fytyra të ndritshme, jetë të lumtur? Përse vetëm lot e vaj?

Mumii dhe mumineja do të përgjigjen: Unë këtë nuk e di sigurisht. Por e di i Dashuri im, All-llahu xh.sh.! ndoshta Ai, nëpërmjet dhembjeve, dënon për të kaluarën mëkatore dhe të pakuptimtë. Ndoshta Ai e kalit njeriun për ardhmëri, ë ta forcojë, ta bëjë të fuqishëm, ta bëjë trim, që trimërisht t'i presë vuajtjet edhe më të mëdha. Ndoshta All-llahu, nëpërmjet dhembjeve, do t'ia hapë njeriut sytë për seriozitetin e jetës, t'i paraqesë hrozontet më të reja e më të thella të besimit. Ndoshta atë që vuan, e pastron nga mëkatet e kaluara, dhe ia përgatit xhennetin dhe shkallët më të larta të xhennetit. Por ndoshta, me anë të vuajtjeve, dëshiron që ta fisnikërojë njeriun, që ta bëjë më të mirë, më bujar e më të virtytshëm.

Çdo hidhërim, çdo pësim dhe çdo vuajtje, janë sprova që All-llahu xh.sh. na i dërgon. Sepse besimin në zemrën e vet, besimtari duhet ta dëshmojë patjetër edhe me anë të sprovës. Sprova është provim për besimtarin, provim për besnikëri ndaj All-llahut të Plotëfuqishëm e Mirëbërës. Sprova është pjesë e jetës. Edhe besimtari nuk do ta kalojë rrugën jetësore pa sprovime, dhe këtë Zoti e di më mirë.

All-llahu xh.sh. në Kur'anin e madhërishëm thotë:

“Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, po t’i jepja myzhde durimtarëve. Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme, thonë: “Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi. Të tillët janë që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë.”

(Kur’ani, 2:155-156)

“Po ju menduat se do të hyni në xhennet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, saqë i Dërguari thoshte, e me të edhe ata që kishin besuar: Kur do të jetë ndihma e All-llahut?! Ja (u erdhi ndihma) vërtet ndihma e All-llahut është afër!”

(Kur’ani, 2:214)

Këto fjalë të All-llahut duhet të jenë idetë e zemrës dhe të shpirtit të çdo besimtari. Ato duhet ta frymëzojnë besimtarin drejt lartësisë së vërtetë e të thellë të besimit me vlerë të pakufishme.

Nëpërmjet sprovave, pësimeve, All-llahu kërkon zemra burrërore besimtare, kërkon kreshnikë të fesë.

Kur pasojnë furtunat e sprovave, lufta në zemër, lufta në shpirt, kërkon trimëri personale, të mbrojtur nga shikimet dhe mirënjohjet.

Fuqia e besimit në këto çaste është në provim. Dashuria ndaj All-llahut është në provim.

Besimtari, besnik ndaj fesë së vet, në tejkalimin e hidhërimit të vet, do të tregojë dashurinë e vet të pastër ndaj Zotit. Në emër të kësaj dashurie ai do ta mbi-zotërojë dhembjen e hidhërimit në vete, dëshpërimi do të ikë para tij. Në këtë vetëhidhërim nuk ka mashtrim, nuk ka vetëshquarje. Këtë hidhërim askush nuk e sheh, përveç All-llahut, dhe pikërisht aty qëndron madhështia e vlerës së tij.

Si kristal i kulluar shndrit besimi i argumentuar dhe i dëshmuar. E zoti pikërisht besim të këtillë kërkon. Njëra nga rrugët për manifestimin e një besimi të këtillë të çeliktë, të paluhatsëm, të fuqishëm është

edhe besimi nëpërmjet vuajtjeve dhe pësimeve. Ndërsa dashuria e pastër ndaj All-llahut shpie në lartësitë më të mëdha të besimit, të cilin mund ta arrijë njeriu.

Ç'bëjnë njerëzit kur godasin vuajtjet dhe fatkeqësitë, kur buzëqeshjet zëvendësohen me lot, kur gëzimin e zëvendëson hidhërimi?

Disa dekurajohen e molisen, i dorëzohen dëshpërimit, hidhërimit, vajit, humbin besimin në vetvete. Në lot, në ofkëllima, në gjëmë, në britma, në vajtim, kërkojnë shpëtim. Këta janë qyqarë, që nuk kanë as fuqi, as guxim. Ndërsa disa të tjerë me zemërim i shtrëngojnë grushtat dhe qortojnë, shajnë gjithçka rreth vetes. Fajësojnë çdo gjë rreth tyre. Ata tërbohen, mallkojnë. Zemërimi shpërthen nga çdo fjalë e tyre, nga çdo shikim. I gjuajnë sendet rreth vetes, përplasnin dyert, bërtasin dhe bëjnë zhurmë në pikëllimin dhe dëshpërimin e tyre të pakuptimtë. Këta janë shpirtra të vrazhdë qyqarësh, të mësuar me dëfrime e llastime. Këta janë shpirtra, që nuk dinë për vuajtje dhe nuk kanë fuqi t'i pranojnë dhe t'i kuptojnë si thirrje.

Disa njerëz, ndërkaq, i përballojnë me guxim vuajtjet dhe hidhërimet. I kuptojnë si domosdoshmëri që i ka goditur, si të vërtetë dhe si provë, që Zoti i Dashur ua ka dërguar me qëllim të qartë dhe të caktuar. Ata në dhembje dhe në hidhërim gjejnë kuptim, qëllim, që Zoti u ka urdhëruar. Ata janë të tillë, që besojnë në caktimet e Zotit – ndaj janë në gjendje që heroikisht t'i përballojnë fatit të vet.

Në zjarrin e vuajtjeve, në sprova, sado të shumëllojshme dhe të rënda që të jenë ato, ata do të kërkojnë zgjidhje në kuptimësimin e durimit, të ndërlidhur

me besimin dhe dashurinë e pakufishme ndaj All-llahut xh.sh.

Ata dhembjen do ta shfrytëzojnë për të forcuar besimin e tyre, për ta fisnikëruar shpirtin e vet dhe veprat e veta. Pas përballimit të vuajtjeve njeriu bëhet më i mirë, më fisnik, më i karaktershëm, më i mëshirshëm, më serioz! Ti e di se hekuri kalitet në flakën e zjarrit. A thua hekuri i pakalitur do bëhej ndonjëherë çelik, sikur të mos ishte kalitur në zjarr? Edhe ai, sikur të kishte pasur mundësi, do të fliste për dhembjet e veta, të cilat i përballon nga të rënat e çekanit në flakën e zjarrit, mirëpo ai do të fliste edhe për formën e vet më të lartë e më të përsosur që e arrin në procesin e kalitjes.

Sigurisht ke dëgjuar për arabeskat shumë të bukura të skalitura në gur, në Xhaminë e Kordovës. Njerëzit qënrojnë të magjepsur para tyre. Çkado që të thuhet para veprës së mrekullueshme të mendjes njerëzore, dorën në zemër, vetëm do ta zhvlerësonte bukurinë e këtyre ornamenteve. Pranë arabeskave, të cilat i ka gdhendur dora e artistit, vetëm duhet heshtur duke e madhëruar emrin e All-llahut, i cili u ka dhuruar aftësi të këtyre skalitësve të panjohur. Dhe tani kujto se si kanë fluturuar xixat nën daltën e artistit, se si ndërmjet të goditurave të daltës nga një gur i madh, i thjeshtë e i papërpunuar, ka lindur dëshmia madhështore e mjeshtërisë njerëzore dhe frymëzimi i All-llahut. Pa xixa dhe pa të rëna nuk do të kishte lindur kurrë një vepër e tillë!

Dhe ashtu siç kalitet çeliku në zjarr dhe ashtu siç përpunohen nën daltë dhe me goditjet e çekanit for-

mohen arabeskat, kështu edhe nga njeriu i thjeshtë, nën goditjet e dhembshme, formohet njeriu fisnik me karakter shembullor.

Romakët e vjetër thoshin:

“Ari provohet në zjarr, kurse trimat në ditë të vështira”.

Edhe vuajtja mund të jetë e dobishme, fisnike dhe krenare. Të llastuarit, të përkëdhelurit, kënaqësitë e përhershme, lehtësitë dhe rrugët pa gjemba e ferra nuk i edukojnë njerëzit e rinj për jetë serioze, e cila kërkon trima të shkathët, të guximshëm dhe të patrembur. Njeriu i lazdruar dhe delikat është sikur lulja e kultivuar në kopshtin qelqor. Atë e dëmton çdo acar, madje edhe puhia më e lehtë. Djemtë dhe vajzat e lazdruara janë si kanarinat e kultivuara në kafaz, të cilat, në kontaktin e parë me natyrën, e humbin rrugën. Edhe mundimi më i vogël, ata i dërmon dhe i asgjëson.

Njerëzit, të cilët në rini kanë duruar dhe kanë vuajtur, në moshën e shkuar do të dinë t’u përballojnë të gjithë vështirësitë, që u ndodhin. Ata nuk vajtojnë, por gjithmonë do të dinë të qëndrojnë në këmbë. Ata, edhe kur të rrëzoen, pas çdo rënie, ngriten përsëri.

Në Holandë është një krahinë që quhet Seeland (Toka e Detit), e cila e ka shtratin nën nivelin e detit. Nga valët dhe stuhitë e detit ajo mbrohet me penda të mëdha. Nganjëherë deti i shpërthen pendat, kurse njerëzit, me fuqinë e trupit dhe të shpirtit të tyre, me punë të qëndrueshme e shterin ujin e detit vërshues, e thajnë përsëri tokën dhe e heqin kripën nga ajo. Qëndresa dhe durimi i tyre është shprehur edhe në stemën e krahinës, ku qëndrojnë

të shkruara fjalët: "LUFTOJ DHE PËRSËRI E ÇOJ KOKËN LART". Pas vuajtjeve dhe dështimeve gjithmonë duhet ngrehur kokën lart, e nuk duhet ligështuar.

Psikologu dhe pedagogu amerikan Xhems thotë se njerëzit e rinj çdo ditë duhet t'i nënshtrohen ndonjë veprimi, që do të kërkojë prej tyre durim dhe forcë vullneti, kështu që me kalitje të piqen për trimëri, për vendosmëri në rrugën burërore. Njerëzit e rinj nuk duhet t'i mbrojmë prej çdo dëshpërimi, qoftë ky edhe më i vogël. Fatkeqësitë e forcojnë shpirtin e njerëzve të rinj, e forcojnë karakterin e tyre, e nxisin mëshirën e dhembshurinë për njerëzit e tjerë. Vuajtjet fisnikërojnë. Vetëm shtigjet e ngushta me gjemba shpiejnë në majat më të larta të maleve.

Kush dëshiron të qëndrojë në sulmet dhe në sprovat morale, duhet të forcohet. Kush dëshiron t'i rezistojë të ftohtit, duhet të qëndrojë më parë në acar. Ai që do të ketë muskuj të fortë, duhet t'i ushtrojë shpesh. Ai që dëshiron të ketë mendjemprehtësi që të arrijë shkallë të lartë të dijes, vijimisht duhet të bëjë përpjekje në këtë drejtim.

Të gjitha këto kërkojnë punë, mund dhe durim. Prej të gjitha këtyre nuk duhet frikësuar, për këto duhet shfrytëzuar, duke i shndërruar në akt fisnik.

"Çdo fatkeqësi nuk është mallkim. Vetëmohimi dhe vuajtja shpesh janë bekim. Tejkalimi i vështirësive me durim nuk na shërben vetëm për mësim, por na forcon edhe për sprovat të ardhme" (Sharpe).

Pa dhembje nuk ka degëza ulliri, pa prova s'ka miq, pa hidhërim s'ka famë.

Romakët e vjetër thoshin: “Fatkeqësia është rast për të treguar virtytet”. Njerëzimi jeton dhe përparon me dhembje. Me dhembje krijohen vepra të mëdha. Në gëzim njerëzit janë të cekët, në dhembje janë më të thellë. Dhembja, vetëm dhembja e kuptimëuar, është në gjendje ta trondisë shpirtin njerëzor, që nga ai të thithë atë që është më e mirë, pastaj i dhuron njerëzimit vepra të mëdha në art, në letërsi, në shkencë. Dhembja dhe vuajtja janë shoqëruese të paevitueshme të jetës sonë, prej lindjes deri në vdekje. Prandaj duhet të pranohen si pjesë përbërëse të jetës sonë. Në dhembje dhe vuajtje nuk duhet ligështuar.

Kuptohet se nuk duhet të kërkohet dhembje e vuajtje. Mirëpo, kur të na ndodhin, duhet t’i pranojmë me besim në All-llahun xh.sh., t’i pranojmë si mundësi, t’i pranojmë me durim. Dhembjes duhet dhënë kuptim, duke e shfrytëzuar për rilindje frymëzimi. Edhe nga vuajtjet duhet nxjerrë mësim. Duhet ta forcojmë besimin dhe ta pastrojmë atë, sepse besim të këtillë All-llahu xh.sh. kërkon prej nesh!

Historia njerëzore është përplot me dhembje, vuajtje e pësime, por edhe mendje të mëdha, njerëz të mëdhenj, vepra të mëdha humane, të rritura nga zjarri i vështirësive dhe i mundimeve.

Ejjubi a.s. i durueshëm

Por e zëmë ngojë të dërguarin e Zotit Ejjubin a.s. Legjenda thotë se ka jetuar në Mesopotami para më shumë se 3000 vjetësh. I ati quhej Ajs, kurse gjyshi Is-hak. E ëma ishte e bija e Lutit a.s.

Ejjubi a.s. ishte shumë i mënçur, i ndershëm, i butë, i mirë dhe njeri i pajisur me virtyte. All-llahu xh.sh., me Mëshirën e Vet, e kishte dhuruar dhe bekuar edhe me pasuri dhe begati. Thonë se kishte tri gra. Njëra quhej Rahma, e bija e Efraimit dhe mbesa e Jusufit a.s. Ejjubi a.s. kishte pasur shumë fëmijë, tufa dësh të pafund dhe kafshë të tjera. Shumë fusha pjellore, që shtriheshin në luginat e Eufratit dhe të Tigisit, kishin qenë të tija. Ishte i çmuar, i dashur dhe i nderuar. All-llahu xh.sh. e dhuroi me peygamberllëk. Ejjubi a.s. i ftonte njerëzit në rrugë të drejtë dhe njerëzit e pranonin thirrjen e tij.

Mirëpo një ditë e goditën fatkeqësitë.

E goditi shtërngata dhe Ejjubi a.s. e humbi tërë pasurinë. U shkatërruan fushat e tij pjellore. Ejjubi a.s. i durueshëm u varfërua, mirëpo ai nuk u dobësua shpirtërisht. Ai vazhdonte ta madhëronte dhe ta falënderonte All-llahun e Madhërishëm xh.sh.

Pas kësaj ndodhi goditja e dytë. U përhap epidemia dhe i vdiqën të gjithë fëmijët.

Vështirë, shumë vështirë ishte për Ejjubin a.s. të mirë e të durueshëm, mirëpo ai, megjithatë nuk u li-

gështua shpirtërisht. Njerëzit mahniteshin me durimin e Ejjubit a.s.

E atëherë i ndodhi edhe fatkeqësia e tretë. Ejjubin a.s. e sulmoi sëmundja e tmerrshme. Prej varrëve, që kishte në trup, u bë mish i gjallë. Dhembjet ishin të padurueshme, rreth tij kundërmonte erë e pakëndshme. Bota filloi të ikte nga Ejjubi a.s. Atë e lanë edhe dy gratë e tij, por mbeti me të Rahma besnike. Nga sëmundja ai u dobësua fort, u tret dhe u shkatërrua krejtësisht. Rahma e strehoi në shpellë, sepse njerëzit, duke u frikësua nga përhapja e infektimit, e ndiqnin. Rahma e ndershme dhe besnike nuk u ligështua. Ajo në të mirë ishte me Ejjubin a.s., por edhe në fatkeqësi, në mundime dhe në vështirësi qëndroi pranë tij. Ajo ia lidhte varrët, e pastronte dhe i sillte ushqim.

Ejjubi durimtar a.s., edhe përkundër të gjitha këtyre mynxyrave, qëndronte si shkëmb graniti, guximtar, i paluhatshëm dhe besnik i pakufishëm, ndaj mendimet e tij ishin gjithnjë të drejtuara kah madhërimi i All-llahut xh.sh. Besimin e kishte të pakufishëm. Trupi i ishte rraskapitur dhe e kishte lëshuar fuqia krejtësisht, mirëpo gjuha ende i punonte. Fjalët, që mezi dëgjoheshin nga lodhja dhe rraskapitja e Ejjubit a.s., ishin fjalë që e madhëronin All-llahun xh.sh. Besnikërinë e Ejjubit a.s. ndaj All-llahut xh.sh. dhe Islamit, asgjë nuk mund ta thente.

Ejjubi a.s. kishte një besim çuditërisht të fortë. Ky ishte besimi, të cilin mund ta kishin vetëm njerëzit me zemër të madhe.

All-llahu xh.sh. kërkonte besimin prej Ejjubit a.s., ndërsa Ejjubi, me guximin e vet, me durimin dhe bes-

nikërinë e vet, e dëshmoi këtë besim ndaj Zotit të Dashur. Lutja e tij, drejtuar All-llahut xh.sh, ishte kjo: “Mua më ka gjetur fatkeqësia, e Ti je më i Mëshirshmi nga të mëshirshmit”! Për të All-llahu xh.sh. ka thënë:

“Vërtet, ne e gjetëm atë të durueshëm. Sa rob shumë i mirë ishte ai dhe i kthyer te Zoti.”

(Kur’ani, 38:44)

Në të gjitha fatkeqësitë, mundimet, vuajtjet, përbuzjet, vetmitë, Ejjubi a.s. nuk u dorëzua. Ishte i lodhur, ishte shkatërruar, ishte i refuzuar e i përbuzur, mirëpo Ejjubi i mirë dhe i durueshëm nuk e mohoi besimin në All-llahun e Dashur xh.sh.

Pranë tij, në fatkeqësitë e tij, Rahma, me dinjitet e karakter të fortë, qëndroi heroikisht, besnike dhe e papërkulur. Dhe një ditë, pas disa vitesh, All-llahu xh.sh. ia largoi vuajtjet Ejjubit a.s. Ai u shërua, e përtëriu pasurinë e tij me vëllim edhe më të madh se përpara, i lindën shumë fëmijë. Gëzimi, buzëqeshjet dhe lumturia u kthyen në shtëpinë e Ejjubit a.s. Ejjubi a.s. përsëri filloi t’i thërrasë njerëzit në besimin Islam, ndërsa njerëzit me admirim i përgjigjeshin. Për këtë Kur’ani thotë:

“E nga mëshira Jonë dhe mësim për ata që kanë të menduar, Ne ia falëm familjen e tij dhe po aq sa ishin ata.”

(Kur’ani, 38:43)

Për historinë, për gjeneratat e ardhshme, besimi, durimi dhe dashuria e Ejjubit a.s. ndaj All-llahut xh.sh. u bënë shembull prej të cilit vlen të mësohet.

Dhe me të vërtetë Ejjubi a.s. që shërbëtor i mrekullueshëm, i virtytshëm dhe i ndershëm i All-llahut.

Prandaj muminët, kur i kaplon vuajtja, dëshpërimi, vetmia dhe sëmundja, duhet ta kujtojnë Ejjubin a.s. dhe t'i përballojnë me durim vështirësitë dhe fatkeqësitë. Edhe gjatë sëmundjes edhe gjatë vuajtjes duhet dëshmuar besimin. Edhe në sëmundje dhe në mundime duhet qëndruar trimërisht dhe duhet duruar që të fitojmë kënaqësinë e All-llahut.

Muhammedi a.s. ka thënë:

"All-llahu i madhërishëm më ka porositur: nëse robit tim i dhembin sytë, e ai me durim e përballon këtë dhembje, Unë do t'ia shpërblej durimin me xhennet".

Ummu-l-A'la-ja rrëfente: "Më vizitoi i Dërguari a.s. i All-llahut kur isha e sëmurë. Atëherë ai më tha:

"Ummu-l-A'la! Të jesh e gëzuar, sepse muslimanen, që vuan nga sëmundja (nëse vetëm duron) All-llahu xh.sh. e pastron nga mëkatet ashtu siç e pastron zjarri argjendin nga ndryshku".

Hasan Basri ka thënë: "Sëmundja e pastron trupin siç e pastron zekati pasurinë. Trupi që nuk di për sëmundje është si pasuria që nuk pastron me zekat. Në të nuk ka përparim".

Ai ë nuk është vënë në sprovë, ka mbetur anash, ai ë ka luftuar kundër së vërtetës ka pësuar disfatë.

Prandaj nëse të kapin sëmundja dhe vuajtja, priti trimërisht. Nuk duhet dorëzuar shpirtërisht. Besimtari nuk guxon të vajtojë, nuk guxon të bëjë gjëmë. Gjëma dhe vajtimi e zvogëlojnë imanin. Me fuqinë e besimit dhe me fuqinë heroike shpirtërore duhet përballuar dëshpërimin dhe duhet lutur të Dashurin All-llah për mëshirë.

Duhet ditur se në dhembje e travaje zhvillohe fuqitë shpirtërore, dhe se nëpërmjet vuajtjeve lindet e rritet frymëzimi i ri. Në përleshje betejash piqen trimat shpirtërorë, trimat e besimit. Sëmundja shpesh e zbulon të vërtetën për ne, për njerëzit rreth nesh dhe për jetën.

Llukmani i thoshte të birit: “Njeriun e durueshëm mund ta njohim vetëm në sëmundje dhe në fatkeqësi”.

Filozofi romak Seneka, për të cilin thuhet se ka besuar në Një Zot, ka shkruar: “Guximi dhe trimëria e të sëmurit në shtrat është e njëjtë me trimërinë e legjionarit romak në fushën e betejës.

Ta rrëfejmë ngjarjen që ndodhi me Jusufin a.s.: Jakubi a.s., i ati i Jusufit, e kishte dërguar me vëllezërit e vet për të lozur. Mirëpo, ata e hodhën në një shpellë. Kaloj karvani andejpari, e mori dhe e solli në Egjipt. Atje, krejtësisht i pafajshëm, ra në burg. Mirëpo, Jusufi a.s. ishte i durueshëm. I duroi burrërisht të gjitha mynxyrat dhe u bëri ballë sprovimeve. As nuk ra në dëshpërim e as nuk u përkul shpirtërisht. Mendimet e tija dhe fjalët e tija i drejtohehin vetëm All-llahut. Vazhdimisht i lutej Atij dhe vetëm nga Ai priste mëshirë.

Sprova e forcoi besimin e Jusufit. I ati, Jakubi a.s., gjatë tërë kohës ishte i shqetësuar dhe i brengosur për humbjen e Jusufit. Ai e përballonte me durim dhembjen e rëndë prindërore. Vështirë e kishte Jakubi a.s., por megjithatë ai nuk u ligështua dhe kurrë nuk e humbi shpresën. Qëndroi heroikisht si shkëmb graniti para përplasjeve të valëve të detit. Atë e forconin sprovat në besimin e vet. All-llahu xh.sh. iu përgjigj një ditë lutjeve të shërbëtorëve të vet besnikë, Jusufit

a.s. dhe Jakubit a.s. Ia ktheu prestigjin Jusufit a.s., duke i dhënë pozitë të lartë dhe e afroi me prindërit e tij. Hidhërimin e zëvendësoi lumturia. Kështu All-llahu i shpërblen durimtarët.

Xhelaluddin Rumi ka shkruar: "O ti që po kërkon të vërtetën, mbaje mend këtë rregull: Ai që ka ndonjë dhembje, ai do ta ndiejë erën e së vërtetës".

Muhammedi a.s. ka thënë:

"Në Ditën e Gjykimit do të vijmë disa njerëz dhe All-llahu xh.sh. atyre do t'u rrëfejë siç po u rrëfeni ju njerëzve në këtë botë. All-llahu do t'u thotë: -Robërit e mi, unë nuk ju kam lënë që ju të vuani në atë botë për arsye se ju kam harruar, por ju kam përgatitur diçka dhe këtë do t'ju jap tani. E këtë ndryshe nuk do ta fitoni, përveç nëpërmjet asaj që keni vuajtur e duruar atje".

Më tutje Muhammedi a.s. thotë:

Durimi është çelësi i xhennetit. Njeriu arrin çdo të mirë, nëse duron vetëm një moment. Njerëz, ose do të pajiseni me durim ose do të shkatërroheni!

Më tej Ai thotë:

- Sabri është veshja ime dhe virtyti im.
- Sabri është drita e muminit.
- Askujt nuk i është dhënë dhuratë më e madhe ose më e mirë se sabri.

- Armë e mrekullueshme e muminit është – sabri dhe duaja.

- Kush kërkon sabër, All-llahu me siguri do t'ia japë.

- Atij që i ndodh ndonjë fatkeqësi, qoftë në trup (siç është sëmundja) ose në pasuri, kurse ai e duron dhe e fsheh këtë e nuk i ankohet askujt, meriton nga All-llahu që t'i falen mëkatet.

- Kur e do All-llahu robin e vet, Ai e sprovon me ndonjë provë bindjen dhe lutjen e tij.

- Atij që i jepen këto katër gjëra, i është dhënë e mira e kësaj dhe e asaj bote: gjuha me të cilën e përmend All-llahun; zemra mirënjohëse durimtare, trupi durimtar në vuajtje dhe në mundime; gruaja e cila nuk i shkakton burrit kurrfarë pengesash, por e ruan nderin dhe pasurinë e tij".

Fjala e urtë popullore thotë: "Durimi – shpëtimi".

Pas betejës në Uhud të vitit 625 pas Isait a.s. arrin lajmi se kishin vdekur shumë muslimanë, madje edhe Muhammedi a.s. Kur filluan të ktheheshin të plagosurit nga lufta, jashtë Medines dolën shumë nëna, motra dhe gra, që të interesoheshin për më të afërmit e vet dhe për vëllezërit e tyre të fesë islame.

Kështu një muslimane e ndali një të plagosur që e njihte dhe e pyeti:

- A po kthehet babai im?

- Ka vdekur.

- E burri im, a po kthehet?

- Edhe ai ka vdekur.

- E ç'u bë me djalin tim, dhembja ime e tmerrshme?

- Edhe ai ka vdekur, duke e mbrojtur Muhammedin a.s.

- E ç'u bë me Pejgamberin e All-llahut? – pyeti gruaja shumë e rraskapitur.

- Falëndero All-llahun, ai është gjallë.

- Falënderoj All-llahun pasi Pejgamberi paska mbetur gjallë, më lehtë do t'i përballoj plagët e mia të rënda – tha besimtarja e madhe.

Dhembja e copëtonte thellë zemrën e saj, e përvëlonte shpirtin e saj. Lotët i rridhnin. Mirëpo atë e

mbante besimi, besimi i thellë, i fortë. U përmbajt muminja, e ndrydhi dhembjen në vete dhe falënderoi All-llahun për shpëtimin e Muhammedit a.s. Zemra besimtare, e thyer, e shpuar nga vuajtjet nuk pëlçet dhe nuk e mohon All-llahun e vet. Të afërmit e saj kishin rënë dëshmorë (shehidë), ndaj ajo ishte plot mburrje e krenari. Ajo ishte bijë, bashkëshorte dhe nënë, por edhe njeri i besimit. All-llahu kësaj gruaje në dhembjet e saj ia zbuloi horizontet e besimit të fortë, të pastër dhe të paluhatshëm. Mëshira e All-llahut e shndriti zemrën dhe shpirtin e saj.

E dinte ajo se në zemrën e saj diku thellë në qenien e njohurive të saj, se të gjithë ne jemi të vdekshëm dhe vetëm presim momentin e vdekjes dhe thirrjen e All-llahut: "Kthehu te Zoti yt!" Askush nuk mund t'i ikë vdekjes. Vdekja është gjithkund rreth nesh. Ndërsa sabri është lehtësim edhe për vdekjen e të dashurve.

E dinte ajo se jeta dhe vdekja janë urdhëra të Zotit. Nga sytë i rridhnin lotët fytyrës, kësaj gruaje fisnike dhe të ndershme, mirëpo besimi në All-llahun dhe sabri islam e mposhtën dhembjen, goditjet e forta dhe dëshpërimin.

Në të vërtetë, ajo e dinte se në Islam nuk ka pikëllim të vërtetë, sepse muminët nuk vdesin, por ata vetëm kalojnë në një jetë tjetër më të mirë, ku i pret shpërblimi i vërtetë. Askush nuk mund t'i ikë vdekjes, ndaj ajo do të na gjejë të gjithë neve. Vdekjen, muminët duhet ta kuptojnë si lindje dhe si pjesë të jetës. Edhe vdekja është nga i dashuri All-llah xh.sh.

I Dërguari i Zotit ka thënë:

“Tri çështje janë me të cilat njeriu e siguron lumturinë në të dy botët: e para – durimi në fatkeqësi; - e dyta – kënaqësia me urdhërat e All-llahut; e treta – të bësh lutje në gazmend dhe në bollëk”.

Në jetën e shumicës së muminëve të njohur e të panjohur, sabri i ka ndriçuar rrugët e së vërtetës dhe rrugët e dëshmuara të besimit, që shpiejnë në drejtim të xhennetit.

Sabri është i nevojshëm edhe në suksese, në gazmende, edhe në fitore kur ato ndodhin. Nuk duhet lejuar shfryrje vërshuese të vëllimit të lumturisë, që nuk i përket fesë islame.

Në rrethana të këtilla durimi e pastron shpirtin, i fisnikëron zemrat e besimtarëve. Edhe nëpërmjet këtij durimi, për të cilin po ashtu kërkohet shumë fuqi, manifestohet pendimi ndaj All-llahut xh.sh., modestia që është e dashur edhe për njerëzit. Në të mirë vërtet nuk duhet të sillemi me mendjemadhësi, e as në të keqe nuk duhet të përulemi. E për këtë lypset sabër!

Me sabër i kontrollojmë sjelljet tona, veprimet tona dhe gjithnjë bëhemi njerëz më të mirë e më të mirë. Kurse të jesh i mirë, ky është synim i muminit të sinqertë.

Sabri dhe lutjet e drejtuara All-llahut xh.sh. gjithmonë kanë qenë armë të muminit. Sabri është njëkohësisht edhe shpërblim i muminit, të cilin All-llahu xh.sh. e dhuron me bollëk nga Mëshira e Vet e pakufishme. Ai ka qenë gjithmonë drita dhe fuqia e besimtarit. Në sabrin e lutjeve drejtuar All-llahut xh.sh. është shpëtimi dhe ngushëllimi:

“Thuaj: O robërit e Mi që keni besuar, kini frikë ndaj Zotit tuaj. Ata që bënë mirë në këtë jetë, kanë të mirë të madhe, e Toka e All-llahut është e gjerë, ndërsa të durueshëmve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!”

(Kur’ani, 39:10)

Muslimanët në radhët e luftës së Talutit luteshin: “Zoti Ynë, na pajis me durim, janë lodhur këmbët tona”.

Muhammedi a.s. është lutur:

“O Zot, Të lutem të më dhurosh kënaqësi pas goditjeve të fatit”.

Ose:

“O Zot, më bën të durueshëm, më bën falënderues, më bën të vogël në sytë e mi, kurse të madh në sytë e botës”.

Është me rëndësi të dimë dhe të përsërisim një të vërtetë të pamohueshme: çdo gjë në botë është kalimtare, përveç All-llahut xh.sh. të përjetshëm. Vdekja është fundi i të gjitha ngjarjeve të kësaj bote. Kjo jetë, në krahasim me jetën e amsueshme, është sa çel e mshel sytë, është vetëm një çast. Ndërsa në Ditën e Gjykimit do të bëhet qërimi i hesapeve përfundimtare dhe dhënia e llogarive për veprat tona. Atje na pret shpërblimi dhe dënimi: Këtë All-llahu xh.sh. e ka premtuar, e Ai është e Vërteta e Shenjtë në të cilën nuk ka dyshim!

Puna - formë e ibadetit

Njeriu është krijesë e atillë për të cilin puna përfaqëson njëri nga bazat themelore të jetës së tij. Përbërja anatomike e njeriut është përshtatur punës dhe lëvizjes. Këtë ligj jetësor, Islami e ka përqaftuar si realitet të shkencës islamike, duke përfaqësuar njërin nga themetet mbi të cilin fillon rruga e drejtë. Puna nuk është vetëm porosi, por ajo është edhe pjesë e ibadetit. Puna dhe mësimi i muminit duhet të bëhen në emër të All-llahut. Vetëm në këtë mënyrë do të jenë të pranuar. Do të dëshiroja të tregoj një ngjarje nga jeta e Muhammedit a.s. Një ditë, Resulull-llahu rrinte me as'habët e vet, kur panë një djalë të fuqishëm dhe fisnik, i cili ishte zgjuar herët dhe shpejtonte për të shkuar në punë. Atëherë as'habët thanë: "E, sikur rinia dhe fuqia e tij të shfrytëzoheshin në rrugën e All-llahut!"

Muhammedi a.s., lidhur me këtë, utha as'habëve:

"Mos flisni kështu, sepse nëse ai është zgjuar herët për t'i mbajtur fëmijët e vet të vegjël, edhe kjo punë është në rrugën e Zotit; nëse është zgjuar herët për ta mbajtur vetveten dhe për t'u ruajtur nga lëmosha edhe kjo është në rrugën e Zotit; nëse është zgjuar herët për t'i mbajtur prindërit e vet pleq edhe kjo punë është në rrugën e Zotit; vetëm ënse është nisur të fitojë ë të mund të fryhet dhe të krenohet para të tjerëve, kjo punë është në rrugën e djallit".

Prandaj Pejgamberi i All-llahut punën e ka konsideruar ndër ibadetet më të mira njerëzore.

Te Sihabi është shënuar hadithi, i cili thotë:

“Të kërkosh fitim dhe furnizim në mënyrë të lejueshme është një lloj xhihadi-lufte të shenjtë që hyn në radhën e veprave më të mira”.

Në një rast hazreti Umeri, duke shkuar në Medine, takon një njeri të rreckosur, i cili qëndronte me duar të lëshuara dhe kurrfarë vullneti shikonte në horizont. Ishte i shëndoshë, por nuk donte të punonte dhe të siguronte bukën e vet. Umeri r.a. i ra me kamxhik shpinës duke i thënë: “Mos e përfaqëso fenë tonë me pamje të të vdekurit, vdekja (Zoti) të marrtë!”

Prindërit duhet t’i mësojnë fëmijët me punë dhe me disiplinë që nga ditët e para, ashtu si i mësojnë t’i thonë fjalët e para, ashtu si i mësojnë t’i qesin hapat e parë. Fëmijëve duhet mbjellë në zemër kuptimin dhe dashurinë për punë, kështu që puna të bëhet pjesë përbërëse e qenies së tyre, të jentë gëzuar kur punojnë, të mos rrinë kot si përtacë.

Fëmijës, kur fillon të kuptojë, duhet thënë: “Biri im, Zoti i Dashur, me Vullnetin e Vet, ka dëshiruar që të jesh këtu në Tokë, i dashuri Zot ty të ka dhuruar detyrë të shenjtë një jetën tënde. Ti duhet të punosh dhe të arriësh qëllimet e caktuara. Ndërsa qëllimet arrihen vetëm me punë. Mos lejo, biri im, të bëhesh njëri ndër përtacët e përbuzur!”

Nxënësit muminë duhet ta zotërojnë me kujdes lëndën, të jenë të shkëlqyeshëm, kështu që edhe nxënësit edhe profesorët, kur t’i dëgjojnë përgjigjet e tyre, të mbesin të habitur e që vetëm mund të thonë: *shkëlqyeshëm!*

Kur mëson, mumini duhet të mësojë me themel. Duhet të futet thellë në mësim, ta përvetësojë atë,

meqë i Dashuri Zot i ka dhënë rastin për mësim. Kurrë nuk guxon të jetë gjysmak. Kurrë nuk duhet t'i lejojë vetes kopjimin e detyrave nga tjetri. Kjo është një lloj dobësie, kurse në zemrën e muminit nuk duhet të ekzistojë kjo e metë. Mumini gjithmonë duhet të jeteë i ndershëm dhe i sinqertë. Ai duhet të jetë patjetër karakter i ndritshëm, shembull për çdo njeri!

Dhe tani kur zë ngojë mësimin gjithnjë më kujtohet përtaci dhe djerrakohësi (që e humb kohën kot). Ç'mund të dalë nga ai? Beso, asgjë! Kush do të mbështetet në të? Beso, askush! Ç'mund të premtojë ai? Sigurisht asgjë!

Shoqëria njerëzore kurrë nuk do të ketë dobi për përtacët. Ata janë barrë e rëndë, por barrë të cilës patjetër duhet ndihmuar që të bëhen më të mirë! Përtaci nuk e shfrytëzon kohë. Ai formalisht e vret kohën. Herët, që nga mëngjesi, mediton si ta kalojë ditën. Ku e kalon ai tërë kohën e vet? Në kafene, në kinema, në disko-klub, e nëse duhet, edhe duke i ngulur sytë në një pikë. Gjithçka tjetër, vetëm punë jo, vetëm mësim jo!

O njeri! Mos i lakmo kurrë përtacit, nëse ia akordojnë prindërit e pasur dhe ia servojnë e ia sjellin çdo gjë në tryezë. Lakmia nuk është cilësi islame, e ndër të tjera ta kesh të qartë se përtacia paguhet shtrenjtë dhe paguhet në flakën e vuajtjeve të luftës jetësore. Përtacin vetëm duhet ankuar. Ai nuk e ndjen gëzimin e jetës nëpërmjet punës. Ai nuk di se ç'është lumturia e mirëfilltë.

Muhammedi a.s. e ka lutur All-llahun xh.sh.:

"O Zot, prej Teje kërkoj mbrojtje nga brengat dhe nga pikëllimi, prej Teje kërkoj mbrojtje nga ligësia dhe përtacia".

Nga urtia islame thuhet: “Mos merr pjesë me përtacin në gjendjen e tij. Sa njerëz të mirë janë prishur me njollat e veset e të tjerëve”.

Filozofi i vjetër Sirahu, sipas gojëdhënës, ka shënuar:

“Përtaci është i ngjashëm me gurin e përlyer:

Çdokush fërshëllen për shkak të ndytësisë së tij.

Përtaci është i ngjashëm me një grumbull mbeturinash:

Kush e prek, i shkund duart.

Përkundër përtacëve, sa madhështorë dhe sa të vlefshëm janë punëtorët!

Sa i qesh fytyra punëtorit të gëzuar kur, pas kryerjes me sukses të punës, kthehet në shtëpi! Sa e hareshme është zemra e djaloshit, i cili sjell në shtëpi lajmin e gëzueshëm për provimin e dhënë me notë të shkëlqyeshme!

Në rezultatin e suksesshëm të punëtorit dhe në dhënien e provimit të studentit është investuar shumë fuqi dhe shumë punë. Mirëpo, në të dy rastet, ajo është luftë për një të ardhme më të lumtur. Çdo sukses është një shkallë e tejkaluar kah drita e shpirtit.

Disa nxënës dhe disa studentë mësojnë vetëm për të fituar një notë në provim, mësojnë për tituj, e jo për dije dhe dëshirë që vërtet t’u shërbejnë njerëzve të mirë. Shkalla e dijes së arritur në këtë mënyrë kryesisht është shumë e ulët. Kjo dije nuk është përvetësuar, kjo nuk është pranuar me vullnet të madh. E si mund t’i dorëzohemi kirurgut që të na operojë nëse dija e tij është e pamjaftueshme, nëse dija e tij është e mangët? Si mund t’i besohet inxhinierit të ndërtimtarisë që ta projektojë urën nëse nuk e njeh mirë statikën?

Prandaj po e përsëris dhe duhet përsëritur vazhdimisht e pakufi – kur të mësosh, mëso me themel, kur të punosh, puno me themel!

Mësimi dhe puna e atyre, që synojnë përsosmërinë e vet, duhet të jetë shembull për njerëzit e tjerë që të edukohen me një mësim dhe punë të këtillë!

Romakët e vjetër kanë thënë: “Të punosh fort, është mënyrë romake!” kurse mumini duhet thën: “Për qëllime fisnike duhet punuar edhe më fort, kjo është mënyra islamike!”

Romakët e kanë thënë edhe këtë: “Asnjë ditë pa punë”. Dhe vërtet, askush nuk duhet kaluar asnjë ditë pa punë. Çdo ndërprerje shpie në lodhje. Mësim dhe përsëri mësim, punë dhe përsëri punë! Edhe njëra edhe tjetra – me një kuptim të lartë fisnik, me një qëllim të lartë fisnik!

Mësimi i mirë dhe puna e mirë me vullnet të fortë e forcojnë karakterin dhe hapin rrugë të gjera kah e Mira e Madhe.

Shpesh mendoj sa të lumtur duhet të jenë ata nxënës, që kanë mundësi për të mësuar. Disa notojnë në mirëqenie e në bollëk. Kanë dhomën e tyre të punës, mjete të ndryshme ndihmëse, literaturë të bollshme. Dimrit dhomën e kanë të ngrohtë, kurse gjatë verës fishkëllojnë ventilatorët freskues. Qetësia dhe të gjitha të mirat janë aty.

Mirëpo, më kot, mësim nuk bëjnë! Këta nxënës të lazdruar, herë shikojnë ilustrimet, herë shikojnë gazetatat dhe kërkojnë ndonjë lajmërim për shfaqjen e filmave, herë shfletojnë fotografite nga albumi, herë shikojnë në tekst, të cilin duhet ta mësojnë, pastaj e shikojnë orën

dhe ofshajnë: "O, sa ngadalë po kalon koha!" Ditë pas dite kalojnë në asgjë. Jeta vazhdon në pakuptim. Dhe një ditë, kur kthehen e shikojnë prapa, shohin shumë vite të kaluara pa kurrfarë rezultatesh dhe suksesesh. Mbesin në shkallën më të ulët intelektuale. Humbja dhe vrasja e kohës e kanë dhënë frytin e vet të keq.

Ndërsa, në anën tjetër, sheh nxënësit e varfër, i cili nga fshati i largët me vite të tëra udhëton kilometra e kilometra prej shtëpisë së vet deri në shkollë, madje edhe për çdo ditë. Ai ndoshta mëson me dritën e qirit, në dhomë të ftohtë. Është i kënaqur kur ka mjaft bukë. Dimrit, nëpër fërfëllizë, i lagur dhe i mërdhirë, hapëron nëpër borë, nëpër skllotë ose baltinë me këpuccë të grisura që ia lëshojnë ujin ndërkaq, kur të kthehet nga shkolla, e presin shumë punë në shtëpi dhe jashtë saj. Koha e tij për punë shkollore është shumë e kufizuar. Pikërisht për këtë arsye ai ushqen në vete vullnet të fuqishëm e fisnik. Para dridhjeve të flakës së qirit, i mërdhirë dhe i rraskapitur, ai mëson me tërë qenien e vet, me përkushtim dhe plotësisht me themel.

Dhe shih, pra, ai është nxënës i shkëlqyer, ai është shembull në shkollë. Mësuesi i tij e përmend me mburrje emrin e këtij nxënësi. Ai është i tillë që nga shembujt e mirë të tij do të mund të mësojnë ata që vijnë pas tij. Ky është nxënës i vërtetë, karakter i fortë.

I solla këta shembuj kontraktitorë, të cilët kanë ekzistuar prej se ekziston qytetërimi njerëzor. Në këta shembuj njerëzit e rinj do të duhej të piqeshin në jetë dhe të mësonin prej tyre.

Kushtet që ka njeriu nuk janë vendimtare. Qenësore është të kesh vullnet për mësim dhe për punë. Të më-

sosh dhe të punosh me gjithë zemër dhe me të gjitha forcat e tua. Dikujt duhet siguruar të gjitha komoditetet, t'i ofrohen të gjitha mundësitë, por kot, mësim dhe punë nuk bën. Ndërsa dikush, pa të gjitha këto mund të arrijë rezultate të jashtëzakonshme. Të duash – do të thotë të mundesh, me ndihmën e All-llahut.

Kur mendoj për nxënësin e mirë e të vyeshëm, më kujtohet thnegla e zellshme dhe bleta punëtore. Ato nuk dinë për ndërprerje, nuk dinë për pushim. Jeta e tyre është punë me vlerë të madhe dhe me plot fryte. Ndërsa, nxënësi jopunëtorë, na kujton brumbullin, i cili zukat më tepër se bleta dhe gjendet gjithkund, por vepra dhe fryt të tij nuk ka. Djaloshi ose vajza kurrë nuk guxojnë t'i përngjajnë brumbullit. Gjithmonë duhet të jenë si bleta ose thnegla. Nuk duhet të lejojnë që të rrëmbehen nga kthetrat e papunësisë dhe të përtacisë!

Klasa e kryer le të jetë vërtet klasë e fituar! Mësimi i mësuar le të jetë vërtet mësim i përvetësuar! Nuk duhet të lejohet mësimi gjysmak. Të jesh i bindur se dituria më në fund gjithmonë do të ngadhënjejë. Këshillat e të diturve gjithmonë do t'i pranojnë ata, të cilëve u nevojitet ndihma. Mjekun e mirë e kërkojnë të gjithë, sepse e dinë se dija e tij është fituar me themel. Nëse ndërtuesi është i ditur, të gjithë do të kërkojnë që ai të jetë ai që ndërton, sepse e dinë se dija e tij është e mirë dhe e sigurt. Çfarëdo dije të ketë i riu, nëse ajo është përvetësuar me themel, ai gjithmonë do të jetë i kërkuar në bursën e tregun e jetës.

Të diturit kërkojnë gjithmonë, kurse të paditurit gjithmonë do të jenë të poshtëruar e të përbuzur! Këtë duhet mbajtur mirë në mend!

Ka nxënës që shtiren se mësojnë dhe nuk janë të sinqertë ndaj vetvetes. Dhe kur nxënësit e këtillë marrin nota të dobëta qajnë duke bërtitur: “Po unë kam mësuar!” Po, ka mësuar, por kurrë asgjë nuk ka nxënë. Çdo gjëje i është qasur lehtë, çdo gjë e ka punuar përciptazi. Prandaj tragjedia e tij është se ka fantazuar se i di të gjitha. Vetëm nota e dobët dhe rënia në provim e kanë kthyer në realitet, pikësisht në pavlerësinë e mësimin të tij, të punës së tij dhe përfundimisht të njohurive të tij. Ai asnjëherë nuk ka mësuar si duhet, asgjë nuk ka mësuar me themel! Prandaj edhe jeta e njerëzve të këtillë kalon në zbrazëtira, në vetëmashtrim.

Ibseni e përshkruan gjendjen e djelmoshave të këtillë, të cilët kot së koti e kanë humbur në papunësi jetën e vet, e cila, kështu siç është, kurrë nuk përsëritet më.

Rreth këtij djaloshi grumbullohen minutat e humbura, orët dhe ditët e jetës së pakuptimtë, duke i folur: “Ne jemi mendimet, të cilat ti është dashur t’i mendosh, ne jemi këngët, të cilat ti është dashur t’i këndosh, ne jemi lotët, të cilat ti është dashur t’i derdhësh, ne jemi veprat, të cilat ti është dashur t’i kryejsh!”

Mirëpo, më kot, jeta ka kaluar përgjithmonë, në pakufi... Vlen ta kujtojmë mendimtarin dhe letrarin egjiptian dr.Taha Huseinin. U lind në fshat. Në rininë e hershme u verbuan nga sëmundja e trakomës.* Mirëpo, ai ishte punëtor i zellshëm. Ashtu i verbër e kreu shkollën fillore dhe të mesme, u bë hafiz, e pastaj u regjistrua edhe në Sorbonë të Parisit. Edhe pse i verbër, arriti t’i kryejme kohë studimet dhe ta mbrojë te-

* Sëmundje infektive e syve (sh.p.)

mën e doktoraturës. Shkroi shumë vepra të rëndësishme, me të cilat u bë emër i njohur dhe i shquar në historinë e letërsisë egjiptiane. Kushtet e tij për punë ishin shumë të kufizuara, mirëpo vullneti i tij i mbizotëroi të gjitha pengesat.

Është edukative që të rinjtë të mendojnë për këtë njeri dhe për veprën e tij, të mendojnë për fuqinë e madhe të vullnetit të tij.

Keni dëgjuar me siguri për shkencëtarin e madh Ibni Sananë. Ai, me emër të plotë quhet Ebu ali el-Husein ibn Abdull-llah ibn Sina, i lindur më 358 sipas Hixhrit osenë vitin 980 sipas Isait a.s. Në moshën katërvjeçare filloi të ndjekë mësimet në mejtep (në shkollë fetare). Në moshën dhjetëvjeçare u bë hafiz dhe dinte përmendësh shumë hadithe. Për të fituar njohuri vizitoi një varg qendrash të atëhershme shkencore islamike. Nuk dinte për pushim. Mësonte me entuziazëm, duke zbuluar njohuri të reja, dhe punoi deri në momentin e fundit të jetës së vet të frytshme. Pas vete la veprën Ligjet e mjekësisë e cila në Përrëndim pati 50 botime, kurse rreth 600 vjet u bë teksti kryesor i shkencës së mjekësisë. Këtij i përkasin edhe dy zbulime të mëdha në fushën e mjekësisë: përdorimi i injeksioneve gjatë mjekimit dhe aplikimi i anestezionit me rastin e operacionit. Ai me këto zbulime u solli dobi të madhe njerëzve dhe ia zbuti dhembjet një numri të pakufishëm të të sëmurëve.

Krahas mjekësisë, Ibni Sina merrej edhe me filozofi, me psikoanalizë, me poezi, me muzikë (ishte i pari që shkroi notat muzikore), me fizikë, meteorologji, me gjeologji. Nga të gjitha këto fusha la punime të

rëndësishme shkencore dhe një mori zbulimesh dhe njohurish të reja. Pandehet se ka qenë njëri nga njerëzit më gjenialë në historinë e njerëzimit. Vetëm mund ta paramendojmë punën e tij kur kemi parasysh se sa i ka dhënë njerëzimit për 52 vjetë jetës së vet! Vërtet, ai ka qenë i talentuar, mirëpo pa vullnet për punë dhe pa punë këmbëngulëse e të vazhdueshme, duke u mbështetur vetëm në prirje të talentit, do të arrinte shumë pak. Shtrojmë pyetje përse të rinjtë nuk marrin mësim nga veprat e këtij mendimtari dhe shkencëtari të madh? Përse shumë prej tyre nuk do të punonin siç ka punuar ai dhe kështu t'i jepnin kontributin e vet përparimit të fisit njerëzor? Shumë e shumë njerëzve u janë ofruar mundësi për punë. Vetëm duhet të duan me tërë fuqinë, të kenë vullnet të hekurt!

Fshatari i vyeshëm

Në një rast Muhammedin a.s. e vizituan disa as'habë. Ndër ta ishte edhe fshatari i vyeshëm. Sa'di, i biri i Muadhit. Muhammedi a.s., duke ia parë kallot në duar, e pyeti se nga i kishte ato, ndërsa ai u përgjigj: "Nga puna me shat". Atëherë Muhammedi a.s. tha:

"Këtë dorë zjarri i xhehennemit nuk e djeg".

Muhammedi a.s. nuk i donte përtacët. Besimtarët muminë duhet ta dinë se All-llahu në Kur'an ka thënë:

"Dhe se njeriut nuk i takon tjetër, vetëm se ajo që ka punuar."

(Kur'ani, 53:39)

Muhammedi a.s. ka thënë:

- *Njerëzit e ditur e vazhdojnë misionin e profetëve të Zotit.*
- *Puno sikur të jetosh njëqind vjet, kurse bëni ibadet All-llaut xh.sh. sikur të vdesësh nesër.*
- *Unë jam dërguar që të jem mësues i parë.*
- *Mësimi është një send i humbur i muslimanëve, prandaj, ku a gjejnë, le ta marrin menjëherë.*
- *Njerëzit e ditur në Tokë shndrisin si yjtë në qiell.*
- *Të mësosh është farz (detyrim rigoroz) për çdo musliman dhe muslimane.*
- *Ai që e lë shtëpinë e vet dhe del të kërkojë mësim, ai është në rrugë të All-llahut.*
- *Ai që kërkon dije, atë e kërkon xhenneti.*

- *Ai që kërkon dije në emër të All-llahut, All-llahu do ta pajisë nga s'e kujton ai fare.*

Me respekt e kujtoj shkencëtarin e madh Lui Paste-
rin. Kalonin nga 48 orë, e ai nuk çohet nga tavolina e
punës, duke kërkuar zgjidhje për probleme të ndrysh-
me, me të cilat u bë i famshëm. Ai ishte i pari, që zbuloi
zierjen (vluarjen) e instrumentve kirurgjike para opera-
cionit. Me këtë i bëri shërbim të madh njerëzimit. Sa
njerëz vetëm në këtë mënyrë shpëtuan nga vdekja?! I
pari zbuloi shkaktarin e erëkuqes (lungës) së kafshëve
dhe metodën e imunizimit. Gjithashtu ky shkencëtar
ishte i pari që zbuloi serumin kundër tërbimit dhe
shpëtoi shumë njerëz nga vdekja e tmerrshme në mun-
dime më të mëdha. Vetëm mund të konstatojmë se çfa-
rë dobie u ofroi njerëzve ky njeri punëtor dhe modest!
Të gjitha i arriti me ndihmën e zotit, me punë të pa-
lodhshme dhe me vendosmëri këmbëngulëse.

Dikush ka shkruar:

"Ditura është jeta e zemrës, zëre,

Paditura është vdekja e zemrës, lëre!"

Francezët thonë: "Talenti është durim". Shumë
nxënës, që janë të talentuar, kanë kryer lehtë klasët në
shkollën fillore, por edhe në shkollën e mesme, sepse
ata kanë qenë të kujdesshëm në orët e mësimin, ndër-
sa lëndët nuk kanë qenë të vëllimshme. Me pak punë
i kanë zotëruar detyrat e parapara. Disa nga këta nxë-
nës, kur të vijnë në studime, që kërkojnë punë dhe
vendosmëri të fortë, e ata këtë s'e kanë, shpesh çaloj-
në. Lënda ka enë e vëllimshme dhe ka kërkuar punë
të vazhdueshme e me themel. Nxënësit e pavendosur
nuk kanë pasur forcë të brendshme që t'i zotërojnë

tekstet, të cilat kanë pasur 1000 e më tepër faqe. Të frikësuar nga qëndrueshmëria e kërkuar, të gjitha i kanë mësuar në mënyrë sipërfaqësore dhe kanë pasur dis-fata. Për të njëjtën kohë, nxënësi mesatar, por këmbëngulës e me shprehi pune, i ka mposhtur dhe tejkaluar të gjitha pengesat.

Fjala e urtë latine thotë: “Pika e shpon gurin”. Kjo është një e vërtetë e madhe. Dhe rishtas po e përsëris: këmbëngulës dhe vetëm këmbëngulës, puna në themel jep rezultate. Puna më themel dhe në detajet më të vogla – kjo është zgjidhje e suksesshme.

Për Leon Tolstojin thuhet se shumë herë i ka përpunuar, i ka përsosur dhe i ka shkruar përsëri tekstet e veta. Ai ka gjetur fuqi që të punojë në mënyrë të vendosur e të vazhdueshme. Nga ai talent, e nga ajo fuqi, kanë dalë aso vepras të mëdha letrare, me të cilat ai ka hyrë në historinë e letërsisë si shkrimtar i madh dhe si njeri fisnik.

Nuk mund të lë pa përmendur oratorin e madh të Greqisë së vjetër, Demostenin. Ai ka belbëzuar. Mirëpo, në një rast e kishte entuziazmuar një orator. Prandaj edhe Demosteni vendosi që t’i përkushtohet oratorisë. Vendosi me tërë qenien e vet. Për ta mbizotëruar belbëzimin, vuri një guralec nën gjuhë e pastaj vazhdimisht i përsëriste tekstet e mësuara. Dilte jashtë Athinës dhe, në një shkëmb mbi det, ushtronte fjalimet e veta, duke ngritur zërin e vet më shumë se gjëma e valëve të detit.

Sot, kur mësohet oratoria, leksioni i parë është Demosteni. Me fjalimet e tij, ai u bë i njohur në histori. Të gjitha i arriti vetëm me vendosmëri.

Shumë të tjerë, që nuk kanë pasur të meta në të folur, kanë mundur ta zotërojnë mësimin e oratorisë para Demostenit, por, për ta arritur këtë, nuk kanë pasur vullnet të fortë, nuk kanë pasur vendosmërinë e tij, energjinë dhe dashurinë e tij për punë. Kur fliste Demosteni, njerëzit e dëgjonin të magjepsur. Fjalët e tij depërtonin thellë në zemrat e njerëzve.

A ke menduar ndonjëherë sa mund dhe sa dije është investuar në ndërmarrjen e zbarkimit në Hënë? A ke medituuar sa qëndrueshmëri dhe sa vullnet është dashur që të arrihet e tërë kjo?

Vlen të dihet e vërteta: kur njeriu i ri i orienton përpjekjet e veta drejt punës fisnike, si sistem i vet i përhershëm, pa hamendje ose pa ndërprerje, me plot fuqi, nuk ekziston rezultat ose shkallë intelektuale, që me ndihmën e All-llahut nuk mund të arrihet.

Kur mendoj për punën e paluhatshme dhe të pa-ndërprerë, më kujtohet lumi i vogël, i cili me shekuj e thellon nëpër shkëmbinj shtratin e vet. Ajo është fuqi e paimponueshme, e pahetueshme, por shih për këtë arsye ajo është fuqi, që nuk mund ta ndalet. Edhe veprat e mëdha njerëzore janë të ngjashme me veprimin e tij. Vullneti i fortë i bashkuar me fuqinë, punën e themeltë dhe vendosmërinë e hekurt krijojnë vepra të mëdha fisnike, që hyjnë në histori.

Nuk ka shumë njerëz, të cilët mund t'i quajmë dijetarë të mëdhenj, mirëpo çdo njeri, në jetën e vet, mund të bëjë ndonjë vepër të madhe. Vetëm duhet t'i caktojmë vetes qëllimin, e pastaj duhet të duam me tërë fuqinë ndërkaq, puna fisnike e ndihmon marshimin drejt qëllimit më të lartë njerëzor – PËRSOSMË-

RISË SË SHPIRTIT. E të përpiqemi për këtë qëllim – kjo është punë e mrekullueshme.

Burhanuddi ez.Zernuxhi këshillon: “Kujtesa nxitet me vendosmëri, me qëndrueshmëri, me ushqim me masë, me namaz – nafile (vullnetar) të natës, me të mësuarit e Kur’anit me kuptim”.

Imam shejh Hasan bin el-Marginani i shkroi këto vargje:

“Të paditurit edhe para vdekjes vdesin

Të diturit edhe pas vdekjes jetojnë.”

Shiko veprat e artit, të letërsisë, të mjekësisë, të teknikës. Të jesh i bindur se asnjë nuk është krijuar lehtë, me pak punë e me pak vullnet. Secila prej këtyre veprave është krijuar gjatë netëve dhe ditëve të tëra me punë të mundimshme, me punë fanatike që do të thotë jetë. Puna është dhuratë e All-llahut xh.sh., të cilën Ai ia ka dhuruar njeriut dhe me këtë e ka ngritur mbi krijesat e tjera të kësaj bote. Puna edukon, e forcon vullnetin. Puna është nder i madh. Puna fisnike e fisnikëron njeriun, e bën më serioz dhe më mendjemprehtë. Çdo punë, sado e vogël që duket, është në dobi të njerëzve, është punë e madhe.

Kur magjetorja gatuan bukë për familje, edhe kjo është një punë e madhe. Kur fshistorja fshin pluhurin nga lulet, edhe kjo është një punë e madhe. Kur filloristi vogël me vendosmëri kërkon zgjidhje për detyrat e matematikës, edhe ajo është punë e madhe. Dhe një varg punësh të mëdha, që janë të pafund.

Në çdo punë të madhe është futur shpirti njerëzor, fisnikëria, mirësia, entuziazmi, qëndrueshmëria

dhe forca e vullnetit. Çdo punë, që ka qëllim të mirë, duhet respektuar.

A e di se si përgatiten njerëzit e mençur për punë? Çdo mbrëmje bëjnë planin e punës dhe të nesërmen i përmbahen rreptësisht. Dhe kështu ditë pas dite, gjatë tërë jetës.

Xhelaluddin Rumi shkroi: "Sunnet i Pejgamberit është munda dhe puna. Hadithi na këshillon se i dashuri i Zotit është ai, i cili punon dhe fiton. Përpiqu dhe puno deri sa të mundesh, o ti që merr vesh dhe që kupton se ç' do të thotë munda dhe puna. Kjo është rruga e Pejgamberit dhe e evliasë".

Një ditë hazreti Umeri r.a. doli jashtë qytetit, dhe, duke vërejtur një grup njerëzish, u afrua, u dha selam dhe i pyeti se ç' punojnë. Ata u përgjigjën: "Asgjë". Duke u çuditur me përgjigje të tillë, hazreti Umeri i shikoi, e pastaj i pyeti përsëri: "E me se jetoni, nëse nuk punoni asgjë?" Ata iu përgjigjën: "Ne vetëm në Zotin kemi shpresë" – "Pasha Zotin, ju nuk jeni ata, që kanë shpresë në Zotin, ju jetoni kot dhe në llogari të të tjerëve" – iu përgjigj hazreti Umeri. "sikur të ishit muslimanë të vërtetë, ju do ta kishit punuar këtë tokë dhe do ta kishit siguruar bukën për vete, e krahas kësaj edhe për kokrrën më të vogël të mbjellë do të bënit sevab. Kështu punojnë muslimanët e vërtetë, që e besojnë Zotin" – përfundoi Umeri i ndershëm.

Vlera e kohës

Në këtë botë kalimtare ne jemi për një kohë të shkurtër, për një kohë të kufizuar. Çdo orë, çdo çast për ne paraqet një vlerë. Nuk guxojmë të luajmë me të, nuk guxojmë ta kalojmë kohën kot. Për njeriun e drejtë kjo është e palejueshme. Jeta është detyrë jash-tëzakonisht serioze, kurse vdekja është dëshmitare e heshtur e këtij serioziteti fisnik.

Anglezët thonë: "Koha është flori". Po, kjo është e vërtetë, mirëpo koha është edhe shumë më tepër se kjo. Koha është çështje themelore e jetës së njeriut. Se si sillemi ndaj kësaj dhurate të Zotit, do të përcaktohet edhe i tërë qëndrimi ynë jetësor.

Në jetën tonë të kufizuar kemi detyra, të cilat duhet t'i realizojmë sipas aftësive dhe mundësive tona. Këto detyra janë shumë të rëndësishme dhe janë urdhëra të All-llahut të Madhërishëm. Njeriu i sinqertë nuk guxon të jetë indiferent. Çdo njeri ka misionin e vet në Tokë ndaj kryerjes së këtyre detyrave. Ai nuk do të guxojë ta presë në besë ose ta tradhtojë këtë mision.

Kur të hyj në bibliotekë dhe t'i shoh veprat e ndonjë shkrimtari, pyes veten: "Si është e mundur të ketë shkruar aq libra për një kohë aq të shkurtër? Si ka arritur ky njeri ta shfrytëzojë kohën në mënyrë kaq të mençur?"

Lexojmë për Imam Gazaliun: Është i lindur më 450 sipas Hixhrit, kurse kaloi në Ahiret në vitin 505

sipas Hixhrit. Shkroi një bibliotekë të tërë, rreth 700 vepra. Pjesën më të madhe e përbëjnë mesazhet e peygamberëve (risalet) të shkruara në 50-100 faqe. Mirëpo, ai ka shkruar edhe një varg veprash shumë të rëndësishme për ranga përmbajtja dhe vëllimi. Komenti (tefsiri) i tij përmban 15 libra të mëdhenj, "Ih-jau-ulumid-din" 4 libra, "Mustafa" 2 libra, "Vesit" 2 libra etj.

Jetoi rreth 55 vjet. Nëse marrim parasysh fëmijërinë e tij dhe shkollimin, vetëm mund të themi se jemi të mahnitur se çfarë energjie dhe çfarë vullneti kishte ky njeri. Si ka ditur ta shfrytëzojë dhe ta përdorë kohën me aq mençuri! Me punën e vet dha kontribut të madh në përhapjen e mendimit islam dhe të doktrinës islame.

Duhet të kujtojmë Bi'runin, Ibni Rushdin, Ibni Haldunin dhe veprat e tyre jetësore, se si për një periudhë të shkurtër kohe i kanë sjellë dobi të madhe fisit njerëzor. Ata kanë ditur ta shfrytëzojnë kohën e vet. Asnjë çast nuk e kanë humbur kot.

Edhe të rinjtë, të cilët e respektojnë jetën e dhënë nga All-llahu, duhet ta shfrytëzojnë në mënyrë të vlefshme kohën që kanë para vetes. Që nga njohuritë e veta të para duhet ta mësojnë doktrinën e shfrytëzimit të drejtë të kohës. Çdo fillim i hershëm jep fryt më të madh se ai i vonshmi.

Nëse, për shembull, një djalosh e mëson gjuhën angleze në moshën njëzetvjeçare, nëse ai jeton deri në moshën gjydhjetëvjeçare, periudha e shfrytëzimit të dijes së tij është dyzet vjet. Çdo vit vonesë e zvogëlon periudhën e shfrytëzimit të dijes së fituar në gjuhë, e

me këtë zvogëohet edhe dobia si për fisin njerëzor ashtu edhe për atë personalisht.

Në një orë të vjetër në Oksford shkruan: “Koha po kalon, por për të jepet llogari”. Dhe vërtet, të gjithë ne jemi përgjegjës për kohën në të cilën jetojmë. Askush prej nesh nuk e di se kur do të vijë çasti i vdekjes. E dimë vetëm se duhet të mësojmë dhe të punojmë me nder e fisnikëri, me emër të Zotit, në dobi të njerëzimit. E dimë vetëm se për çdo moment jemi më afër vdekjes, e cila vjen si një cilindër i pandalshëm. Askush nuk përjashtohet nga vdekja. E koha i numëron sekondat e veta. Ajo nuk rri. Dhe i thërret të zhellshmit e të aftët në punë. Para çdo njeriu qëndron punë e madhe dhe e vëllimshme! Këtë punë vetëm duhet njohur dhe duhet vënë vete si qëllim.

Mendoni vetëm sa mund duhet për punën më të vlefshme – edukimin shpirtëror. E është e pakufishme dhe plot shtigje puna, që shpie kah ky qëllim i lartë. Nuk di saktësisht sa vjet ke. Ndoshta 17, 18 apo 19? Nuk di as për djelmoshat e vajzat e tjera, që do t’i lexojnë këta rreshta, por do të gëzohesha sikur të gjithë do ta kuptonin seriozisht se vitet e kaluara nuk thehen kurrë më, se ato i takojnë vdekjes.

Po e përmend këtë, sepse besoj se me këtë dije shkojmë më me guxim dhe me më shumë bindje drejt lumturisë më të madhe – në vendin e denjë të Ditës së Gjykimit.

I riu shpesh duhet të mendojë për vdekje, por jo në atë mënyrë që këto mendime ta paralizojnë, e pastaj vetvetes t’i thotë: “Përse, më në fund, e gjithë kjo, pasi vdekja është fund i të gjithave?” Po, me të vërte-

të, ajo është fund i të gjithave, mirëpo jeta është e caktuar me detyrë që ajo të jetohet seriozisht, me dinjitet, me vlerë, e kuptimësuar, e qëllimshme. Shekspiri ka thënë: “Kape momentin për balluke!” dhe vërtet ashtu duhet vepruar. Ky është obligim i të mirëve. Mirëpo, këtu duhet të jemi konsekuentë. Bukur ka thënë Quintiliani: “Shpeshherë, derisa të mendoj se si t’ia filloj një punë, bëhet tepër vonë”.

Sikur të gjithë të rinjtë ta dinin vlerën e kohës dhe vlerën e vendosmërisë së shfrytëzimit të saj! Kam lexuar se një njeri e ka zotëruar shkëlqyeshëm një gjuhë të huaj, duke mësuar vetëm në pauzë derisa priste drekën dhe darkën në restorant. Ndoshta ka pritur nga 10 ose 15 minuta për çdo ditë dhe, në shikim të parë, kjo duket pak. Mirëpo, kur të shumëzohet me ditët e vitit, atëherë del se kapitali i kohës vërtet është i madh.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“All-llahu le të mos ma bekojë asnjë ditë në të cilën nuk mësoj diçka të re!”

Hasan Basri shkruan: “Çdo ditë që vjen, i thotë njeriut: - O njeri, unë jam ditë e re dhe do të dëshmoj për atë që punon sot. Kur të largohem prej teje, nuk do të kthehem kurrë më. Prandaj, përgatit ç’dëshiron, por dije se do të gjesh vetëm atë që ke përgatitur vetë, e le ç’të duash, por dije se në atë ditë kurrë më nuk do të kthehesh”.

“O njeri, dita jote është mysafiri yt, i cili do të lë. Në fund ose do të falënderojë ose do të përgojë. Po kështu qëndron puna edhe me natën”.

Ebu Tajjib el-Mutebbi ka thënë:

“Nuk po shoh të meta më të mëdha te njerëzit,

Se mungesat e njerëzve, të cilët mund të përsosin diçka deri në fund.

Me punën e bërë, arrihet ajo që dëshirohet.

Ai që dëshiron ta realizojë dëshirën, çohet natën.

Ditët e rinisë i shfrytëzon,

Sepse rinia nuk zgjat deri në amshim”.

Thuhet se Jahja bin Muaz er-Razi ka thënë:

“Nata është mjaft e gjatë, mos e shkurto me gjumin tënd.

Dita është e shenjtë, mos e turbullo me mëkatet e tua!”

- Katër gjëra nuk mund të kthehen kurrë më: Fjala e thënë, shigjeta e hedhur, koha e kaluar dhe rasti i pashfrytëzuar (fjalë e urtë arabe).

Saktësia është virtyt i të mençurve

Në rrugën e madhe kah drita e shpirtit ndeshemi edhe me një virtyt, që mund të përvetësohet dhe të bëhet pjesë përbërëse e qenies dhe e jetës njerëzore, që njeriu të jetë tamam njeri i vërtetë. Pa këto virtyte në jetë nuk ka nxitje për shkallë më të larta shpirtërore, për përsosmëri të shpirtit.

Nëse pyet se për cilin virtyt po flas? Po flas për saktësinë, për precizitetin, për qasjen e themeltë të çdo veprë.

Duhet të jemi të saktë: në mëngjes, në drekë, në mbrëmje, çdo sekondë, çdo minutë, çdo orë, gjithnjë. Kur ta dëgjosh thirrjen e muezinit duhet të nisesh në namaz: i shpejtë, energjik, i freskët, i saktë, t'i përgjigjesh me kohë thirrjes së All-llahut.

Kurrë nuk duhet shkelur marrëveshjen. Kur të zgjidhen detyrat nga matematika, ato duhet të jenë të sakta. Kur të caktohet mbledhja, duhet të vijmë në kohë të saktë. Kur premtojmë se do ta kthejmë sendin e huazuar, duhet ta kthejmë në kohë të caktuar. Kur të bëjmë çfarëdo pune, duhet të jemi të saktë, precizë, të themeltë. Kur i premtojmë All-llahut për besnikëri duhet ta mbajmë premtimin maksimalisht.

I dashuri Zot xh.sh. është përsosmërisht i saktë. Në krijimtarinë e tij nuk ka zbrazëtira, nuk ka mangësi. E gjithë natyra, gjithësia, hapësira e pakufishme, madje edhe atomi më i imët – të gjitha janë krijuar me

saktësinë më të përkryer nga dija e All-llahut. Atmosfera jonë e mbron jetën në tokë nga depërtimi i rrezeve radioaktive. Sikur mbrojtjen e atmosferës ta forconte vetëm pak më shumë ose ta dobësonte pak, do të pasonin rreziqe të mëdha për ekzistencën biologjike në Tokë.

Sikur vetëm për një çast të ndalej Toka në rrotullimin e saj rreth boshtit të vet ose rreth Diellit, do të shkatërrohej, do të ndodhte katastrofë e vërtetë. Jeta do të shlyhej, mirëpo All-llahu e di më së miri! Do të pasonin tërmete të mëdha, shtërngata, do të aktivizoheshin vullkanet, do të tërbohej deti.

Sikur truri njerëzor të pushonte për disa minuta të pranonte gjak, do të pasonte vdekja. Sikur të ndalej qarkullimi i gjakut në zemër për një kohë të shkurtër, do të pasonte vdekja. Sikur... Sikur... Dhe "Sikur" të këtilla të pakufishme...

"...e në ligjin e All-llahut kurrë nuk do të hasësh devijim."

(Kur'ani, 35:43)

"Në çdo send kemi krijuar me masë të caktuar. Puna jonë (në krijim) është e shpejtë sa çel e mshel sytë".

(Kur'an, 54:49-50).

Ke lexuar ose ke dëgjuar për zellshmërinë e blëtës. Mirëpo ndoshta nuk e ke ditur se ajo në hoje ndërton prizme gjashtëkëndëshe dhe me raport të atillë të këndeve, saqë, me një shpenzim të vogël të energjisë dhe të materialit, arrin vëllimin më të madh. Kjo njohuri e entuziazmoi profesorin e njohur të matematikës nga Parisi. Ai i ka matur saktë këndet në gjashtë-

këndëshin e huallit të bletës. Dhe kur i ka vërtetuar relacionet e këndëve me llogari diferenciale, për të fituar hapësirë maksimale, për çudi të vet, ka konstatuar e të dhënat llogaritëse shmangen nga këndet e bletës për tri sekonda. Përsëri e ka verifikuar llogarinë. Dhe çfarë përfundimesh nxori? Tabelat llogaritëse, me të cilat e kishte bërë llogarinë, kishin pasur gabime për tri sekonda. Bleta nuk kishte gabuar, kishte gabuar autori i tabelës llogaritëse ose gjatë botimit të veprës ishte përvjedhur gabimi në shtyp. Bleta e saktë, precize, me efekt maksimal i ka ndërtuar hojet e veta.

Të jesh i bindur se gjithkund rreth nesh ndeshemi me krijime të përsosura. Kjo është vepër e All-llahut xh.sh. të Gjithëfuqishëm dhe të gjithëdijshtëm. All-llahu xh.sh. e ka krijuar njeriun në trajtën më të bukur dhe më të përsosur. Mendja nuk mund ta kuptojë funksionalitetin aq të ndërlikuar të organizimit njerëzor. Veprat e njeriut duhet të jenë të atilla çfarë dëshiron All-llahu xh.sh. All-llahu xh.sh. është i saktë, ndaj Ai e do saktësinë. Njerëzit e karaktershëm e të mirë duhet të jenë të tillë. Ky është virtyt i çmuar, të cilin çdokush duhet ta miratojë!.

Immanuel Kant, filozof i njohur gjerman, me dekada, për çdo ditë, saktësisht në ora tre pasdite dilte nga shtëpia e vet në shëtitje. Njerëzit, sipas tij, i kurdisnin orët e veta. E këtillë ishte jeta e tij dhe puna e tij.

Kujtoje ndërmarrjen e depërtimit të raketës në gjithësi. Merre me mend sa muaj dhe sa vjet studimesh dhe hulumtimesh janë nevojitur që të fillojë një ndërmarrje e këtillë. Janë bërë verifikime të panumërta të saktësisë së çdo pjese të raketës, të çdo instrumenti, të

çdo lëvizjeje. Është dashur të arrihet patjetër preciziteti fantastik, përndryshe e tërë puna në këtë drejtim do të shkonte huq.

Në krijimtarinë e All-llahut xh.sh duhet të mësojmë për saktësinë. Besimtari duhet të jetë i sigurt se ai është njeri, i cili duhet ta ndjekë këtë cilësi të njerëzve të karaktershëm.

Saktësia është virtyt dhe ndaj kësaj dhuntie të All-llahut duhet të sillemi me respektin më të madh. E për ne shembull i saktësisë ka qenë Resulull-llahu a.s., i cili, me jetën e vet, me veprën dhe fjalët e veta, ka dëshmuar se si duhet jetuar në mënyrë të mençur dhe të vlefshme.

Kam pasur një mik, që ishte jashtëzakonisht i saktë. Sikur të thoshte: "Do të vij", këtë e bënte saktësisht në minutë, saktësisht me tiktaket e orës. Një ditë më premtoi se do të vinte në orën 7 të mbrëmjes. Ora rrahu shtatë herë, kurse zilja në derë ende nuk ishte dëgjuar. Kaloi një minutë, kaluan dy, tri minuta, e atëherë dëgjova, zilja cingëroi... Hapa derën, por nuk ishte ai. Djaloshi tha: "Mikut tuaj, pak para marrëveshjes për taim, i vdiq motra, ndaj më dërgoi që t'ju kërkoj falje në emër të tij".

U ktheva ngadalë dhe mendova: "Miku im është njeri i madh".

Trimave u ndihmon fati

Njerëzit me karakter e zemër fisnike i stolis virtyti i mrekullueshëm – trimëria. Islami, me misioni e vet të shenjtë të nxitjes dhe të kultivimit të çdo gjëje pozitive, e stimulon trimërinë, madje trimërinë fisnike, që manifestohet në mbrojtjen e besimit në Një Zot xh.sh., në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe të respektimit të personalitetit njerëzor, vlerave morale dhe etike, në mbrojtjen e drejtë të nderit dhe të vlerës së familjes, të shtëpisë dhe të vendlindjes.

Me trimëri fisnike ndriçohet shpirti njerëzor, zbulohen horizonte të gjera të besimit, udhëzohet në rrugën drejt dritës shpirtërore, shtegut të amshueshmërisë, të paracaktuar për hapat e njerëzve më të virtytshëm.

Ibrahimin a.s. besimtarët e idhujve e vunë në turrë të druve që ta digjnin shpirtin e tij, trupin e tij dhe besimin e tij. Mirëpo, i qetë dhe pa frikë, me zemrën plot trimëri, Ibrahim i a.s. fisnik u nis që t'u dalë përpara vrushkujve të zjarrit. Për asnjë moment zemra e tij nuk u dridh, nuk u shqetësua. Fjalët, mendimet, ishin të drejtuara kah i Madhërishmi All-llah xh.sh.

“Medet për ju dhe për ata që i adhuron, pos All-llahut, po a nuk po kuptoni? Atëherë ata thanë: Digjeni atë (Ibrahimin) dhe ndihmoni zotat tuaj, nëse doni t'u ndihmoni! Po Ne i thamë: O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin! Ata deshën t'i bëjnë atij (Ibrahimit) kurth, po Ne ata i bëmë më të dështuarit. E Ne shpëtuam atë e edhe

Lutin në atë tokën që e kemi bekur për njerëz. Dhe ia falëm atij Is-hakun, e si dhuratë edhe Jakubin. Dhe që të gjithë i bëm të mirë (pejgamberë)."

(Kur'ani, 21:67-72)

Isa a.s. trimërisht u ngrit në mbrojtjen e besimit në Një All-llah xh.sh. para akuzave të gjyqit romak dhe kompleteve smirëzeza. Me trimëri fisnike ai e mbrojtì dinjitetin njerëzor dhe të drejtë për lirinë e mendimit të njerëzve, të fjalëve dhe të besimit.

Përkundër fuqisë së fortë fizike të Perandorisë Romake, Isa a.s. shëndetlig, ishte fitimtar moral dhe shpirtëror. Në asnjë moment nuk iu frikësua kërcënimeve me gjykim dhe vuajtjeve të tmerrshme. Ai vërtet ishte trim.

Kur i hodhën nxënësit e tij në arenat e Romës, nën kthetrat e bishave, ata nuk u sprapsën asnjë hap. Bishat i shqyen dhe i copëtuan, por ata nuk e mohuan besimin e vet në Një Zot xh.sh. Bashkë me ulërimën e luanëve dhe tigrave të egërsuar, të përgjakur me gjakun e njerëzve të pafajshëm, dëgjohej vetëm lutja e martirëve për lavdinë e Zotit të Madhërishëm. Të qëndrosh në besimin në Një Zot, mos ta mohosh, përkundër ndërsimit të bishave të tërbuara dhe të uritura – kjo është trimëri e vërtetë heroike.

Profeti i fundit i Zotit, Muhammedi a.s., qe shembull i trimërisë fisnike. Në betejat, në të cilat mori pjesë sikur fryma e vdekjes dhe e frikës ta mbulonte fuqinë e betejës, shumë prej tyre, të cilëve nga shqetësimi, në rrëmujën e luftës filloi t'u dridhej zemra, në sytë e Resulull-llahut kërkonin shpresë. Ai qëndronte

si shkëmb i patundur në shkëlqimin e dritës së besimit. Të gjithë shpejtonin të afroheshin pranë tij ose pas tij, që fuqia e trimërisë së tij, fuqia e besimit të tij t'u jepte fuqi edhe atyre. Edhe muxhahidinët e ndjenin afërsinë e tij, duke dëgjuar fjalën e tij, rishtas edhe më fort, më trimërisht vërsuleshin me emrin e All-llahut në gojë në luftë, por edhe në vdekje.

Te vend i quajtur Mu'te, ushtria islame u ndesh me ushtrinë e madhe të Bizantit. Epërsia e bizantinëve ishte dukshëm më e madh. As'habët këshilloheshin ndërmjet vete se çka të bënin në këtë situatë. Abdulllah ibni Revaha tha: "Ju jeni nisur të kërkoni vdekjen heroike. Ne nuk luftojmë me armikun në mbështetje të numrit tonë dhe të fuqisë sonë, por në mbështetje të fuqisë së besimit tonë, me të cilin All-llahu xh.sh. na ka dhuruar. Ta fillojmë betejën me ta! Na presin dy të mira: fitorja ose vdekja heroike!"

Dhe pa frikë, pa hamendje asnjë çast, grupi heroik i muxhahidinëve islamikë u nis në sulm kundër bizantinëve.

Në luftë ra dëshmor udhëheqësi ushtarak Zejd Ibni Harith, prandaj udhëheqjen e mori në duar Xhafer Ibn Ebu Talib. Atje i ngordhi kali, dorën e djathtë ia prenë armiqtë, mirëpo, flamurin e mbajti me dorën e majtë. Shumë shpejt ia prenë edhe këtë dorë, mirëpo ai edhe pa duar vërsulej përpara duke u dhënë shembull ushtarëve të vet. Pa duar nuk mund të luftohej, ndaj armiku shpejt e mbyti. Resulull-llahu për këtë trim pat thënë se në vend të dy duarve, në xhennet do t'i ketë dy krahë (fluturues). Për këtë arsye as'habët e quajtën Tajjar", do të thotë, ai që fluturon me krahë.

Ibni Umeri rrëfente se pas betejës në Mu'te e kërkuan Xhaferin në mesin e të vdekurve. Ai kishte në trup rreth 50 plagë. Të gjitha ishin në pjesën e përparme të trupit, sepse Xhaferi nuk ia kishte kthyer shpinën armikut.

Kjo ishte trimëri heroikenë luftë për ideale të mëdha fisnike. Xhaferi e flijoi jetën e vet në emër të All-llahut xh.sh. që tu sillte njerëzve dashuri e paqe dhe e mbrojti dinjitetin e njeriut.

Njeriu duhet ta edukojë zemrën e vet për trimëri fisnike gjatë tërë jetës. Kur lakmia e së keqes vërsulet në shpirtin njerëzor, duhet vepruar trimërisht kundër saj. Ashtu siç kanë ditur shumë trima t'u kundërvihen dhunuesve fodullë e mburravecë, të cilët, u nisën të shkelin çdo gjë të vlefshme në qenien e njeriut, po ashtu edhe njeriu i ri duhet t'u kundërvihet vendosmërisht veseve dhe të metave, të cilat përpiqen të zhdukin çdo gjë të mirë në shpirtin e tij. Në këtë luftë të madhe duhet të jesh patjetër trim fisnik, i qëndrueshëm, besnik i qëllimit të caktuar: i përsosmërisë shpirtërore.

Drita e virtytit

Shkalla më e lartë e shpirtit është e lidhur me jetën e virtytshme. Kjo është një e vërtetë e qartë dhe e kuptueshme. Historia, mësuësja e jetës, na tregon se njerëzit e mëdhenj shpirtërisht kanë qenë me karakter të pathyeshëm dhe moralisht të përkryer e me virtyte të larta. Të kujtojmë pejgamberët e Zotit: Ibrahimin a.s., Musanë a.s., Isain a.s., Muhammedin a.s. dhe shumë njerëz të tjerë të mirë.

Populli që ka pasur moral në nivel të lartë, gjithmonë ka shënuar përparim të dukshëm, ndërsa popujt, të cilët janë zhytur në baltën e amoralitetit, janë hedhur në vetëshkatërrim.

Historia na rrëfen për shkatërrimin e Sodomës dhe Gomorës, qytete të zhytura në kurvëri të tmerrshme; për shkatërrimin e Kartagjenës, për rënien e Athinës dhe të Romës. Derisa në Romën dhe Athinën e lashtë burrat dhe gratë kanë qenë personifikim i virtytit dhe cilësive morale, këto qytete kanë lulëzuar, duke bartur zhvillimin e qytetërimit në të gjitha anët. Mirëpo kur në jetë filluan të depërtojnë laviret dhe marrëdhëniet jashtëmartesore, duke u përhapur kështu dashuria e lirë dhe amorale, kur erdhën në fron mbretëreshat – lavire: Mesalina, Popeja, atëherë këta popuj filluan të shkatërrohen. Shkatërrimi ishte i pashmangshëm, ashtu sikur që pas ditës bëhet natë. Ai personifikohej në erupcione vullkanike, tërmet, in-

vazione të popujve të tjerë. Epshi i tmerrshëm me të keqen dhe ndytësinë e vet, që barte në gjirin e tij, sillte shkatërrimin.

I dashuri All-llah ua tërhoqi vërejtjen popujve:

“A nuk i kemi shkatërruar Ne popujt më të hershëm?

Dhe pastaj pas atyre ua shoqëruam të tjerët më të vonshëm. Ne ashtu bëjmë me kriminelët.”

(Kur’ani, 77:16, 17, 18)

Orgjitë e kurvërisë gjithnjë kanë shkaktuar dilema, të cilat u kanë hapur njerëzve shtigje të ndryshme. Të rinjtë gjithmonë janë gjendur para sprovave të tmerrshme, të nisen rrugës së virtytshme e të urtësisë apo rrugës së kurvërisë, që i ftonte me një thirrje joshëse, pas së cilës fshihej buzëqeshja shpirtligë e djallit.

Ja se çka shkruan në kohët e lashta shkrimtari i vjetër grek Ksenofoni për një dilemë të këtillë të heroit mitologjik. Herkullit:

“Herkuli, heroi mitologjik i Greqisë, mishërim i fuqisë burrëror dhe i guximit, kur ishte në moshën e djallërisë, një ditë u gjend para dy grave. Njëra filloi t’i fliste:

- O Herkul, pikërisht po të shoh se je duke menduar se në cilën rrugë të nisësh. Eja me mua, në rrugën time të këndshme. Të presin vetëm gëzimet, dërrimet, gostitë, të gjitha i ke pa mund dhe pa punë!

- Grua, si e ke emrin? – e pyeti Herkuli.

- Miqtë e mi më quajnë Fat, kurse armiqtë e mi më quajnë Mëkat, - u përgjigj gruaja.

Atëherë filloi tjetra:

- Nuk dua të të mashtroj. Nuk ka asgjë madhështore e të lavdishme pa punë e pa përpjekje. Nëse ni-

sesh rrugës sime do të punosh shumë. Nëse do që të lavdërojë e tërë Greqia, përpiqu t'i bësh mirë Greqisë. Nëse dëshiron që arat e tua të japin prodhime të begatshme, punoi ato! Nëse dëshiron të bëhesh luftëtar, mësoje këtë mjeshtëri nga njerëzit e përgatitur. Nëse dëshiron fuqi, nëse dëshiron vullnet të fortë e të hekurt burri, ushtroje trupin tënd, përballoi punës së vështirë fizike. – atëherë e ndërpreu Mëkati.

- A po dëgjon, Herkul, se në çfarë rruge të vështirë po do të të shpie kjo grua, e sa rrugë të lehtë po të ofroj unë?

- E gjerë, - briti Virtyti. – Çfarë të mire mund t'i japësh t'i? Pi para se të marrë etja, ha para se të marrë uria. Ti mallëngjehesh për ëndrra, jo pse je e lodhur nga puna, por nga mospuna, sepse asgjë nuk ke punuar. Ithtarët e tu i nxit në dashuriçka, para se atë ta kërkojë natyra dhe nevoja e tyre. Edhe pse je tërheqëse, të gjithë të mirët të mohojnë, kurse të ndershmit e fisnikët të përbuzin. Unë, përkundrazi, jam dashamirë e njerëzve që kanë plot virtyte, trimëri e burrëri. Herkul, bir i prindërve të lavdishëm, nëse nisesh rrugës sime, rrugës së virtytit, lavdia jote do të jetë e pavdekshme”.

Qasja e afrimi në kurvëri është trokitje në dyer të xhehenemit. E kush troket në këto dyer të ferrit, ato i çilen hapekrah dhe këto dyer të djallit e tërheqin në humnerat e thella të xhehenemit. E lusim All-llahun e Dashur xh.sh. që t'i ruajë të gjithë njerëzit nga ky sprovim i rëndë!

Unë e di se te djemtë e mirë dhe te vajzat e mira në aspektin e zgjedhjes së rrugës së urtësisë apo të kurvërisë – dilema nuk do të ketë. E di se ata, në jetën

e virtytshme, do të ngjiten në sferat më të larta shpirtërore. Kjo është rruga më e bukur.

Duhet të jesh i moralshëm, i virtytshëm, i ndershëm. Nuk duhet të shiten cilësitë e virtytit, që All-llahu xh.sh. ia ka dhuruar njeriut. Nuk duhet t'i shmangeni rrugës së moralit. Islami ka parashtruar kërkesa rigorozë për pastërti morale.

Dëgjo se ç'thotë All-llahu xh.sh. në Kur'an:

"Dhe mos iu afroni amoralitetit (zinase), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe."

(Kur'ani, 17:32)

Muminët duhet ta dëgjojnë All-llahun xh.sh. dhe ta kenë ndërmend këtë urdhër të tij. Kushdço qoftë ai që thërret në afrim të amoralitetit nuk mund të jetë njeri i mirë dhe nga ai flet vetë djali, i cili fton në grykë të xhehennemit. Këtu duhet qenë të vendosur, të qartë, të fortë dhe kësaj të keqeje guximshëm duhet thënë: "Jo", "jo" dhe gjithnjë "jo". Duhet thënë: Unë e dua të Dashurin All-llah xh.sh. dhe kurrsesi nuk dua të jem i padëgjueshëm ndaj urdhërave të Tij.

Me ajetin e mësipërm Kur'anor All-llahu ndalon qartë çdo qasje të kurvërisë. Sheriati thotë: "Kur është një gjë e ndaluar, është e ndaluar edhe çdo gjë, që shpie në drejtim të saj". Kështu Islami ndalon edhe mendimin e degjeneruar për aktin e kurvërisë, pornografinë, fjalët e pahijshme, veshjen provokative, përqafimin, puthjen, kapjen dorë për dorë të djaloshit dhe të vajzës, si dhe të gjitha rastet dhe rrethanat, që do të mund të sillnin në shkeljen e urdhërit të All-llahut.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Pas besimit në shumë zota dhe idolatrisë, nuk ka mëkat më të madhe tek All-llahu, se marrëdhënia suksuale e burrit me gruan, që nuk është e lejuar (hallall)”.

Muhammedi a.s. e ka thënë edhe këtë:

“Sytë shkaktojnë prostitucion me të shikuar, veshët me të dëgjuar, gjuha me të folur, dora me të prekur, këmba me të ecur”.

“Atë ditë kur askund nuk do të gjendet hije, përveç hijes së All-llahut, All-llahu xh.sh. do të vendosë shtatë njerëz në hijen e vet”.

Ndër këta shtatë gjendet edhe i riu, të cilit, kur t’i afrohet gruaja e bukur dhe e pashme, ai përgjigjet: *“Jo, unë i druaj All-llahut”.* Dëgjo tregimin për Jusufin a.s., të birin e Jakubit a.s.:

Jusufin a.s. e shitën shpëtimtarët e tij, të cilët e nxorën nga pusi, ku e kishin hedhur vëllezërit e vet. E bleu një njeri i shquar i Misirit. Kur’ani për këtë thotë:

“E ai që e bleu nga Misiri (Egjipti) i tha gruas së vet: Bëni pritje të kënaqshme, se është shpresa t’ia shohim hajrin ose ta adaptojmë për fëmijë! Ja, kështu (sikurse e shpëtuam nga bunari), Ne i bëmë vend Jusufit në tokë (në Egjipt), e që t’ia mësojmë atij shpjegimin për disa ëndrra. All-llahu është mbizotërues i punës së Vet, por shumica e njerëzve nuk e dinë (fshehtësinë e çështjeve). E kur e arriti pjekurinë e tij, Ne i dhamë pushtet e dituri. E kështu Ne i shpërblejmë punëmirët. E ajo, në shtëpinë e së cilës ishte Jusufi, i biri lajka atij dhe ia mbylli dyert e i tha: Eja! Ai (Jusufi) tha: All-llahu më ruajtë, ai zotëriu im (e burri yt), më nderoi me vendosje të mirë (si mund t’i bëj hile në familje?). S’ka dyshim se tradhtarët nuk kanë sukses. Ajo e

mësyni atë qëllimisht, e atij do t'i shkonte mendja ndaj saj, sikur të mos i prezentohej argumenti nga Zoti i tij. Ashtu (e bëmë të vendosur) që të largojmë nga ai të keqen dhe të ndytën. Vërtet, ai ishte nga robët tanë të zgjedhur."

(Kur'ani, 12:21-24)

Jusufi a.s. ishte shërbëtor besnik i All-llahut. Ai, përkundër thirrjes joshëse të djallit, nuk e mohoi besimin e vet në All-llahun xh.sh. uk e tradhtoi rrugën e All-llahut. Ai qe shërbëtor i ndershëm, i sinqertë dhe i qëndrueshëm i All-llahut.

Duhet ndjekur shembullim moral të Jusufit a.s. dhe virtytet e tij. I riu dhe e reja islame janë të virtytshëm dhe fisnikë. Ata janë heronj të moralit. Ata janë si flamuri i ngritur lart në të cilin shkruan "VIRTYTI". E flamuri i virtytit nuk guxon të jetë i përlyer. E di se të jesh i virtytshëm është vështirë, mirëpo shih për këtë është nder dhe heroizëm. Nga beteja për rini të ndershme, kundër kurvërisë dhe amoralitetit, dalin trimat-heronj, dalin njerëz me karakter të ndritshëm. Kurorat e fitores së tyre janë të mrekullushme. Janë të pastra, pa njolla, të praruara me freskinë e diellit të shpirtit njerëzor. Ajo betejë është farkatorja e karakterit të shkëlqyer. Vërtet, bukuria e pastër e virtytit rinor nuk mund të rrëfëhet me gojë.

Shileri, poet i madh gjerman, shkroi:

*"Do të doja të shoh kush mund t'i bëjë ballë,
Dhuntisë së mrekullueshme të së pastrës rini
Dhe amanetit të virtytit e të mirëfilltës bukuri".*

Për bukurinë e virtytit, për cilësitë, për shpirtbardhësinë, për buzëqeshje të sinqertë vlen të qëndrojmë në rrugën e Fjalëve të All-llahut. Dashuria dhe res-

pekti ndaj Zotit të Plotfuqishëm, njohuria për vlerat personale, synimi në rrugën e lumturisë, kah gëzimi i të dy botëve, dëshira për arritjen e shkallës më të lartë shpirtërore, janë armë të pastërtisë morale. Në zemrat e njerëzve të lumtur gjithmonë është i ngritur lart flamuri i virtytit, e besimtari i All-llahut nuk do ta lëshojë kurrë flamurin e besuar. Prandaj All-llahu i Madh i mbron njerëzit me karakter dhe me virtyte të larta. Duhet mbajtur në mend:

“E nëse të godet shejtani me ndonjë vesvese, ti kërko strehim te All-llahu, sepse vërtet Ai dëgjon e di.”

(Kur’ani, 7:200)

Kontrolli i epsheve seksuale disave u duket si prangat, që e pengojnë njeriun. Ky është hutim i dukshëm. E vërteta e mirëfilltë është se në kontroll është shpëtimi nga robërimi ndaj pasioneve. Pikërisht me anë të kontrollit, Islami dëshiron t’i jetësojë vlerat shpirtërore në brendinë e njeriut ë rruga e afrimit të burrit me gruan të jenë brenda kufijve moralë, brenda kufijve të njerëzisë, që i ka caktuar All-llahu xh.sh.

Nga përmbledhja e porosive të të urtit Sulejman a.s. po sjellim vargjet:

*“Kush mund ta bartë zjarrin në gji,
e rrobat mos ti digjen?*

*Kush mund të ecë nëpër prush të nxehtë,
e këmbët e veta mos t’i përcëllojë?*

*Kështu i ndodh atij, që i qaset gruas së të afërmit të vet,
Nuk do të mbetet pa dënim kushdo, që atë e prek”.*

Prandaj është thënë e Vërteta e njohur:

“Sa më larg kurvërisë....”

Njeriu është vepër madhështore e All-llahut xh.sh.

All-llahu e krijoi njeriun në trajtën më të bukur, e frymëzoi atë nga Shpirti i Vet dhe e bëri zëvendës të Vet në tokë. Duke i dhuruar shpirtin dhe mendjen, e ngriti mbi të gjitha qeniet e gjalla.

All-llahu është mbrojtës i dinjitetit dhe i nderit njerëzor. Ai është mbrojtës i të drejtave themelore njerëzore. Muhammedi a.s. ka thënë:

“Njeriu është vepër madhështore e All-llahut dhe vaj halli për atë që e njollos nderin dhe dinjitetin e veprave të All-llahut. O njerëz, nderoni dhe çmoni vlerën e personalitetit dhe të dinjitetit njerëzor!”

(Nga fjalimi i Resulull-llahut a.s. në Arefat në vitin 10 sipas Hixhrit).

Islami i ofroi njeriut shkallën më të lartë të mundshme të dinjitetit dhe i tregoi rrugët, të cilat shpiejnë kah përsosmëria deri te vetë kënaqësia e All-llahut – dhurata më e bukur.

Muslimani ta nderojë njeriun dhe dinjitetin e tij. Ta nderojë si vepër të Zotit, si krijesë të Zotit, si vëlla të familjes nga babai i përbashkët Ademi a.s. dhe nëna e përbashkët Havva.

Zemrat tona duhet të dinë se pas All-llahut dhe të Dërguarit të Tij, duhet nderojnë shumë babën dhe nënën:

“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindër-

ve. Nëse njerin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as of oh, as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrihe pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: Zoti im! Mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël!”

(Kur’ani, 17:23-8)

“Ne e kemi obliguar njeriun me punë të mirë ndaj prindërve të vet...”

(Kur’ani, 29:8)

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Mos ikni nga prindërit, sepse ai që e bën këtë, bën kufur” (mëkat të madh).

“Mëkate të mëdha janë: mosbesimi në All-llahun xh.sh., sjellja e ashpër ndaj prindërve dhe padëgjueshmëria ndaj tyre, vrasja e njeriut dhe betimi i rrejshëm”.

“Ai që dëshiron të hyjë nëpërmjet dyerve më të mira në xhennet duhet të sigurojë patjetër kënaqësinë e prindërve”.

“Kënaqësia e Zotit qëndron në kënaqësinë e prindit, kurse zemërimi i Zotit në zemërimin e prindit”.

Ebu Hurejre r.a. sjell hadithin, të cilin e shënuan Buhariu dhe Muslimi:

“Erdhi një njeri te Pejgamberi a.s. i Zotit dhe pyeti:

-Cili prej njerëzve është më i merituar që t’i kushtoj kujdesin dhe miqësinë time? – Nëna – i tha Pejgamberi i All-llahut.

- E kush vjen pas saj? – pyeti ai njeri.

- Nëna, - u përgjigj Muhammedi a.s.

- Kush është atëherë pas saj? – përsëriti njeriu.

- Nëna, pastaj baba, - përfundoi Pejgamberi i All-llahut”.

Muhammedi Resulull-llah pastaj tha edhe këtë:

“Kush i nderon prindërit e vet do ta ketë vendin në xhennet, nën hijen e drurit Tuba, e përveç kësaj All-llahu do ta bëjë të lumtur edhe derisa të jetë në këtë botë”.

Buhariu ka shënuar nga as’habi Mugire ibni Sh’uabe se Muhammedi a.s. ka thënë:

“All-llahu rreptësisht e ndalon padëgjueshmërinë ndaj prindërve”.

Ebu Bekri r.a. e tregon hadithin:

“Për të gjitha mëkatet, me përjashtim të padëgjueshmërisë ndaj prindërve, All-llahu xh.sh. ia shtyn dënimin deri në Ditën e Gjykimit kujt të dojë, ndërsa për padëgjueshmëri ndaj prindërve, All-llahu xh.sh. u jep dënimin (fëmijëve të padëgjueshëm) edhe para vdekjes së tyre”.

Mumini nuk duhet të lejojë që shejtani t’ia marrë mendtë, e pastaj ruana Zot, të bëjë mëkate ndaj prindërve dhe t’i lëndojë ndjenjat e tyre. Nuk duhet të lejojë që djalli të sundojë zemrën dhe shpirtin e tij. Mumini patjetër duhet të shkelë çdo mendim të poshtër të djallit, që ky i mallkuar në shpirtligësinë e vet do t’ua imponojë të tjerëve.

Çdo gabim i bërë ndaj prindërve me siguri shpie drejt dyerve të hapura të xhehennemit. Prandaj ata që besojnë nuk do të bëjnë kurrë një mëkat të tillë.

Muhammedi a.s. u thoshte nënave dhe baballarëve të rinj:

“Silluni mirë me prindërit tuaj, e pastaj edhe fëmijët tuaj do të veprojnë kështu ndaj jush. Bëhuni të ndershëm dhe modestë, e mandej edhe bashkëshortët tuaj do të jenë të ndershëm dhe modestë”.

Në një rast tha:

“T’i kisha pasur prindërit ose njërin prej tyre (ka menduar për nënën) e në namazin e jacisë, duke lexuar Fatihen, ta dëgjoja se po thërret – Muhammed! – do t’i përgjigjesha – urdhëro!”

Dëgjo tregimin për Uveys Karanië, për njeriun e mirë dhe fisnik:

Ka jetuar në Jemen, në kohën e Muhammedit a.s. filloi ta shpallte Islamin. U bë i njohur për respektin, që i bënte nënës së vet. Ajo krenohej me Uveysin dhe me ahlakun e tij. Lajmet për Resulull-llahun gjithnjë e më shpesh arrinin në Jemen. Grahësit e deveve, tregtarët e udhëtarët tregonin për Ngjarjen e Madhe që po ndodhte në shkretëtirën e Arabisë. Flisnin për fenë e mrekullueshme, e që po i përtërinte njerëzit dhe po u sillte gëzim në shtëpi. Uveysi u interesua për Islamin, shprehu dëshirë që ta njihte Pejgamberin a.s. të All-llahut. Këtë dëshirë disa herë e shprehu para nënës, duke e bërë me dije se me gëzim do të udhëtonte me karvanët e parë në Medine. Nëna nuk e refuzoi në mënyrë të drejtpërdrejtë, mirëpo gjithnjë shprehte frikën se mos po e sulmonin cubat, të cilët vazhdimisht endeshin nëpër shkretëtirë. Dhe kështu Uveysi mbeti në shtëpinë e vet, duke mos dëshiruar t’i lëndonte ndjenjat e nënës dhe ta shtonte shqetësimin e saj.

Një ditë nëna e thirri Uveysin dhe i tha se edhe ajo do të gëzohej, nëse ai do të nisej për vizitë tek i Dërguari a.s. i All-llahut. Vetëm e luti që të kthehej menjëherë në shtëpi pa marrë parasysh se a do ta gjente apo nuk do ta gjente Pejgamberin. Nëse Pejgamberi

gjendet në shtëpi, biseda me të le të mos jetë e gjatë, tha ajo. Uvejsi premtoi se do jetë ashtu – nëse do Zoti.

Dhe deveja e karvanit të parë e mori Uvejsin në rrugën e qëllimit të tij aq të dëshiruar për takimin me Muhammedin a.s. Nuk kaluan shumë ditë, e Uvejsi trokiti në derë të shtëpisë së Resulull-llahut. Me të dëgjuar trokitjen, derën e çeli hazreti Fatimja dhe e pyeti se ç'dëshiron. Ai i tha se ka ardhur prej së largu që ta njohë Muhammedin a.s. dhe mësimin, që po e predikonte ai. Mirëpo, Muhammedi a.s. nuk kishte qenë në shtëpi. Pas një kohe të shkurtër duhej të vinte. Fatimja i tha këtë Uvejsit. Ai deshi të presë, mirëpo i kishte premtuar nënës se do të kthehej shpejt në shtëpi. Me plot hidhërim në zemër u kthye në Jemen. Megjithatë, hidhërimi i tij ishte i mpleksur me krenari, që e kishte mbajtur premtimin e vet, që ia kishte dhënë prindit të tij të mirë. Uvejsin e mirë, në rrugën e tij fisnike, e shoqëronin engjëjt. Muhammedi a.s., posa arriti në shtëpi, ndjeu, me vullnetin e All-llahut, se në shtëpinë e tij kishte ardhur njeriu me ahlak të mrekullueshëm. Hazreti Fatimja i tregoi për vizitorin e çuditshëm, i cili edhe pe kishte ardhur nga një vend i largët, nuk deshi ta shkilte për asnjë çast besën që ia kishte dhënë nënës së vet.

Sikur të kishte jehuar mësimi i gëzuar i tekbitit, të cilin nëpër shkretëtirë e përhapnin engjëjt. Sikur edhe ata gëzoheshin dhe festonin ndermin e të birit ndaj nënës së moshuar. E dinin se ky nderim i çel dyert e xhennetit dhe i hap rrugët drejt tij.

Pas prindërve, dashuria dhe respekti i muminit, është i orientuar ndaj vëllezërve dhe motrave të gjakut, të besimit e pastaj ndaj të gjithë njerëzve të mirë.

All-llahu xh.sh. ka thënë:

“Muminët janë vëllezër”.

(Kur’ani, 49:10)

Muhammedi a.s. thoshte:

“Asnjëri prej jush nuk do të jetë besimtar i vërtetë, derisa nuk ia do të mirën edhe vëllait ashtu si edhe vetes”.

“Kush beson në All-llahun dhe në Ditën e Gjykimit, le të sillet mirë dhe njerëzisht ndaj fqinjit të vet”.

Ushtarët muslimanë e zunë rob një beduin të varfër. Ata e njoftuan me Islamin dhe ai u bë musliman. Muhammedi a.s. e thirri beduinin pranë vetes, me dëshirë që ta mësonte për Islamin. Beduini, duke ardhur para Pejgamberit të All-llahut, filloi të dridhej.

“Përse dridhesh, o njeri?” – e pyeti Resulull-llahu a.s. “A thua nuk e di, se unë jam djali i Emines, grua e thjeshtë, e cila më ushqeu me atë ushqim me të cilin ushqehesh edhe ti. Jam i lindur në shtëpi të thjeshtë sikur edhe ti, unë jam i yti... Eja afër meje dhe rri sh lirë”.

Fjalë të rëndomta, por fjalë të mëdha, e zgjuan edhe më tepër zemrën e beduinit. Ai qau nga gëzimi dhe nga dashuria ndaj All-llahut xh.sh. dhe të Dërguarit të All-llahut. E prekën shumë thjeshtësia dhe kujdesi i Muhammedit a.s., i cili në mënyrë të thjeshtë, por fisnike i dha zemër dinjitetit të tij njerëzor.

Një as’hab rrëfente. “Njëherë e takova Pejgamberin e All-llahut. Ecte krejt ngadalë. Para tij ecnin edhe më ngadalë dy pleq jomuslimanë. E pyeta përse ecte aq ngadalë dhe përse nuk i kalon këta njerëz, kurse ai m’u përgjigj:

“A nuk po sheh se janë pleq?”

Muhammedi a.s. nuk ka dashur ta lëndojë pleqërinë e këtyre njerëzve, duke kaluar shpejt pranë tyre, që rastësisht të mos e ndjejnë veten më pak të vlefshëm dhe që të mos dëshpërohen për kalimin e shpejtë të rinisë së tyre.

Kur Ebu Bekri u bë halif në të gjitha anët filluan të shpërthejnë kryengritje dhe çrregullime. Ato ditë në Medine qëndronte ushtria së cilës Resulull-llahu a.s. për të gjallë të vet i kishte urdhëruar të nisej në ekspeditë luftarake nën komandën e Usame bin Zejdit.

Këtyre luftëtarëve islamë Ebu Bekri r.a. u mbajti fjalim:

“Trima! Kur të hyni në luftë, luftoni si trima dhe si luftëtarë të ndershëm! Mos lejoni kurrë që të njolloseni nga mosbesimi ose tradhtia. Në luftë askënd mos e shëmtoni, mos i mundoni të gjallët, e as të vdekurit mos i masakroni! Mos i mbytni pleqtë, gratë dhe fëmijët. Mos i shkatërroni të mbjellat e huaja, mos i theni degët e pemëve, ndërsa nga bagëtitë therni vetëm aq sa është më e domosdoshme për ushqimin tuaj. Nëse ndesheni me njerëz, të cilët janë strukur të vetmuar në qilarë manastiresh dhe i luten Zotit, respektoni dhe kurseni nga shqetësimi më i vogël. Ndoshta mund të takoni edhe të atillë, të cilët janë me koka të rruara e me perçe që nuk jetojnë në manastire. Të tillët vetëm prekni me këllëf të shpatës dhe ua kujtoni emrin e Allahut xh.sh. All-llahu le t’u ndihmojë.”

Mumini është shpirtgjerë, është njeri që e çmon personalitetin dhe dinjitetin njerëzor. Njeriu është vepër e All-llahut, ndaj mumini do të sillet ndaj kësaj vepre ashtu siç kërkon mësimi islam. Shpirti i besim-

tarit është si kandil, i cili ndriçon me shkëlqim të pakrahasueshëm, duke ftuar në dashuri, në paqe dhe në respekt. Drita që rrezaton nga shpirti që synon kah majat më të larta, është e parezisttueshme. All-llahu i ka caktuar njeriut vend të shquar dhe të denjë në Tokë dhe në Gjithësi! E ky respekt, që i është bërë njeriut, e ngarkon atë me përgjegjësi të jashtëzakonshme ndaj jetës dhe ndaj të gjithë njerëzve në përgjithësi. Është detyrë e njerëzve fisnikë që të sillen seriozisht ndaj kërkesave të All-llahut.

All-llahu xh.sh. të mëshirshëmve u dhuron mëshirën e vet

Mëshira është dhuratë e All-llahut, të cilën Ai, i Mëshirshëm pa fund, ua dhuron zemrave të njerëzve të mirë dhe fisnikë. Zemra besimtare, zemra që beson në të Vetmin Zot, është përplot dashuri të mëshirshme, dritë të mëshirshme.

All-llahu xh.sh. ka thënë:

“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”

(Kur’ani, 21:107)

“All-llahu është i butë dhe fal shumë.”

(Kur’ani, 2:225)

“All-llahu është mëshirues, ndaj Ai fal shumë.”

(Kur’ani, 25:70)

Dhe vërtet mëshira e All-llahut është e pakufishme. Ai ia dhuroi fisit njerëzor Udhëzimin e lajmëtarët e fesë Ademin, Ibrahimin, Musain, Isain a.s. dhe shumë të njohur e të panjohur që përfundimisht të vijë vula e peygamberëve të Zotit, i miri, fisniku, modesti dhe i mëshirshmi Muhammed, i biri i Abdulllahut, bekimi i All-llahut qoftë mbi të!

Duhet lutur All-llahun që t’i pasurojë zemrat njerëzore me mëshirë. Me këtë virtyt njerëzor hapekrah

çelen dyert e xhennetit. Kjo është Rruga e Drejtë, Rrugë e Madhe –drejt *përsosmërisë së shpirtit*.

Në betejën e Bedrit u zunë robër shumë mushrikë (jobesimtarë). Muhammedi a.s. urdhëroi që me ta të sillen në mënyrën më të mirë njerëzore. U shpërndanë në familjet muslimane të Medines, duke ngrënë të njëjtin ushqim me muslimanët, visheshin njësoj si muslimanët. Sjellja e këtillë ë atë kohë ishte një kthesë e shënuar në metodën e luftimit. Islami zbatoi mëshirën edhe në luftë. Sjellja e këtillë humane te shumë robër zgjoi simpati ndaj Islamit. Jeta e muslimanëve i bindi shumë të tjerë se Islami vërtet na qenka diç e re, e shquar, e mirë, diç që me siguri do t' u sjellë njerëzve lumturi. Kur i liruan robërit që të shkojnë në shtëpitë e tyre, ata e përhapën lajmin në tërë Arabinë për fisnikërinë dhe mëshirën e të Dërguarit të All-llahut dhe për muslimanët, për vëllazërimin, barazinë, dashurinë dhe harmoninë, që zotëronte ndër muslimanët. Së shpejti shumë prej tyre e pranuan Islamin, kur e kuptuan thelbin dhe madhështinë e tij.

Në luftën e Uhudit më 11 shevval të vitit 3 sipas Hixhrit, Muhamedit të plagosur, në momentin më të vështirë as'habët vrapuan t' i vinin ndihmë dhe e lutën që t' i mallkonte fodullët, mendjemëdhenjtë, mushrikët (jobesimtarët) arrogantë. Ndërsa ai, në vend të mallkimit, tha:

“Nuk jam dërguar të mallkoj, por të ftoj!”

Një vit pas Hixhrit në Mekke zotëronte uria. Kryetari i mushrikëve (jobesimtarëve), Ebu Sufjani, i drejtohet Muhamedit a.s në Medine me lutje që t' i ndihmojë të uriturit. Dhe i madhi Resulull-llah më-

shirshëm dërgoi ndihmë në Mekke që t'i shpëtonte të rrezikuarit nga uria. Në asnjë moment nuk i shkoi mendja për të keq, edhe pse mushrikët mekkas i sollën shumë dëme edhe vetë atij dhe muslimanëve në përgjithësi. Ai qe Pejgamber i mëshirshëm i Zotit.

Në vitin 8 sipas Hixhrit, kur Resulull-llahu me muslimanët hyri në Mekke, të gjithë mushrikët veç sa s'vdiqën nga frika. Ata prisnin hakmarrjen për krimet dhe dëmet, që u kishin bërë muslimanëve. Mirëpo, Islami është ide e mëshirës, e dashurisë dhe e shpëtimit në të dy botët, Rrugë e Drejtë, ndërsa Muhammedi a.s. lajmëtar i besimit të All-llahut. Kur u soll rreth Qabesë, u ndal në derë dhe turmës së njerëzve që ishin tubuar ta dëgjojnë ia tha porosinë kur'anore:

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër rështë ruajtur (nga të këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”

(Kur'ani, 49:13)

Të gjithë u habitën me mëshirën e Resulull-llahut. Njëri ndër njerëzit më të mrekullueshëm, para Qabesë, proklamoi mëshirën, dashurinë, barazinë, dhe të gjitha këto në emër të Zotit. Edhe atyre, të cilët u kishin shkaktuar idhërim të madh muslimanëve, u tha:

“Shkoni, të gjithë jeni të lirë. Do t'ju them ashtu siç ju tha Jusufi vëllezerve të vet: -As dobinë sot prej jush nuk e dua, Zoti le t'ju falë, e ai është më i mëshirshmi ndër të mëshirshmit”.

Një sjellje e këtillë i pushtoi shpirtat dhe zemrat e njerëzve. Edhe kundërshtarët më të përbetuar të Islamit filluan ta duan Islamin me gjithë zemër.

Njeriu mbeti njeri. Muhammedi a.s. tha:

- Mos harroni se mëshira është njëra ndër themelet e Islamit!

- Në kopshtet e xhennetit do të zënë vend vetëm ata, që kanë zemër të sinqertë, të pastër dhe të mëshirshëm.

- Do të shkatërrohet dhe do të vuajë ai njeri, të cilin nuk e ka mëshiruar Zoti.

- Nuk është me ne ai, i cili nuk është i mëshirshëm ndaj të rinjve tanë dhe ai që nuk i nderon të vjetrit.

- Zoti nuk do të jetë i mëshirshëm ndaj atyre, të cilët nuk janë të mëshirshëm ndaj njerëzve.

- Besimtarë më të mirë janë ata, që durojnë në fatkeqësi, ndërsa falin kur janë të fuqishëm.

Heroi Salahuddin Ejjubi, çlirimtar i Palestinës, zuri vend në histori jo vetëm si trim i madh, por edhe i njeri zemërgjerë. Kur u rrethua Jerusalemi, ndër kryqtarët mbretëronte uria. Shumë syresh fshehtas dilnin jashtë mureve të qytetit dhe vinin tek ushtarët muslimanë, duke u lutur për ushqim. Saladdin urdhëroi që të gjithë të uriturve t'u jepej ndihmë në ushqime, kurse të gjithë të sëmurëve ndihmë në barna.

Në kohën e luftë së tretë të kryqëzatave, mbreti anglez Riçard zemër Luani, u sëmur rëndë. Me lutjen e kalorësve të Riçardit, Salahuddini e dërgoi mjekun e vet personal, i cili e shëroi Riçardin.

Salahuddini i ka falur armiqtë, madje u ofroi edhe ndihmë kur e pa se kishin nevojë të madhe për të. Falte, sepse besonte në All-llahun xh.sh. dhe besonte në

mësimin Islam, sepse e ndiqte shembullin e Pejgamberit të Zotit, Muhammedit a.s.

Shpata e tij, por edhe sjellja e tij e mirë dhe mëshira, i pushtuan bedenet e Jerusalemit.

Hapësirat e zemrës njerëzore janë të vogla që bashkë me mëshirën të bartin edhe vërshimin e urrejtjes, e cila, si helm, e shkatërron qenien njerëzore. Duhet të përpiqemi, që te ne të ngadhënjejë mëshira, që ajo të jetë shoqëruesja jonë e vazhdueshme. Ky është bar, që shëron shpirtrat e njerëzve dhe i shpie në rrugë kah mëshira e All-llahut xh.sh. Jeta është shumë e shkurtër, e përse ta kalojmë me hidhërim e me urrejtje të helmuar?

Mumini duhet t'i kuptojë njerëzit, të përpiqet t'i marrë vesh, t'i falë kurdoherë që ka mundësi, aty ku lejon feja Islame. Në emër të mëshirës, për të arritur fitoren e saj, duhet evituar të keqen, që i sjell fatkeqësi njeriut. E ç'është e keqja? Do të të them: çdo vepër e djallit, çdo qëllim i tij. Mëshira dhe falja janë si vëlla e motër. Që të dyja bashkarisht e vrasin dhe e çrrënjisin të keqen dhe urrejtjen nga zemrat njerëzore.

Zemra që di të falë, me siguri i pushton zemrat e tjera, duke u hapur të gjithëve rrugë drejt shpirtit të ndritur.

Viktor Hygo në romanin "TË MJERËT", e përshkruan efektin e çuditshëm të mëshirës së falur. I ikuri nga burgu, Zhan Valzhani, kthehet të bujë te një njeri zemërmirë. Ky tregoi mikpritje të madhe, duke mos e pyetur fare e kush ishte ai dhe nga vinte. Në mëngjes, Zhan Valzhani kryeneç vjedh gjëra të çmuara në shtëpinë e këtij njeriu bujar, mikpritësit të vet, i mbledh shandanët e argjendit dhe ik. Mirëpo, ai nuk

shkoi shumë larg dhe e zuri patrulla e xhandarmërisë e sollën te pronari dhe ia treguan shandanët e vjedhur. Ky për një çast u ndal, pastaj tha që ta lironin Zhanin, sepse ata shandanë ai vetë ia kishte falur atij. Zhani mbeti pa gojë dhe nuk foli. Veprimi i pakuptueshëm mëshirues e tronditi nga themelet. Ai e kuptoi se përveç të keqes, ekziston edhe e mira, që, m sipas fuqisë së vet, është e pakufishme. Që prej atëherë, Zhani u bë njeri i mirë dhe gjatë tërë jetës së vet përhap vetëm mëshirën dhe dashurinë.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Pasha All-llahun, në xhennet do të shkojë vetëm ai që ka qenë i mëshirshëm”.

- As-habët e pyetën: - A tha nuk jemi të gjithë të mëshirshëm, o Pejgamber i All-llahut? Në këtë pyetje ai u përgjigj:

- Nuk është mëshirë, kur dikush është i mëshirshëm vetëm ndaj fëmijës ose të afërmit të vet, por ndaj të gjithëve, që kanë shpirt – (Këtu Muhammedi a.s. e ngriti zërin).

“Ithtarët e mi do të shkojnë në xhennet me Mëshirën e All-llahut, me pastërtinë e zemrës, me fisnikërinë e shpirtit dhe për mëshirën që kanë pasur ndaj të gjithë muslimanëve, e nuk shkohen në xhennet vetëm për shumë namaze dhe agjërime”.

- Kështu fliste Resulull-llahu a.s. Ndrsa ne ndeshemi nganjëherë me njerëz, të cilët nuk kanë në qenien e tyre asnjë fije mëshire. Është jetë e vështirë për njeriun, i cili zemrën e vet e ka të mbushur me urrejtje

* Fjalët e Pejgamberit – “Për shumë namaze dhe agjërime” – kanë për qëllim të aludojnë për namazet dhe agjërimet nafile e jo për ato që janë të obligueshme (farze). (sh.p.)

helmuese, të cilën ia ka mbjellë djalli. Është fatkeqe dhe e mjerë një jetë e këtillë. Besimtarët duhet ta dinë se nuk ka iman të vërtetë në zemrën e njeriut, e cila nuk është e pasur me mëshirë. Prandaj, nëse muminët dëshirojnë të kenë besim të vërtetë në vete, domosdo duhet të jenë të mëshirshëm. All-llahu xh.sh. e kërkon këtë nga besimtari. Këtë e kërkoi Pejgamberi i Zotit:

“Të mëshirshëmve, Zoti i Mëshirshëm u ofron mëshirë”
(Hadith)

Për këtë arsye çdo nënë – besimtare ua mëson fëmijëve të vet mëshirën, që shtrihet në kufijtë më të largët që lejon All-llahu xh.sh. I mëson të kenë mëshirë ndaj thërmive të bukës që bien në tokë, të kenë mëshirë ndaj thneglës, ndaj shpendit, ndaj bimës. I mëson që të kenë mëshirë ndaj njeriut, ndaj çdo gjëje të gjallë dhe jo të gjallë. Kjo është ajo mëshirë dhe përdëllesë, që i trondit edhe zemrat më të forta njerëzore. Prej tyre i heqin prangat e së keqes së djallit. Fjala dhe vepra e mëshirshme i hapin hapekrah dyert e xhennetit.

Shpirtrave të ndjeshëm u zbulohen shumë sekrete të fshehura. Njohuritë e papritura, deri atëherë të panjohura, dalin nga errësira dhe sqarohen në dritën më të dukshme e më të qartë.

Lumturia e pakufishme e pasuron zemrën e mëshirshme me plotësinë dhe bukurinë e vet, të cilën njeriu a nuk mund ta paramendojë. Këto vlera i afrojnë njerëzit, u sjellin paqe dhe gazmend, u paralajmërojnë ardhmëri të qartë për dijitet dhe respekt, ashtu siç kërkon All-llahu xh.sh.

Fjalëkeqi – fatkeqi

All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shkumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin.”

(Kur'ani, 49:12)

Muhammedi a.s. nuk e lejonte askënd që të fliste çkado qoftë keq për as'habët e tij. Ai ka thënë:

“Kurrësi nuk lejoj që askush, për asgjë dhe për askënd nga as'habët e mi të më tregojë diç të keqe, sepse unë dëshiroj që para tyre të dal me zemër të pastër dhe me qëllime të pastra”.

E pastaj e tha edhe këtë:

“Njerëzit më të mirë janë ata, të cilët, kur i shohin të tjerët, e kujtojnë All-llahun xh.sh., kurse keqbërës dhe ndër njerëz më të këqij janë ata, që përhapin fjalë e i ngatërrojnë miqtë, kurse të mirëve u gjejnë të meta”.

Përgojimi dhe përhapja e fjalëve e zhduk imanin ashtu siç i shkund bariu gjethet me shkop”.

Xhabir ibni Abdull-llah rrëfen: “Njëherë ishim me Pejgamberin e All-llahut kur befas prej dikah kundërmoi një erë e keqe. Muhammedi a.s. i pyeti të pranish-

mit se a e dinin se nga vinte kjo erë e keqe. Kur u përgjigjën ata se nuk e dinin, ai u tha:

“Kjo erë e keqe vjen nga ata, që i përgojnë besimtarët”.

Fjalëkeqi është fatkeqi, kurse përgojimi është fjalë e keqe e mallkuar. Ajo bart me vete urrejtje dhe intriga (fitne), nga të cilat sigurisht lindin fatkeqësi. Kur i dëgjon fjalët e Kur'anit dhe mësimet e Resulull-llahut a.s. frika e kaplon njeriun edhe vetëm kur i shkon mendja te përgojimi. Është e qartë se kjo e keqe e hap rrugën për në grykë të xhehennemit, në humnerën e tij, prej nga nuk ka kthim. Shpesh pyes veten, si mund të përgojnë dhe të përhapin fjalët e huaja me qëllim të keq, nganjëherë edhe ata që e falin namazin, që agjërojnë, që me siguri e dinë fare mirë se ç'kanë thënë për këtë All-llahu xh.sh. dhe Muhammedi a.s. Si nuk i kaplon tmerri kur ecin buzë greminës së xhehennemit? Të ngritesh kundër fjalëve të All-llahut, ta falësh namazin dhe të shkosh në xhami... e ç'punë është kjo?

Njerëzit me mendime të mira dhe me ëllime të mira do të qëndrojnë larg nga të gjitha ato rrugë të dyshimta, në të cilat i thërret djalli në smirën e vet. Ai do të lejojë që ky smirëzi ta hedhë kryengulthi në greminë.

Njeriu i mirë do të dalë ballëhapur para të afërmeve të vet, para miqve të vet, sepse ai qëndron larg nga fjalët e këqija. Ai nuk do të lejojë ë dritën e shpirtit të tij ta mbulojë terri i së keqes dhe i përgojimit. Ai me siguri nuk do të jetë ai, i cili e ha mishin e vëllait të vdekur. Ai me siguri nuk do të bjerë në këtë ndyrësi të tmerrshme. Ai e ruan dinjitetin e njeriut, kurse All-llahu e ruan dinjitetin e tij. Sikur njerëzit të donin ta pranonin të Vërtetën se fjala e keqe është një e keqe e

kulluar, sa shumë lumturi do të kishte në këtë botë! E përse nuk dëgjojnë?

Tani do t'ju tregoj një ngjarje të vërtetë nga periudha e muslimanëve të parë:

Pejgamberi i All-llahut në një rast e dërgoi te fisi Benu Mustalik mbledhësin e zekatit, Velid ibni Ukbe ibni Ebi Muajtini. Ndërmjet këtij njeriu dhe këtij fisi ekzistonte urrejtja dhe mosdurimi qysh nga periudha paraislame. Kur dëgjuan beduinët se po vinte emisari i Resulull-llahut a.s. shpejtuan me gëzim në grupe të mëdha që ta pritnin me nderimet dhe me respektimin më të mirë. Mirëpo, Velidi, duke parë një grumbull aq të madh njerëzish që po i dilnin përpara, u frikësua, duke menduar se ishin nisur për ta vrrarë për shkak të grindjeve të vjetra. Ai ende kishte në vete ndjenjat e përparshme ndaj beduinëve të këtij fisi. Dhe mosmarrëveshja ishte e qartë dhe e mundshme. Velidi i frikësuar iku dhe e lajmëroi Muhammedin a.s. se fisi Benu Mustalik ishte çuar në kryengritje dhe nuk donte të jepte zekat. Ndërsa, Muhammedi, si gjithmonë i matur, i qetë, e mori me rezervë këtë lajm dhe të njëjtit fisi ia dërgoi përsëri emisarin e dytë, Halib ibni Velidin, që ta verifikonte pohimin e parashtruar. Halidi, si luftëtar me përvojë, iu qas me kujdes vendbanimit beduin. Dhe ja, ai e dëgjoji zërin e muezinit se si po thërriste besimtarët në namaz. U gëzua, sepse kjo ishte shenjë e qartë se fisi nuk kishte hequr dorë nga Islami, e pra as nga dhënia e zekatit.

Erdhi lirisht në mesin e beduinëve, u prezentua, kurse ata e pritën përzemërsisht. Mosmarrëveshja e mëparshme u sqarua shpejt dhe u kuptua drejt. Falë

urtisë së Muhammedit a.s. dhe kujdesit të tij në pranimin e lajmit, iu shmangën fatkeqësisë së madhe, e cila do të mund të kishte pasoja të papërshkruara. Si shkas i kësaj ngjarjeje zbriti porosia Kur'anore:

“O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtoni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që kei bërë.”

(Kur'ani, 49:6)

Ngjarja me fisin Benu Mustalik është një vërejtje e jashtëzakonshme se si duhet të jemi të urtë në të gjitha situatat dhe të mos mbështetemi në lajme të paverifikuara. Megjithatë, për fat të keq, ndeshim njerëz, të cilët i pranojnë shumë lehtë lajmet për të cilat nuk janë të sigurt. E pikërisht lajmet e këtilla mund t'u sjellin njerëzve lëndime të mëdha shpirtërore. Nganjëherë njerëzit shpirtligj dhe me karakter të dobët qëllimisht i përhapin fjalët që t'u sjellin të këqija të afërmve dhe njerëzve të mirë. Meqë përgojimi është sikur “ngrënia e mishit të vëllait të vdekur”, atëherë kuptohet se në çfarë shkalle të tmerrshme arrin sjellja e së keqes në këtë mënyrë. Për shpirtligj të këtillë është përgatitur fundi i xhehennemit nga i cili nuk ka kurrfarë shtegdalje. E këtë All-llahu e di më së miri!

Resulull-llahu ka thënë:

“Ruajeni dhe respektoni të drejtën e huaj. Mos spiunoni askënd dhe mos hulumtoni të fshehtat e tjetrit që, duke i ritreguar, t'i përhapni. Përpiquni të tregoheni të sinqertë ndaj gjithkujt dhe pa qëllime të fshehura, ndërsa ruhuni

nga bisedat dhe përdorimi i fjalëve dykuptimore, me anë të të cilave do të mund t'i fyeni të tjerët".

Njerëzit nuk janë as të vetëdijsëm se sa goditje e rëndë dhe sa dhembje mund të shkaktojë gjuha e mbrapshtë, fjala e kobshme. Shpifjet, intrigat, grindja e njerëzve, janë vese që thithin lëngjet nga shpirtligësia e djallit. Këto janë shigjeta të helmueshme të drejtuar kundër shpirttrave të njerëzve. Bartësit e këtyre të këqijave janë pjellë e zjarrit të amshueshëm. Prandaj Islami u ngrit kundër kësaj së keqeje në të gjitha aspektit dhe trajtat e saj.

Në haxhin e Lamtumurës Resulull-llahu ka thënë:

"Ata, që bëjnë shpifje për gratë e ndershme, qofshin të mallkuar në të dy botët. Ata, që i akuzojnë gratë e ndershme për tradhti bashkëshortore ose për amoralitet, e nuk mund të sjellin për këtë katër dëshmitarë të besueshëm, dënoni me 80 të rëna dhe në të ardhmen kurrë mos u besoni më, sepse ata janë njerëz të këqij".

Hasan Basri rrëfente:

"Nuk je me iman të vërtetë derisa të tjerëve u gjen të meta, sepse as vetë nuk je pa të meta. Prandaj evitohet më parë të metat e tua, e lëri të tjerët e të metat e tyre. Mirëpo, ta kesh të qartë mirë, se kurrë nuk do të mund t'i evitosh të gjitha të metat e tua, prandaj më mirë është që t'u kushtohesh atyre dhe të merresh me to.

Te njeriu i mençur gjuha është pas zemrës: kur ai do të thotë diçka, më parë mendon, e nëse kjo mund të jetë e dobishme, atëherë e thotë. Në të kundërtën, njeriu i mençur hesht. Ndërsa tek injoranti zemra është pas gjuhës. Ai flet kur t'i teket, duke mos menduar aspak për këtë.

Më parë duhet të jesh zotërues i vetvetes, gjuhën tënde ta mbash lidhur dhe të mos u nënshtrohesh lakmive të trupit”.

Xhafer el-Mensur e këshillonte djalin e vet:

“Prej meje i ke dy këshilla:

Mos fol pa menduar.,

E mos puno derisa mos t’i vërejsh pasojat!”

Muxhahidinët jovetjakë

Hudhejfe el-A'devi tregon për ngjarjen, që ka ndodhur pas luftës në Jermuk, në rrjedhën lindore të lumit Jordan. Në atë luftë, që u zhvillua më 20 gusht të vitit 636 sipas Isait a.s., ushtria islamike, që kishte rreth 25.000 njerëz, korri fitore të madhe kundër bizantinëve, të cilët kishin mbi 100.000 ushtarë. Si mundi, Halid ibn Velidi, që komandonte ushtrinë islamike, të korrite një fitore aq të madhe? Luftëtarët e tij në zemrat e veta e dinin se e mbronin atdheun e vet, idealet e veta, kurse shpirtrat e tyre shkonin shtigjeve, që shprienin kah përsosmëria. Bartnin në vete të gjitha vlerat njerëzore. Hudhejfe el-A'devi dëshmon për një cilësi të jashtëzakonshme të këtyre luftëtarëve, për jovetjakësinë e tyre:

“U nisa vetëm ta kërkoj axhën e plagosur në fushën e betejës dhe mora me vete pak ujë që, nëse e gjej të gjallë, t’i japë të pijë. Duke i rrotulluar të vdekurit, më në fund, e gjeta. Ishte plagosur rëndë. Kur më pa, më dha shenjë se është i etshëm dhe sikur të kishte ujë, do të pinte. Porsa ia afrova shtambën me ujë te goja, rënkoi një luftëtar tjetër i plagosur dhe m’u lut që t’i jap ujë. Axha nuk e piu ujin, por më dha shenjë me dorë, t’ia çoja ë plagosurit, i cili thirri. Kur iu afrova atij të plagosurit, e njoha se ishte vëllai nga feja, Hisham ibn el-AS. Pikërisht kur iu afrova me ujë në dorë, gjëmoi i plagosuri i tretë. Mirëpo, derisa arrita

te ky, ai tanimë veç dha shpirt. U ktheva te Hishami. Edhe ai kishte vdekur. U ktheva te axha mirëpo edhe ai kishte vdekur”.

Dhe vërtet, nuk është çudi se me kësi njerëz e kësi ushtarë, Halid ibn Velidi ka mundur të korrë fitore pas fitoreje.

Islami na mëson se bota është krijuar për të gjithë njerëzit. Mëshira e bollëkshme e All-llahut i ka ofruar të gjitha të mirat e kësaj bote, tërë fisit njerëzor. Mumini e di se jeta islame është dhënie jovetjake dhe marrje jovetjake. Mumini e di se për njeriun e mirë pa dashuri nuk ka lumturi të vërtetë dhe jetë të vërtetë. Mumini nuk është egoist, nuk është vetjak. Zemra e tij është e madhe dhe në mirësinë e vet përfshin gjithçka që është emirë dhe fisnike.

Prandaj, sa të mjerë e të gjorë janë ata njerëz, të cilët mendojnë se e gjithë kjo që është krijuar rreth tyre, është krijuar vetëm për ta. Të mjerët, sa janë të mbushur me vetvete, me kryelartësi, me mendjemadhësi, me arrogancë. Ata kërkojnë që të dëgohen vetëm fjalët e tyre, që të plotësohen vetëm dëshirat e tyre. Ata dëshirojnë që ata, dhe gjithmonë vetëm ata, me çdo kusht, në çdo rast të jenë të parët. Shtyhen, qortojnë, madje edhe shajnë gjithnjë derisa të kënaqet egoizmi i tyre. Të tillët janë arrogantë, të mbrapshtë, i torturojnë prindërit e vet, e fyejnë vëllain ose motrën, i nënçmojnë të afërmit e vet. E nëse këto dëshira nuk u plotësohen, qofshin kërkesat e tyre edhe të pamundshme, ata, në tërbimin e tyre djallëzor, në shenjë proteste, do të pushojnë të flasin dhe të komunikojnë me rrethin e vet, sepse nuk është kënaqur “uni” i tyre. Në jetë janë

si gur i hedhur. Vaj halli për atë që takohet e ta. Marshojnë në dynjallëk pa zemër e pa shpirt. Ndërsa, harrojnë se një ditë patjetër do të shtrihen në tabutin e ftohtë – të zbehtë, të heshtur.

O Zot, egoizmi e degjeneron njeriun, aq shumë e deformon sa që nëpërmjet tij sheh fytyrën e djallit në triumfin e vet, që shkel njeriun dhe dinjitetin e tij. Njeriu vetjak, në të vërtetë, është vetë djalli, është vepër e tij.

Si nuk sheh njeriu e e prek vdekja, vdekja e sigurt dhe se një ditë do të gjendet në tabut i verdhë si dylli? Si nuk mendon se çdo gjë në këtë botë është kalimtare, pra edhe ai? Si nuk mendon se në këtë botë është për një kohë shumë të shkurtër?!

Mumini nuk guxon të jetë vetjak. Nuk guxon të jetojë vetëm për vete. Kjo nuk është fisnike. Gjithmonë duet të jeshë vëlla dhe shok – vëlla dhe shok i njeriut të mirë. Dora e tij gjithmonë i është shtrirë njeriut të mirë dhe me qëllime të sinqerta. Kur gëzohet vëllai, gëzohet edhe ai. Kur hidhërohet, merr pjesë në hidhërimin e tij, e ndihmon dhe e ngushëllon! Ky është obligim i vërtetë.

I ofron ndihmë kur ka nevojë ai. Nganjëherë edhe vetëm fjala e mirë dhe e ngrohtë ia kthen fuqinë dhe vetëbesimin.

Kur e kalon rrugën i verbëti, ai e ndihmon. Nëse sheh qoftë edhe një krande në rrugë, ai e largon. Nëse ka rënë buka në tokë, e merr nga respekti ndaj të Dashurit All-llah xh.sh. Ai ia ka dhuruar atë bukë, për ne e ka krijuar. Nëse pëllumbi gugat ose trumcaku cicëron dimrit për rreth dritares, ai i jep troha buke. Nëse e ndihmon atë, që e ka krijuar All-

llahu, ai e ndihmon All-llahun. Të gjithë këto janë vepra fisnike.

Islami na mëson të mos bëhemi vetjakë.

Kur muslimanët-muhaxhirë filluan të vinin nga Mekka në Medine, Ensaritë përzemërsisht i pritën, duke u ofruar pjesë të shtëpive të veta, rroba të veta, ushqimin e vet, i përqaftuan vëllazërisht, sinqerisht. Në mënyrë jovetjake dhanë, dhe nga jovetjakët morën. E All-llahu së shpejti i dhuroi me gjithçka që dëshiruan.

Në betejën e Uhudit njëri nga mushrikët më luftarakë Ibni Kami, depërtoi nëpër radhët e muslimanëve dhe e plagosi Muhammedin a.s. Muxhahidinët krijuan një mur të gjallë dhe një rrethim të padepërtueshëm. I vunë trupat e vet nën shpatat e mushrikëve dhe me gjoks i kthenin heshtat dhe shigjetat. Ebu Talha, që ta pengonte shpatën e mushrikut që të mos e qëllonte Pejgamberin e Zotit a.s., shtriu duart kah tehu i shpatës. Mushrikët ia prenë dorën. Gjaku rridhte nga plaga e hapur, po ai vazhdoi ta mbronte me trupin e tij jetën e Resulull-llahut. Thërriste: "O Profet i Zotit, mos e ngrit kokën, se mos po të qëllojnë shigjetat. Gjoksi im është mburoja jote".

Kjo është ndjenjë fisnike jovetjake, e frymëzuar me besim në Zotin. Dhe shembujt e sakrificave jovetjake të njeriut – mumin radhiteshin pa fund. Ata i kishte frymëzuar besimi në Një Zot dhe dashuria ndaj Tij, vlerat që dhanë fryte të altruizmit. Ata ishin njerëz të mrekullueshëm. Ata i qëndisën me shkronja të arta vlerat e virtyteve të veta në historinë njerëzore. Përkundër tyre, bijtë e egoizmit përhapnin lakminë, pangopshmërinë dhe grykësinë.

Është një legjendë që tregon se në kohët e lashta jetonte një mbret, i cili plaçkiste nga shtetasit e vet arin që ta grumbullonte në thesarin e vet. I vriste njerzit dhe për sasinë më të vogël të arit. Një ditë prej ditësh ushtarët e huaj e sulmuan shtetin e tij, thyen çdo rezistencë dhe e zunë rob mbretin grabitës e lakmitar. Edhe ata kishin dëgjuar për krimet e tij. Ushtarët e shkrinë arin në kupe dhe ashtu të shkrirë e të zjarrtë ia derdhën me forcë në gojë të hapur. I bërtisnin: "kapërdije, kapërdije, kuçedër e pangopur, i biri i djallit shpirtlig!"

All-llahu xh.sh. ka thënë:

"Është e vërtetë se njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm. Pse kur e godet ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi. Ndërkaq, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprrac. Përveç atyre që falen, të cilët janë të rregullt në faljen e namazit të tyre."

(Kur'ani, 70:19-23)

Muhammedi a.s. ka thënë:

"Sikur njeriu të kishte psur një luginë me ar, pak do t'i dukej e do të dëshironte edhe tjetrën, e nuk do të ngopet me asgjë, pos me dhe. Megjithatë Zoti e fal atë, i cili pendohet".

"Ruhuni nga lakmia, sepse ajo, në të vërtetë, është varfëri e përhershme. Ruhuni, madje edhe nga ajo me të cilën arsyetohet lakmia dhe të gjitha rrethanat, që ju nxisin në lakmi!"

Filozofia Islame thotë:

- Kush e dëbon spirtligësinë, atij i zbulohet dashuria dhe atëherë jeton në dashuri, duke përjetuar lumturinë e amshueshme.

Natyra e njeriut është e pangopshme dhe njeriu do të dëshironte që të gjitha pasuritë materiale të botës t'i fuste në grushtat e tij.

Njeriu është vetjak dhe lakmitar.

Xhelaluddin Rumi ka shënuar:

“Ajo thirrje që të thërret në lakmi,

Është zëri i ujkut, që dëshiron të të përbijë!”

All-llahu xh.sh. nuk i do mendjemëdhenjtë

Muslimani është modest dhe kurrë nuk është mendjemadh. Mendjemadhësia edhe mburrja janë të papëlqyeshme dhe ata që janë të tillë vetveten e degradojnë. Greminat e mendjemëdhenjve janë tepër të thella, ato janë të pafund.

“E kur u thamë engjëjve: përuluni (bini në sexhde) Ademit, ata menjëherë u përulën, me përjashtim të Iblisit (djallit). Ai refuzoi dhe u mbajt në të madh dhe u bë pabesimtar.”

(Kur’ani, 2:34)

Armiku më i madh i njeriut është djalli i mallkuar, ai është shpikësi dhe iniciatori i mendjemadhësisë dhe mbrojtësi i mendjemëdhenjve. Ai është vetë e keqja. Mendjemadhësia e tij nuk e lejoi që t’i përulet Ademit dhe t’i nënshtrohet urdhërit të All-llahut. Mendjemadhësia e nxiti të bëhet mëkatari më i madh dhe dhunuesi më i madh, babai i gënjeshtërs. Të metat dhe veset e tij e detyruan që të ngritet kundër çdo të mire njerëzore, kundër ngritjes së shpirtit në shkallë më të larta, kundër rrugës së përsosmërisë së shpirtit. Rruga e djallit shpie kah thellësitë më të ulëta të xhehennemit të tmerrshëm. Mumini në rrugën e vet të përsosmërisë së shpirtit duhet të qëndrojë me guxim dhe vendosmëri që të mos bjerë në kurthin e djallit.

“All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet.”

(Kur’ani, 4:36)

“Ata (të drguarit) e kërkuan ndihmën, ndërsa çdo kryelartë idhnak pësoi dështim. E pas tij (kryelartit) është xhehennemi, në të cilin i jepet ujë të ndyrë (që rrjedh prej lëkurave të djegura). Përpiqet ta përbijë, por nuk mund ta gëlltisë atë, atij i vjen vdekja nga të gjitha anët (sipas shenjave shkatërruese), po ai nuk vdes (e të shpëtojë prej vuajtjeve, atë e pret dënim shumë i rëndë”.

(Kur’ani, 14:15-17)

“Dhe mos ec nëpër tokë me mburrje, pse ti as nuk mund ta çosh tokën as nuk mund ta arrish lartësinë e maleve. E keqja e të gjitha këtyre është e urrejtur te Zoti yt”.

(Kur’ani, 17:37-38)

O njeri i ri, dëgjo tash se ç’thotë Kur’ani, se si Llukmani i mirë dhe fisnik e këshillonte të birin:

“Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve, mos ec nëpër tokë kryelartë, se All-llahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet. Të jesh i matur në ecjen tënde, ule zërin tënd, se zëri më i egër është pallja e gomarit”.

(Kur’ani, 31:18-19)

Ja se si All-llahu e kritikon mendjemadhësinë, këtë cilësi të shejtanit të mallkuar. Fatkeqësisht, disa njerëz nuk e dëgjojnë Fjalën e All-llahut, e bien në kurthin e djallit. Nga mendjemadhësia e tyre e harrojnë të vërtetën e shenjtë, e cila iu shpallet botërisht dhe

tregohet me tërë ndritshmërinë e vet. Kanë shpëtim vetëm ata, që e çrrënjosin mburrjen nga zemra e vet. Musai a.s. e ftoi faraonin që të hiqte dore nga e keqja, ta ndalonte shtypjen dhe poshtërimin e të varfërve, mirëpo ai, nga mendjemadhësia, e refuzoi këtë. Mendjemadhësia e faraonit përfundoi në valët e detit të shqetësuar. Ai u përpoq që, në momentin e fundit, të pendohej, mirëpo tanimë ishte vonë.

Nuhu a.s. e ftoi popullin e vet që të largohej nga e keqja dhe prapësia, e ftoi që të bëhej populli i mirë dhe fisnik, shumë pjesëtarë të popullit të tij ishin mendjemëdhenj dhe i refuzuan me arrogancë këshillat e vëllait të vet, Nuhut a.s. All-llahu i dënoi me përmbytje.

Buzë Detit të Vdekur të sotëm jetonte populli i zhytur në shpirtligësi të tmerrshme. Mbi të zotëronte ndytësia amorale. Çdo njeri i mirë tmerrohej nga të metat e tyre. All-llahu xh.sh. ua dërgoi vëllain e tyre, Lutin a.s., që t'i ftonte të ktheheshin në njerëzishmëri, në dashuri të sinqertë, në ndershmëri dhe fisnikëri. Ky popull ishte shpirtkeq dhe mburravec i mallkaur. Mund ta shihte tërë atë të keqe, që barte në vete.

Marrëdhëniet e panatyrshme midis meshkujve ishin evidente. Shumë prej tyre i refuzuan këshillat, mësimet dhe lutjet e Lutit a.s. Ai donte t'u ndihmonte, donte t'i shpëtonte. Mendjemadhësia nuk i lejonte ta dëgjonin Fjalën e Mirë, që i udhëzonte kah lumturia. Një ditë herët në agim u dënuan tmerrësisht.

Njeriu mendjemadh gjithmonë është i urrejtur dhe i pranuar me keqardhje. Kjo cilësi e neveritshme i largon njerëzit. Për këtë arsye duhet larguar nga ata

njerëz, që nuk duan ta largojnë këtë shpirtligësi djallëzore nga zemra e tyre. Shfrenimi, mendjemadhësia dhe kryelartësia janë cilësi që nuk duhet të kenë vend në shpirtin e muminit. Mumini është i thjeshtë dhe i pendueshëm. Kurrë nuk mburret dhe kurrë nuk lavdërohet. Ai kurrë nuk lejon që mendjemadhësia të gjejë vend pjellor në zemrën e tij. Dëshira e djallit nuk mund të ndikojë në të.

Muhammedi a.s. shpesh lutej All-llahu xh.sh.:

“O Zot, më bën të vogël në sytë e mi, kurse në sy të botës të madh!”

Frymën e modestisë e barti në tërë jetën e vet. Muret e shtëpisë së tij ishin të ndërtuara me qerpiçë të rëndomtë, kure kulmi i mbuluar me gjethe të palmës. Flente në dyshek në dyshek lëkure të mbushur me gjethe, vishej thjesht dhe ushqehej thjesht. Me ditë të tëra nuk ndizej zjarri në vatrën e shtëpisë së tij. Ai dhe anëtarët e familjes së tij shpesh nuk kishin se ç'të hanin, ndaj çdo njeriu ishte jashtëzakonisht i kujdeshëm dhe i këndshëm. Fliste qetë, kurse sytë e tij me shikim të ëmbël, të mirë dhe fisnik, pushtonin zemrat e njerëzve. Me sjelljen e vet armiqtë i kthente në miq. I mrekullueshëm dhe pa asnjë fije mendjemadhësie që i dashuri ynë Resulull-llahu (Mëshira e All-llahut qoftë mbi të!). Ai thoshte: “Modestia është kurora e njerëzores”. “As’habët e tij me përpikëri ndiqnin shembullin e tij. Kur erdhi ushtria islame para dyerve të Jerusalemit, paria e qytetit vendosi t’i dorëzojë çelësat e dyerve të qytetit, por vetëm me kusht që halifi h. Umer r.a. t’i merrte në dorë. Ai u nis për rrugë me përcjellësin e tij beduin. Kishin vetëm një deve dhe udhëtonin me

të, duke i hipur me radhë kur erdhën afër Jerusalemit, radhën e kishte h.Umeri r.a. të ecë në këmbë dhe të tërhiqte devenë, e t'i hipte beduini. Përkundër këmbënguljes së beduinit që h.Umeri r.a. të hyjë në qytet hipur në deve, h.Umeri r.a. nuk pranoi. Kur erdhën kështu para parisë së Jerusalemit, ata u çuditën, por edhe u mahnitën. Para tyre qëndronte sundimtari i shtetit të atëhershëm të fuqishëm, i veshur me rroba më të thjeshta, këmbësori që mbane devenë të cilës i kishte hipur përcjellësi i tij. Kjo ishte një periudhë e re që po vinte. Njëri nga as'habët tregonte se, duke u falur në xhami pas h.Umerit r.a., në xhyben e tij kishte numëruar dymbëdhjetë arna. Në atë kohë ai ishte halif i Perandorisë së madhe Islame.

Edhe shumë shembuj të tjerë do të mund të sillnim nga historia e njerëzve të mëdhenj e të shquar, të cilët i kanë çmuar vlerat e modestisë. Nuk duhet të harrojmë edhe të panjohurit e panumër, të cilët, me modestinë e tyre të qetë, endën pëlhurën më të bukur të qëndisur me vlera njerëzore – në historinë e fisit njerëzor. Ne nuk i njohim, por All-llahu xh.sh. i njeh dhe i di.

Ushqimi i mendjemëdhenjve është e keqe e njeriut vetjak, që e vret modestinë e njeriut. Njerëzit e rinj, që synojnë përsosmërinë e shpirtit të vet, duhet të asgjësojnë çdo egoizëm në zemrën e vet. Modestia dhe përvuajtënitë, fryte të parimeve fisnike, duhet të shfrytëzohen nga fuqia e besimit të fortë. Ajo është forcë, që ndihmon të mbytet kuçedra njëqindkrerëshe e egoizmit në çdo zemër. Ndërkaq, edhe për këtë sukses, krahas besimit, kërkohen vullnet dhe përpjekje që i do All-llahu xh.sh. E gjithë kjo zgjon fuqitë e fshehta

në zemrën dhe në shpirtin e njeriut, burime këto të pashtershme të vlerave më të larta shpirtërore.

Ngadhënjyes mbi kryelartësinë djallëzore është njeriu i drejtë, i cili ec rrugës së njohurive dhe aftësive më të larta.

Harith ibni Vehhab r.a., thotë: “Kam dëgjuar Pejgamberin e All-llahut a.s. që thotë:

“A doni t’ju them se kush është xhehennemli? Çdo mendjemadh i vrazhdë, çdo mburravec dhe ai që shet mend”.

Xhabir r.a. pohon se Pejgamberi i All-llahut ka thënë:

“Unë më tepër i urrej dhe prej meje do të qëndrojnë më së largu Ditën e Gjykimit, ata që imponohen në bisedat veta dhe të cilët me vetëkënaqësi pispilloren në të folurit e vet”.

Gazaliu ka thënë se mburrja dhe madhërimi i vetvetes është rruga drejt adhurimit të idhujtarisë.

Në Mesnevi Xhelaluddin Rumi thotë: “Sa të jesh kryelartë, i fryer dhe krenar e mendon se je njeri i madh, mbaje mend, o njeri, se je i papjekur!”

Prandaj njeriu besimtar, në zemrën e vet duhet të bartë dëshirën dhe vullnetin këmbëngulës: mendjemadhësia duhet shtypur patjetër. Këtë e kërkon All-llahu. Është obligim të veprohet kështu.

Mos përqesh, mos fyej!

Marrëdhëniet ndërmjet muslimanëve duhet të jenë vëllazërore, sepse muslimanët janë vëllezër. Muslimani-muslimanit, njeriu-njeriut, duhet t'i drejtohet në mënyrën më të mirë. All-llahu xh.sh., e ndalon përdorimin e emrave fyes dhe përbuzës. Ai ndalon të tallurit dhe të përqeshurit, ndalon turpërimin dhe poshtërimin. Këtë gjë muminët dueht ta dinë. Nëse dëshirojmë mëshirën e All-llahut xh.sh. – patjetër duhet t'i zbatojmë urdhërat e All-llahut në jetë.

All-llahu thotë:

“O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas abesimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë.”

(Kur'ani, 49:11)

“Mjerë për secilin që ofendon e përqesh (njerëzit).”

(Kur'ani, 104:1)

Muhammedi a.s. ka thënë:

Muslimanë, kini kujdes, duani dhe ndihmoni njëri-tjetrin. Nuk guxoni ta fjeni njëri-tjetrin, nuk guxoni njëri-

tjetrit çkado qoftë t'i plaçkitni ose t'i rrëmbeni". "Kush nuk është i përzemërt ndaj krijesave të Zotit dhe ndaj të varfërve, as Zoti xh.sh. nuk do të jetë i përzemërt me të".

"Muslimani nuk është ngatërrestar e as dhunues, që fjen dhe që sulmon, as sharës e as njeri që mallkon, e as lypës dhe horr, i cili flet fjalë të pahijshme, nuk është harbut".

"Kurrë mos e shkelni të drejtën dhe nderin e dikujt. Mos i shkaktoni vetvetes dhunë. Mos harroni se mëshira është njëra ndër themelet e Islamit".

"Ai që do ta poshtërojë vëllain e vet, nuk do të vdesë derisa nuk përjeton diç të ngjashme".

Muhammedi a.s. u nis për Taif që ta predikonte Islamin. Së pari iu drejtua tre kryeparëve të vendit me të cilët ishte farefis. Që të tre e sulmuan ashpër dhe iu turrën si rrugaçit në rrugë. Muhammedi a.s., plot plagë dhe i larë në gjak, u skajua në një kopsht, pronari i të cilit ishte i krishterë. Ky e pranoi miqësisht Resullull-llahun dhe i ofroi ndihmë të nevojshme.

Kur shpëtoi nga persekutuesit e luti All-llahun e Dashur xh.sh.:

"O Zot, më mbroj për shkak të fuqive të mia të dobëta, për shkak të varfërisë sime dhe mshnjohjes së personalitetit tim në sytë e njerëzve, Më i Mëshirshmi i të gjithë të mëshirshëmve. Ti je Zot i dobtëve dhe Ti je Zoti im. Ku më le? Ndonjë të huaji të largët, që më pret mizorisht ose ndonjë armiku, të cilit Ti ia mundëson të sundojë mbi mua? Nëse Ti nuk pezmatohesh në mua, unë nuk frikohen prej tyre. Mbrojtja jote gjithmonë është më e mira.

Kërkoj mbrojtje te Drita Jote, me të cilën ndriçohet errësira dhe udhëzohen njerëzit, të lutem për mbrojtje

nga zemërimi Yt dhe hidhërimi Yt, që do të mund të më godisnin. Unë të pendohem gjithnjë deri sa Ti të jesh i kënaqur. Nuk ka forcë as fuqi tjetër, pos Tëndës!”.

Me besim, me besim të fortë i Ndershmi Resulull-llah a.s. i përballoi të gjitha sulmet dhe fyerjet e mushrikëve.

Një ditë Ebu Xhehli ia ndaloi namazin publik. Resulull-llahu a.s. nuk e dëgjoji dhe me zemërim e refuzoi ndalesën. Ebu Xhehli i poshtër iu afrua Muhammedit a.s., kur ai ishte në sexhde, dhe i hodhi në krye një enë plot me zorrë dhe rropulli të devesë. E bija e Resulull-llahut vrapo t’i ndihmonte babait të vet dhe ta pastronte nga ndytësitat e hedhura nga Ebu Xhehli i poshtër.

Në zemërimin dhe urrejtjen e tyre të poshtër, mushrikët nuk zgjidhnin mjete. Njëherë, kur i Dërguari i All-llahut ishte në namaz, fshehtas pas shpine iu afrua Ukba ibni Ebu Muejt dhe u mundua ta ngulfafe me një copë petku.

Në të gjitha të keqijat e mushrikëve ai përgjigjej me dinjitet dhe fisnikëri. Ai nuk kishte ardhur që të ushtronte dhunë ose që të hakmerrej, ai kishte ardhur që t’i udhëzojë njerëzit në rrugën e drejtë. Ai i urrent fyerjet dhe përqeshjet. Bënte thirrje që të çmohet njeriu, dinjiteti i tij, liria dhe nderi i tij, kundër shtypjes dhe dhunës ngritej me tërë qenien dhe veprën e vet.

Ibni Abasi tregon se Resulull-llahu kishte thënë:

“Kur isha në Miraxh, kam ndjerë një erë shumë të këndshme.

- Çfarë ishte kjo erë? – pyeta. Më thanë se ishte era e floktares, e cila punonte te bija e faraonit.

Asaj i ra krehëri nga dora, e tha: -Në emër të All-llahut xh.sh. Ebija e faraonit atëherë tha: "Në emër të babait tim. Floktarja tha: - Zoti im është edhe Zoti i babait tënd!

- Vallë, ti paske tjetër Zot përpos babait tim? – e pyeti e bija e faraonit. – Po! – u përgjigj ajo!

Faraoni e thirri dhe e pyeti: - Vallë, ti na paske tjetër Zot, përveç meje? Floktarja u përgjigj vendosmërisht: -Po, Zoti im dhe yti është All-llahu! Faraoni atëherë urdhëroi shërbëtorët dhe ata sollën një kazan të madh bakri të skuqur në zjarr. Për shkak të qëndresës së floktares ndaj besimit, me urdhërin e faraonit, shërbëtorët më parë filluan t'i hidhnin fëmijët e saj në kazanin e vluar. Kur i erdhi radha foshnjes së posalindur, foshnja tha:

- Nënë, mbahu dhe mos u hamend. Ti je në rrugë të drejtë!

- Më në fund e hodhën edhe floktaren".

Shih tiraninë e faraonit! Shih sjelljen e tij shtazarake, sjelljen e bishës! Nga mendjemadhësia e vet edhe fëmijët e pafajshëm i hodhi në zjarr, pa e brejtur ndërgjegjia asnjë fije. Kryelartësia e tij nuk e lejonte që të pranonte askënd mbi vete. Arrogant, ai zhdukte jetë të pafajshme, sepse zotëria i tij ishte Iblisi (djalli) i mallkuar. E, sa neveritshëm u mashtrua faraoni! Ai mendonte se do të jetonte gjithmonë, por nga ai s'mbeti asgjë, pos pluhurit. Të gjithë tiranët do të duhej të dinin se në fund të çdo gjëje do të mbetet vetëm pluhuri.

Perandori romak, Neroni, në tiraninë e vet, shkelte nderin dhe dinjitetin e njerëzve. Me kënaqësi asgjësonte jetën e njerëzve të pafajshëm. Bishat i cipëtonin ithtarët e Isait a.s. Përrenj gjaku rrodhën nëpër barin e arenës së Romës. Mirëpo, për të, edhe kjo nuk ishte

mjaft. Ai e dogj Romën, me qëllim që këta njerëz të pafajshëm t'i akuzonte për djegien e saj, kështu që të mund t'i vriste më lehtë. Përse? Sepse ishte tiran, ndaj asgjë të mirë dhe fisnike që ekzistonte në zemrat e njerëzve nuk mund ta duronte. E gjithë "kundërvajtja" e tyre ishte se i ftonin njerëzit në dashuri, paqe, virtyte dhe për të vërtetën.

Mirëpo, All-llahu xh.sh. nuk le pa dënuar të keqen e bërë ndaj njeriut dhe dinjitetit të tij, sepse njeriu është vepra më e bukur e All-llahut xh.sh. Dhe All-llahu xh.sh. e dërrmoi dhe e bëri hi e pluhur tiraninë e Neronit, sepse All-llahu xh.sh. nuk i do tiranët. Ja një citat nga "Mesnevia" e Xhelaluddin Rumi: "Cilësia e njerëzve të mëdhenj është se flasin ngadalë dhe se kanë një të folur të ëmbël. E meta më e madhe është nënçmimi i tjetrit, e ngritja e personalitetit të vet. Ky e pengoi shejtanin që t'i nënshtrohej Ademit a.s. Këto dy vese mund të shërohen vetëm me dashuri".

Për tiraninë All-llahu xh.sh. ka thënë:

"A në çdo bregore ngritni ndonjë shtëpi (ndërtesë) sa për lojë? Dhe a i ndërtoni pallatet e fortifikuara që të jeni përgjithmonë? E kur rrëmbeni, rrëmbeni mizorisht."

(Kur'ani, 26:128-130)

A e di ti se ç'thotë Zoti për ta?

A di ti se ç'bën Ai me ata?

"Dhe ashtu ata e trajtuan atë (Hudin) gënjeshtar, e Ne atëherë i shkatërruam. Edhe ky është një fakt, po shumica e tyre nuk besuan".

(Kur'ani, 26:139)

“E sa vendbanime që përbuzën jetën e vet Ne i kemi shkatërruar, e ja, ato janë shtëpitë e tyre, që pas tyre ato pak kohë janë banuar prej ndokujt dhe Ne ishim trashëgues të tyre.”

(Kur’ani, 28:58)

Zilia dhe shpirtligësia hapin dyert e xhehennemit

Shpirti i pastër si uji i kthjellët i përroit malor, i ndritshëm si rrezja e diellit, nuk ka në vete asnjë fije zilie. Ky është shpirti islam, i cili është i domosdoshëm për të gjithë ata që synojnë kah përsosmëria.

Në luftën e madhe për qëllim të lartë duhet shtypur kryet gjarpërit ziliqar, që e shkatërron imanin, e asgjëson personalitetin e mirëfilltë të njeriut dhe nga njeriu krijon shërbëtor, rob të djallit.

Për hir të dashurisë ndaj All-llahut duhet shkatërruar edhe çdo mendim shpirtkeq. All-llahu kërkon këtë nga besimtari, ndaj është obligim që të veprohet kështu.

I pari ziliqar ka qenë Iblisi (i mallkuar qoftë ai!). Ia kishte zili Ademit a.s., ia kishte zili njeriut, nga shpirtligësia e tij e çmendur filloi t'i ngatërrojë njerëzit dhe vazhdimisht t'u sjellë të keqija.

Ndërkaq, emri i All-llahut në gojë dhe në zemër, i ruan shpirtrat e muminëve nga komplotet e ferrit të Iblisit.

“Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit. Prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi. Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht. Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja. Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron.”

(Kur’ani, 113)

Muhammedi Resulull-llahu a.s. ka thënë:

- Zilia i zhduk veprat e mira si zjarri drutë.

- *Asnjëri prej jush nuk do të jetë besimtar i vërtetë, nëse nuk ia dëshiron vëllait atë të mirë, të cilën ia dëshiron vetes.*

- *Te besimtari nuk mund të gjenden bashkë imani dhe zilia.*

- *Zilia dhe dyshimi e shkatërrojnë shoqërinë njerëzore.*

- *Vetëm dy vetave mund t'u lakmohet: njeriut, të cilit All-llahu i ka dhuruar pasuri, e ai e shpenzon për vepra të mira; njeriut të cilit All-llahu i ka dhuruar mençuri, dhe ai vepron me këtë, por i mëson edhe të tjerët.*

Sikur të gjithë besimtarët në tërësi t'i dëgjonin fjalët e All-llahut, sikur t'i dëgjonin dhe t'i zbatonin të gjitha ato që ka thënë dhe ka vepruar Pejgamberi i All-llahut, sa lumturi do të kishte në këtë botë, sa lehtë e sa më mirë do të jetohej! Mirëpo, për fat të keq, njeriu shpesh bie nën ndikimin e djallit të mallkuar. Për besimtarin dhe besimtarene çdo zili e lakmi është e pakuptimtë. Përse të lakmojmë? Çdo gjë në këtë botë kalon, vetëm All-llahu i Madhërishëm është i përjetshëm. Çdo gjë ë kemi është për një kohë të shkurtër në duart tona. Përfundimisht pason vetëm vdekja e njëmendtë. Atë e ndeshim çdo ditë.

All-llahu kërkon që të respektohet Fjala e Tij, e ajo këshillon se mumini nuk guxon të lakmojë. Besimi, besimi i fortë në Një All-llah, e fisnikëron zemrën e njeriut, e çrrënjës vesin, sado të thella qofshin rrënjët e tij, qoftë ajo madje edhe rrënja e të keqes, e zilisë.

Drita e All-llahut xh.sh. ndriçon rrugët e errëta të së keqes, mendimet e fshehura, qëllimet e këqija, që lindin në shpirtrat dhe në zemrat e njerëzve. Këto njohuri duhet përçafuar fuqishëm dhe duhet zbatuar në jetë si gëzim, që njerëzit të gëzohen, që ta takojnë mendimin e drejtë e të vërtetë, që ta takojnë njeriun e vërtetë.

Hasan Basri i mirë e fisnik, shkruan: "Zilia shkatërron besimin më shpejt se përhapja e zgjebes në trup". Për shkak të dëmit që sjell zilia, besimtarin duhet këshilluar që shpirtligësinë dhe zilinë t'i çrrënjosë nga qenia e vet.

Zilia dhe shpirtligësia janë si mortaja, që i mbytë njerëzit. Kjo sëmundje është e keqe dhe e rrezikshme. Fatkeqësisht, atë e ndeshim gjithkund. Shpeshherë e ndeshim edhe tetë rinjtë. Nxënësi e ka zili nxënësin në shkollë. Ai nuk mendon, por vetëm xhelozon. Përse të ketë zili, kur edhe ai që xhelozon mund ta arrijë të njëjtin sukses, nëse jo edhe më të madh, vetëm nëse përpiqet e mundohet mjaft? Dhe ja, lind zilia, si pjellë e përtacisë dhe mungesës së vullnetit dhe përpjekjeve për punë. E përse t'ia shesim shpirtin tonë djallit për shkak të neglizhencës vetjake?

Zilia lind kur njerëzit i shohin të tjerët se si arrijnë suksese në jetë, lind ndaj pasurisë së të tjerëve, ajo lind në çdo hap. Shfaqet në forma të shumënduarta. Mirëpo, një gjë është e sigurt, se pas saj qëndron vetë djalli, i cili i fton njerëzit me thirrje joshëse në kurthet e shpirtligësisë së vet. Kurrë nuk duhet harruar se kjo e keqe është cilësi e Iblisit, e kjo është mburrje dhe krenari e tij. Besimtari i vërtetë nuk lejon që kjo e keqe të mbretërojë në shpirtin e tij.

Nëse shfaqet ky gjarpër helmues, këtij duhet dërrmuar kokën menjëherë. Duke e mbytur këtë të keqe, njeriu e mbyt djallin në qenien e vet. Prandaj muminët më me ëndje do të pranojnë t'i djegin duart në zjarrin e skuqur sesa të lejojnë që kjo e keqe të mbretërojë në shpirtin e tyre.

Zemra e mirëfilltë besimtare

Të mirëve dhe të ndershëmve u çelen dyert e besimit. Me të dëshmohet rruga e gjerë, që shpie kah përsosmëria e shpirtit.

Resulull-llahu a.s. ka thënë:

“Ihsani (zbukurimi i gjithçkafit) është t’i shërbesh Zotit tënd, ashtu sikur Ta shohësh, sepse edhe pse nuk e sheh, në të vërtetë, Ai të sheh ty”.

Besimi është dhuratë e All-llahut, me të cilën ai na ka nderuar, që nëpërmjet tij të mund të shkojmë rrugës së drejtë, ka arritjet më të larta të shpirtit njerëzor dhe të njohurive njerëzore. Musliman do të thotë të jesh besnik ndaj All-llahut të Dashur xh.sh., besnik me tërë qenien tënde, me mendime, me dëshira dhe me të gjitha ato cilësi që e bëjnë njeriun njeri. Këtë besnikëri e kërkon All-llahu xh.sh. Nëpërmjet kësaj besnikërie i afrohem Krijuesit tonë gjithnjë e më tepër, ashtu siç rritet besimi në ne, siç rritet mirësia në veprat tona, ashtu rritet bukuria e shpirtit tonë. Dhe ky afrim zhvillohet gjithnjë më fuqishëm ashtu siç forcohet dashuria jonë ndaj Zotit të Dashur xh.sh. Mëshira e tij e madhe na jep impuls dhe forcë në këtë marshim të madh. Dhe një ditë, Ditën e Madhe të Gjykimit, do ta shohim Zotin tonë, All-llahun xh.sh. Ai do të jetë shpërblimi ynë më i madh. Të mirëve do t’u çelen dyert e lumturisë së amshueshme, të shpëtimit dhe të paqes!

Muhammedi a.s. në gjendjen e vetëdijes së plotë e përjetoj Miraxhin. Ishte i dërguar në lartësitë më të mëdha shpirtërore dhe që i shpërblyer me afërsinë e All-llahut xh.sh. kjo është shkalla më e lartë, që njeriu mund ta arrijë në këtë botë, e kjo dhunti i është dhënë vetëm një numri të të dërguarve më të zgjedhur të All-llahut. Edhe për ne, për njerëzit e rëndomtë, janë të hapur dyert e mundësitë e njohurive më të larta, të diturisë dhe të arritjeve të shkallëve më të larta shpirtërore. Ne kemi miraxhin tonë në namaz, kur me tërë qenien tonë i dorëzohemi shkëlqimit të sexhdes, kur përulësia jonë, dashuria jonë dhe besimi ynë ndaj të Dashurit All-llahut xh.sh. arrin bukuritë mahnitëse të shpirtit njerëzor.

Ebu Hurejre r.a. rrëfen: “Në një rast Resulull-llahu na ka thënë se All-llahu xh.sh. thotë

- Ai që i bëhet armik një robi Tim, të cilin Unë e kam zgjedhur dhe i cili për Mua është më i afërt, Unë atij njeriu i shpall luftë. Me kurrnjë send robi im Mua nuk mund të më afrohet më tepër se me atë me çka Unë e kam obliguar. Robi Im gradualisht më afrohet Mua edhe me kryerjen e ibadeteve vullnetare (nafile), dhe unë filloj ta dua. E kur Unë e dua atë, dashuria e tij ndaj Meje mbizotëron, e të dëgjuarit e tij me të cilin dëgjon, do të jetë vetëm për Mua, të parit e tij me të cilin sheh, do të jetë vetëm për Mua, dora me të cilën punon, punon vetëm për Mua, këmbët me të cilat ec, ecin vetëm për Mua. Një njeri i këtillë, nëse kërkon diç prej Meje, Unë do t’ia plotësoj, e nëse Mua më drejtohet për mbrojtje Unë do ta mbroj”.

Është shënuar se Resulull-llahu shpeshherë ka bërë namaz aq gjatë natën, saqë, nga qëndrimi i gjatë,

i janë ënjtur këmbët. Ai i është përgjigjur thirrjes së All-llahut xh.sh.

“Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

O ti i mbështjellë! Ngrihu për falje natën, përveç një pjese të vogël të saj. Gjysmën e saj ose diç më pak se gjysmën. Ose shto diç prej saj dhe Kur’anin lexoje me vërmendje. Ne do të shpallim ty fjalë të rëndë (të madhe). E s’ka dyshim e aktiviteti i natës është fuqizues dhe fjalë më e qartë. Vërtet, ti gjatë ditës ke angazhim të gjatë (të madh). Po ti përmende Zotin tënd dhe plotësisht përkushtojë Atij! Zot i lindjes dhe i perëndimit, nuk ka zot tjetër vetëm Ai, pra Atë merre për mbështetje”.

(Kur’ani, 73:1-9)

“Lutnie Zotin tuaj të përulur e në heshtje, se Aio nuk i do ata që teprojnë”.

(Kur’ani, 7:55)

E pyetën Pejgamberin e Zotit:

“Për çka njerëzit e meritojnë më tepër xhennetin?” Ai u përgjigj:

“Për besim të sinqertë dhe për veti të mira”.

Mistikët, kryesisht rekomandojnë katër kushte, që i afrohen devotshmërisë: ngrënia me masë, që do të thotë sa ta lësh ngrënien sa ta hetosh ngopjen; të flesh aq sa kërkon më së paku organizimi; të flasësh me maturi dhe atë që është e dobishme, dhe të rrish me njerëz të mirë, duke iu larguar çdo ndeje, ku nuk ke kurrfarë dobie.

Akt i rëndësishëm i besimit është të kujtuarit e All-llahut xh.sh. në çdo moment. Ky kujtim duhet të depërtojë nga thellësia e zemrës dhe ta ndërlihdë tërë

qenien njerëzore. Zjarri i dashurisë ndaj All-llahut xh.sh. duhet ta ndezë qenien tonë.

Për këtë vepër madhështore nevojitet besim i fortë, që ka themele të thella në ekzistencën tonë. Me anë të besimit ndërtohet ndërtesa e njohurive të sigurta. Nëse besimi është i fortë, i paluhatshëm, i pashkatërrueshëm, rritja e besimit tonë, e më të edhe e qenies sonë njerëzore, do të jetë në frymën islame. Ky është besim i sigurt. Shi për këtë duhet ditur në mënyrë të sigurt se besimit i nevojiten themele të parrënueshme. Nëse nuk ka këso themele, tërë ndërtimit tonë shpirtëror, gjatë sprovave të para, i kërcënohet rreziku. Për këtë arsye duhet lutur All-llahun, duhet falënderuar, duhet madhëruar Atë:

“O ju që besuat, përkujtoni All-llahun sa më shpesh. Dhe madhëroni Atë mëngjes e mbrëmje. Ai ju mëshiron juve e edhe engjëjt e Tij, e për t’ju nxjerrë juve prej errësirave në dritë dhe Ai ndaj besimtarëve është shumë mëshirues. Ditën që e takojnë Atë (Zotin), përshëndetja ndaj tyre është Selam! (paqe) dhe për ta ka përgatitur shpërblim të mirë.”

(Kur’ani, 33:41-44)

Muhammedi Resulull-llah a.s. ka thënë:

“Çdo gjë ka spastrimin e vet, kurse zemra pastrohet duke e përmendur All-llahun xh.sh. Askush nuk do të jetë besimtar i përsosur derisa All-llahu të mos i bëhet më i dashur se pasuria, se familja, se vetvetja dhe më i dashur se e tërë bota. Vërtet All-llahu besimtarin e ri e trajton si melek”.

Nga komenti i Xhelaluddin Rumi për “Mesnevinë”:

“Kur te robi shfaqen lotët nga respekti i madh ose nga dashuria ndaj All-llahut xh.sh. këta lotë përfaqësojnë gurë të çmueshëm tek All-llahu dhe te melekët”.

Shejh Attari nga Xhunejd Bagdadia na sjell këtë mendim imagjinar: “Duke ecur një ngushtice (gryke) pashë shumë engjëj. Me plot kujdes rreshtoheshin njëri pranë tjetrit. I habitur, e pyeta njërin prej tyre: - Ç'bëni kështu?

Ai m'u përgjigj: -Këtu para teje ishte një njeri besimtar, i cili e donte pa kufi All-llahun xh.sh. Nga respekti i madh dhe dashuria ndaj ZOTIT, lëshoi një psherëtimë të gjatë, kurse nga sytë i rrodhën disa pika lot. Lotët që rrjedhin në emër të All-llahut, kanë vlerën më të madhe tek All-llahu dhe tek engjëjt, ndaj ne engjëjt kemi zbritur në tokë dhe po i mbledhim këta lot margaritarë, po ia japim njëri-tjetrit dhe po i baritim në lartësitë më të mëdha”.

- Në zemrat e njerëzve zë ndryshku ashtu siç zë në hekur. Zemra pastrohet duke kujtuar dhe due e përmendur All-llahun xh.sh. të Madhërishëm.

- Lutja nuk është e plotë nëse nuk është e përmbytur dhe e pendueshme.

- Shpirti pa vlera është si shpata e drunjtë në këllëf.

Hasan Basri ka shkruar:

- Dituria është më e mirë se trashëgimi i pasurisë, edukimi është nderi më i pastër, besimi është pajisja më e sigurt, ibadeti është fitimi më i mirë, arsyeja është udhëheqësja më mirë, mirësjellja është shoku më i mirë, mirësia është ndihmësja më e mirë, kënaqësia është pasuria më e madhe, ndihma e All-llahut

është ndihma më e mirë, kurse kujtimi i vdekjes është predikuesi më i mirë.

- Mos qesh shumë, sepse qeshja e vë në gjumë zemrën.

- Kush i frikësohet All-llahut xh.sh. All-llahu do të bëjë çdo gjë në këtë botë që t'i frikësohet atij, e kush i frikësohet botës, All-llahu xh.sh. do ta bëjë që ai të frikësohet prej çdokuj dhe çdo gjëje.

Umer ibnu-l-Hattab ka thënë:

“Kujtonie shpesh xhehennemin, zjarrin e tij të furishëm, thellësitë e mëdha dhe shtyllat e hekurta”.

Maliku besimtar tërë natën rrinte zgjuar duke bërë ibadet. Njëherë vajza e tij i tha: “Babë, flej pak”. Ai iu përgjigj: -“Shpirti im, po frikësohem se do të vijë mëshira e All-llahut dhe do të më gjejë në gjumë”.

Veprimi i drejtë

“All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërme, e ndalon nga amoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim”.

(Kur’ani, 16:90)

Një grua nga fisi Beni Mehzum, kushërirë e Hashimitëve, mashtrohet dhe vjedh. As’habi i ndershëm Ussame, angazohet për të te Pejgamberi i All-llahut me lutje që t’ia falë fajin.

Ja se ç’tha Resulull-llahu:

“Besoni, sikur edhe Fatimja ime, vajza ime e dashur, të kishte vjedhur, unë për këtë do t’ia preja dorën”.

“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kinie dro All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që vepron”.

(Kur’ani, 5:8)

“Fjalët e Zotit tënd janë plot të vërteta (çka lajmërojnë) dhe plot të drejta (çka gjykojnë). S’ka kush që t’i ndryshojë Fjalët (vendimet) e Tij. Ai është që dëgjon e di”.

(Kur’ani, 6:115)

“Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët”.

(Kur’ani, 42:40)

Thuhet se një njeri, një çifut deshi ta sprovonte Resulull-llahun a.s. Bleu nga Pejgamberi i Zotit hurme, duke ia paguar përpara shumën e kontraktuar dhe caktuar kohën e dorëzimit të mallit. Dy ditë para afatit të caktuar, ai kërkoi realizimin e porosisë dhe filloi ta fyejë Muhammedin a.s. – “A nuk do të ma paguajsh borxhi, Muhammed? Ju itharët e Abdul-Mutalibit, vërtet nuk po i nderuakeni afetet”. Aty ishte i pranishëm Umeri r.a. Ai u fye nga sjellja e padrejtë e çifutit, ndaj deshi ta sulmojë. Muhammedi a.s. iu drejtua Umerit r.a.:

“Ne të dy do ta zgjidhim këtë çështje në një mënyrë tjetër. Umer, përse nuk po ma tërheq vërejtjen që ta kryej me ndërgjegje obligimin tim, dhe përse nuk po kërkon kujtesë të sinqertë dhe të ndershme nga unë. Nisu me të dhe plotësoja këtë në mënyrë që në sasinë e kontraktuar t’i japësh 20 saa* për frikën, që e ka pësuar.

Çifuti mbeti i mahnitur nga sjellja e Pejgamberit të Zotit dhe, i entuziazmuar nga ky, vendosi ta pranojë Islamin.

I Dërguari i Zotit e dinte se në themelet e drejtësië fillon stabilitetin e bashkësisë njerëzore. Pa drejtësi nuk ka as lumturi, as mirëqenie. Prandaj në urdhërin vijues të All-llahut në Bashkësinë Islame të Medines, zotëronte një drejtësi e pashoqe.

Personaliteti i individit, dinjiteti i tij njerëzor, pasuria e çdo individi, liria e tij në ato ditë të Islamit të vërtetë, kanë qenë plotësisht të mbrojtura dhe të paprekshme.

* Saa – lloj monedhe. (sh.p.).

Muhammedi a.s. para vdekjes tha:

“Nëse ndonjëherë dikujt i kam rënë në shpinë, ju shpina ime për ndëshkim, nëse e kam fyer ndonjëherë, ja nderi im për hakmarrje, nëse e kam marrë ndonjëherë të mirën e dikujt, ja ku është e mira ime”.

Në kohën e h.Umerit r.a., halifit të dytë, disa muslimanë e kishin zaptuar tokën e një çifuti dhe aty e kishin ndërtuar xhaminë. Kur mori vesh Umeri r.a. për këtë veprim, urdhëroi që të rrënohej xhamia, dhe toka t’i kthehej pronarit – çifutit.

Është interesant shkrimi i Umerit, djalit të Abdul-Azizit (717-720), gjatë periudhës së hilafetit të tij, për sjelljen ndaj jomuslimanëve, e që e sjell Ibni Sadi-u:

“Në emër të All-llahut të Gjithëmëshirshëm dhe të Plotëmëshirshëm! Nga shërbëtori i Zotit urdhëruesit të besimarit, Umerit, të birit të Abdul-Azizit, guvernatorit Adijj ibn Artat dhe besimtarëve rreth tij. Paqja qoftë me ju! Ju përcjell bekimet e All-llahut, përveç të cilit zot tjetër nuk ka. Keni kujdes për pozitën e të mbrojturit (jomuslimanë) dhe silluni me dashuri ndaj tyre. Nëse ndonjëri prej tyre e pret pleqërinë, nuk ka mjete për jetesë, ju do të jeni ata që duhet të kujdeseni për të. Nëse ai ka vëllezër të gjakut, kërkoni prej tyre që të kujdesen për të. Zbatoni dënimin ndaj atij, që i bën ndonjë të keqe. Po ashtu, nëse keni rob, që është plakur, ju duhet të kujdeseni për të deri sa të vdesë ose lëshoni të lirë.

Paqja me ju!”

Do t’ju rrëfej një ngjarje mjaft interesante:

Në vitet e para të kespeditave islamike, ushtria muslimane e kishte pushtuar qytetin Emes të Sirisë.

Bizantinët u tërhoqën. Qytetarët e kishin paguar xhizjen (sigurimin). Mirëpo, për shkak të pozitës në luftë, ushtria islamike u detyrua të tërhiqej nga qyteti. Udhëheqësi i ushtrisë islamike e ktheu xhizjen e marrë duke thënë se muslimanët nuk ishin në gjendje ta mbronin qytetin, prandaj do të ishte e padrejtë t'i ndalnin të hollat ë kishin marrë. Banorët e qytetit me lot në sy e morën këtë lajm. Ankonin që po shkonte ushtria islamike, e po vinte ushtria e tyre, bizantine. Ky ishte një shembull i mrekullueshëm i drejtësisë islamike.

Një ditë h.Umeri r.a., në kohën e hutbes, priti një të krishterë. I krishteri kishte ardhur t'i akuzonte disa doganierë në kufi, të cilët kinse e kishin dëmtuar. Umeri r.a. veproi sipas drejtësisë.

Muhammedi a.s. urdhëroi gjykatësin Nexhran Ebu Ubeidau:

“Gjyko gjithmonë drejt!”

I Dërguari i Zotit urdhëroi që gjykatësi të mos gjykojë, nëse është nervoz.

Ebu Bekri, bekimi i Zotit qoftë mbi të, duke marrë hilafetin, iu drejtua popullit me këto fjalë: “Më keni zgjedhur për udhëheqës tuajin, mirëpo kjo nuk do të thotë se unë jam më i miri ndër ju. Nëse do të punoj drejt, më ndihmoni. Nëse do të gaboj, më korrigjoni. Më nënshtrohuni derisa unë i nënshtrohem Zotit dhe Pejgamberit të Tij. Nëse unë pushoj t'i nënshtrohem Zotit dhe Pejgamberit, obligimi juaj është që ju të mos më nënshtroheni më”.

Esh-Shebi raporton për deklarimin e Shurejhut, i cili ka thënë: “kur më emëroi gjykatës, halifi Umer r.a. më tha: - Gjyko sipas asaj që gjen në Librin e Zotit, nëse asgjë nuk gjen në Librin e Zotit, gjyko sipas asaj

që gjen në vendimet e Resulull-llahut a.s. e nëse nuk gjen as në vendimet e imamëve të parë, përpiqu të gjykosh sipas arsyes së shëndoshë dhe këshillohu me njerëz, të cilët dinë dhe të cilët janë besimtarë”.

Mësimi islam gjithkund solli një rilindje. E drejta islame u manifestua në të gjitha poret e jetës. Për këtë flasin qartë të dhënat historike. Në gjyq për lëndë të ndryshme si qytetarë të rëndomtë dilnin edhe halifët. Është shënuar se kanë dalë para gjyqit dhe Ebu Bekri r.a., Umeri r.a., Aliu r.a., pastaj halifët e mëvonshëm, si Abdul-l-Melik, El-Mensur, disa qeveritarë të Spanjës e shumë t tjerë. Të gjithë këta kadiu i ka marrë në përgjegjësi në gjyq për shkak të akuzave të ndryshme të qytetarëve të rëndomtë, shpesh edhe të qytetarëve jomuslimanë. Në fenë islame, drejtësia është e njëjtë për të gjithë njerëzit.

Shi për këtë arsye, drejtësia duhet mësuar nga Mësimi i All-llahut. Drejtësia duhet të pëfshijë tërë qenien tonë. Duhet të jemi të drejtë ndaj babës tonë, ndaj nënës, vëllait, motrës. Ndaj çdo njeriu. Imami është i dobët atje, ku nuk ka drejtësi! Është shumë me rëndësi të jemi të drejtë ndaj vetvetes. Në qoftë se duhet, drejtësia le të jetë kundër nesh, në qoftë se nuk jemi të denjë për të. Në emër të qëllimit të lartë, në emër të drejtësisë, të jemi edhe kundër vetvetes, kjo është rruga e më të mirëve dhe shpirtërisht më të mëdhënjve.

Vetëm njerëzit e drejtë mund të ecin shtegut diellor, i cili, nëpërmjet dritës, shpie drejt përsosmërisë së shpirtit. Mëshira e All-llahut xh.sh. është për ata që ecin këtyre shtigjeve. Kurrë nuk duhet harruar:

“All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi,...”

(Kur’ani, 16:90)

All-llahu xh.sh. është e vërteta

Njëri nga nëntëdhjetë e nëntë emrat e Zotit është “E Vërteta Kulminante”. All-llahu xh.sh. është e Vërteta dhe ai e do të vërtetën. Prandaj mumini gjithmonë duhet të jetë pranë saj. Ajo, gjatë jetës së tij, është shoku më besnik, vetëm me të ai është i lumtur. Ata që besojnë Zatin, duan të vërtetën, sepse ajo është dëshira e Zotit. E përse All-llahu e thërret të vërtetën? E thërret, sepse vetëm nëpërmjet të vërtetës njeriu mund të bëhet fisnik, i pastër, besimtar i vërtetë dhe i drejtë. Këtë e dëshiron All-llahu dhe për këtë thërret në luftë kundër gënjehtës.

“...largohuni nga ndytësitë e idhujve dhe largohuni fjalës shpifëse.”

(Kur’ani, 22:30)

“E mos e ngatërmoni të vërtetën me të pavërtetën dhe me vetdije ta fshihni realitetin”.

(Kur’ani, 2:42)

Kur i di këto porosi do ta kuptosh se sa është përgjegjësia e çdo mumini para këtyre njohurive. Njeriu nuk guxon ta keqpërdorë dhuntinë e Zotit, e cila i është dhënë, dhuntinë e fjalëve të gjalla. Njeriu nuk ka të drejtë që harmoninë në natyrë, e cila me të vërtetën e lavdëron Zotin, Krijuesin e vet, ta shkelë me gënjeshtëri e vet. Gënjeshtëria është e panatyrshme në

natyrën e së vërtetës! A e di ç'është ideali i edukimit musliman? Ky është djaloshi, kjo është vajza, të cilët janë të sinqertë, pa gënjeshtër, të njerëzishëm, pa dyfytërsi, të vendosur në parimet e veta, pa marrë parasysh çdo gjë t'kundërt, që i rrethon.

A nuk është dhuratë e mrekullueshme kur për një njeri të ri mund të thuhet: "Ai është shembull i dashurisë ndaj të vërtetës, shembull i përgjegjësisë për çdo fjalë, për çdo vepër të vet. Ai është shtyllë e të mirëve. Ai është njeri i fjalës, në të cilën mund të kemi besim, ai nuk luan me të vërtetën. Të gjithë e dimë – gënjeshtër gjithmonë ka qenë e përbuzur, e neveritshme. Gënjeshtari gjithmonë ka qenë i poshtëruar, jo i denjë për besim. Po, të gjithë e dimë këtë, madje edhe vetë gënjeshtarët e dinë këtë, por megjithatë gënjejnë. – Përse? Pyet ndokush.

Gënjejnë të ligët dhe qyqarët. Ata nuk kanë guxim të dalin para të vërtetës. U duket se kalojnë më lehtë duke gënjyer. Por vetëm për një kohë të shkurtër. Sepse, siç thotë fjala e urtë popullore – Rrenja i ka këmbët e shkurtra – ajo ka jetë të shkurtër. Momentalisht tregon rezultate, mirëpo më në fund ajo gjithmonë demaskohet, dhe atëherë pason shkatërrimi i saj.

Frika lind gënjeshtër, kurse guximi të vërtetën. Muminët duhet të jenë të guximshëm, gjithnjë të qëndrueshëm përballë së vërtetës. Nëse gabojnë diç, ata e pranojnë haptas. Nuk gënjejnë për punë të vogla. Nuk ia shesin shpirtin e vet gënjeshtërës së mbrapshtë. Kam dëgjuar njeriun që gënjen, flet duke e lavdëruar dhe duke e ngritur veten. Nëpërmjet velit të gënjeshtërës e madhëron "unin" e vet. E pas gjithë kësaj qëndron gë-

njeshtra e turpshme dhe e pakuptimtë. Që të nesërmen ai e zbulon anën e vet të mirëfilltë, fytyrën e vet të mirëfilltë, fytyrën e mashtruesit të rëndomtë. Njeriu i karaktershëm nuk ia lejon vetes këtë. Ai dëshiron që me të vërtetën të marshojë në jetë. Ai dëshiron të jetojë për të vërtetën.

Le të jetë urdhër: Kurrë gënjeshtër!! As me fjalë, as me gjeste, as me sjellje dyfytyrëshe. Duhet ikur nga ligatina e gënjejtrave. Të ruhemi nga thirrja e saj.

Muhammedi a.s. ka thënë:

Ai që na mashtron – nuk është yni”.

Më tutje ai thotë:

“E vërteta njëmend na shpie në virtyt, e virtyti na shpie në xhennet”. “Karakteristikë e munafikut është që kur flet – rren, kur premtion diç – nuk e mban fjalën, e kur t’i besohet diç – ai tradhton”.

“Kujdes! Do t’ju njoftoj për mëkatet më të mëdha: e këto janë t’i bësh shok Zotit dhe t’i keqtrajtosh prindërit. Pastaj: rrena dhe dëshmia e rrejshme”.

As’habi Ebu Zerr r.a. rrefent: “Miku im më ka porositur (mendon në Muhammedin a.s.) disa vepra të mira. Më ka porositur që të flas të vërtetën, qoftë ajo edhe e hidhur, më ka porositur që në rrugën e Zotit të mos i frikësohem qortimit të askujt!

Mos i lejo vetes që të harrosh asnjëherë fjalët e kësaj këshille dhe të këtij mësimi, sepse me të vërtetë nuk vlen të gënjeshtër! Herët ose vonë gënjeshtera do të zbulohet. Sa i gjoë është ai, të cilin e zëmë duke gënjer. Sa i poshtëruar i duket vetes pas kësaj njohurie. Çfarë vlerash humb njeriu kur gënjen!

Prandaj edhe Zoti i Vërtetë dhe i Dashur deshi që ta ruajë njeriun nga gënjeshtria. Kur dikush flet të pavërtetën, skuqet në fytyrë. Kjo është mbrojtje e natyrshe kundër gënjeshtres. Në të vërtetë, ka edhe të atillë, të cilët, edhe kur gënjejnë, nuk skuqen, mirëpo ata janë njerëz të vrazhdë, shpirtra të prishur. Ti largohu nga njerëzit e atillë në zemrat e të cilëve djalli e ka vendosur mbretërinë e vet.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Xhihadi më i lartë është që tiranit t’ia thuash të vërtetën në fytyrë”.

Shih, pra, se sa është ngritur e vërteta në doktrinën islame. E vërteta është radhitur në xhihadin më të lartë! Sepse t’ia thuash të vërtetën në fytyrë dikujt vërtet kërkohet fuqi. Dhe këto fjalë muslimanët e vërtetë i realizuan besnikërisht.

Mund të ketë ndoshta nganjëhreë çaste, kur e vërteta kërkon vuajtje ose hidhërim. As atëherë nuk duhet gënjer! Nëse e vërteta nuk bën të thuhet, duhet heshtur, duhet bërë memec, nuk duhet folur. Heshtja shpeshherë është arma e të drejtëve. Në rrethana të këtilla lutja drejtuar All-llahut jep përgjigje. E vërteta gjithmonë duhet të jetë ideal i njerëzve me virtyte dhe me karakter të lartë. Të jesh gjatë gjithë jetës me tërë qenien tënde me të vërtetën – ky është heroizëm i vërtetë. Çdo njeri i mirë dëshiron të jetë heroi, i charactershëm, dëshiron ta arrijë përsosmërinë e shpirtit!

Kur e lexojmë historinë e fisit njerëzor, mahnitei me njerëzit, të cilët ditën të qëndrojnë me të vërtetën, sido që të jetë ajo.

Janë të pakufizuar shembujt e njerëzve të mreku-llueshëm, të cilët, duke qëndruar nën disiplinën e së vërtetës, flijuan çdo gjë që kishin, e më në fund edhe jetën e tyre. Ata ditën se jetojnë për amshim.

Muhammedi a.s luti All-llahun xh.sh.:

“O Zot, pastroje zemrën time nga hipokrizia, pastroje punën time nga të përfaqësuarit e rrejshëm, gjuhën time nga gënjeshtria, syrin tim nga shikimi vjedhës, sepse Ti e di se çka fshihet në shikimin vjedhës dhe çdo gjë që fshihet në zemër”.

Sinqeriteti është obligim

Sinqeriteti është rruga drejt arritjeve më të larta të shpirtit njerëzor, rruga e virtyteve të karaktershme. Me sinqeritet hapen shtigje drejt dyerve të xhennetit. Mirëpo, nevojitet sinqeriteti jo vetëm ndaj të tjerëve. Para së gjithash, sinqeriteti nevojitet ndaj vetvets, që është ndoshta më së vështiri të arrihet. Për këtë lypen forca të mirëfillta. E këtë forcë e ofron besimi në Një Zot. Ai frymëzon, Ai nxit.

Gabimin tënd personal nuk duhet kërkuar gjithmonë te tjetri, por, para së gjithash, në vetvete. Gabimi duhet të shqyrtohet sinqerisht. Mirëpo, mjerisht, "uni" i lënduar i personave qyqarë gjithmonë kërkon që fajin t'ia hedhë tjetrit. Për personalitetin e lig të gjithë janë fajtorë, njerëzit, rrethanat, madje edhe koha, vetëm ai jo. Kështu ndodh në çdo mospuskes. Çkado që të punohet. Mund të jetë ky sport, punë, por edhe lojë... reaksioni është gjithmonë i njëjtë.

O, All-llahu im, sa mashtrime, sa gënjeshtër! Sa tmerrshëm është lënduar "uni" ai njerëzve të tillë. Ai është i gatshëm për çdo gjë. Madje edhe për më të keqen. Nëpërmjet një "uni" të këtillë sikur shihet shpirtligësia e djallit.

Veprimet e këtilla nuk i kanë hije njeriut të sinqeritetit. Kjo është karakteristikë e njerëzve të mjerë dhe të gjorë. Mumini nuk guxon të jetë i këtillë. Mumini është i sinqertë ndaj vetvetes, e po ashtu dhe ndaj të

tjerëve. Nëse ka ndonjë mossakses, çfarëdo qoftë ai, ai e shqyrton: përse është shkaktuar ky mossakses. Ai i kërkon në mënyrë të gjithanshme të gjitha shkaqet dhe me arsye nxjerr përfundimet. Vetëm me sjellje të sinqerta ndaj vetvetes është e mundshme të njihen gabimet dhe lëshimet personale. E ato, vetëm kur njihen mirë, mund të evitohen dhe të ngjadhënjejhet mbi to. Njeriu guximtar nuk përkulet para mossaksesit. Duke i njohur gabimet dhe duke i mbizotëruar ato, ai do të ecë edhe më fuqishëm përpara. Për të, me ndihmën e All-llahut xh.sh., nuk ka pengesa, të cilat nuk mund të tejkalohen.

Çdo gjë që punohet, më parë duhet pyetur ndër-gjegjen, a është punuar drejt. Në paqe dhe në qetësinë më të madhe njeriu duhet t'i analizojë fjalët dhe veprimet e veta. Mumini, kur të shikojë ndonjë film, kur shkon në ndonjë shfaqje argëtuese, kur shkon në çfarëdo ndërmarrje, duhet ta shqyrtojë në vetvete qëllimin e vet të vërtetë, nijetin – a thua ka diç të mirë në të. Mumini është vetëkritik në shoqëri, me vlerësim real të mundësive dhe të dëshirave të veta. Ai hesht më tepër sesa flet, flet atëherë kur kjo është e nevojshme. Tek ai më parë prijnë mendimet, e pastaj fjalët. Kurrë nuk është io ngutshëm, i vetëbindshëm dhe kryeneç. Ai e respekton demokracinë e të folurit, e respekton bashkëbiseduesin e vet, dëshirat e tij për t'u shprehur deri në kufijtë e urdhërit të All-llahut xh.sh. Për të gjitha këto vlera, duhet pasur patjetër zemër të mirë dhe të sinqertë.

All-llahu xh.sh. di për të gjitha mendimet dhe qëllimet e njerëzve. Sinqeriteti i plotë arrihet duke iu

drejtuar në mënyrë të ndershme e të qartë Atij, Krijuesit të Dashur. Është mirë që, pas namazit, ta hapim plotësisht zemrën tonë, që përroi i margaritarëve të sinqeritetit të rrjedhë nëpër të. Në lutje, në përsiatje të qetë, hapen rrugët e papritura, me të cilat arrihet në shpirtin tonë çdo gjë që është e mirë. Me sinqeritet të mirëfilltë të ndërlydhur me besim të pakufishëm, pastrohet zemra dhe shpirti, kurse prej tyre si prej burimit malor, rrjedh dashuria ndaj çdo sendi të All-llahut, ndaj çdo gjëje që ka krijuar Ai: ndaj shpendit në fluturim, ndaj bletës në lule, ndaj thneglës së vyeshme. Të gjitha këto, me jetën e tyre, e lavdërojnë Krijuesin e vet dhe dëshmojnë për vërtetësinë e Tij.

E askush nuk e pranon rrëfimin e sinertë nga zemra e njeriut sikur All-llahu xh.sh. Askush nuk mund ta kuptojë si Ai shpirtin e njeriut nuk mund ta falë dhe t'i ofrojë ndihmë. Prandaj, vetëm Atij duhet t'i drejtohem në lutjen e qetë e të sinqertë. Edhe rrezet e dritës së besimit me shkëlqim të plotë do të depërtojnë në pjesët më të fshehta të shpirtit njerëzor. Sinqeriteti ndaj All-llahut xh.sh., ndaj njerëzve dhe ndaj vet-vetes do t'i japë gjithmonë frytet më të bukura. Në përpjekje për këto të mira nuk duhet lodhur as nuk duhet përkulur, e as ndalur. Zoti e do këtë rrugë.

Hamid al-Kaffaf-i tregon: "Kur All-llahu i Madhërishëm xh.sh. do ta dënojë robin e vet, Ai ia dhuron përvujtninë dhe devotshmërinë, por e privon nga sinqeriteti". Fevzi Mosterasi shkroi këto vargje:

*"Nëse në punën tënde nuk je i sinqertë ndaj Zotit,
Përveç dënimit, nuk do të kesh asgjë nga Ai,
O Hanif! Ki kujdes që të mos i përziësh*

sinqreitetin e hipokrizinë!

Veprat e mira janë si ari,

Kurse hipokrazia si vërshima”.

Ebu Hurejre tregon se Resulull-llahu a.s. ka thënë:

“Ka shumë njerëz që agjëronë, e nga kjo nuk kanë

asgjë, përveç urisë dhe etjes. Ka shumë njerëz që

luten natën, e asgjë nuk kanë nga kjo lutje, përveç

pagjumësisë – i këtillë është çdo njeri, i cili nuk i kryen

këto veprime me besnikëri dhe me sinqeritet të plotë”.

Premtimi është borxh

I riu i karaktershëm, në rrugën e tij të madhe drejt qëllimeve më të larta të jetës njerëzore, patjetër duhet të bartë me vete virtytin e fjalës së mbajtur. Ajo duhet të bëhet pjesë e tij.

Vetëm në këtë mënyrë e vetëm kështu hapet rruga kah *përsosmëria e shpirtit*.

Resulull-llahu a.s. ka thënë

“Premtimi është borxh”.

Ai që nuk e kryen këtë borxh hynë në radhën e atyre që nuk mund të bartin cilësi të njerëzve të aftë dhe të ndershëm. E sikur ta dinin të rinjtë se sa vlerë të çmueshme bartë në vete premtimi i dhënë dhe fjala e mbajtur! Sikur ta dinin se si shndrit fytyra e të riut që e mban në vetvete këtë virtyt!

Në jetë ndeshim njerëz të ndryshëm. Kalojnë si lumi përreth nesh dhe pranë nesh. Jemi në kontakt me ta. Dhe ja, dallohen ata, të cilët, si shkëmbinjë të lartë e të parrënueshëm, qëndrojnë mbi një det resh. Këta janë njerëz në virtytet e të cilëve jemi bindur. Të këtullët, nëse e kanë dhënë fjalën, do ta mbajnë. Njërzit e fjalës do t'i respektojnë edhe ata që i duan edhe ata që nuk i duan. Do t'i admirojnë!

Hapësira e fjalës së njeriut shtrihet që nga imtësitë më të vogla e deri te çështjet më themelore të jetës, deri në kuptimin dhe vetë thelbin e saj.

Nëse premtoj se do ta kthej librin e huazuar në kohë të caktuar dhe këtë e bëj – kjo është fjalë e mbajtur. Nëse i premtoj shokut se do t'i ndihmoj në ndonjë punë dhe këtë premtim e mbaj – edhe kjo është fjalë e mbajtur.

Dhe një varg fjalësh të mbajtura e lindin njeriun e vërtetë.

Prandaj, duke filluar ë nga fëmijëria, që nga shqiptimi i fjalëve të para, duhet mbjellë te fëmija frymën e fjalës së mbajtur, fjalëve të forta, frymën e premtimit të mbajtur, besa e dhënë te shqiptarët është e barabartë me vetë jetën e besëdhënësit.* Duhet rradhitur gur pas guri për të ndërtuar ndërtesën madhështore të karakterit. Këtu duhet të jemi të qëndrueshëm, të fortë, të pathyeshëm.

Dhe ja, një ditë, para nesh do të mbijë një kështjellë e madhe e zemrës njerëzore, e ndritshme, e shkëlqyeshme si dielli, e ngrohtë si zjarri diellor! Do të themi: Ky është njeri i vërtetë, njeri i fjalës (khs. te shqiptarët: njeri i besës, burrë i fjalës. (Sh.p)).

Nëpërmjet një varg veprash, në shikim të parë të vogla, gjatë tërë jetës së vet, njeriu e ka ndërtuar me durim veprën e madhe të besimit në zemrën e vet. E ka ndërtuar vlerën dhe peshën e fjalës së mbajtur (besës), që i ka dhënë Krijuesit të vet, Zotit të botëve. Që i ri ai e ka premtuar besnikërinë e vet ndaj idealeve për çdo gjë të mirë dhe për çdo gjë të bukur. Në këtë

* Besa e burrit – pesha e gurit. Fjala besë nuk mund të përkthehet në asnjë gjuhë të popujve të botës në kuptimin përkatës që ajo ka te populli shqiptar, sepse besa është një institucion i veçantë te shqiptarët. Besa është kulmi i peshës së fjalës së dhënë, i premtimit, e që shpeshherë mund të arsyetohet, të paguhet vetëm me jetën e vet premtuesit, dhënësit të besës. (sh.p.).

frymë ka shqiptuar fjalë në lutjet e veta të para, që kanë përfaqësuar themelin e besnikërisë ndaj Zotit. Ky betim, ky premtim më i lartë dhe më i shenjtë, nuk ishte betim çasti ose dite. Ky ishte premtim i jetës dhe i tërë ekzistencës së njeriut.

Të jesh njeri i fjalës në këtë premtim më të lartë, është trimëri e çdo njeriu – e çdo djaloshi ose çdo vajze, që synon përsosmërinë e shpirtit të vet. Fjala e dhënë i hap dyert e xhennetit. Njeriu i mirë hyn ngadalë nëpër to në mëshirën e pakufishme të All-llahut.

Muslimanët e parë e bartën këtë vendim në vete si një gjë normale. As në ndërlidhje, nuk mund ta merrnin me mend se mumini mund të jetë njeri, që nuk e mban fjalën. Në të vërtetë, të mos e mbash fjalën do të thotë të mos e mbash vëllain tënd, të mos e respektosh. Ai që nuk e nderon tjetrin, nuk e nderon as veten, sepse e shaktërron dhe e hedh në baltë autoritetin e vet dhe dinjitetin e vet njerëzor. Këtë mumini nuk guxon ta bëjë!!

Ja një ngjarje nga ditët e para të Islamit:

Para hazreti Umerit r.a. halifit të dytë, pas një lufte, perianin e shquar Hurmuzan e sollën të robëruar, por muslimanët e kishin dënuar me vdekje. Ai i tha Umerit r.a.: - Sundimtar i besimtarëve të vërtetë, jam i etshëm, e ndoshta nuk do të më mbytni të etshëm! Hazreti Umeri urdhëroi ë të mos ekzekutohet dënimi me vdekje derisa ai të mos e shuante etjen. Ku e mori Hurmuzani gotën e ujit në dorë, i tha h.Umerit: -A jam i sigurt, o sundimtar i besimtarëve të vërtetë, ta pi këtë gotë? H.Umeri i premtoi siguri. Atëherë Hurmuzani e hodhi gotën në tokë dhe uji u derdh. Tash i tha

h.Umerit: - premtimi i mbajtur, o sundimtar i besimtarëve të vërtetë, është dritë që shkëlqen! H.Umeri nuk e theu fjalën e vet dhe e liroi Hurmuzanin. Ky, duke e parë forcën e karakterit të h.Umerit që e kishte ndërtuar Islami, me kënaqësi vendosi të bëhet musliman! Nëpërmjet sjelljes së h.Umerit mësoi për fuqinë dhe madhësinë e Islamit. E mësoi të vërtetën. Meqenëse ai ishte i mençur, h.Umeri e pranoi në radhën e këshilltarëve të vet.

Ka shembuj të pakufishëm. Një plejadë e mrekullueshme e muslimanëve të parë, me karakterin e tyre e kanë shkruar historinë e madhe të vlerave njerëzore.

Këshilla e të urtëve thotë: "Duhet të jesh njeri i fjalës. Nga premtimi më i vogël deri te premtimi më i madh".

Kjo është rruga e drejtë. Apo jo? – Mumini, në të vërtetë, dëshiron të ecë kësaj rruge! Kjo është rruga e tij!

Nuk duhet betuar pa nevojë

Sa herë kam dëgjuar djem e vajza duke u betuar pa nevojë për gjëra më të imëta. “Pasha nënën, pasha nderin, pasha dinjitetin tim”, e madje shpesh përmendet edhe emri i Zotit. Shpesh kam pyetur: “Përse dhe për të keq shumë betime?” Kam përshtypjen se këta njerëz të rinj nuk i besojnë as vetvetes, ndaj, për t’i bindur të tjerët në vërtetësinë e fjalëve të veta, e shfrytëzojnë betimin.

Mumini nuk vepron kurrë kështu. Nëse ndokush pyet diçka, ai do të përgjigjet: “Po! Kjo është kështu, kjo është e vërtetë” ose “Kjo nuk është e vërtetë. Unë kurrë nuk rrej, ndaj nuk kam nevojë të betohem”.

Muhammedi a.s. ka thënë dhe ka tërhequr vërejtjen: *“Betimi ndihmon për ta shitur mallin, por e asgjëson bekimin e Zotit”*.

Hazreti Umeri r.a. ka këshilluar: “Betimin mos e prano lehtë, sepse mund të bjerë kokës”. Megjithatë, nëse muminit i bie puna të betohet, atëherë duhet të ketë kujdes për betimin e vet. Në të vërtetë, ai mund të betohet në All-llahun, por vetëm atëherë kur ka arsye serioze. Për çkado tjetër nuk është e preferueshme. Në radhë të parë, betimi në këtë funksion nuk ka pasoja juridike, e ka edhe ndalesa për këtë lloj betimi.

“Zoti juaj e ka ndaluar të betoheni në baballarët tuaj. Kush betohet, le të betohet në All-llahun ose le të heshtë”. (Hadith).

Burejde, as'hab i Muhammedit a.s., tregon se si ka thënë një njeri: "Jo, pasha tempullin e shenjtë Qabënë!", për të cilën gjë Ibni Umeri i tha: "Mos u beto në askë tjetër, përveç në Zotin, sepse e kam dëgjuar Pejgamberin e Zotit që thotë:

"Kush betohet në dikë tjetër, përveç në Zotin, ai mbetet i pafe ose idhujtar".

Ka njerëz që betohen rrejshëm që t'i sigurojnë vetes ndonjë dobi.

"Atij që me betim ia zvogëlon të drejtat një muslimani (dhe në këtë mënyrë i sjell dëm) Zoti ia ndalon të shkojë në xhennet, por ia ka caktuar (si vendbanim) xhehennemin".

Kur Muhammedi a.s. i shqiptoi këto fjalë, një as'hab pyeti: "Po, në qoftë se kjo është për një gjë të vogël?", e Muhammedi a.s. iu përgjigj:

"Qoftë kjo edhe për një rrenë të erakut (lloj i drurit të hidhur)".

Ti, o djalosh, mbaje mend se betimi i panevojshëm është i qortueshëm, kurse betimi i rrejshëm është një prej mëkatave më të mëdha.

Jusufbeg Çengiqi në poemën e vet "Avdija" e këshillon vëllain e vet, Avdiun e vogël:

*"Ti rrejshëm mos u beto,
Duhet vëlla të vdesësh,
Vuajtjet t'i përballosh,
Nuk ëshë lehtë, Avdi-o!
Kush rrejshëm betohet
Nga vuajtjet mundohet,
E pastaj mallkohet,
Fajtor nuk jam, Avdi-o!"*

Me rëndësi është ta njohim edhe një problem serioz, të cilin e ndeshim shumë shpesh te besimtarët. E ky është betimi në All-llahun edhe për gjëra më të vogla. All-llahu është Krijuesi ynë, ndaj emri i Tij nuk duhet përdorur aty, ku nuk është vendi. Kjo e fryen Islamin. Muminët e vërtetë kurrë nuk veprojnë kështu. Kështu veprojnë vetëm ata që janë të ligj, të cilët, nga dobësia e vet, përpiqen të tregojnë se kanë të drejtë, prandaj sipërfaqësisht fshihen pas emrit të Zotit. Kjo është rrugë e mëkateve, që i shpie drejt humnerës së xhehennemit. Arshi dridhet, kur në betime të parëndësishme përmendet emri i All-llahut.

Paratë harxhoi me mend e me vend

Është edhe një cilësi e njerëzve të karaktershëm, e atyre që synojnë përsosmërinë e shpirtit të vet. Kjo është sjellja e arsyeshme me para. Mumini krurë nuk bëhet rob i margaritarëve dhe i shkëlqimit të tyre. Paraja kurrë nuk guxon ta zotërojë shpirtin e tij. Shumë njerëz, në të kaluarën, për ar e kanë shitur shpirtin dhe nderin e tyre, për ar – për këtë mallkim njerëzor – që të kenë sa më tepër, pa marrë parasysh arsyet dhe pengesat morale janë nënçmuar vlerat shpirtërore dhe janë shitur për stoli të çmuara. Shpeshherë njeriu bëhet rob i parasë dhe shërbëtor i saj. Paraja duhet t'i shërbejë njeriut e jo njeriu parasë.

Është normale në jetë që njeriu të arrijë të fitojë para. Kjo është e domosdoshme për jetesë. Mirëpo, ky fitim duhet të jetë i drejtë dhe i ndershëm. Paraja, kurrë nuk duhet të bëhet lëndë themelore e kërkesave dhe e synimeve tona. Duhet ta lusim All-llahun xh.sh. që të na ruajë nga kjo e keqe.

Ne duhet ta dimë si gjë të sigurt se të gjitha të mirat materiale, që kemi, na janë huazuar nga All-llahu xh.sh. dhe na janë dhënë për përdorim të përkohshëm për këtë jetën tonë të shkurtër. Kurrë nuk duhet të harrojmë: Asgjë nuk është jona. E tërë fuqia dhe e tërë mirëqenia janë te All-llahu dhe prej All-llahut xh.sh. Këtë duhet pasur gjithmonë parasysh.

Thuhet se halifi Umer ibni Abdu-l-Aziz kërkonte nga të afërmit e vet t'ia hapin grushtat kur të vdesë. Le ta shohë e tërë bota se nuk mori asgjë me vete. Vetëm vepra të mira dhe të këqija.

Në Kur'an thuhet:

"Vetëm të All-llahut janë gjithçka ka në qiej dhe ç'ka në tokë!"

(Kur'ani, 2:284)

Njerëzit e mëdhenj gjithmonë janë të kënaqur shpirtërisht me atë që kanë. Pasuria e vërtetë nuk qëndron në ar, por në lumturinë e vet të brendshme dhe në lumturinë e paqes së shpirtit që di për Krijuesin e vet.

Në kohë të lashta, në një mbretëri, mbreti kishte qenë shumë fatkeq. Kishte pasuri të madhe, por nuk ndjehej i lumtur dhe i kënaqur. I kërkonte ato, por më kot. Radhiteshin këshillat dhe udhëzimet e filozofëve se si mund ta gjente fatin dhe të bëhej i lumtur. Më në fund, kur të gjitha shpresat kishin perënduar, një filozof i tha: "Mbret fisnik! Hulumto në mbretërinë tënde njeriun që vërtet është i lumtur, merre këmishën e tij dhe vishe dhe gjithmonë do të jesh i lumtur". U shpërndanë lajmëtarët nëpër tërë mbretërinë që ta gjenin njeriun e këtillë. Pas shumë kërkimeve takuan një bari, që po i ruante delet në livadh. Kur e pyetën se a është i lumtur, ai iu përgjigj se lumturinë e vet të madhe nuk do ta jepte për kurrfarë thesari të kësaj bote. Ia kërkuan këmishën, duke i premtuar shpërblim të madh.

"Do t'jua falja, por nuk kam" – tha bariu i lumtur.

Paratë kurrë nuk duhet derdhur vend e pa vend. Nëse janë fituar në mënyrë të ndershme, në fitimin e tyre gjithmonë qëndron mundi dhe djersa jonë ose e të afërmeve tanë. Ndaj mundit dhe djersës gjithmonë duhet të sillemi me respekt. Duhet çmuar punën dhe mundin. Paratë duhet kursyer brenda kufijve që i ka caktuar All-llahu xh.sh. Kursimi niuk duhet të shndërrohet në koprraci. Kur të kursehet, duhet kursyer me qëllim fisnik, ashtu që paraja e kursyer të përdoret atje, ku All-llahu xh.sh. do të jetë më i kënaqur.

Kur të blesh diç, blej me masë dhe me modesti. Nuk duhet shpenzuar kot së koti në veshje, por nuk vlen edhe të jemi tepër modestë që të mos kalojmë në parregullsi dhe në rreckamani. Duhet gjetur kufirin e arsyeshëm. Kurrë nuk duhet krahasuar me ata, të cilët bëjnë jetën tepër luksoze, por as me ata, të cilët janë koprracë. Gjithmonë duhet të jemi të matur dhe vetëm atëherë njeriu me të vërtetë do të jetë i lumtur, sepse mesi i artë e edukon karakterin, ndjenjën gjithënjëzore. Njerëzit fitojnë para, po shumica harrojnë se paraja të obligon.

I dashuri Zot ka thënë:

“Besoni All-llahut dhe të Dërguarit të Tij dhe jepni nga ajo që Ai u bëri trashëgues në të, se ata që besuan prej jush dhanë për hir të Zotit, ata kanë shpërblim të madh.”

(Kur’ani, 57:7)

“Dhe në pasurinë e tyre kishte përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë, por nuk lyp).”

(Kur’ani, 51:19)

“Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe atij në kurbet, po mos shpenzo tepër e pa rrugë. Ata që shpenzojnë tepër (mastrafxhinjtë) janë vëllezër (në veprim) të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të Tij.”

(Kur’ani, 17:26-27)

“Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e All-llahut, është si i një kokrre që i mbin shtatë kallinj, në secilin kalli njëqind kokrra. All-llahu ia shumëfishon (shpërblimin) atij që dëshiron. All-llahu është bujar i madh, i di qëllimet.”

(Kur’an, 2:261)

“Juve ju preokupoi përpjekja për shumimin (e pasurisë, të fëmijëve, të pozitës)! Derisa të mos i vizitoni varrezat (të bëheni banues i tyre – të vdisni). Jo, nuk është ashtu! Gjithsesi këtë do ta kuptoni më vonë! Përsëri jo, jeni gabim! Më vonë do ta kuptoni! Jo, pse, sikur ta dinit me një dije të sigurt (nuk do të bënit ashtu). Ju patjetër do ta shihni xhehennemin. Madje atë do ta shihni të bindur plotësisht. Pastaj në atë ditë do të pyeteni për të mirat (e dynjasë).”

(Kur’ani, 102:1-8)

Këto janë urdhëra dhe vërejtje të Krijuesit tënd. Mumini kurrë nuk bëhet i shurdhër për fjalët e Tij. Të kujtojmë duart e shtrira të halifit Umer Ibni Abdu-l-Azizit, Zoti i Madh le ta mëshirojë!

Kam lexuar tregimin: Një tregtar i pasur para vdekjes i thirri bijtë e vet dhe i obligoi: “Fëmijë, unë natën e parë nuk guxoj të rri vetëm në varr! Pashë Zotin e

Madh mbyllnie dikë natën e parë me mua, që të mos jem vetëm në varr! Do të më jetë sadopak më lehtë!

Bijtë e dëgjuan dhe pasi i ati ndërroi jetë, e gjetën një hamall, që natën e parë të kalonte me të në varr. Që të mos ngulfatej i vunë një gyp për të marrë ajër nëpër varr. Kur agoi të nesërmen, erdhën bijtë dhe e nxorën hamallin nga varri. Ishte gjallë, por krejtësisht i bardhë si delja, kurse dhëmbët i kërcëllinin. Kur e thirrën që tëvinte në shtëpi dhe t'ia jepnin shpërbli-min e premtuar, ai e refuzoi: "Mosni vëllezër, ju lutem, qofshi shëndosh! Derisa jepja xhevap për atë që kam fituar me litarin tim të hamallit, u thinja fare!"

Si do të japin llogari ata, të cilët i kanë mashtruar të tjerët dhe kanë hëngër pasurinë e huaj!?

Tregonte Ajsha r.a. se si anëtarët e familjes së Muhammedit a.s. njëherë therën një dele. Pejgamberi i Zotit a.s. pyeti se ç'kanë ndarë, kurse Ajsha iu përgjigj: "Ka mbetur vetëm shpatulla". Ai tha:

"Të gjitha na paskan mbetur, përveç shpatullës!"

Muhammedi a.s. ka thënë:

"Sadakaja e zbut zemërimin e Zotit dhe e ruan njeriun nga vdekja e keqe dhe e rëndë".

Është këshillë e lashtë që të mos huazohen para. Borxhi është shok i keq. Borxhi gjithmonë lind hidhërimin dhe e largon buzëqeshjen nga fytyra. Borxhliu nuk është i lirë. Çfarëdo huazimi qoftë, ai shkakton hidhërim dhe tek ai që jep edhe tek ai që merr para. Paraja e huazuar nuk është para e bekuar. Në të ka diç që nuk është e mirë, vulë e së keqes – ajo harxhohet shpejt dhe humb lehtë.

Pyeti ynë shkruan:

*“Borxhliu gjithmonë është i hidhëruar
Edhe në ditën e Bajramit është i shqetësuar...”*

Në borxh duhet hyrë vetëm atëherë, kur nuk ka rrugëdalje tjetër, e nëse hyjmë borxh, atëherë së paku duhet ta kthejmë me kohë borxhin. Njeriu me karakter duhet të mbetet gjithmonë i karaktershëm.

Tani dëgjo se si kanë vepruar as'habët me paratë, ku i kanë harxhuar ato, ku e kanë investuar këtë pasuri.

Vitin e nëntë pas Hixhrit, Resulull-llahut i erdhi lajmi se ushtria bizantine ishte nisur në marshim drejt shtetit Islamik. Pejgamberi i ftoi luftëtarët islamë që të vihen nën flamurin e luftës, ta mbrojnë fenë e tyre dhe atdheun e tyre nga depërtimi i bizantinëve. Thirrjes iu përgjigjën rreth 30.000 muxhahidinë, prej tyre 10.000 kalorës. Për ekspeditë ushtarake dhe për pajisjen e ushtrisë nevojiteshin shumë të holla, prandaj Resulull-llahu a.s. analizoi të gjitha nevojat e ushtrisë islamike. I pari u përgjigj h.Ebu Bekri. Ai vuri në dispozicion të pasurisë së vet. Muhammedi a.s. e pyeti se çka i kishte lënë familjes së vet: “Ja kam lënë All-llahun dhe Pejgamberin e All-llahut!” H.Umeri e vuri në dispozicion gjysmën e pasurisë së vet, h.Uthmani tërë karvanin, që përgatitej për Siri, e dorëzoi për nevoja të mbrojtjes. Edhe të gjithë as'habët e tjerë shpejtonin të jepnin ndihmën e vet materiale. Muslimanët i hoqën stolitë, qaforet dhe tërë arin e vet e dorëzuan për rrugën e shenjtë, në emër të dashurisë ndaj All-llahut xh.sh.

Për çdo punë duhet të këshillohemi

Institucion i rëndësishëm në Islam është këshillimi, marrëveshja. Nëse muslimani duhet të marrë vendim për ndonjë hap të rëndësishëm në jetën e vet, për ndonjë veprim, domosdo duhet të këshillohet, duhet të kërkojë mendimin e miqve të afërt ose të njohurve. Shumë njerëz gjithmonë gjejnë zgjidhje më të mençur, marrin vendim më të drejtë, sesa individit vetë.

“Andaj t’i falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet...”

(Kur’ani, 3:159)

“Çka u është dhënë nga ndonjë send, ajo është kënaqësi në këtë botë, e ajo që është te All-llahu është shumë më e mirë dhe e përjetshme, por për ata që besuan dhe që vetëm Zotit të tyre i mbështeten. Dhe ata që u shmangen mëkateve të mëdha e të shëmtuara, dhe kur hidhërohen, ata falin. Edhe ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta, e nga ajo që Ne ua japim ata e shpërndajnë. Edhe ata që kur i godit e padrejta, i kundërvihen”.

(Kur’ani, 42:36-39)

Një as’hab tregonte: “Kurrë nuk kam parë dikë që të pyesë aq shpesh për këshilla, siç bënte Resulullahu a.s.” Pejgamberi i All-llahut a.s. një herë i tha Ebu Bekrit r.a. dhe Umerit r.a.:

“Nëse ju të dytë pajtoheni për diçka, unë nuk do t’ju kundërvihem”.

Gjatë marshimit të ushtrisë islame në Bedër, kur iu afruan burimit më të afërt, Pejgamberi i All-llahut urdhëroi që ushtria të ndalej. Muxhahidi el-Hubbab bin el-Munzir e pyeti Muhammedin a.s. se a e kishte caktuar All-llahu këtë vend apo ndoshta ky ishte ndonjë veprim taktik. E kur Muhammedi a.s. tha se nuk ishte as njëra as tjetra, atëherë el-Hubbabi propozoi që të shkonin sa më afër armikut dhe t’i pushtonin e t’i mbyllnin të gjitha burimet, por më parë për ushtrinë islamike duhet të ndërtohej një saranxhë* me ujë. Kjo do t’ia vështirësonte pozitën armikut, sepse do të vuante për ujë. Muhammedi a.s. dhe as’habët menjëherë e miratuan këtë propozim.

Kur erdhi Resulull-llahu a.s. në Medine u shtrua çështja se si të bëhej thirrja për namaz. Pati propozime të ndryshme, si: ndezja e zjarrit, rënia e kambanës. Njëri nga të pranishmit në këshillim tregoi se në ëndërr kishte mësuar se muslimanët duhet të thirren në namaz me fjalën e gjallë të njeriut. Resulull-llahu a.s. dhe të pranishmit e tjerë e miratuan këtë propozim dhe që atëherë ekziston ezani.

Resulull-llahu ka thënë:

“Kush mendon të bëjë ndonjë punë, e këshillohet me njerëzit e mençur dhe me njerëzit që kanë përvojë, All-llahu xh.sh. do të bëjë ashtu që të jetë më së miri për të”.

“Besimi është këshillim dhe udhëzim për të mirë”.

* Lloj pusi artificial, që mbushet me ujë atmosferik, sternë, sterë, hurdhë, cisternë natyrale (sh.p.).

“Suksesi është i sigurt në çdo punë, nëse këshillohesh me njerëz të mençur dhe ekspertë”.

“Kush këshillohet, ai fiton. Nuk ka të mira, nëse njerëzit nuk këshillohen”.

“All-llahu xh.sh. e ç’mon lart marrëveshjen e muslimanëve për të gjitha punët”.

Ja disa thënie të urta të Sulejmanit a.s., të birit të Dautit, mbretit izraelit:

*“Biri im, ruaj urdhërat e babës tënd
dhe mos i refuzo mësimet e nënës sate!
Lidh për vete në zemër përgjithmonë,
mbështilli ato rreth qafës sate
që të të shohin kur të ecësh,
që të të ruajnë kur të flesh,
Dhe të bisedojnë me ty kur të zgjohesh.
Mësimi i të mençurve është burim i jetës.
Ai të shpëton nga kurthi i vdekjes.
Dëgjo këshillat dhe prano mësimet,
Që në fund të bëhesh i mençur.
Këshilla në zemrën e njeriut është ujë i thellë,
Dhe njeriu i arsyeshëm do ta shfrytëzojë”.*

Xhelaludin Rumi në Mesnevi thotë:

*“Mendja e bashkuar me mendjen tjetër dyfishohet,
Drita rritet, e rruga ndriçohet.”*

Nganjëherë ndeshim njerëz, të cilët, pa u këshilluar me askënd, marrin vendimet më të rëndësishme në jetë. Ky është “uni” në njeriun, që nuk lejon as dëgjimin e mendimeve të njerëzve të tjerë. “Uni” nuk dëshiron as të ndjejë se ekziston dikush që ka mendim

që mund të jetë më i drejtë se i tij. Këta janë shpirtra egoistë, të cilët kurrë nuk gjejnë zgjidhje të drejtë, por gjithmonë sillen në rreth të mendimeve dhe të ndjenjave të veta, qofshin ato edhe të gabuara. Në zemrat e tyre nuk ka ngrohtësi të mirëfilltë njerëzore që do të mund të ngrohte edhe zemra të tjera.

Të gjithë njerëzit e mirë janë këshilluar. Me këshillat e të urtëve dhe të mençurve i kanë hapur vetes rrugë të ndritshme. Edhe muminët veprojnë kështu. Për këshilla i pyesin prindërit, të afërmit, të diturit, miqtë.

Mirëpo, gjithmonë para të gjitha këshillve, këshillat duhet kërkuar në shkencën islame. Islami jep përgjigje në të gjitha apyetjet, në të gjitha problemet, pastër, qartë, në mënyrë të kristaltë, përgjigje të drejta, jep udhëzime që shpiejnë drejt zgjidhjeve më të mira. Në ç'mënyrë kërkohet kjo këshillë? Do të të them: kërkohet në Kur'an, në Hadith, në praktikën islame. Duhet lutur All-llahun xh.sh. pas namazit, që të hapen dyert e diturisë për çështjet e pazgjidhura. All-llahu xh.sh. është i mëshirshëm dhe mëshirën e Vet ua dhuron besimtarëve. Drejtimi i sinqertë kah Ai, Zoti ynë do të japë, nëse do Zoti, përgjigje të drejtë.

Largohu nga i paditur

Njeriu është qenie shoqërore. Njeriu është i lidhur me njeriun, i udhëzuar kah njeriu. Bashkëpunimi ndërmjet njerëzve e bën jetën më të mundshme dhe më të lehtë. Ti dhe shoku yt dhe të gjithë ne, pa përjashtim, ndjejmë nevojë të kemi dikë të afërm, në të cilin mund të mbështetemi, të cilit mund t'i besojmë, ta kemi dikë afër, që na kupton. Pa miq, pa shokë jemi të vetmuar, jemi të humbur.

Së këndejmi rezulton e dhëna se psikiatrët dhe psikologët i nxisin njerëzit të gjejnë miq dhe ta thyejnë vetminë. Kjo nxitje është bar i vërtetë që të evitohen ose të zbuten sëmundjet shpirtërore.

Synimi ynë njerëzor për miqësi buron nga thellësia e emocioneve tona, buron nga thellësia e shpirtit dhe e zemrës sonë. Në brendinë tonë ekziton bashkëndjenja ndaj njeriut vëlla, kudo që të gjendet dhe çfarëdo kobi oe race t'i takojë ai. Kjo është ndjenjë e vërtetë dhe e sinqertë, që ka lindur bashkë me shpirtin tonë, shkëlqim i qartë i mirësisë së All-llahut ndaj njeriut. Prandja çdo gjë që është e mirë, që është fisnike dhe e ndershme, që ka frymë miqësore ndërmjet njerëzve të mirë dhe të sinqertë, është një pasuri më e çmuar e kësaj bote.

Dihet se koha e rinisë është periudha më e përshatshme për krijimin e miqësisë, e cila, nëse është e mbështetur në ndjenjat e sinqerta fisnike, mund të

zgjasë në të gjitha sprovat dhe fatkeqësitë jetësore. Rinia, nëpërmjet miqve, e shpejton pjekurinë shpirtërore dhe e mbizotëron egoizmin sedërmadh. Duke e kultivuar këtë ndjenjë, njerëzit e rinj i zhvillojnë në vetvete cilësitë më fisnike dhe i dhurojnë njëri-tjetrit virtytet më të bukura. Bashkërisht i përsosin cilësitë e veta në nivel shumë më të lartë se sa do ta bënte këtë individi vetë. Solidariteti i ndërsjellë, bujaria dhe jo-egoizmi, këto cilësi të mrekullueshme të miqësisë, i ngrejne shumë lart vlerat e personalitetit njerëzor. Miku në mikun zbulon pasurinë, që ndoshta ky vetë, vështirë do ta zbulonte. Bashkërisht i njohin dhuntitë e Zotit, me të cilat All-llahu xh.sh. e ka dhuruar me bollëk fisin njerëzor.

Prandaj duhet kërkuar mikun në njeriun e sinqertë, në njeriun e mirë. Kjo është ndërmarrje serioze në jetë. Është e sigurt se njerëzit ndikojnë njëri në tjetrin. Është filozofi e lashtë: Më trego me kë rri se të tregoj kush je ti, që do të thotë se me kë shoqërohesh i tillë je edhe vetë! Nga zgjedhja e mikut shpesh varret e tërë rruga jetësore. Njerëzit e mirë dhe të ndershëm mund të ndihmojnë shumë, kurse të këqijtë dhe shpirtligët mund të dëmtojnë shumë. All-llahu xh.sh. ka thënë:

"...hiqur prej të padishëmve".

(Kur'ani, 7:199)

I urti Sari Abdull-llahu ka shkruar:

"Sado që të jetë e nxirë zemra, sado që të jesh privuar nga edukimi, nëse fillon të shoqërohesh me njeriun e mençur dhe të edukuar, ti, me ndihmën e Zotit,

do të gjesh lumturinë dhe shpëtimin dhe do të arrish në lartësitë më të mëdha”.

“Ushqim i shpirtit janë këshillat dhe mençuria. Këto mund t’i fitojmë nga njerëzit e rëndomtë, të cilët edhe vetë presin që dikush t’ua shtrijë dorën dhe t’i udhëheqë. Ushqimin shpirtëror duhet kërkuar nga njerëzit me edukatë të lartë, nga ideologët shpirtërorë, të pajtohesh me ta dhe t’i dëgjosh udhëzimet e tyre”.

Dëgjoje këtë tregim:

“Babë”, tha një ditë djali, “dëshiroj ta vizitoj fqinjin tonë”. “Mirëpo, ai nuk është njeri i mirë, more bir” – tha baba. “Më mirë është të largohesh nga ajo shoqëri, por nëse do, ti shko”.

Rruga deri te fqinji ishte e përbaltur. Shiu bine rrëke. I biri u kthye shpejt krejt lagur dhe i përlyer nga balta.

“Babë, shih si jam bërë, krejt rrobat m’u batisën. Kishte shumë baltë. Ç’të bëj?”.

“Tanimë asgjë. Por, ja mësimi për ty. Kur të shkosh rrugës së përbaltur nuk mund të mbetesh i pastër. E kur të shkosh në shoqëri të keqe, nuk mund të mësosh asgjë të mirë, vetëm keq. Këtë, të lutem, kurrë mos e harro!” – e mësoi baba.

Ja disa mendime të filozofisë islame:

- Kush ik nga të këqijtë, ngel i sigurt.
- Për mik duhet zgjedhur njeriun punëtor, besimtar dhe me cilësi të shëndosha, kurse duhet ruajtur nga përtacët, të papunët, llafazanët, të degjeneruarit dhe ngatërrestarët.

- Mos pyet për njeriun, por shikoja mikun.

- Miku mikut i ngjet. Nëse është i keq, shpejt lëshoje!

Nëse është i mirë, shoqërohu me të – do të jesh i udhëzuar!

Fjala e urtë popullore persiane thotë:

“Njeriu i keq është më i rrezikshëm se gjarpëri,
pasha All-llahun që është strehim i të gjithëve,
sepse të shpie në xhehennem,
kurse miku i mirë të shpie në xhennet”.

Për këtë arsye njeri i mençur gjithmonë largohet nga shoqëria e keqe dhe kërkon shoqëri të mirë. Gjithmonë duhet verifikuar shpirtin e njeriut, të cilin e zgjedh për shok. Kaherë është thënë urtia:

“Lulja e lalës është e bukur, por farën e ka të zezë. Kështu duken edhe njerëzit e këqij, pamja e jashtme e të cilëve është elegante dhe tërheqëse, por zemrën e kanë të zezë dhe kanë tipare antipatike”. Njerëzit e mëdhenj janë rritur pranë njerëzve të mëdhenj. Shpirti e ushqen shpirtin. Prandaj të gjithë njerëzit e mëdhej kanë krijuar miqësi të sinqertë dhe të thellë me njerëz të mirë, që kanë qenë të denjë për një miqësi të tillë. Të kujtojmë Sokratin dhe afrinë e tij të madhe shpirtërore me nxënësit e vet. Gjithnjë ishin me të, madje edhe në çastin e vdekjes, kur qe i detyruar që të pinte gotën e helmit.

I prekshëm dhe i ndjeshëm ishte qëndrimi i Isait a.s. me nxënësit e vet. Besimi në Zotin dhe dashuria ndaj Isait a.s. i kishin frymëzuar për heroizmat më të mëdha. I lanë të gjitha dhe shkuan pas tij, pas mësimin të tij. Kurrfarë persekutimesh, e as bishat në arena, nuk i ndalën në rrugën e tyre të shenjtë.

Si sjellje e jashtëzakonshme njerzore është shënuar miqësia e Muhammedit a.s. me as'habët e tij. Ky

njeri i madh, i mrekullueshëm i pushtonte njerëzit me zemrën e vet të madhe. Çdo fjalë e tij, çdo sjellje e tij, krijonin gjithnjë miqësi të reja. Njerëzit e asaj kohe ishin krenarë që mund ta quanin mik. Ndërsa fryma e kësaj miqësie u vazhdua edhe pas vdekjes së tij. Ajo vazhdon edhe sot. Dhe të gjithë ata muminë, që vijnë, e aq në zemër e kanë Islamin, janë të nderuar që Muhammedin a.s. e konsiderojnë mikun e vet më të madh. Ai vdiq, por jeton ideja, që ai e përhapri dhe ajo do të vazhdojë deri në fund të botës.

Muhammedi a.s. i dont edhe i çmonte shumë as'habët e vet. Sa ngrohtësi kishte vetëm në shoqërinë e tij me Ebu Bekirin r.a. e ndershëm, me Umerin r.a. e drejtë, me Uthmanin r.a. të mirë, me Aliun r.a. fisnik, me Bilalin r.a. trim dhe me shumë të tjerë.

Në një hadith Resulull-llahu a.s. thotë për as'habët e vet:

“As'habët e mi janë si yjtë. Pas cilit të shkoni, do t'ju çojë në rrugë të drejt”.

Për miqësinë dhe respektin e as'habëve ndaj Muhammedit a.s., i dashuri Usame ibni Sherik rrëfente: “Erdha në një rast te Pejgamberi i Zotit, Muhammedi a.s. As'habët e tij ishin grumbulluar rreth tij, por ashtu të qetë dhe si ka hije, sikur t'i kishin shpendët mbi kokë”.

Emisar i Kurejshitëve në Hudejbije, në vitin e gjashtë sipas Hixhrit, ishte Urve ibni Mesud. Pas kthimit në Mekke qëndrimin e Muslimanëve ndaj Muhammedit a.s. ai e përshkruan me këto fjalë:

“Kurejshitë! Kam qenë te mbreti persian, bizantin dhe abisinas dhe e kam parë fuqinë e tyre, por nuk

kam parë sundimtar që t'i bëhet nderim aq i madh, ashtu siç i bëjnë Muhammedit shokët e tij".

Është thënë se i urti Sulejman a.s. ka thënë për miqësinë:

"Mos i zë miqtë, që nuk janë të mirë së paku si ti. Besnikëria paraqet bazën. Miqtë besnikërisht ia tërheqin vërejtjen njëri-tjetrit dhe përmirësohen me mjeshtëri".

Hamid al-Kaffaf ka thënë: "Kur do ta dënojë dikë, All-llahu xh.sh. ia dhuron shoqërinë e njerëzve të këqij, kurse e privon nga njohuria e vlerës së vet të mirëfilltë".

Duhet të jesh i urtë. Duhet të mësoh nga këshillat dhe mësimet e lashta për fuqinë, për bukurinë dhe për rrugët e miqësisë. Urtia flet me mijëra vjet, ajo thërret për arsye, për fisnikëri, për shoqëri të mirë, për vëllazëri, për kërkimin e njeriut në njeri, për kërkimin mikut të vërtetë. Të gjitha rrugët drejt këtyre synimeve të mëdha vërtet çojnë kah lumturia e vërtetë e jetës. Duke ndjekur këtë rrugë, horizonti i përsosmërisë së shpirtit bëhet më i ndritshëm. Prandaj, vëllai im, motra ime, munda i bërfe për kërkimin e mikut të vërtetë, është i vlefshëm dhe i çmueshëm. Miqësia e vërtetë sjell paqe dhe lumturi. All-llahu xh.sh. e do miqësinë e njerëzve të mirë dhe të ndershëm.

Fjala e mirë – veprim i mirë

Fjala e All-llahut xh.sh. është:

“Ti merre të lehtë, urdhëro për mirë...”

(Kur’ani, 7:199)

Islami bart porosinë e paqes, të shpëtimit, të dashurisë, me të gjithë njerëzit vullnetmirë me përshëndetje aq karakteristike: Paqe! Shpëtim! Selam! I këtillë është mësimi Islam. Zemra islame është e madhe, ajo përfshin tërë gjithësinë. Në këtë frymë është edhe qasja e njeriut të mirë, vëllait sipas gjinisë nga stërgjyshi i përbashkët Ademi a.s. dhe stërgjyshja hazreti Havva.

Njëri nga as’habët, në një rast, kërkoi nga Muhammedi a.s. t’i mallkojë mushrikët (të pafetë).

“Unë nuk jam i dërguar të mallkoj, por kam ardhur të thërras”.

- u përgjigj Resulull-llahu a.s., mumini i vërtetë nuk mallkon. Ai i afrohet çdo njeriu, që tregon një grimë sado të vogël vullnet të mirë me plot kujdes dhe zemërgjerësi. Do ta nderojë njeriun, dinjitetin e tij njerëzor dhe personalitetin e tij, sepse njeriu është vepër madhështore e All-llahut dhe vaj halli për atë, që e dhunon nderin dhe dinjitetin e veprave të All-llahut.

Vëllait, njeriut të mirë duhet afruar me dashuri. Në marrëdhëniet ndërnjerëzore duhet sjellë plotësinë dhe bukurinë e zemrës fisnike islame. Njeriut mumin duhet qasur njerëzisht. Ai flet fjalë të mira, sepse ai

është urdhëri i All-llahut xh.sh. Në veprimet dhe sjelljet e muminit nuk guxon të ketë vrazhdësi dhe ashpërsi. Është e mrekullueshme e vërteta e lashtë: “Fjala e mirë e pushton botën!”

A nuk e sheh se si All-llahu sjell shembuj:

“A nuk ke kuptuar se si All-llahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart. E që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frutin e vet në çdo kohë. All-llahu, pra, u parashtron njerëzve shembuj ashtu që ata të mendojnë. Dhe shembulli i fjalës së keqe si një pemë e keqe që është shkukur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar.”

(Kur’ani, 14:24, 25, 26)

“E ti robërve të Mi thuaju le ta thonë atë që është më e mira, pse djalli ndërren mes tyre, e është e ditur se djalli është armik i hapët i njeriut.”

(Kur’ani, 17:53)

Hazreti Ajsha dëshmon se Resulull-llahu a.s, ka thënë: *“Vërtet All-llahu është i butë e i dashur dhe Ai e do mirësjelljen dhe butësinë. Me mirësjellje fitohet ajo që nuk mund të fitohet me vrazhdësi”.*

(Muslim).

Hazreti Aliu r.a. ka thënë:

*“Përpiqu fjalëmbël gjithmonë të jesh,
Ti i dashur për njerëz do të bëhesh.
Fjala e ëmbël miq fiton,
Të hidhurën, dije, as miku s’e do”.*

Në përmbledhjen e të urtit Sulejmanit a.s. është shkruar:

*“Fjalët e mira janë hoje mjalte,
Të ëmbla për shpirt e ilaç për eshtra”.*

Të diturit ka herë kanë thënë:

“Fjala e mirë edhe dyert e çelikta i hap”.

Butësia i shkatërron të gjitha pengesat dhe gjithmonë ngadhënjën. Brahma e pyeti forcën: “Kush është më e fortë se ti?” Forca u përgjigj: “Butësia”.

600 vjet para Isait a.s. Ezopi i urtë e shënoi këtë fabulë:

Një njeri ishte nisur në rrugë të gjatë. Era i tha Diellit:

- Hajde të lidhemi me kusht e cili prej nesh mund t’ia heqë kapelën nga koka, Dielli u pajtua. Dhe era filloi e para të frynte me fërfëllimë e fishkëllimë mbi kokën e udhëtarit, me qëllim që t’i hiqte kapelën. Mirëpo, sa më tepër tërbohej dhe ulërinte era, aq më fort udhëtari e shtrëngonte kapelën në kokë. Dhe, më në fund, era e lodhur hoqi dorë. I erdhi radha Diellit. Butë dhe ngadalë i shtoi rrezet e veta. Pa fuqi dhe pa imponim të forcës. Nxehtësia bëhej gjithnjë më e fortë e më e fortë. Udhëtari filloi të djersitej. Era ia uroi Diellit fitoren. Butësia ngadhënjeu mbi forcën”.

Është mençuri t’u ikësh kritikave të të afërmve, gjithnjë derisa të ketë mundësi. Shpitrat e njerëzve janë të ndjeshëm, prandaj ndaj njerëzve duhet pasur shumë kujdes. Më mirë lavdata të sinqerta, sesa qortim, nëse kjo në çfarëdo mënyre është e mundshme. Më mirë mësim dhe udhëzim i butë, sesa dënim. Te njeriu, me rastin e qortimit, reagojnë impulset e brendshme, që ftojnë për rezistencë. Prandaj, edhe nëse kritika është e domosdoshme, le të jetë e butë, e

miradijshme, me plot arsye. “Mos gjyko që të mos jesh i gjykuar” (Konfuçie).

“I përmbajtur në vërejtje, bujar në lavdërim të sinqertë” (Schwab). Vërejtja e sinqertë e gabimit është vepër islamike. Duhet ndihmuar të afërmit që ta evitojnë ndryshkun dhe ligësinë në zemrën e vet. Njeriu duhet nxitur kah e mira. Duhet trimëruar në heroizma për qëllime fisnike. Me nxitje të butë zbulohen vlerat e çmuara, të cilat gjenden në thellësinë e shpirtit të njeriut. A është kjo sa dy grushta ose vetëm sa një grusht, për parimin e përpjekjeve fisnike për fitoren e më të bukurës, nuk është aq qenësore. Më e rëndësishme është të duash fisnikërisht, dashuria lind dashurinë, urrejtja lind urrejtjen, kurse puna për qëllim të mirë jep të mirën.

Gjithmonë duhet t’i kemi parasysht fjalët e Resullull-llahut Muhammedit a.s.:

“E mira më e madhe, që mund ta bësh, është që, me ndihmën tënde, një njeri të udhëzohet në rrugë të drejtë. Kjo është për ty më e mirë dhe më e vlefshme sesa tërë bota dhe gjithçka që ka në të”.

Është shumë i rëndësishëm afrimi miqësor ndaj njeriut. Përshëndetja e përzemërt, shtrëngimi i fortë dhe i sinqertë i dorës, shprehin respekt dhe dëshirë për miqësi të ndërsjellë të mbështetur në njerëzinë.

All-llahu xh.sh. ka thënë:

“Kur përshëndeteni me ndonjë përshëndetje, ju ktheni përshëndetje edhe më të mirë, ose kthenie ashtu. All-llahu llogarit për çdo send.”

(Kur’ani, 4:86)

Buzëqeshja është stoli e fytyrës së njeriut. Nëpërmjet buzëqeshjes së sinqertë depërton dhe rrezaton shkëlqimi i shpirtit të ndershëm dhe fisnik. Kjo buzëqeshje nuk të kushton asgjë, ndërsa sjell gëzim dhe i afron zemrat e njerëzve. Ajo bart në vete duart e porosive më të mrekullueshme. Prandaj mumini i vërtetë nuk e kursen buzëqeshjen e sinqertë. Kjo është dhunti e All-llahut xh.sh. dhe është dëm i madh të mos shërbehesh me të në rrugë për të mirë ndër ne, rreth nesh dhe në zemrat e të afërmeve tanë.

Muhammedi a.s. ka thënë:

“Ta presësh vëllain tënd dhe ta ftosh në shtëpi është gëzim i zemrës, është shenjë e veprës së mirë”.

A thua nuk është i tmerrshëm shtrëngimi i flashkët, gjakftoftë dhe mospërfillës i dorës? A nuk është i tmerrshëm zëri i ftohtë? Si e vret ky qëndrim kontaktin e parë dhe e thyen lidhjen njerëzore!

Edhe zëri me të cilin njeriu i drejtohet njeriut le të jetë i gëzueshëm dhe i përzemërt! Zëri i këtillë është njësoj si shtrëngimi i dorës.

Njeriu i mençur dhe qëllimshëm nuk e harron kurrë këtë. Njerëzve duhet përmendur emrat e tyre të bukur. Me ta duhet t’i thërrasim. Edhe kjo është njëra nga mënyrat e krijimit dhe e forcimit të miqësisë. Kërkesat e njerëzve nganjëherë janë të vrazhda. Kur e shoh njeriun, i cili në mënyrë urdhëruese dhe të egër kërkon diç nga të afërmit e tij, mendimet më shkojnë te shpirti ashpër, që nuk di e ç’është njeriu. Përse nuk e lut mirë, nuk i drejtohen mirë, përse nuk e pyet njerëzisht?

Një psikolog pikërisht thotë se janë fjalë magjike: “Keni mirësinë...” “Nëse nuk ju vjen vështirë...”, “Ju

lutemi, nëse kjo për ju nuk paraqet ndonjë vështirësi...”, “E gjithë kjo është sjellje e mirë dhe është cilësi e njerëzve të edukuar, e njerëzve të mirë dhe e njerëzve të shquar shpirtërisht. Përse me zënka e grindje të ashpra, përse me llomotitje dhe zemërime, kur mund të arrihet më tepër me paqe e me dashuri? Me anë të kësaj rruge mund të arrihet më shpejt e vërteta, ndaj duhet mbështetur në të.

Njeriu me njeriun duhet të bisedojë, duhet ta nxisë që t’i shprehë ndjenjat e veta, mendimet dhe pikëpamjet e veta. Me këtë rast duhet respektuar bashkëbiseduesin dhe dëshirat e tij. Duhet bërë zemërgjerë. Kështu veprojnë njerëzit emirë dhe të mençur me frymëzim të fortë dhe me elli me fisnike. Ata kurrë nuk i ndërhyjnë tjetrit në fjalë, kurrë nuk e ndërprejnë bashkëbiseduesin. Ata dëshirojnë të dëgjojnë edhe mendime të ndryshme, që mund të ndryshojnë nga mendimi i tyre. E dinë fare mirë se mendimet e nduarnduarta janë thesar prej të cilit duhet nxjerrë të vërtetën e mirëfilltë e të përbashkët. Mjerisht, njerëzit në dis-kutime shpesh kalojnë në efekt. Tërbohen e shkumojnë njëri kundër tjetrit, duke i mbrojtur nganjëherë me këmbëngulje edhe pikëpamjet e veta të gabueshme. Ky është egoizëm që mban në vete vulën e shpirtit djallëzor. Nga bisedimet e këtilla, ku mbizotëron “uni” egoist, e jo dëshira për të vërtetën, nuk ka zgjidhje as rezultate. Madje edhe nëse bashkëbiseduesi gabon, nuk duhet të jesh i vrazhdë me të. Të vërtetën duhet shprehur butë dhe me kujdes. Atëherë ajo bëhet pasuri e përhershme e atyre që e dëgjojnë.

Psikologu i njohur amerikan Carnegie thotë: “Në konflikt mendimesh, shumë më me mend është t’i thuhet bashkëbiseduesit: -Ndoshta edhe unë po gaboj. Të përpiqemi t’i analizojmë faktet një nga një, në mënyrë që bashkarisht ta gjejmë të vërtetën”.

Dhe përnjëmend kjo do të jetë me siguri rrugë më e mirë për gjetjen e së vërtetës dhe pranimin e dyanshëm të saj sesa këmbëngulja e zjarhtë dhe efektive në “unin” e vet. Nganjëherë diskutuesit, duke mos respektuar bashkëbiseduesin, përpiqen ta nënçmojnë dhe ta përqeshin atë, bëjnë mëkat të madh dhe e tregojnë fytyrën e vet të vërtetë.

Fyerja dhe poshtërimi lindin rezistencë, armiqësi dhe urrejtje. Prandaj thuhet:

“Rrafshoni rrugën, në vend që ta bëni gropa-gropa”.

“Lehtësoni, e mos e vështirësoni. Mos frikësoni e mos tmerroni”.

(Hadith).

Sokrati qëmoti e ka njohur natyrën e shpirtit njerëzor, se si është ai i ndjeshëm dhe që nga krijimi i vet i butë e fisnik. Ka ditur se si duhet të jetë i kujdesshëm me bashkëbiseduesin. Është e njohur metoda e sjelljes së tij në dialog, kur, duke bërë pyetje, bashkë me bashkëbiseduesin e vet, nxirrte përfundime për të vërtetën.

Mirëpo, nganjëherë, kur e dimë se një diskutim nuk do të ketë fryt, më mirë është të mos diskutojmë fare. Atëherë është mençuri të heshtim. Me mend ka thënë Konfuçie: “Nëse mund të bisedohet me ndonjë njeri, e ne megjithatë nuk bisedojmë, atëherë e kemi humbur një njeri. Ndërsa, nëse me dikë nuk duhet të

bisedojmë, e ne megjithatë bisedojmë, atëherë i kemi harxhuar kot fjalët tona”.

All-llahu xh.sh. ka thënë:

“Thuaju (o i Dërguar): O ithtarë të librit (Teokrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë, që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri-tjetrin zotër pos All-llahut! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)”

(Kur’ani 3:64)

Parimi islam është t’i ftojme njerëzit në rrugë të mirë dhe t’u bëjmë mirë njerëzve e të gjitha qenieve të gjalla, t’u ndihmojmë dhe t’i bëjmë të lumtur të tjerët, t’u japim shpresë – kështu vepron mumini. Edhe nëse has në rezistencë, nuk duhet dorëzuar.

“Andaj (të keqen) ktheje në mënyrë më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt”

(Kur’ani, 41:34)

Besimtari doemos duhet të dëgjojë fjalët e All-llahut xh.sh. dhe të veprojë ashtu siç kërkon Ai.

Njëri nga 99 emrat e All-llahut xh.sh. është edhe Ai i Cili Do. Prandaj Islami, bashkë me paqen ndaj të gjithë njerëzve vullnetmirë dhe qëllimmirë, ofron edhe dashuri, të sinqertë, të plotë, të pastër.

“Pritet që All-llahu të verë miqësi ndërmjet jush dhe atyre që kishit armiqësi, All-llahu është i fuqishëm, All-llahu i fal mëkatet, është mëshirues.”

(Kur’ani, 60:7)

Enesi r.a. tregon se Resulull-llahu a.s. ka thënë:

“Asnjëri prej jush nuk do të jetë besimtar i vërtetë derisa nuk i dëshiron vëllait të vet atë, që i dëshiron edhe vetes”.

“Ju nuk do të keni iman të plotë derisa nuk duheni dhe nuk kujdeseni njëri për tjetrin”.

“Mos e urreni, mos e xhelozoni njëri-tjetrin dhe mosë ia ktheni shpinën njëri-tjetrit. Bëhuni vëllezër dhe krijesa të vërteta të All-llahut.”

Xhelaluddin Rumi shkruan:

“Medashuri, hidhërimi në ëmbëlsi shndërrohet,

Me dashuri nga bakri ar bëhet.

Me dashuri brenga kthehet në disponim

Me dashuri sëmundja kalon në shërim.

Buda rrëfente:

“Urrejtjen nuk mund ta përfundosh me urrejtje, por me dashuri”.

Dashuria është njëra ndër fjalët e bekuara që është e shkruar në flamurin islam. Me të fjala e vërtetë depërton në zemrat e njerëzve dhe i zgjeron gjithmonë njohuritë e reja dhe bukuritë e jetesës në këtë Tokë. Dhe njerëzit e mirë, me zemër mumini, gjithmonë sipas urdhërit të All-llahut xh.sh., çdo njeriu i qasen me butësi dhe me dashuri, çdo njeriu i drejtohen me fjalë të mira, të gëzueshme, të vërtetë.

Kjo do të zgjasë derisa agimi i së vërtetës të agojë në zemra, derisa paqja, e mira dhe dashuria të ngadhënjejnë në të gjitha anët e më gjerë. Për këtë kërkohet durim. Çdo zemër njerëzore ka të drejtë ta gëzojë

fjalën e mirë dhe njohjen e së vërtetës. Është e padrejtë t'i kufizohet kjo.

All-llahu i Mirë gëzohet për dashurinë ndërmjet njerëzve, gëzohet për fjalët e mira dhe për çdo dritë në shpirtin njerëzor.

Vetedukimi

Shtytës i rëndësishëm në ecje drejt përsosmërisë së shpirtit është vetedukimi. Këtë duhet zbatuar nëse dëshirojmë sukses të vërtetë. Këshilla për djaloshin dhe vajzën islame është: Duke iu përmbajtur në mënyrë korrekte rregullave islamike, çdo ditë duhet verifikuar ndërgjegjen e vet, sjelljen, fjalët dhe veprat. Atëherë duhet të jemi plotësisht të sinqertë ndaj vetes. Duhet t'i drejtohem vetvetes në mënyrë të qetë. Në këtë rrëfim të qetë është i pranishëm vetëm All-llahu xh.sh.

Mumini duhet shtruar pyetjen: a është dashuria e tij ndaj All-llahut xh.sh. e tillë, çfarë e kërkon Islami. A e ka ndjekur në mënyrë të mjaftueshme rrugën që i është treguar. A e ka bartur mjaft në zemër dhe a e ka vërtetuar me vepra porosinë themelore të Islamit. "Nuk ka Zot tjetër, përveç All-llahut". A i ka kryer obligimet, që janë urdhëruar nga Zoti i Dashur? A i ka nderuar prindërit e vet, vëllain, motrën, të afërmit dhe çdo njeri të mirë? A ka ditur të kërkojë falje për dhembjen e shkaktuar dhe fyerjen e bërë? A ka qëndruar larg nga ngatërresa dhe përgojimi? A ka qenë xheloz, a e ka fyer dikë? Duhet parë se a ka qenë i vyeshëm në punë gjatë mësimit? Apo mos e ka humbur kot kohën e çmuar, të cilën All-llahu xh.sh. ia ka falur, a ka qenë i virtytshëm? A e ka respektuar dinjitetin njerëzor? A i ka dhënë ndihmë atij, që ka pasur

nevojë për të? A i ka thirrur në vepra të mira dhe a i ka larguar nga e keqja. A thua...? A thua...?

Pyetjet këmbëngulëse e vërtetojnë dhe e pastrojnë ndërgjegjen. Kontrolli i veprimeve personale ofron rezultate më të mira të fuqisë dhe të vetëdijes për mundësitë dhe aftësitë tona të brendshme.

Është obligim të verifikohet, të rishqyrtohet ndërgjegjja vetjake. Është obligim gjithashtu që në të, të investohet një pjesë e kohës sonë.

Me gjithë zemër dhe me tërë shpirtin tonë duhet t'i qasemi kësaj pune serioze. Në shikim të parë, ky problem duket i vogël, i parëndësishëm, mirëpo, në të vërtetë, është i madh e me përmasa grandioze, është i rëndësishëm për çdo djalosh dhe për çdo vajzë, për shpirtin e tyre, për amshueshmërinë e tyre, për të mirën e të gjithë njerëzve. Është e sigurt se përpjekja jonë për përsosmëri na udhëzon në rrugë, që shpie kah personaliteti i njeriut të vërtetë.

Nëse në kopshtin e shpirtit të rinj ka baroja, nuk duhet të heqim dorë, të përkulemi ose të dorëzohemi.

Është e vërtetë e qartë se All-llahu xh.sh. i ndihmon ata, të cilët përpiqen të shkojnë rrugës së Tij, kurse ai që ngul këmbë të bëhet njeri i vërtetë, e ndjek këtë rrugë. Në këtë rrugë duhet të jemi të guximshëm dhe të qëndrueshëm. Fuqishëm dhe në mënyrë të çeliktë, duhet thënë: "Me ndihmën e All-llahut të madhërishtëm, unë dua t'i çrrënjosh nga zemra ime të gjitha barojat e së keqes, që shpirti im një ditë të bëhet i përsosur.

Në këtë punë duhet përmbajtur një sistemi të caktuar. Kjo punë dhe kjo luftë për fisnikërimin e vlerave shpirtërore fillon me spastrimin e mendimeve të jetës

nga të gjitha veset dhe të këqijat, nga të gjitha reflektimet e tyre, që janë shtresuar në shpirtin tonë. Çdo mendim të keq duhet ta largojmë që në nismën e tij. Pastaj duhet t'u shpallim luftë gabimeve themelore personale, të cilat bëhen me vetëdije të plotë, me vullnet të lirë edhe përkundër vërejtjeve të ndërgjegjes. Kur të mposhten këto, duhet ngadhënyer edhe më tutje! Në këtë luftë domosdo duhet të jemi këmbëngulës, madje, nëse ka nevojë, të përqëndrohemi edhe me muaj në një gabim. Duhet lutur All-llahun e Dashur për ndihmë, të luftojmë se edhe ndihma, nëse Zoti thotë, do të vijë. Pastaj, duhet filluar luftën kundër gabimeve të bëra në shpejtësi. E pas tyre, kundër gabimeve të vogla e më të vogla, kundër shkeljeve të vogla e të imëta. Duhet ta njohim mënyrën e analizës së të metave dhe të gabimeve personale. Duhet të mësohemi me luftën e pandërprerë kundër kuçedrës së të metave dhe ligësive tona çdo ditë duhet të bëjmë përtërirjen shpirtërore. Le të ngadhënjë çdo ditë Ligji i All-llahut në shpirtin tonë, le të ngadhënjë e mira, paqja dhe dashuria mbi gjambat e ligësisë. Vijimisht duhet të depërtojë thellë e më thellë në pjesët më të fshehta të shpirtit. Duhet gjurmuar edhe këndin më të vogël të tij. Në thellësitë më të largëta të shpirtit tonë, ku ende mbretëron errësira, duhet përhapur dritën e mirësisë. Duhet t'i zbulojmë me ngulm shkaqet e së keqes, e pastaj t'i çrrënjosisim nga themeli.

Kjo është rruga e drejtë që All-llahu xh.sh. e kërkon nga çdo njeri. Në ty, në mua, në çdo njeri zhvillohet luftë e madhe. Fuqitë e sëmirës dhe së keqes zhvillojnë luftë të pamëshirshme në shpirtrat tanë. Mumi-

ni, me besimin e vet, me obligimet islame dhe me vetedukimin, me pendimin e sinqertë, do ta sigurojë fitoren e vlerave më të bukura në qenien e vet.

Po flas edhe për pendimin, sepse pendimi është ndikim i fuqishëm që sjell mëshirën e All-llahut xh.sh dhe sukses në veprimet e mira. Ne jemi të gabueshëm dhe vetëm me pendim të sinqertë, duke iu drejtuar Krijuesit xh.sh., në përpjekje e punë, mund t'i evitojmë gabimet tona. Vetëm All-llahu xh.sh. është i pagabueshëm.

Në Kur'anin e Madhërishëm thuhet:

“O ju që keni besuar, pendohuni tek All-llahu me një pendim të sinqertë, në mënyrë që Zoti juaj t'i largojë prej jush të këqijat, t'ju shpie në xhennete, në të cilat rrjedhin lumenj...”

(Kur'ani, 66:8)

I Dërguari i All-llahut a.s. ka thënë:

“Të gjithë njerëzit janë mëkatarë, e mëkatarët më të mirë janë ata, që sinqerisht pendohen, i kthehen All-llahut xh.sh. dhe u shmangen mëkateve. Mëkati është fryt i veprës së djallit të mallkuar. Ai e hedh njeriun në fatkeqësi, e shpie në mallkim, e zhdok nderin, autoritetin dhe dinjitetin e tij. Mëkati krijon perde ndërmjet njeriut dhe All-llahut, e largon njeri nga mëshira dhe nga bekimi i All-llahut”.

Është e sigurt se pendimi i sinqertë dhe i thellë e zhdok mëkatin dhe sjell gëzim në zemrën e njeriut. Ne fitojmë impulse me fuqi të pakufishme që t'i mbizotërojmë të gjitha pengesat në rrugën e drejtë kah shpirti i ndritshëm.

Me hapjen e zemrës me drejtim të pendueshëm ndaj All-llahut xh.sh. njeriu i afrohet qëllimit më të shenjtë dhe

më të shtrenjtë. Është me rëndësi të dimë dhe mos të harrojmë kurrë se pendimi i sinqertë është pjesë e rëndësishme e vetedukimit. Dëgjo këtë ngjarje nga periudha e muslimanëve të parë në kohën e Muhammedit a.s.:

Ka'bi ibni Maliku dhe dy shokë të tjerë kishin munguar në ushtri. Nuk kishin bërë ballë ta linin rehatin nën hije dhe sigurinë e shtëpisë së vet. Kur u kthyen muslimanët nga ekspedita ushtarake. Resulull-llahu a.s. shpalli bojkot kundër atyre që kishin munguar. Ata u penduan dhe i luteshin All-llahut xh.sh. për falje të gabimeve të tmerrshme që kishin bërë. Në ushtimën e bojkotit mospërfillja dhe përbuzja e përgjithshme e heshtja e plotë krijuan një mur të padepërtushëm rreth të munguarve. Ata prisnin gjykimin e All-llahut.

Ja se si e përshkruan shkrimtari arab fundin e kësaj ngjarjeje: "Në agimin e ditës së pesëdhjetë prej kur Resulull-llahu ua kishte ndaluar njerëzve të flisnin me ta, Ka'bi filloi të falej në kulmin e shtëpisë së vet. Të gjitha mendimet e veta i kishte drejtuar kah All-llahu xh.sh. dhe falej. Pastaj priste para lindjes së Diellit, duke i ngritur duart në lutje. Lutej pendueshëm, me zemër të thyer, kurse lotët i rridhnin pandërprerë. Pastaj u ngrit, u përkul në ruku dhe përsëri lutej. Në gjendje të njëjtë ishin edhe dy të munguar të tjerë.

Dhe pikërisht kur Ka'bi ishte thelluar krejt në lutjen e pendimit të tij, nga maja e kodrës u dëgjua zëri: "Myzhde Ka'b-o!" Ka'bi përsëri ra në sexhde. Lajmi i gëzushëm sillte shpëtimin dhe zgjidhjen e sprovës. Lajmëtari shpejtonte me kalë drejt Ka'bit dhe dy të tjerëve që t'i njoftonte se Resulull-llahu a.s. herët në

agim i kishte lajmëruar muslimanët e All-llahu xh.sh. për të tretë kishte treguar mëshirën e Vet. Ka'b-i, në shenjë falënderimi, ia dhuroi lajmëtarit rrobat e veta dhe shpejtoi të shkonte në xhami. Muhammedi a.s. rrinte i rrethuar nga as'habët. Ai i tha Ka'b-it:

"Gëzohu mirë, sepse gëzim të këtillë nuk ke pasur prej se të ka lindur nëna".

A është prej teje, o Pejgamber i Zotit, apo prej All-llahut xh.sh.?" – pyeti Ka'b-i.

"Prej All-llaut".

- tha Muhammedi a.s.

Në shenjë falënderimi Ka'b-i hoqi dorë nga pjesa më e madhe e pasurisë së vet për nevoja të bashkësisë islame. Pendimi i Ka'b-it dhe pendimi i shokëve të tij qe plotësisht i sinqertë. Për këtë arsye All-llahu xh.sh. i dhuroi me faljen e Vet dhe i shpëtoi nga bojkoti, përbuzja dhe turpi. Që atëherë Ka'b-i dhe shokët u bënë edhe më të mirë dhe më besnikë të Islamit dhe të All-llahut xh.sh.

All-llahu xh.sh. ka thënë:

"O ju që besuat, kinie parasyshfrikën ndaj All-llahut dhe le të shikojë njeriu e çka ka bërë për nesër, dhe kinie frikë All-llahun, e s'ka dyshim se All-llahu është Ai që e di në detaje atë që punoni!"

(Kur'ani, 59-18)

Prandaj muslimanët gjithmonë përpiqen që shpirtrat e vet t'i bëjnë më të mirë, duke bërë verifikimin e imanit dhe ahlakut të vet. Kjo përpjekje ka filluar me njeriun e parë, me Ademin a.s., dhe vazhdon gjatë tërë historisë njerëzore. Edhe Muhamme-

di a.s. erdhi me këtë mendim. Shpesh e luste Allahun e Dashur xh.sh.:

“Të lutem, o Zot, të më mbrosh nga veset, punët e dëshirat e këqija dhe sëmundjet”.

Na la emanet ta vazhdojmë këtë vepër të madhe në luftë për mirëqenie dhe shpëtim të njeriut.

Ai fliste:

“I mençur është ai, i cili vetveten e merr në përgjegjësi (i qëron hesapet me vetveten), dhe i cili punon për jetën pas vdekjes, kurse i lig është ai, i cili udhëhiqet nga pasionet, e prapë shpreson dhe kërkon nga All-llahu xh.sh. që t’ia plotësojë dëshirat e ndryshme”.

“Xhiahadi më i mirë është lufta me vetveten”.

Lutej:

“O Zot, më bën nga ata, të cilët pendohen shumë dhe të cilët përpiqen të pastrohen”.

Pas kthimit prej një lufte, tha:

“U kthyem nga lufta, në të cilën fituam, por e cila qe shumë e vështirë dhe e mundimshme. Tani para nesh kemi një luftë edhe më të madhe – luftën kundër pasioneve personale”.

Ai tha edhe këtë:

“Lum ai njeri, të cilit i interesojnë të metat personale, ndaj, duke menduar për to, nuk ka kohë të mendojë për të metat e huaja”.

Hazreti Umeri r.a. kishte bërë zakon të thotë: “Qëroni hesapet me vetveten, para se të thirreni në ballafaqimin përfundimtar”.

“All-llahu xh.sh. e mëshiron secilin që na tërheq vërejtjen për veprat tona të këqija”.

Shpesh e luste mikun e vet Selmanin r.a. që t’ia tërhiqte vërejtjen dhe haptas t’ia tregonte gabimet.

Muslimanët e parë pranë Muhammedit a.s. u takuan si vëllezër dhe njëri-tjetrit i thoshin: “Vëllai im! Unë nuk mund t’i shoh të gjitha gabimet dhe të metat e mia, as nuk mund t’i dijë. Ma tërhiq vërejtjen për to dhe më largo nga e keqja”. Dhe ata, pa kurrfarë zemërimi ndërmjet vete, i pranonin kritikën vëllazërore dhe i përmirësonin gabimet e veta. E konsideronin mik të madh atë, i cili i ndihmonte në këtë rrugë.

Vërtet obligim islam është që njëri-tjetrin ta qortojmë dhe t’ia tërheqim vërejtjen. Ne do të duhej të jemi si muslimanët e parë, e jo kryelartë dhe egoistë. Lufta për fitimin e virtyteve mbi mëkatet dhe veset ndër ne duhet të jetë e pandërprerë, e përditshme deri në frymën e fundit të jetës sonë. Vlen të përpiqemi në këtë rrugë, sepse kjo është rruga e xhennetit, kurse dorëzimi është rruga për në xhehennem.

Kam lexuar: Tevbe bin es-Simme nga Raka e kishte bërë zakon që gjithmonë t’i jepte llogari vetvetes. Kur e bëri një ditë këtë i ra ndërmend se ishte bërë 60 vjeç. I llogariti ditët dhe konstatoi se këto ishin 21.900 ditë. Mori frymë thellë e tha: -Vaj halli për mua, a thua para All-llahut xh.sh. do të dal me kaq shumë mëkate, nëse çdo ditë kam bërë nga një mëkat. Mirëpo, unë për çdo ditë kam bërë nga 10.000 mëkate. Nga frika vdiq. Atëherë dikush tha: “Për mrekulli kërceu në xhennetin më të lartë”. Kjo u tha për arsye se ai që jep llogari para vetvetes për veprat e veta, pendohet dhe përmirësohet, prandaj është lehtë të japë llogari edhe para All-llahut xh.sh.

Hasan Basri rrëfente: “O njeri, nëse do të jesh i drejtë, atëherë mos i fsheh të metat e tua, por vazhdi-

misht i evito dhe kështu do të jesh më i dashur tek All-llahu xh.sh.”.

O njeri! Sa i dobët dhe sa i pakujdesshëm që je. Të tjerët i fajëson për mëkate, kurse mëkatet e tua i fsheh. I sheh të metat më të vogla të vëllait, e nuk i sheh të metat e tua edhe më të mëdha. Shumë pak je i drejtë, e shumë i padrejtë, o njeri!

Njeriu do të jetë në gjendje të mirë gjithmonë derisa të jetë urdhëruar i vetvetes, derisa mendimet t’i shndërrojë në vepra, derisa ta kujtojë All-llahun xh.sh. e pastaj ta rishqyrtojë vetveten, kurse Dita e Gjykimit do të jetë për të shqetësimi kryesor. Do të jetë në gjendje të keqe derisa të ngurrojë të bëjë mirë, derisa të veprojë sipas epsheve të trupit, derisa të jetë i pakujdesshëm dhe të përfundojë me dëshira të shkreta.

Shpesh i drejtohet zemrës, sepse zemrat ndryshken shpejt. Bëhuni të rreptë ndaj vetvetes, sepse njeriu është i dhënë pas së keqes, prandaj, nëse nuk i frenoni epsheet e trupit, ato do t’ju çojnë në katastrofën më të madhe”.

Vetëkritikën duhet nxitur dhe inkurajuar. Ky është obligim i të gjithë qëllimtarëve. Ky është akt fisnik. Në vetvete gjithashtu duhet zgjuar ndjenjat, sepse të afërmit tanë presin prej nesh rezultate në vetëkontrollin dhe vetëkritikën tonë. Kjo është metodë e shkëlqyeshme në rrugën e suksesit. Është konstatuar se shpresa e prindërve, e edukuesve dhe e të afërmeve tanë ndikon pozitivisht në pjesëmarrësit e vetëkontrollit dhe të vetëkritikës. Nxitjet me fjalë të mira dhe me gjeste fisnike vetëm mund ta rrisin vlerën e rezultatit. Nëpërmjet një rruge të këtillë “uni” pozitiv i njeriut të ri e shton vlerën e vet. Në këtë detyrë njerëzit e rinj

duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin. All-llahu xh.sh. e do bashkëpunimin e këtillë. Në të gjitha këto përpjekje dhe impulse duhet të jetë gjithnjë i pranishëm mendimi dhe nohuria se i tërë ky mund është në rrugën e All-llahut xh.sh. Ky është impulsi më i fortë me përmasa të pakufishme të mirësisë.

Kam lexuar: një herë h.Umeri u ndal në arë, dhe kështu kaloi koha e namazit të ikindisë me xhemat. Vetveten e dënoi për këtë lëshim dhe tha: "Kjo arë le të jetë vakëf për të varfërit".

Paska ndodhur një herë që Temim ed-Dari paska fjetur gjatë kohës së ibadetit të natës (tehexhudit). Për këtë shkak e dënoi veten dhe gjatë tërë vitit nuk fjeti natën. Duhet të mësojmë nga njerëzit e mençur dhe të mirë se si bëhet njeriu i përkryer. Nëse ka nevojë, edhe duhet dënuar për kundërvajtje, por duhet qenë i butë dhe i arsyeshëm në dënim. Qëllimi i dënimit është që njeriu të bëhet më i mirë, e jo që t'i bëhet keq. Dënimi duhet të jetë njëra nga metodat edukative,.

Në tregimin "Ati Sergej" Leon Tolstoj shkruante se si murgu Sergej, që ta mbyste epshin e vet, në një rast e preu me sëpatë gishtin e dorës së vet.

Herën e dytë, kur iu nënshtrua epshit dhe e shkeli betimin e murgërisë, e dënoi vetveten duke e braktisur shpellën e vet të murgërisë dhe doli të lypte si lypës anëmbanë hapësirave të gjera të Rusisë dhe të jetonte i përbuzur dhe i poshtëruar.

Islami nuk kërkon kesi dënim. Islami kërkon besim dhe mirëkuptim për çdo gjë. Heroi, i bindur dhe i vetëdijshëm, është i nevojshëm në luftë kundër mëkateve të zemrës dhe rreth zemrës. E mumini duhet të

jetë i këtillë. Në luftën praktike kundër së keqes, krahas vetëkontrollit, do të mund të shërbente në mënyrë të dobishme tabela e kontrollit të vetedukimit. Në të janë paraqitur rubrikat, të cilat analizohen për çdo mbrëmje dhe pastaj jepet nota e sukseseve të arritura në luftë kundër gjërave tona negative notat janë prej 1 deri në 5. Në fund të muajit bëhet kontrolli i përgjithshëm i vetedukimit. Rubrikat bëhen sipas zgjedhjes së lirë të bazuar në synimet dhe në qëllimet personale.

Pas disa muajsh me radhë të verifikimit dhe të rishqyrtimit të sinertë të veprimeve personale, njeriu me anë të tabelës, në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar mund ta shikojë rrugën e kaluar në përpjekjet e veta qëllimmira.

Në shtojcë është paraqitur tabela që orientimisht tregon se si është dashur të veprohet në momentin e caktuar.

Në luftën për fitore nëpërmjet vetedukimit dhe vetëkontrollit, me rëndësi është të njihen trajtat e saj. Kjo e lehtëson avancimin e mirë. Kështu, në vetëkontroll paraqiten dy synime themelore, të cilat manifestohen si vetëkontroll i jashtëm dhe i brendshëm.

Vetëkontrolli i jashtëm shfaqet te personat, të cilët orientohen më tepër kah fati dhe rezultati i rastësishëm pa mund dhe pa përpjekje. Personat, që synojnë vetëkontroll kësisoji, përpiqen që për moseset e veta gjithnjë t'i fajësojnë të tjerët ose rrethanat e tjera, e kurrnjëherë veten, fajtorin e vërtetë. Ky është qëndrim i pasinqertë ndaj vetvetes, në mënyrë të vetëdijshe ose të pavetëdijshe, por në çdo rast i dëmshëm.

Shembull i vetëkontrollit të jashtëm: dikush që dëshiron ta lërë duhanin përpiqet që të mos e shohë cigaren ose të mos e ndiejë erën e tij. Po kështu, dikush që dëshiron të dobësohet e braktis ushqimin e mirë. Ky është mekanizmi mbrojtës kundër pasioneve tërheqëse. Ai nuk ka fuqi që të ballafaqohet drejtpërdrejt me provokimin.

Vetëkontrolli i brendshëm shfaqet te personat që e kanë të theksuar fuqinë shpirtërore, aftësinë dhe dëshirën për mund dhe përpjekje kundër veseve dhe pasioneve negative. Njeriu me qëndrim të këtillë, me ballafaqimin provokativ të cigares ose të ushqimit të mirë, u qaset problemeve në mënyrë thelbësore. Ai në vete merr vendim të fortë se nuk do të dorëzohet as para njërës as para tjetrës sprovë, pa marrë parasysh se këto provokime qëndronin drejtpërdrejt para tij. Njohuria e tij për dëmin e njërës dhe tjetrës, dhe vetëdija për përdorimin e veprimeve të këtilla, është forca me të cilën ai ngadhënjën.

Vetëkontrolli i brendshëm është ajo forcë e mirëfilltë, e cila futet në thelbin e ngjarjeve të shpirtit të njeriut për dallim nga vetëkontrolli i jashtëm, që synon vetëm efektet e jashtme. Përpjekjet tona dhe përpjekjet e atyre, të cilët bashkë me ne, marrin pjesë në edukim, do të duhej ta zhvillonin dhe ta intensifikonin frymën e vetëkontrollit të brendshëm. Kjo është rruga drejt suksesit.

Rinia kalon

Të gjithë ne jemi dëshmitarë të rrjedhës së kohës. Presim dhe përcjellim një rën pas tjetrës: pranverat, verat, vjeshtat, dimrat, vitet. Ecja e kohës është e pandalshme nëpër fërkimet e shtigjeve të veta, në të cilat nuk ka ndryshime. Jemi dëshmitarë të ngjarjeve, në të cilat koha del fituese.

Në pranverë këndellet çdo gjë, gjallërohet jeta. Zgjohet natyra, përtërihet gjelbërimi, lulet, behari, kundërmojnë erëra të këndshme, dëgjohet gumëzhima dhe zukama e bletëve, cicërima e zogjve. Ndërkaq, në vjeshtë gjithçka shuhet, zbehet e qetësohet, pason gjumi ndaj gjithçka bie në prehje dhe në pushim.

Nga viti në vit, me kalimin e kohës, rrotull motive, lind dhe vdes jeta në natyrë. Në mënyrë të pandalshme, fuqishëm e rrufeshëm sa që edhe shkëmbinjtë dërrmohen, zhduken, kështu vijimisht e pandërprerë zhduken dhe vdesin të gjitha botët në gjithësi. Edhe ne njerëzit perëndojmë. Askush, përveç All-llahut xh.sh., nuk mund ta pengojë ose ta ndalojë marrshimin tonë drejt fundit të jetës.

Varret, qytetet e rrënuara, qytetërimet e zhdukura në heshtje dëshmojnë se çka ka ndodhur në shekujt dhe në mileniumet e kaluara. Ato gjithashtu janë edhe lajmëtarët e zhdukjes sonë të ardhshme.

“Çdo gjë që është në të (në tokë) është e zhdukur (kalimtare). E do të mbetet vetëm Zoti yt që është i ma-

dhëruar e nderuar! E, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"

(Kur'ani, 55:26-28)

*"Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!
E kur të çahet qielli. Dhe kur të shkapërderdhen yjet. Dhe
kur të përzihen detet. Dhe kur të trazohen varret. Atëbotë
secili njeri e di e çka ka punuar dhe çka ka lënë prapa!*

(Kur'ani, 82:1-5)

Vëllai im, motra ime! Dije mirë se një ditë njeriu do të zhduket nga faqja e dheut. Dhe pas saj do të qëndrojë, para Krijuesit të vet, All-llahu xh.sh. Gjithçka rreth nesh flet për vdekjen, si një e vërtetë e pashmangshme. Vdekjen e shohim çdo ditë, dëgjojmë çdo ditë për të. Gjithkund rreth nesh njerëzit vdesin. Kam lexuar në një epitaf të vjetër:

"Ai, All-llahu është Krijues i amshueshëm!

O vizitues i varrit tim,

mendo për gjendjen time.

Unë dje kam qenë, siç je ti sot,

kurse nesër, ti do të jesh si unë sot".

Në një epitaf tjetër lesova:

"Nga valët e fatit askush nuk mund të shpëtojë,

Sepse secili domosdo do ta pijë gotën e vdekjes

dhe në amshim do të shkojë".

All-llahu xh.sh. ka thënë:

*"Çdo krijesë do ta shijojë vdekjen, e Ne, në shenjë sprove
ju sprovovjmë me vështirësi e kënaqësi, dhe ju ktheheni te Ne."*

(Kur'ani, 21:35)

“Agonia e vdekjes i vjen me atë të vërtetën (zbulohet çështja e ahiretit); kjo është ajo prej së cilës ke ikur.”
(Kur’ani, 50:19)

“S’ka dyshim se Ne japim jetën dhe vdekjen dhe vetëm te Ne është kthimi.”
(Kur’an, 50:43)

Njeriu është bërë nga dheu dhe përsëri do të bëhet dhe.* Ja një ngjarje e vërtetë si mësim i vlefshëm i jetës. Në një betejë, para disa qindra vjetësh, tre ushtarë, të plagosur rëndë, fshihen nga armiku në bodrumin e kështjellës së tyre. Armiku fitoi, kurse ata, të struktur në bodrum, por të mbuluar nga rrënojat, vdiqën. I mbuloi harresa e kohës. Në fillim të këtij shekulli, gjatë gërmimeve arkeologjike, në atë bodrum u gjetën tre skelete. Dy ishin në këmbë të mbështetur për muri, kurse i treti në pozitë të shtrirë. Vetëm kaq kishte mbetur nga këta tre ushtarë. Dikur nejrëz plot gjallëri e shpresa, plot forcë, tani ishin shndërruar në pluhur.

Sikur njerëzit të mendonin më tepër për vdekjen dhe takimin e afërt me të! Sikur të mendonin se një ditë duhet të vdesin patjetër! E mjerisht shumica dërrmuese nuk mendojnë. Ikin nga mendimet, që i shqetësojnë. Sikur duan t’i mbyllin sytë para së vërtetës dhe para fakteve, që janë aty pranë nesh dhe gjithkund rreth nesh.

* khs. me anekdotën shqiptare: - Puna e mirë o dhe, që po rrotullon dhe! Marë paç o dhe e i pari i dheut. – kështu iu përgjigj lavërtari plak pashës dhe sejmënëve të tij. Sepse, edhe pasha ishte nga dheu, e edhe do të bëhej, por ai ishte i pari i dheut – ishte sundimtar i vendit.

O njeri i ri! Tash në ty gufon jeta pranverore, mirëpo duhet ditur se pas pranverës sigurisht vjen vera dhe vjeshta. Në vjeshtë gjethet vdesin dhe bien për dhje. Kurse në vjeshtën e jetës sonë vdesim ne, njerëzit. Ky fakt duhet ta përshkojë edhe qenien njerëzore gjithnjë derisa të mos depërtojë në atomin më të vogël të jetës. Me mendimet për jetën e shkurtër dhe për vdekjen e sigurt, duhet ecur nëpër jetë. Këtë e kërkon besimi, por këtë e kërkon edhe arsyeja.

Me këto njohuri duhet t'i nxisim përpjekjet tona për jetë më serioze dhe më frymëzuese, që me këto synime të mëdha dhe fisnike të përgatitemi për ditën më të madhe të çdo njeriu në jetë – ditën e ballafaqimit me All-llahun e Dashur xh.sh. E për këtë takim në ditën përfundimtare të gjyqit duhet filluar menjëherë që në fillim të jetës, në rininë më të hershme, e cila do të vazhdojë deri në vdekje.

Një ditë, kur të vijë çasti i vdekjes, njeriu i veprave të mira do të qëndrojë i qetë para Krijuesit xh.sh. të vet. Qëndron i qetë, sepse ka jetuar një jetë të frytshme dhe të dobishme, shpirti i tij do të shndrisë si ylli më i bukur dhe më i ndritshëm, kështu që edhe ai vetë do të pyesë: "O Zoti im, a thua kështu po shndrit shpirti im, a thua kj odritë është shkëlqim i jetës sime të kaluar? Para tij do të çelen dyert e xhennetit dhe do të dëgjojë fjalët e engjëllit: "Paqe dhe Shpëtim!".

Për bukurinë e këtij momenti, për takimin e mrekullueshëm me All-llahun e Madh, vërtt vlen të jeto het jeta e ndershme dhe fisnike.

Rinia është koha më e bukur e jetës. Ajo është periudha e energjisë, e fuqisë, e ëndrrave, e rezistencës

dhe e përpjekjeve. Njerëzit e rinj me qëllime fisnike dhe me vepra të mira do ta stolisin atë periudhë shumë të bukur të lulëzuar e të shkëlqyshme të jetës së tyre. Ata nuk lejojnë që ajo të kalojë kot. Mirëpo, rinia, ashtu si edhe tërë jeta, kalon shpejt. Kur arrin pleqëria, ankimet dhe vajtimet janë të kota.

Njeriu, që ta arrijë shkallën më të lartë shpirtërore deri në vjeshtën e jetës së vet, duhet të veprojë që nga pranvera e hershme e rinisë së tij.

Në urtitë e lashta thuhet: “Mbjell që të mund të korrësh”.

“Puno në rini që të gëzosh në pleqëri frytet e punës sate!”.

E pyesin një plak nëntëdhjetëvjeçar se si i ka kaluar jeta. Ja se ç’tha: “Sikur të kisha hyrë për një derë e të kisha dalë për tjetrën. Krejt kjo ishte sa çel e mshel sytë”.

Për të dhënë ara fryt në vjeshtë duhet të punohet e të mbillet në pranverë. Në bregdet është një bimë, e cila lulëzon vetëm krye çdo njëqind vjetëve. Gjatë tërë një shekulli, ajo përgatitet për këtë akt të madh – për lulëzim. Këto janë lule të mrekullueshme para bukuri-së së të cilave njeriu mbetet i magjepsur. Njëqind vjet në fshehtësi të madhe, me Vullnetin e Zotit, ajo përgatit dhuratë të mrekullueshme për njerëzit.

Sa mirë do të ishte sikur të gjithë njerëzit e rinj të ishin si kjo bimë dhe gjatë tërë jetës të punonin mirë, ndershëm, fisnikërisht që në fund të jetës së vet ta dhuronin frytin e përpjekjeve të veta – lulen shumë të bukur, shpirtin e pastër e të ndritshëm. Në këtë dhuratë duhet besuar, duhet dashur, duhet përpjekur.

Përmend shpesh fjalët e All-llahut drejtuar të gjithë njerëzve:

“Dhe thuaj: Veproni, All-llahu do të shohë veprën tuaj, edhe i Dërguari i Tij e besimtarët, e më vonë do të ktheheni te njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes, e do t’ju njoftojë për atë që vepruat!”

(Kur’ani, 9:105)

Mbi baltën dhe brrakën e ligësive, duhet ndërtuar ura të parrënushme dhe të sigurta të së mirës, që të fitojë gjithçka është e ndershme dhe e drejtë. Në këtë fitore, zemra e njeriut pasurohet me dritë ashtu siç pasurohet toka me rreze dielli gjatë kohës së qiellit të kthjellët.

Në rrugën e ndershme drejt përsosmërisë shpirtërore nuk guxon të ketë lodhje e ngecje. Gjithmonë duhet synuar lart e më lart, gjithnjë deri në kufijtë më të lartë, që i ka caktuar All-llahu xh.sh.

Është thënë me mend: “Të jesh gjithmonë i pakënaqur me atë që ke arritur, sepse aty ku do të jesh i kënaqur, aty do të mbetesh” (F.Quarles).

Është e ditur se: Pas mundit, pason shpërblimi i madh.

Prandaj këshilla e drejtuar njeriut të ri me vullnet të mirë dhe dëshira të mira është:

- Mos u bëj ditë pranvere pa shkëlqim diellor!
- Mos u bëj lumë malor pa pika margaritari dhe pa rrjedhë të kthjellët!
- Mos u bëj rini pa ideale më të bukura, pa synime të mrekullueshme, pa përpjekje që të arrish përsosmërinë e shpirtit tënd!

Tani, në fund të këtij mësimi modest për rrugën e vërtetë, që shpie kah lumturia absolute, paqja dhe shpëtimi në të dy botët, do të dëshiroj të pyes: A thua do të mendosh për përpjekjet fisnike të njerëzve të mirë? A thua do të mendosh për qëllimin më të lartë njerëzor? Apo ndoshta në zemrën tënde ka filluar të piqet vendimi që t'i përsosësh tiparet fisnike dhe ta arrish përsosmërinë e shpirtit tënd? Sikur ta dish vetëm se sa do të gëzoheshin engjëjt për vendimin tënd të mirë, bilbili me këngën e vet, lulja e pranverës në lulëzimin e saj të gëzueshëm, madje edhe përrocka malore me gurgullimën e vet të gëzueshme.

Me këtë vendim, në rrugën më të bukur, të pret shpërblimi më i madh: mëshira e All-llahut xh.sh. dhe shpëtimi nga të këqijat e xhehennemit. Të jesh i sigurt: për këtë shpërblim të mrekullueshëm vlen edhe të jetohet.

“Atyre që patën frikë nga All-llahu, u thuhet: Ç’është ajo që shpalli Zoti juaj? Ata do të thonë: Shpalli çdo të mirë? Ata që bënë vepra të mira, edhe në këtë jetë kanë shpërblim të mirë, por shpërblimi i tyre në botën tjetër është shumë më i mirë, e sa vend i mirë është ai i të devotshmëve. Është xhenneti i Adn-it, ku do të hyjnë, në të rrjedhin lumenj, aty kanë çka të dëshirojnë, ashtu i shpërblen All-llahu të ruajturit, të cilëve, duke qenë të pastër, engjëjt ua marrin shpirtin, duke u thënë: Selamunn alejkum – gjetët shpëtimin, hyni në xhennet, për hir të asaj që vepruat.”

(Kur’ani, 16:30-32)

Për të ecur në rrugë të drejtë, për ta arritur shpërblimin më të lartë, për paqe dhe lumturi shpirtërore,

duhet lutur All-llahun xh.sh. prandaj le të jenë të për-
hershme fjalët e zemrave tona:

*E lus All-llahun të më mbrojë nga shejtani i mallkuar,
Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!*

*“Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botëve!
Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit! Sunduesit në
Ditën e Gjykimit! Vetëm dy të adhurojmë dhe vetëm te Ti
kërkojmë ndihmë! Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën
e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre që kun-
dër vetes tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën
veten!*

(Kur'an, El-Fatiha)



Copyright©Logos-A, 2008

www.logos-a.com.mk



*E lus All-llahun të më mbrojë nga shejtani i mallkuar,
Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!
Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të botëve!
Bamirësit të përgjithshëm, Mëshirëbërësit! Sunduesit në
Ditën e Gjykimit! Vetëm dy të adhurojmë dhe vetëm te Ti
kërkojmë ndihmë! Udhëzoni në rrugën e drejtë! Në
rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të
atyre që kundër vetes tërhoqën hidhërimin, e as në të
atyre që e humbën veten!*

Në çdo njeri është mbjellë thellë përpjekje për realizimin e vlerave gjithënjëzore. Islami, për t'i realizuar këto synime njerëzore, në mënyrë të natyrshme dëshmoi rrugën e qartë drejtë arritjes së virtyteve më të bukura, duke ndriçuar qëllimin që gjendet në krye të kësaj rruge – përsosmërinë e shpirtit.

Dhuratë për përsosmërinë e shpirtit është paqja dhe lumturia absolute në të dy botët. Për të arritur sukses në këtë rrugë të shenjtë – kërkohet besim, dashuri, vullnet dhe përpjekje.

Shumë njerëz ndalen, devijojnë, kurse të lodhurit heqin dorë që në fillim, mirëpo shumë prej tyre ecin me guxim drejt qëllimit të tyre.

Në faqet vijuese do të flitet për rrugën e mundimshme të shpirtit njerëzorë nëpër kopshtet e virtyteve dhe moralet e veseve njerëzore në rrugën për qëllimin më të lartë – përsosmërinë e shpirtit.

Këto janë nxitje modeste për njerëzit e rinj e të fuqishëm dhe për njerëzit e lodhur që të qëndrojnë në rrugë të mbarë dhe që virtytet e tyre të lindura t'i ngrenë në vlera të larta, ashtu që dashuria, mëshira, bujaria dhe virtytet e shumta të tyre, me ngrohtësinë e shpirtit të vet njerëzor, të shndrisin si rreze dielli. Është e njohur e vërteta: etja e njeriut për virtyte është e pashuar, e për njerëzit vullnetmirë e qëllimmirë këto virtyte kurrë nuk janë të mjaftueshme.

